



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 20 DHJETOR 2011

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE 20.
DECEMBRA 2011. GODINE

Dhjetor – Decembar
2011

E marte, më 20. 12. 2011

Drejton seancën: Kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
Kabinet qeveritar,

I hapi punimet e mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Në mbledhje janë të pranishëm 73 deputetë, që do të thotë se mund t'ia fillojmë punës.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Koha për diskutime jashtë rendit të ditës është e kufizuar deri në 30 minuta.
Diskutimet në emër të grupeve parlamentare - 5 minuta, në emër të deputetit - 3 minuta.
Deputetët e paraqitur për diskutim duhet të deklarohen se në çfarë cilësie e marrin fjalën.
Fillojmë.

Në emër të Grupit parlamentar Lëvizja “Vetëvendosje”, Rexhep Selimi e ka fjalën.

REXHEP SELIMI: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Zotërinj deputetë,

Përderisa në veriun e Kosovës vendasit shqiptarë në fshatrat e tyre në komunën e Leposaviqit janë të izoluar nga pjesa tjetër e Kosovës dhe të kërcënuar nga Serbia, në jug të vendit, në komunën e Shtërpçës po ashtu po vazhdon padrejtësia ndaj shqiptarëve nga ana e institucioneve qeverisëse lokale në bashkëpunim me institucionet paralele ilegale serbe që funksionojnë si kudo ku jetojnë serbët nëpër Kosovë. Në kuvendin e komunës, e cila ka 19 këshilltar komunal, ku 9 prej tyre janë serbë dhe 10 shqiptarë, në vargun e shumë vendimeve në dëm të shqiptarëve, është marrë një vendim në kundërshtim me vullnetin e qytetarëve shqiptarë të asaj zone për deponimin e mbeturinave në hapësirat e fshatrave Viçe, Kashtanjevë dhe Izhancë.

Ky vendim ka pasuar pasi që po ashtu ishte edhe iniciativë e strukturave paralele ilegale serbe në këtë komunë. Me gjithë kundërshtimet e banorëve në zonën e të cilëve është ngritur deponia e mbeturinave, vendimi është marrë me 13 vota pro, që nënkupton që po vazhdon bashkëpunimi i pushtetarëve në dëm të interesave të qytetarëve shqiptarë kudo nëpër Kosovë.

Lëvizja “Vetëvendosje” në Shtërpçë ka organizuar një peticion që ka pasur një efekt të jashtëzakonshëm për ndaljen e ndërtimit të kësaj deponie. Mirëpo, shumica e banorëve të fshatrave shqiptare për ndërtimin e kësaj deponie të mbeturinave janë informuar nga ky peticion. Kjo tregon se pushteti lokal dhe të zgjedhurit e tyre - këshilltarët komunal shqiptarë, nuk kanë bërë debat të hapur paraprakisht me qytetarët për këtë gjë. Kjo ngjarje është pasqyruar edhe në shtyp qysh në korrik, përkatësisht në tetor të këtij viti nga ana e të përditshmes “Kosha Ditore”, me tituj si vijon, citoj: “Strukturat paralele

synojnë ndërtimin e një deponie mbeturinash në "Lugjet e Viçes" dhe titulli tjetër: "Lugjet e Viçes, vend i përbashkët i organeve legjitime dhe strukturave paralele për deponi mbeturinash".

Këta dy tituj do të duhej të kishin dhënë alarmin për institucionet qendrore se çfarë po ndodhë me këtë problem në komunën e Shtërpçës. Mirëpo, as peticioni i qytetarëve, as kundërshtimi i tyre dhe as ngritja e këtij problemi në media, nuk e ka ndaluar komunën e Shtërpçës dhe këshilltarët e saj të SLS-së dhe PDK-së që të mos i kthejnë fshatrat shqiptare në deponi të bërlllokut që vjen nga Shtërpca.

Në të njëjtën kohë, me gjithë problemin që ka të bëjë me mbeturinat, po ashtu një problem tjetër i ngjashëm po vazhdon të jetë shqetësim për qytetarët shqiptarë të kësaj komune.

Flamuri i Serbisë po vazhdon të jetë i ngritur në institucionet e komunës. Në objektin komunal të komunës së Shtërpçës, tash e dhjetë vite valon zyrtarisht flamuri i Serbisë dhe në të njëjtin objekt të gjitha shkrimet dhe mbishkrimet janë të shkruara vetëm në gjuhën serbe në alfabetin cirilik. E në ndërkohë, përballë objekteve të komunës bashkëjeton me te edhe objekti i strukturave ilegale serbe, ku flamujt e njëjtë përballë tjetrit, njëri në objektin komunal dhe tjetri në objektin e strukturave ilegale serbe.

Në të shumtën e rasteve, marrja e vendimeve bëhet në anën tjetër të rrugës nga strukturat ilegale për të zyrtarizuar dhe zbatuar në komunën e Shtërpçës dhe nga kryetari i saj. Të gjitha këto probleme dhe të tjera, do të duhej që menjëherë ta shqetësojnë Qeverinë e pashqetësuar për këso gjërash dhe të reagojnë në mbrojtje të interesave të qytetare pa dallime etnie, në vend se të vazhdonte ta diskriminojë përherë shumicën shqiptare dhe minoritetet tjera joserbe në Kosovë.

Shqiptarët atje presin reagimin e menjëhershëm të institucioneve përkatëse shtetërore në mbrojtje të interesave të tyre, para se ata të reagojnë vet kundër padrejtësive të vazhdueshme ndaj tyre. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, fjalën e ka Burim Ramadani.

BURIM RAMADANI: Ju faleminderit, kryetar!

Të nderuara deputete,

Të nderuar deputetë,

Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës është seriozisht e shqetësuar me nivelin e lartë dhe tejet dëmtes të shpërndarjes dhe përdorimit të drogave tek nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme të Kosovës.

Statistikat e fundit të këtyre ditëve tregojnë për një nivel tejet të lartë të përdorimit të drogave nga nxënësit e shkollave e që janë fëmijët tanë për të cilët ne së bashku duhet të angazhohemi që t'iu mundësojmë një jetë më tumirë dhe, tek e fundit, ky është misioni ynë i përbashkët.

Thënë më shkurt, sipas statistikave të tashme mbi 20% e nxënësve të shkollave të mesme përdorin lloje të ndryshme të drogave dhe kjo i bie që çdo i pesti nxënës i shkollës së mesme përdorë një lloj të caktuar të drogave. Mosha e fillimit të përdorimit të drogave ka rënë dhe tash prek moshën edhe 12 vjeçare, përkatësisht klasën VIII të shkollës fillore. Derisa marihuana shpërndahet në shumicën e lokaleve përreth shkollave fillore dhe të mesme, nxënësit përjashtohen nga shkollat për shkak se bëjnë mungesa të mëdha në orë të mësimi e jo për shkak të përdorimit të drogave, pra për shkak të pasojës dhe jo për shkak të shkakut. Mësimdhënësit nuk janë të trajtuar dhe trajnuar mirë për çështjen e drogave, prandaj nuk mund të kujdesen në mënyrën më të mirë për nxënësit, ndërsa në shkolla mungojnë psikologët.

Më shumë se 14 persona, sipas statistikave të fundit, të moshave të ndryshme kanë vdekur vetëm gjatë këtij viti për shkak të përdorimit të drogave dhe ku është Qeveria e Kosovës, çfarë duhet të bëjë ajo? E themi tepër qartë: asnjëherë gjatë këtij viti nuk është ngritur kjo çështje në mbledhjet e Qeverisë të Kosovës, e mos të flasim për veprime konkrete.

Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës bën thirrje që në vitin 2012, Qeveria të ketë kujdes tepër të veçantë për mbrojtjen e të rinjve të Kosovës. Dhe, çka duhet bërë? Ne e dimë që ekziston një strategji kombëtare e Republikës së Kosovës kundër drogave 2009 – 2012, por me përgjegjësi të plotë po ju themi se ajo strategji nuk është realizuar dhe arsyeja kryesore është kjo: mungesa e bashkëpunimit dhe e koordinimit ndër sektorial brenda Qeverisë së Kosovës dhe sidomos në trekëndëshin: Ministri e Punëve të Brendshme, Ministri e Shëndetësisë dhe Ministri e Arsimit. Prandaj, strategjia nuk është funksionale.

I nderuari kryetar,

Qëllimi i kësaj paraqitjeje sot të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës është që të ofrojmë idetë dhe propozimet tona, planin dhe projektin tonë për të luftuar shpërndarjen dhe përdorimin e drogave tek nxënësit dhe për këtë kemi një numër rekomandimesh:

1. Të themelohet Komisioni shtetëror kundër kultivimit, shpërndarjes dhe përdorimit të bimëve narkotike dhe ky Komision të mos udhëhiqet nga ministri i Punëve të Brendshme, por nga kryeministri.

Shumë të rralla janë rastet kur MPB-ja udhëheq komisione të tilla dhe këto dalin të suksesshme.

2. Të fillojë menjëherë në janar të vitit 2012, draftimi i strategjisë së re.

3. Qeveria të investojë në hulumtime mbi të cilat do të duhet të ndërtohen veprimet, strategjitë dhe politikat efektive.

4. Qeveria të bashkëpunojë ngushtë me shoqërinë civile dhe organizatat e profesionalizuara në këtë fushë. Shembull konkret është OJQ “Labirnth” që po bën

punë të shkëlqyeshme në edukimin dhe trajtimin e rasteve të tilla dhe Qeveria duhet të punojë ngushtë me këtë dhe me OJQ-të tjera për ta ndihmuar atë në kapacitete financiare dhe humane,

5. Duhet të organizohet trajnimi i mësimdhënësve në tërë Kosovën për fushën e drogave, ndërsa në shkolla duhet të ketë në mënyrë obligative nga një psikolog,

6. Të ndërtohet Qendra ose Instituti kombëtar për trajtimin e sëmundjeve dhe të varshmërisë dhe kjo të ndodhë gjatë vitit 2012,

7. Duhet të ndërmerret një fushatë senzibizuese për nxënësit, për rreziqet e drogës dhe pasojat që ajo lenë në mentalitet dhe në edukimin e brezave.

Ne, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, besojmë se ky objektivi është i arritshëm dhe me këto veprime ne nuk lëmë që droga të shtrijë edhe më shumë rrënjët nëpër shkolla. Ne këtu duhet të japim mesazhin e qartë për nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme, - mos u mashtroni nga një gëzim i momentit që mund t'ju sjellë një cigare apo një dozë droge. Mendoni për më gjatë, mendoni për jetën, për të ardhmen tuaj! Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Suzan Novobrdaliu e ka fjalën.

SUZAN NOVOBRDALIU: Ju faleminderit, kryetar!

Kolegë deputetë,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Çështja të cilën dua ta ngrejë është marrja e dokumenteve personale nga Policia e Kosovës me rastin e shqiptimeve të dënimeve.

Kjo praktikë e filluar nga koha e UNMIK-ut, konsiderohet nga vetë policia dhe juristët si shekeje e të drejtave të njeriut dhe mbi të gjitha këta qytetarë po maltretohen nëpër polici dhe gjykata që t'i tërheqin dokumentet e tyre.

Jo rrallë herë ka ndodhur që këto dokumente edhe të humbin në polici apo gjykatë ose të vonohet procedura në gjykatë dhe shoferi ta drejtojë për një kohë të gjatë makinën e tij pa dokument. I bëj thirrje ministrit të Ministrisë të Punëve të Brendshme, që me një vendim të ndalohet kjo praktikë e keqe, sepse sot Kosova ka digjitalizuar sistemin e të dhënave dhe adresave si dhe pagesave dhe nuk ka mundësi që qytetari t'i ikën mos pagesave. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! fjalën e ka deputetja Emiljija Rexhepi.

EMILIJIA REDŽEPI: Zahvaljujem se!

Poštovani predsedniče,

Uvaženi predstavnici Vlade,

Kolege poslanici,

Poštovani građani,

Želim da se u ime zajednice koju predstavljam, zahvalim na učinjenom pozitivnom koraku pregovaračkom timu odnosno zamenici premijera, g.-đi Editi Tahiri oko

priznavanja diploma, odnosno nostrifikacije diploma, veliki problem koga su predstavnici manjinskih zajednica imali proteklih 11. godina, i bili diskriminirani oko zapošljavanja po javnim institucijama naše zemlje.

Takođe, profesori, doktori, ekonomisti, menadžeri, inženjeri, odnosno svi ostali koji su završili fakultete u zemljama u regionu, nisu imali mogućnosti daljeg školovanja, usavršavanja na raznim smerovima prištinskog i prizrenskog univerziteta, pa se upravo iz tih razloga, zbog egzistencije veliki deo naše zajednice iselio sa Kosova.

Poštovani ministre obrazovanja, možda zbog loših informacija, upravo od naših "političkih predstavnika" koji drže monopol nad obrazovnim sistemom na bosanskom jeziku već 10 godina u vašem Ministarstvu, nadam se da će ovu problematiku shvatiti kao gorući problem Bošnjačke nacionalne zajednice i da će u što kraćem vremenskom periodom vaša administracija početi rešavati pojedinačne probleme oko nostrifikovanja diploma predstavnika manjinskih zajednica kako bi se konačno stvorili adekvatniji uslovi zapošljavanja po javnim i privatnim institucijama, sve u cilju kvalitetnije afirmacije i integracije manjinskih zajednica uz ravnopravno poštovanje i uvažavanje svih građana Kosova. Zahvaljujem se, predsedniče!

KRYETARI: Ju faleminderit, deputete!
Fjalën e ka deputeti Zenun Pajaziti.

ZENUN PAJAZITI: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Kabinet qeveritar,

Më lejoni të shtroj një çështje që ka të bëjë me pagesat, taksat kufitare të sigurimeve. Kjo është një çështje që është shtruar edhe më herët. Unë kam provuar që muajt e verës këtë çështje ta shtroj, kam mbledhur një numër të madh informacionesh dhe më është thënë që për shkak të mospranimit të kompanive të sigurimit ose të asociacionit të kompanive të sigurimit ITU, gjegjësisht për shkak se nuk janë pjesë e kartonit të gjelbër, duhet që, siç ka qenë edhe më herët, të bëhen këto pagesa. Informacionet çojnë se është 1:10 numri ose sasia e të hollave që paguhen në dëmshpërblim me ato që inkasohen dhe, me qenë se është thënë që diku kah viti i ri do të ketë mundësi që të jemi pjesë e ITU, unë mendoj që, meqenëse është në valë, në prag të vitit të ri kemi një numër të madh të qytetarëve tanë që udhetojnë dhe kryesisht ata janë paguesit kryesor të këtyre taksave kufitare dhe, po ashtu, kohëve të fundit kemi edhe ankesa të transportuesve të mallrave nga disa shtete, që është rritur tregtia me vendin tonë kohëve të fundit, unë mendoj se është momenti i duhur që edhe Kuvendi të kërkojë nga Banka Qendrore, e cila i kontrollon në njëfarë mënyre këto kompanitë e sigurimeve dhe Shoqatën e kompanive të sigurimeve dhe Qeveria të koordinojnë që të paktën derisa të bëhemi pjesë e kartonit të gjelbër, të zbritet ende kjo taksë, e cila më së shumti i rëndon qytetarët tanë që udhetojnë dhe që punojnë përkohësisht ose që jetojnë në botën perëndimore dhe, konkretisht, kohëve të fundit edhe shumë transportues të mallrave nga disa vende që duhet ta paguajnë këtë taksë shtesë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!
Deputeti Rasim Demiri e ka fjalën.

RASIM DEMIRI: Hvala predsedniče!

Poštovani predsedniče parlamenta,

Uvaženi poslanici.

Bošnjačka zajednica na Kosovu, pored svog političkog života ima mnoge potrebe i u obrazovanju i kulturi. Vezano za kulturne aktivnosti, predstavnici Bošnjačke zajednice su odmah posle rata na Kosovu zahtevali od opštinskih struktura u Prizrenu odobrenje lokacije iz javnog vlasništva za Bošnjački kulturni centar. I pored više zahteva i urađenih idejnih projekata, čak i podrške tadašnje kancelarije Sjedinjenih Američkih Država i spremnosti nekih donatora da pomognu podizanje takvog centra, nažalost nije došlo do pozitivnog odgovora za odobrenje potencionalne lokacije za podizanje objekta Bošnjačkog kulturnog centra.

U međuvremenu je traženo izdavanje prostora iz javnog opštinskog vlasništva u Prizrenu za smeštaj Bošnjačkog kulturnog centra i ponovo nije usledio pozitivni odgovor. Izdavanje ovog prostora kao prvi korak, a javne lokacije za budući objekat kao drugi, su preko neophodni Bošnjačkim udruženjima iz kulture, jer nemaju ni minimum prostora za pripremu i održavanje svojih kulturnih manifestacija.

Samim tim, ugroženo je jedno pravo našoj nacionalnoj zajednici, kojoj i po Ustavu i po zakonima Republike Kosova pripada. Napominjem da smo mi politički predstavnici Bošnjaka Kosova pod svakodnevnim pritiskom na terenu da se ovo pitanje reši u institucijama sistema. Zbog toga smo mi Bošnjački predstavnici iz koalicije „VAKAT“ odlučili da podignemo svoj glas u ovom časnom domu i zatražimo podršku od svih poslanika, kao i angažman svih kosovskih struktura da bi se pitanje prostora Bošnjačkog kulturnog centra u Prizrenu uzelo veoma ozbiljno u razmatranje, kako na lokalnom nivou, tako i na nivou Republike Kosova.

Uvaženi poslanici,

Nadamo se da ćemo u ovom pravcu imati vašu punu podršku. Zahvaljujem!

KRYETARI: Ju faleminderit, deputet! Deputeti Visar Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Ju faleminderit, kryetar!

Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Ish punëtorët e Fabrikës së Tubave në Ferizaj kanë ushtruar padi në Gjykatën Komunale të Ferizajt në vitin 2001, që të vërtetohet largimi i dhunshëm nga puna prej forcave serbe në vitin 1990. Gjykata Komunale, në vitin 2002 vendosi që ish punëtorëve t'ua njej padrejtësinë e largimit të dhunshëm të tyre nga vendi i punës, nga forcat serbe në vitin 1990 dhe t'ua kompensojë të gjitha të ardhurat mujore prej se janë larguar. Këtë aktgjykim në afatin ligjor nuk e zbatoi Fabrika e Tubave, edhe pse ishte i formës së prerë.

Përkundër të këtij aktvendimi, në valën e 19-të të privatizimit, AKM-ja e bëri shitjen e Fabrikës të Tubave me një çmim skandaloz prej vetëm 3.675.000 euro. Me privatizimin e fabrikës u shkel aktvendimi i gjykatës. Po ashtu, punëtorët kanë ushtruar

edhe një padi për vlerësimin e borxhit dhe Gjykata Komunale në Ferizaj, në bazë të aktvendimit të vitit 2006, e definoi borxhin prej 25.659.000 eurove. Ky aktvendim thotë që edhe nëse rrezikohet borxhi, që debitori, pra AKM-ja, tash AKP-ja ua ka kreditorëve, të gjitha asetet e luajtshme duhet të shitet dhe borxhi i kreditorëve, punëtorëve duhet t'u paguhet.

AKM-ja në atë kohë ushtron ankesë kundër këtij aktvendimi në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, por kjo e fundit e ka hedhur poshtë këtë ankesë si të pabazë dhe aktvendimin e Gjykatës e vërteton.

Me privatizimin e fabrikës, largohen nga puna 647 punëtorë dhe kjo sjell një organizim të fuqishëm të ish-punëtorëve. Sindikata, pas shumë vështirësive dhe pengesave nga klanet e ndryshme, bëri që ata të dërgojnë një kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës, më 3 mars të vitit 2009, në lidhje me vlerësimin e kushtetutshmërisë së aktvendimit të Gjykatës Komunale të Ferizajt.

Gjykata Kushtetuese, më 17 dhjetor e solli aktgjykimin, ku e shpall kërkesën të pranueshme. Ajo e konsideron se ka pasur shkelje të nenit, e drejta për gjykim të paanshëm të Kushtetutës në lidhje me nenin 6, e drejta për gjykim të drejtë, dhe nenin 13, e drejta për zgjidhje efektive në bazë të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Aktgjykimi thotë që ekzekutimi i aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Ferizaj duhet të bëhen nga autoritetet kompetente e në veçanti nga Qeveria dhe AKP-ja, si pasardhëse ligjore e AKM-së.

Aktgjykimi u jep afat ligjor prej 6 muajsh organeve për të ndërmarrë masat për ekzekutiv.

AKP-ja kërkoi nga Gjykata Kushtetuese sqarim në lidhje me aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese, me arsyetimin që aktgjykimi ka qenë i paqartë për agjencinë. Por, Gjykata Kushtetuese kthen përgjigje AKP-së dhe i thotë që aktvendimi i 11 janarit 2002 është final dhe i detyrueshëm për ekzekutim.

Aktgjykimi nuk është zbatuar ende edhe pas 9 viteve, kurse përkundër vendimit të formës së prerë, Agjencia Kosovare e Mirëbesimit, në atë kohë, e privatizoi ndërmarrjen.

Duke dështuar për një periudhë kaq të gjatë kohore në zbatimin e aktgjykimit të 11 janarit 2002, autoritetet e dhura ua kanë privuar dispozitave të nenit 31 të Kushtetutës, nenit 6 dhe nenit 13 të Konventës Evropiane gjithë efektin e tyre të dobishëm, ashtu siç ceket në aktgjykim.

Gjykata Kushtetuese, më 4 tetor të vitit 2011...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Hajde, 30 sekonda!

VISAR YMERI: ... dhe AKP-së, me të cilin ua përkujton se aktvendimi i gjykatës, i vendosur më 17 dhjetor 2010, do të zbatohen nga autoritetet kompetente, në veçanti nga Qeveria dhe Agjencia Kosovare e Privatizimit.

Gjykata e fton Qeverinë dhe AKP-në që t'i bindet këtij aktgjykimi sa më parë që është e mundur, por jo më vonë se 17 dhjetori i vitit 2011, i cili tashmë ka kaluar. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputetja Time Kadrijaj e ka fjalën.

TIME KADRIJAJ: I nderuar kryetar i Kuvendit,
Të nderuar deputetë,

Këto ditë nëpër media, por edhe nga deklaratimet e disa institucioneve shëndetësore po ndodhë një fenomen jo i zakonshëm në kushte normale. Por për institucionin tonë, siç është Ministria e Shëndetësisë, këto dukuri po janë normale, por edhe po i mbrojnë me arsyetim kotë dhe jo hiq të qëndrueshme, që s'mundet t'iu besojë asnjë laik, e jo shtresat më të larta të shoqërisë.

Këto ditë, institucionet shëndetësore gjatë furnizimit me barëra nga lista esenciale nga Ministria e Shëndetësisë, një sasi e madhe e barërave iu kanë dërguar me afat të skaduar. Kjo ka ndodhur në Drenas, Podujevë, Suharekë dhe në shumë qytete të tjera.

Pas ankesës së institucioneve shëndetësore për këtë dukuri, Ministria e arsyeton veprimin e vet, duke thënë se kjo është pasojë e planifikimit jo të mirë të nevojave për barëra nga vetë institucionet shëndetësore.

Si rregull, në momentin e pranimit të barërave nga Ministria e Shëndetësisë, afati i skadencës duhet të jetë një vit. Atëherë, shtrohet pyetja: Pse Ministria e Shëndetësisë nuk i ka dërguar këto barëra nëpër institucione shëndetësore para një viti apo 6 muajve, po i ka dërguar tash, pas skadimit të afatit të përdorimit? Atëherë, me këtë kuptohet se këto kemi një keq-menaxhim apo keqpërdorim të rëndë.

Pas takimit me disa menaxher të institucioneve shëndetësore, ata u përgjigjën në lidhje me këtë temë. Kërkesa për furnizim me barëra dhe material tjetër shpenzues bëhet përmes internetit, pra në mënyrë elektronike. Secili produkt e ka kodin e vet dhe sasia e kërkesës është e limituar veç e veç, sa e ka lejuar Ministria e Shëndetësisë.

Për ta arsyetuar këtë keqpërdorim, po e ilustruj me një fakt shtesë, që sot e posedoj këtu:

Sot këtu para vetes e kam një faturë dalëse nga Ministria e Shëndetësisë dhe emrat e barërave që janë furnizuar institucionet shëndetësore. E kam bërë një analizë veç për një tabletë Enalapril. Sipas Ministrisë së Shëndetësisë, një tabletë Enalapril kushton 0.72 centë. Sasia e furnizimit është 40 mijë tableta për një institucion shëndetësorë. Ndërsa një paketim origjinal i këtyre barërave është 20 tableta dhe nëpër barnatoret private kushton 1 euro e 30 centë. Atëherë, një kuti origjinale, sipas Ministrisë së Shëndetësisë po del se

është 14 euro e 40 centë dhe krahasoni tashti 14 euro 40 centë, me një euro e 30 centë. E në total, me këtë Ministria e Shëndetësisë ka keqpërdorë 26 mijë e 200 euro, veç për një tabletë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Dhe, e fundit për sot, deputetja Donika Kadaaj - Bujupi.

DONIKA KADAJ - BUJUPI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Para se të filloj diskutimin, më lejoni që të tërheq vërejtjen për kufizimet të cilat u janë bërë sot mediave në Kuvend, të reagoj për këtë kufizim, sepse konsideroj që kjo nuk shkon në angazhimet dhe transparencën e Kuvendit, e cila duhet të jetë në rritje. Konsideroj dhe kam frikë që veprimet e tilla dhe më tutje do të na sjellin raporte jo të mira sa i përket lirisë së shprehjes dhe ju ftoj, në emër të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, që ky kufizim i lëvizjes së tyre të tërhiqet dhe mediat të kenë qasje dhe mundësi të kryejnë punën e tyre në gjithë Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Tani të kaloj te tema.

Lidhet me Ligjin e konkurrencës, i cili edhe pse është miratuar vitin e kaluar, vazhdon të ketë ngecje të shumta në zbatim dhe sidomos në sektorë të ndryshëm vazhdojnë dyshimet për abuzim me pozitën dominuese të disa ndërmarrjeve apo kompanive. Me këtë vazhdon të dëmtohet qytetari, respektivisht konsumatori në Kosovë dhe vazhdon të thellohet kriza ekonomike në vend.

Me theks të veçantë, të nderuar kolegë, kërkoj vëmendjen e juaj në dy sektorë. Është sektori bankar dhe avio-kompanitë. Edhe pse në Kosovë po rritet numri i bankave, kamatat e kredive vazhdojnë të mbesin tepër të larta. Si pasojë, biznesi me këtë përqindje të ulët të kreditit dhe me këto kamata të larta, nuk mund të zhvillohet. Kamatat e larta bankare në kohën e pasluftës arsyetoheshin me shkallën e lartë të rrezikshmërisë në kthimin e kredive. Mirëpo, shkalla e kredive të këqija në Kosovë është më e ulët se në rajon, ndërkaq kamatat vazhdojnë të jenë më të larta. Edhe më tutje pretendohet që rreziku është i madh në kredidhënie dhe për këtë bankat i praktikojnë kamatat më të larta në rajon, ndërsa dihet që kemi ekonominë më të dobët në rajon dhe bizneset të cilat kanë nevojë për t'u rritur, ndërsa kështu në këtë mënyrë nuk mund të rriten.

Përveç bizneseve, këtë çmim tepër të lartë po e paguajnë edhe qytetarët. Ne e dimë që çdo familje sot në Kosovë ka marrë një kredi, për shembull, për të shkolluar fëmijët e tyre, ndërkaq kredia ka qenë kredi biznesi. Është e pamundur që këto kamata të larta të kthehen nga njerëz të cilët edhe kështu janë në masë të madhe të papunë, ndërkaq obligohen që për të përmbush nevojat e tyre familjare, të marrin kredi me kamata tepër të larta.

Ulja e kamatave do të ndihmonte në zhvillimin ekonomik të vendit dhe njëherazi rritje të punësimit nga ana e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, të cilat luajnë një rol shumë të rëndësishëm në ekonominë e Kosovës.

Në një tryezë me gratë afariste, të organizuar javën që lamë pas, u kërkua nga vetë ato që Kuvendi i Kosovës të rritë kontrollin mbi Qeverinë dhe të kërkojë nga Agjencia ...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit, deputete!

Ju njoftoj se Kuvendi e ka një Rregullore të Punës për vete, komisionet gjithashtu kanë rregullore të punës, edhe për qasjen e mediave në Kuvend është një rregullore për këtë çështje dhe në çdo Kuvend që kemi qenë, kemi parë se mediat megjithatë e kanë hapësirën e kufizuar. Kështu që edhe në Kuvendin tonë, si në çdo kuvend, mediat e kanë hapësirën e tyre të mjaftueshme për të kryer detyrën e tyre profesionale.

Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Koha për pyetje parlamentare

Në pajtim me nenin 45.1 të Rregullores së Kuvendit, koha për pyetjet e deputetëve për Qeverinë është e kufizuar në 60 minuta. Deputeti për një mbledhje mund të parashtrojë më së shumti 2 pyetje.

Fillojmë me deputetin Lutfi Haziri, pyetje për ministrin Ramë Buja.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, zoti kryetar!

Zoti ministër,

Qeveria ka premtuar Universitetin Publik të Gjilanit, dëshiroj ta di nga ju, si bartëse sektoriale, deri në cilën fazë keni mbërri në realizimin e këtij projekti për Universitetin Publik të Gjilanit?

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën!

MINISTRI RAMË BUJA: I nderuar zoti kryetar i Kuvendit,

Zoti kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

I nderuari deputet Haziri,

Qeveria e Kosovës, gjegjësisht Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë është përcaktuar që ndryshimeve t'ju qaset në mënyrë shumë sistematike sipas Strategjisë së zhvillimit të arsimit të lartë. Kështu, krahas zgjerimit të rrjetit të institucioneve të arsimit të lartë privat, në këtë periudhë është bërë zgjerimi i rrjetit të arsimit të lartë edhe publik, si pavarësimi i Universitetit të Prizrenit, themelimi i Universitetit të Pejës dhe në vijim jemi në përgatitje të themelimit të Universitetit të Gjilanit dhe të Gjakovës.

Në Gjilan është krijuar bazë e mirë për themelimin e këtij universiteti. Aktualisht atje funksionojnë këto drejtime të Universitetit Publik të Prishtinës, si drejtimi ekonomik, drejtimi juridikë, drejtimi i edukimit me programin parashkollor, fillor dhe programin për avancimin e mësuesve.

Unë besoj që me këto përgatitje që po bëhen dhe janë jo pak intensive, vitin e ardhshëm, pa përcaktuar datë të saktë, do t'i qasemi këtij problemi më seriozisht. Faleminderit, shumë!

KRYETARI: Deputet, ke pyetje shtesë!

LUTFI HAZIRI: Faleminderit!

Gjilani e ka pasur Shkollën për Edukim 35 vjet. Hapja e disa drejtimeve janë dekoncentrim nga UP-ja në qendra të caktuara, sepse është degë e fakulteteve të UP-së. Po më intereson ta dije - deri ku ka mbërri projekti për realizimin e Universitetit Publik të Gjilanit, cilat janë masat, cili është buxheti, cilat janë trupat punuese dhe cilat janë objektet që janë zgjedhur apo janë trajtuar nga ana e Qeverisë?

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën!

MINISTRI RAMË BUJA: Në shfrytëzimin e Universitetit në themelim të Gjilanit, që besoj do të pasojë shpejt, siç ju thashë, do të jenë ato objekte që aktualisht janë dhe një shoqërim që po i bëhet me një ndërtim të një amfiteatrit, që do t'i përplotësojë këto kushte teknike për të nisur punën atje, Komisioni për ekzaktësim ose saktësim të punëve se si do të bëhet, do të themelohet që në fillim të vitit 2012, dhe punët tjera besoj do të shkojnë mirë, sepse në fakt këto tri drejtime që janë të akredituara atje, na krijojnë bazën e mirë për të hyrë në fazën e themelimit të Universitetit të Gjilanit, gjë që do ta bëjmë më së shpejti. Faleminderit, shumë!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputetja Alma Lama, pyetje për kryeministrin, zotin Hashim Thaçi.

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryetar!

Mediat e shkruara po kalojnë një periudhë të vështirë të mbijetesës, qoftë për faktin e mungesës së një tregu të mjaftueshëm të marketingut, qoftë edhe për shkak të zhvillimeve teknologjike të cilat kanë sfiduar në mënyrë të jashtëzakonshme vitet e fundit, një sfidë kjo jo vetëm për mediat në Kosovë, por mediat në të gjithë botën.

Heqja e tatimit mbi vlerën e shtuar do të ishte një hap minimal për të ndihmuar ekzistencën e mediave e për të siguruar në këtë mënyrë një nga të drejtat themelore të njeriut, që është e drejta për t'u informuar.

Shumë vende të Bashkimit Evropian i tatojnë mediat me vlerën zero, vende të tilla si Britania, për shembull, e cila është modeli i mediave të lira dhe të pavarura, edhe pse në kushte të një ekonomie mjaftë të fortë, TVSH-në për media të shkruara e ka zero. Po kështu, edhe disa vende të tjera të BE-së e kanë TVSH-në zero, po kështu edhe disa vende të rajonit kanë vepruar në këtë mënyrë. Ndërkohë, vendet e tjera të Bashkimit Evropian e kanë TVSH-në për media në vlera mjaftë minimale, siç është ajo nga 3 deri në 5%. Prandaj, pyetja ime për kryeministrin e Kosovës është - pse Qeveria e Kosovës deri tani nuk e ka hequr TVSH-në për media të shkruara? Faleminderit!

KRYETARI: Zoti kryeministër, e ke fjalën!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Fillimisht dëshiroj të falënderoj për pyetjen tuaj! Ne nesër kemi mbledhje të Qeverisë dhe një nga pikat e rendit të ditës do të jetë edhe kjo, pra TVSH-ja do t'ju hiqet mediave, është një nga premtimet e mia elektorale dhe do ta përmbushë këtë premtim, në mënyrë që t'u krijojmë hapësirë, mundësi më të mëdha të gjitha medimeve në Republikën e Kosovës. Prandaj, kam besim të plotë që kjo çështje do të përmbyllet shumë shpejt. Natyrisht se jemi në konsultim edhe me mekanizmat, duke marrë edhe këshilla ndërkombëtare që gjithçka të jetë sipas standardeve ndërkombëtare. Kështu që ne do t'ua lehtësojmë punën edhe më fuqishëm dhe më mirë, por gjithmonë sipas standardeve ndërkombëtare, mediave në Republikën e Kosovës.

Ndërsa, në pyetjen që ishte më herët për Universitetin e Gjilanit, i nderuari zoti Haziri, do të jemi së bashku, besoj, në ceremoninë e inaugurimit të Universitetit Publik të Gjilanit më 1 tetor të vitit të ardhshëm. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputete, ke pyetje shtesë?

ALMA LAMA: Po, kam një koment shtesë. Më vjen mirë që kryeministri më në fund e ka marrë parasysh këtë kërkesë të mediave, por mbi të gjitha është kujtuar për premtimin e tij elektorale, është kujtuar ta mbaj tani premtimin, edhe pse ka kaluar një vit. Mendoj që edhe heqja e reklamave që është bërë ndaj mediave, është një verim i mirë nga ana e Qeverisë, sepse është bërë pa kritere, pra nuk ka pasur kritere të drejta në shpërndarjen e mediave dhe ka qenë tentativë për t'i blerë ato, mirëpo situata e krijuar aktuale nga mediat shihet si një tentativë për t'i gjuhëzuar, ndërsa mos heqja e TVSH-së deri tani është parë si një pandjeshmëri e Qeverisë së Kosovës në lidhje me të drejtën e qytetarëve për t'u informuar. Edhe një herë, më vjen mirë që edhe pse vonë, pas një viti ky premtim do të mbahet. Të shohim nëse do të mbahet, se kështu premtuat edhe për çështjen e zëdhënësit, mirëpo nuk e mbajtët fjalën. Faleminderit!

KRYETARI: Kryeministër, nuk ke përgjigje? Mirë!

Vazhdojmë. Deputetja Nazane Breca, pyetje për ministrin Ferid Agani.

NAZANE BRECA: Faleminderit!

I nderuari kryetar,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

I nderuari ministër Agani,

Përpilimi i protokolleve dhe udhërrëfyesve klinikë në të gjitha nivelet e kujdesit shëndetësor është shumë i rëndësishëm, sepse i ndihmon në ofrimin e kujdesit të unifikuar dhe më kualitativ të popullatës sonë.

Në vitin 2008, në mbështetjen e Bankës Botërore ka qenë një projekt gjatë të së cilit janë përpiluar 16 protokolle për sëmundjet më të shpeshta në kujdesin parësor shëndetësor. Që prej atëherë, këto protokolle, forma elektronike e tyre është dorëzuar në Ministri të Shëndetësisë dhe që prej atëherë askush nuk e ka parë të arsyeshme që të formohet një bord i profesionistëve, i cili do ta jep vizën që këto protokolle të jenë në përdorim tek të gjithë mjekët që punojnë në kujdesin parësor shëndetësor.

Pyetja ime është se kur pritet që këto protokolle ta marrin vizën nga Ministria e Shëndetësisë dhe të dalin në përdorim zyrtar?

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën!

MINISTRI FERID AGANI: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar kryeministër, zëvendëskryeministra,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

E nderuara deputete,

Ministria e Shëndetësisë, në bazë të Udhëzimit administrativ 12/2010, ka formuar Këshillin kosovar për udhërrëfyes dhe protokolle klinike, detyrë e të cilit ka qenë hartimi i udhërrëfyesve dhe protokolleve klinike të reja, si dhe revidimi i atyre ekzistuese.

Një udhërrëfyes apo protokoll, për të qenë i aplikueshëm në territorin e Kosovës, duhet të hartohet ose të revidohet në bazë të metodologjisë evropiane të sistemit GRI, është shkurtësë prej anglishtes për ngritjen e udhëzuesve për hulumtim dhe vlerësim dhe të kalojë nëpër Komisionin e vlerësimit të Ministrisë e më pastaj të nënshkruhet nga ministri i Shëndetësisë.

Protokollet që ju i përmendni, si dhe shumë të tjerë që hartuar nga shoqata, donatorë apo kompani farmaceutike duhet patjetër të kalojnë nëpër këtë filtër dhe vetëm pas të marrin miratimin e plotë, mund të botohen dhe të aplikohen.

Në vitin 2011, Ministria e Shëndetësisë ka formuar grupe punuese të cilat kanë hartuar 21 udhërrëfyes dhe protokolle klinike. Këta udhërrëfyes dhe protokolle klinike janë hartuar për të tri nivelet e kujdesit shëndetësor, pra përfshirë edhe nivelin parësor të kujdesit shëndetësor. Këto dokumente kanë kaluar vlerësimin e parë në Komisionin për vlerësim dhe pas përmbushjes së rekomandimeve të komisionit, ato do të nënshkruhen nga ministri i Shëndetësisë.

KRYETARI: Deputete, ke pyetje shtesë!

NAZANE BRECA: Faleminderit!

A jeni duke folur për të njëjtat protokolle, zoti ministër, sepse në qoftë se këto protokolle, për të cilat unë fola, kanë qenë të pilotuara në 4 pilot qendra në Kosovë, ekziston edhe raporti në lidhje me këtë pilotim dhe ka dalë një raport, domethënë, me rezultate shumë pozitive për përdorshmërinë e këtyre protokolleve. Në qoftë se është fjala për përpilimin e të njëjtave protokolle, atëherë unë nuk e di pse është e nevojshme që të

njëjtat protokolle edhe një herë të përpilohen, kur mundet ai buxhet që do të shkojë për përpilimin e këtyre protokolleve, të shkojë për përpilimin e protokolleve të reja e jo të njëjtave mbasi që ato veç ekzistojnë, domethënë edhe është bërë pilotimi i tyre, por vetëm presin një vizë nga Ministria e Shëndetësisë. Faleminderit!

KRYETARI: Ministër!

MINISTRI FERID AGANI: E nderuara zonja deputete, Unë thashë se të gjitha ato protokolle të cilat janë përpiluar, e në mes tyre edhe këto që ju po flisni, janë pjesë e një rishqyrtimi sipas metodologjisë evropiane të sistemit GRI dhe janë në fazën përfundimtare të vlerësimit. Pra, vetëm pritet që rekomandimet e këtij komisioni për vlerësim të inkorporohen në to dhe do të nënshkruhen shumë shpejt.

KRYTARI: Faleminderit, ministër!

Deputetja Time Kadrijaj, pyetje për ministrin Ferid Agani!

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Ministër, gjithmonë në pyetjet dhe prononcimet e juaja po deklaroni se një prej sfidave të Ministrisë së Shëndetësisë është mungesa e buxhetit dhe buxheti i vogël që po i ndahet Ministrisë së Shëndetësisë. Në disa prononcime tuajat keni thënë apo deklaruar, se keni blerë barna tash së voni, sasia e njëjtë, cilësia e njëjtë, por me çmim diku 5.000.000 më pak se tenderët paraprak. Pyetja: Këto mbetje prej 5.000.000 eurove a do t'i shfrytëzoni për blerjen shtesë të barnave nga lista esenciale?

KRYTARI: Ministër, e ke fjalën!

FERID AGANI: E nderuara zonja deputete,

Planifikimet e institucioneve shëndetësore në kërkesat për barna dhe material harxhues, për vitin 2011 kanë qenë mbi 30.000.000 euro. Buxheti në dispozicion i Ministrisë së Shëndetësisë ka qenë 18.700.000 euro. Prej kësaj lehtë mund të llogaritet se mundësitë reale të furnizimit të institucioneve shëndetësore me barna nga buxheti i Kosovës janë rreth 60%. Mjetet e mbetura, të cilat janë shfrytëzuar për blerjen e barnave dhe materialit shpenzues, që ka rezultuar me ngritje të theksuar të kapacitetit të përmbushjes së kërkesave të institucioneve për barna dhe material harxhues, natyrisht se janë shfrytëzuar për ngritjen e nivelit të furnizimit të institucioneve shëndetësore me barna dhe material harxhues.

Ministria e Shëndetësisë, me përmirësimin e sistemit të menaxhimit, konkretisht përmirësimin e sistemit të prokurimit të barnave, nëpërmjet të nënshkrimit të kornizave, nëpërmjet të nënshkrimit të kontratave kornizë trevjeçare, ka arritur që të ulë çmimet e barnave në masë të konsiderueshme. Nëpërmjet procedurave të këtilla kemi arritur që të kursejmë afër 5.000.000 euro në blerjen e sasisë së njëjtë dhe barnave me cilësi të njëjtë. Dhe, natyrisht se ky kursim prej 5.000.000 euro është dedikuar për blerjen e barërave dhe materialit harxhues të nevojshëm në këtë 40%-shin, të cilin s'kemi pasur mundësi që ta plotësojmë.

Kjo më së miri ilustron faktin se furnizimi me citostatikë është më i mirë se më parë. Nga 10.160 vizita në Institutin Onkologjik, janë administruar 8.054 terapi citostatike. Kërkesat për insulinë janë të mbuluara 100%, nevojat për shërbime të hemodializës janë të mbuluara 100%, mungesa e materialit esencial shpenzues është më e vogël se sa që ka qenë në vitet e kaluara dhe, në përgjithësi, furnizimi i institucioneve shëndetësore, në bazë të asaj se si kanë planifikuar, është më i mirë se sa në vitet e kaluara.

KRYTARI: Deputete, ke pyetje shtesë?

TIME KADRIJAJ: Thashë, keni deklaruar: “sasia e njëjtë, cilësia e njëjtë”. Sipas asaj çka dimë ne, nuk ka zbritje të çmimit të barnave. Me këtë deklaram, ministër, a keni dashur ta akuzoni ministrin e mëparshëm Bujar Bukoshi, që i ka keqpërdorë ato 5.000.000, apo si po e cilësoni zhdukjen e 5.000.000 eurove në atë periudhë? Faleminderit!

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI FERID AGANI: E nderuara zonja deputete, Unë e thashë shumë qartë se me një sistem të përmirësuar të prokurimit të barnave është arritur që barnat të blihen me çmim më të lirë.

Më lejoni t’ju jap vetëm 3 shembuj konkretë. Për shembull, citostatiku “Docetaxell”, në vitin 2010 është blerë me çmimin 585 euro, në vitin 2011, me çmimin 147 euro. Citostatiku “Gencitabin” është blerë në vitin 2010 me 115 euro, kurse në vitin 2011, 37 euro. Citostatiku “Pac1 taxell”, është blerë me çmimin 62.5 euro, në vitin 2011, 23.2 euro.

Tash, mos t’ju lodhi me detaje, Janë të elaboruara këto çmime, të ulura në treg. Pra, ne kemi arritur që t’i blejmë më lirë barnat e njëjtë, sasinë e njëjtë, cilësinë e njëjtë. Prandaj, mendoj se kjo është një arritje e Ministrisë dhe një kontribut konkret në këtë situatë të vështirë të furnizimit me barna, kur buxheti për barna është shumëfish më i vogël se sa që i nevojshëm.

KRYTARI: Faleminderit, ministër!

Deputetja Kimete Bytyqi, pyetje për ministrin Blerand Stavileci!

A e kemi këtu ministrin? Nuk e kemi këtu? Doni ta bëni pyetjen?

Fjala, deputetes Kimete Bytyqi, me kartelë të Afërdita Berishës!

KIMETE BYTYQI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar Kabinet Qeveritar,

Kolegë deputetë,

Edhe pse s’është ministri i Bujqësisë, unë për hir të qytetarëve, to ta parashtroj pyetjen.

Duke pasur parasysh faktin se shumë vreshtarë në komunën e Therandës, vreshtat e komunës së Therandës janë shkatërruar për shkak të kalimit të trasesë së autostradës “Dr.

Ibrahim Rugova”, si projekt nacional i vendit tonë dhe duke ditur faktin se komuna e Therandës është qytet simbol, që identifikohet me kultivimin e hardhisë së rrushit dhe që shumë vreshtarë janë të interesuar që të mbjellin hardhi të reja të cilat kanë nevojë për subvencionimin nga kjo ministri.

Andaj, kërkoj nga kjo ministri, që të më njoftojë se cili është planifikimi i Ministrisë të Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për subvencionimin e vreshtave të Therandës, në mbjelljen e hardhive të reja të rrushit në këtë komunë? Faleminderit!

Drejtimin e seancës e merr nënkryetari i Kuvendit, zoti Xhavit Haliti

KRYESUESI: Faleminderit!

Ministri nuk është! Shkojmë më tutje.

Deputeti Visar Ymeri, pyetje për ministrin Bedri Hamza. Deputetit Ymeri fjalën!

VISAR YMERI: Faleminderit, kryesues!

Konsorciumi “Cosmocell”, partnerë të të cilit ishin kompania italiane “Capital managment holding PLC”, si dhe kompanitë kosovare “Dukagjini” dhe “Kujtesa”, në vitin 2006, ishin shpallur fitues të licencës së dytë të telefonisë mobile në Kosovë, duke ofruar 81.000.000 euro. Konsorciumi fitues ishte shkualifikuar më pas nga Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit, pasi që nuk kishte arritur t’i paguaj 81.000.000 eurot e licencës brenda afatit të paraparë ligjor. Me shkualifikim të “Cosmocell”-it dhe dhënien e licencës ofertuesit të dytë, konsorciumit tjetër pra, ART-ja është dashur t’i transferojë në buxhetin e vendit 16.200.000 eurot e garancisë bankare të “Cosmocell”-it, duke bërë ekzekutimin e kësaj garancie, ashtu siç parashihej me pakon tenderuese.

Pyetja ime është kështu: Çfarë u ka ndodhur këtyre 16.000.000, ministër?

KRYESUESI: Ministër, e keni fjalën!

BEDRI HAMZA: I nderuar nënkryetar,
I nderuar zoti kryeministër,
Kabinet Qeveritar,
Deputetë të nderuar,
Zoti Ymeri, faleminderit për pyetje!

Është pyetje, e cila është ngritur disa herë në Kuvendin e Kosovës edhe në legjislaturat e kaluara, mirëpo siç jeni në dijeni dhe për informatën tuaj, ky proces për dhënien e licencës së dytë telefonisë mobile, është udhëhequr nga Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit, i cili i ka përcaktuar të gjitha kushtet dhe ka udhëhequr këtë procedurë. Departamenti i Thesarit nuk ka asnjë të dhënë dhe nuk ka hyrje bankare të kësaj shume, pasi që Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit është institucion, i cili i përgjigjet Kuvendit, aty janë duke u zhvilluar disa procedura gjyqësore, por për informata më të detajshme, pasi që është kompetencë dhe është përgjegjësi, që bie në fushën e tyre, ju lutem, i drejtoheni Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit.

KRYESUESI: Faleminderit!
Pyetje shtesë, deputet!

VISAR YMER: Ministër, siç e kam deklaruar edhe në deklarinimin jashtë rendit të ditës së javës së kaluar dhe siç, natyrisht, të gjithë qytetarët e Kosovës, mendoj, e dinë këtë çështje, kjo garanci bankare skadon në janar të vitit 2012 dhe pas atij skadimi nuk do të mund t'i marrim këto para kurrë. Mua po më intereson, çfarë ka bërë Qeveria për të ushtruar kërkesa ndaj ART-së që ta ekzekutojë këtë, për shkak se është ministria juaj ajo e cila do të duhej të kujdesej që këto para të vijnë në buxhetin e Kosovës, meqenëse ju e menaxhoni buxhetin e Kosovës.

KRYESUESI: Faleminderit!
Zoti ministër, fjalën!

BEDRI HAMZA: Zoti Ymeri, të paktën do të duhej të ishte e qartë ndarja e kompetencave në mes të Ministrisë së Financave dhe Autoritetit të Rregullatorit të Telekomunikacionit. Nuk mundet Ministria e Financave të ndërhyjë në kompetencat e këtij institucioni. Është përgjegjësi e këtij institucioni, nëse vjen dokument i tillë në Ministrinë e Financave për t'u ekzekutuar, Ministria e Financave sigurisht se do ta ekzekutojë, por është më se e qartë, është fushë e përgjegjësisë së Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit. Prandaj, e keni të qartë ndarjen e kompetencave në mes të këtyre institucioneve.

KRYESUESI: Faleminderit!
Deputeti Visar Ymeri, pyetje për ministrin Memli Krasniqi!

VISAR YMERI: Faleminderit!
Klubi i atletikës "Rogana" nga fshati Roganë, i komunës së Dardanës, është një ndër klubet më të suksesshme të atletikës që i ka Kosova. I themeluar në vitin 2005, ky klub i mbanë shumicën e rekordeve të Kosovës në disiplinën e ndryshme të vrapimit, si në 200 metra, 400 metra, 600 metra, 800 metra, 1000 metra dhe 1.500 metra. Po ashtu, në stafetë 4 x 100 metra dhe 4 x 400 metra, si dhe në gjysmëmaratonë prej 21 kilometri.

Që nga viti 2008 e deri në vitin 2011, ky klub është klubi më i mirë i atletikës. Gjatë këtyre 4 vjetëve, ka fituar kupën dhe kampionatin e Kosovës në atletikë. Atletët e saj vetëmohues kanë marrë pjesë dhe kanë fituar çmime edhe në garat ndërkombëtare, ndërkohë që në fshatin e tyre nuk kanë as pistë vrapimi. Deri tash si klub kanë mbetur gjallë falë donacioneve të pakta, por të çmuara, nga diaspora.

Pyetja ime drejtuar juve, është kështu: A ka ndonjë program ministria juaj që ta ndihmoni këtë klub të atletikës, pra klubin "Rogana"?

KRYESUESI: Faleminderit!
Zoti ministër!

MINISTRI MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

I nderuar Kabinet Qeveritar,

Të nderuar deputetë,

I nderuar deputet Ymeri, faleminderit për pyetjen!

Ndër angazhimet bazë të Ministrisë të Kulturës, Rinisë dhe Sportit është subvencionimi i aktiviteteve të Komitetit Olimpik të Kosovës dhe i federatave sportive, bazuar në kërkesat për mbështetjen e aktiviteteve të organizuara nga ana e tyre. Gjithsesi, Federata Atletike e Kosovës është ndër federatat që në vazhdimësi ka pasur mbështetjen e Ministrisë. Gjatë këtij viti, për organizimin e aktiviteteve të saj, kjo federatë ka përfituar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit 33.577 euro. Në bazë të politikave programore të Ministrisë, nuk është e mundur që të financohen drejtpërdrejt klubet sportive, por ato përfitojnë përmes mbështetjes që ne i japim federatave përkatëse. Megjithatë, klubet mbështeten drejtpërdrejt në rastet e pjesëmarrjes në gara ndërkombëtare, në organizimin e kampeve stërvitore, apo në raste të caktuara përmes furnizimit me pajisje sportive. Mungesa e infrastrukturës adekuate sportive është një sfidë e madhe për të gjitha sportet e organizuara në vendin tonë dhe ne jemi të angazhuar maksimalisht për ta zbutur gjendjen e rëndë në këtë drejtim. Duke ditur gjendjen e vështirë infrastrukturore edhe në sportin e atletikës, ne qysh tani kemi planifikuar që në bashkëpunim me federatën përkatëse t'i evidentojmë nevojat prioritare, në mënyrë që të shohim mundësinë për përmirësimin e kushteve në këtë drejtim, sado pak.

Sukseset e klubit atletik “Rogana” janë gjithsesi mbresëlënëse dhe ne i inkurajojmë ata që të vazhdojnë me suksese të tilla dhe përmes Federatës Atletike të Kosovës ata do ta kenë gjithmonë mbështetjen e Ministrisë.

Më lejoni të shtoj në fund se miratimi i Ligjit të ri për sport, që është në rend dite të kësaj seance të sotme, do të krijojë mundësi të reja për të ndihmuar edhe më shumë sportistët tanë dhe veçanërisht ata që kanë treguar dhe po tregojnë suksese në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Pyetje shtesë? Jo! Deputeti Afrim Kasolli, pyetje për ministrin Ramë Buja.

AFRFIM KASOLLI: Faleminderit, nënkryetar!

Edhe unë po ashtu, me këtë pyetje dua të ngrejë shqetësimet e banorëve të të njëjtit fshat të komunës së Dardanës. Ky fshat i zonës kufitare është i banuar tërësisht me qytetarë shqiptarë dhe numëron afërsisht 500 shtëpi dhe 2700 banorë. Shqetësimi i qytetarëve të këtij fshati ka të bëjë me faktin se mësimi në shkollën fillore “Metush Krasniqi”, mbetet në 4 ndërrime, dhe atë mbi 450 nxënës fillorë, nga klasa e parë deri te klasa e nëntë. Pastaj këtu mësojnë mbi 500 nxënës të gjimnazit “Ismail Qemali”, si dhe 420 nxënës të shkollës së mesme teknike “Andrea Durrësaku”, paralele të ndara nga qendra në Dardanë. Kjo situatë ka bërë që orët mësimore në këtë shkollë të shkurtohen deri edhe në 25 minuta dhe rrjedhimisht si pasojë e kësaj gjendjeje, të bie cilësia në arsim.

Ky fakt, në mënyrë eklatante përpos që përgënjeshtroi sloganin propagandistik të kësaj Qeverie, se më nuk ka shkolla në Kosovë, ku mësimi mbahet në më shumë se dy ndërrime, po ashtu krijon vështirësi në menaxhimin e suksesshëm dhe kalueshmërinë nën mesataren e testeve të arritshmërisë dhe provimin e maturës.

Të gjitha qeveritë e deritanishme, si lokale, ashtu edhe qendrore, duke njohur këtë problematikë, kanë premtuar ndërtimin e objektit të ri shkollor për shkollat e mesme, por një gjë e tillë ende vazhdon të mbetet vetëm premtim.

Pyetja është: Pse Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë nuk ka ndërmarrë asnjë hap konkret deri më tani për zgjidhjen e problemit të banorëve të kësaj ane, pra, ndërtimin e një shkolle të re, sidomos kur dihet se banorët e fshatit i kanë shkruar për këtë problem edhe MASHT-it, por deri më tani nuk kanë marrë asnjë përgjigje?

KRYESUESI: Faleminderit!
Zoti ministër!

MINISTRI RAMË BUJA: I nderuar zoti kryesues,
I nderuar zoti kryeministër,
Zëvendëskryeministra, kolegë ministra dhe të nderuar deputetë,
I nderuar deputet Kasolli, faleminderit shumë për pyetjen e bërë!

Në bazë të dhënave të Departamentit të infrastrukturës dhe shërbimeve teknike në MASHT, të regjistruara në vitin 2009 nga drejtorët e shkollave, në komunën e Dardanës, në tri ndërrime kanë mësuar 3 shkolla. Kurse, në 4 ndërrime asnjë. Ndërsa, shkolla fillore dhe e mesme e ulët “Metush Krasniqi”, në Roganë, ka pasur 489 nxënës dhe ka punuar në 3 ndërrime. Në bazë të dhënave të sektorit të sistemit të menaxhimit të informatave të arsimit SMIA në MASHT, ku të dhënat vijnë nga drejtoritë komunale të arsimit, çdo vit shkollor, në shtatorin e vitit 2011 të këtij viti shkollor, në komunën e Dardanës, në tre ndërrime mësimin e zhvillon vetëm një shkollë, kurse në katër ndërrime, asnjë. Ndërsa, shkolla “Metush Krasniqi” ka 446 nxënës dhe mëson në 3 ndërrime. Pasi që në këtë fshat ka paralele nga shkolla e mesme e lartë “Ismail Qemali” nga Dardana. Numri i ndërrimeve është zvogëluar, pasi që ka pasur edhe investime nga donatorët, siç janë ato në vitin 2010 në ndërtimin e aneksit të shkollës së mesme të lartë “Andrea Durrësaku”, ku është eliminuar ndërrimi i tretë.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ka investuar në ndërtimin dhe renovimin e shkollave në komunën e Dardanës, sipas viteve:

- Shkolla fillore dhe e mesme e ulët “Metush Krasniqi”, në Hodonoc, faza e dytë e punimeve, punë finale dhe inventarizim të vitit 2004.
- Shkolla fillore dhe e mesme e ulët në Shipashnicë, ndërtimi i ri dhe inventarizimi i objektit 2007.
- Shkolla fillore dhe e mesme e ulët e re, lagja Malësia në Dardanë, ndërtimi i ri dhe inventarizimi i vitit 2010.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, për shkak të një cilësie, disipline dhe serioziteti më të mirë të mbajtjes së mësimi, që ndikon në mbikëqyrje pedagogjike dhe mësimnxënie, ka pasur një politikë në të gjitha qeveritë në nivel të Republikës së Kosovës, që në fshatra të mos ndërtojë shkolla të mesme të larta. Strategjia jonë u përqendrua në kalimin e një numri paralelesh nga shkolla e mesme e lartë nëpër lokalitetet rurale, aty ku ekzistojnë kushtet për zhvillimin e mësimi. Kështu, u veprua edhe më rastin e shkollës së mesme “Ismail Qemali”, në Roganë të Dardanës, ku janë krijuar paralele të ndara, të cilat mësimin e mbajnë në ndërrimin e tretë. Kurdo që krijohen rrethana të favorshme financiare, natyrisht, për investime kapitale dhe për një studim të kushteve të përcaktuara me dispozita, do ta bëjmë gjithsesi, realizimin e një ndërtimit të një shkolle në këtë fshat që ka prioritet, natyrisht, dhe keni ju të drejtë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Pyetje shtesë, zoti Kasolli e ka fjalën!

AFRIM KASOLLI: Faleminderit, ministër!

Po ky është problemi më i madh, për shkak se tani ju këtu prezantoni të vërtetat zyrtare dhe problemi më i madh i kësaj Qeverie është shpërputhja ndërmjet të vërtetave zyrtare dhe të vërtetës reale. Por, pyetja ime është: A keni ndërtuar ndonjë shkollë, kur nuk keni pasur nxënës në momentin e inaugurimit dhe nuk i keni orientuar drejtë buxhetin, që të investohet me të vërtetë mirëfilli aty ku ka nevojë. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti ministër Buja!

RAMË BUJA: Absolutisht, mbi 80 shkolla që janë ndërtuar në Kosovë, gjithsesi që kanë pasur prioritet dhe ndonjë vend edhe nuk kemi pasur numër të mjaftueshëm të nxënësve, për shkak të rrethanave dhe ambientit ku është ndërtuar shkolla. E kemi bërë ndonjë rast të tillë, por megjithatë, gjithmonë kemi prioritetet e caktuara me strategjinë vepruese të Ministrisë së Arsimit dhe të Qeverisë, për të bërë këtë.

Edhe kjo shkollë në Roganë, gjithsesi do të realizohet me t’u realizuar të mundësive financiare për ta bërë. Kjo nuk ka asnjë dilemë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputeti Liburn Aliu, pyetje për zëvendëskryeministren Edita Tahiri.

LIBURN ALIU: Më 3 korrik është deklaruar publikisht nga zonja Edita Tahiri se marrëveshjet e arritura deri atëherë me Serbinë do të fillojnë së zbatuari nga 1 nëntori i këtij viti dhe se nga kjo datë do të zbatohet ligji në gjithë territorin e Kosovës. Për më tepër, në të njëjtin deklaram keni dhënë edhe premtimin publik se strukturat ilegale të Serbisë do të eliminohen, kurse qytetarët do të lëvizin lirshëm. Pra, duke shikuar këtë gjendje, pyetja ime është kështu mjaftë e thjeshtë, por duke e ditur edhe realitetin, pra a janë eliminuar strukturat paralele me 1 nëntor, siç keni premtuar? Kjo është pyetja.

KRYESUESI: Faleminderit! zonja zëvendëskryeministre, fjalën e keni.

ZËVENDËSKRYEMINISTRJA EDITA TAHIRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Deputetë të nderuar,

Kabinet i nderuar qeveritar,

I nderuar deputet Aliu,

Për sa i takon çështjes së marrëveshjeve të Brukselit, së pari dua të them se të gjitha marrëveshjet që janë arritur deri tash, janë 6 sosh, janë arritur në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, parimin e reciprocitetit ndërmjet dy shteteve, si dhe mbi parimin që çdo marrëveshje nënkupton shuarjen e strukturave paralele në fushën e caktuar për të cilën është arritur marrëveshja.

Për sa i takon pyetjes tuaj dhe datës 1 nëntor, në qoftë se e keni lexuar marrëveshjen apo konkluzionet, siç njihen, sepse ato janë dorëzuar në Parlament, aty thuhet, pra qartë në marrëveshjen për lëvizjen e lirë që më 1 nëntor dalin nga përdorimi, përkatësisht fillon zbatimi i daljes nga përdorimi i tabelave ilegale të automjeteve dhe zëvendësimi i tyre me tabelat legale të Kosovës dhe ky proces më 1 nëntor ka filluar, Ministria e Punëve të Brendshme e zbaton këtë pjesë të marrëveshjes dhe unë mund t'ju informoj se në bazë të statistikave të Ministrisë së Brendshme, deri më tash, rreth 3 mijë 100 tabela ilegale kanë dalë prej përdorimit dhe janë zëvendësuar me tabelat legale të Republikës së Kosovës, si dhe mund t'ju them se prej 1 nëntorit shihen zyret të cilat kanë lëshuar tabela ilegale paralele.

E njëjta do të ndodhë me çështjen e marrëveshjeve të tjera, p.sh. marrëveshja për regjistrat civilë ka filluar së zbatuari më 5 dhjetor, që nënkupton që shihen zyrat që deri tash kanë dhënë dokumente të gjendjes civile për qytetarët, ndërsa sa i takon p.sh. tregtisë së lirë, tashmë zyrat paralele që dikur kanë shërbyer si dogana paralele apo polici paralele, ato kanë dalë nga përdorimi, sepse eksportuesit e Republikës së Kosovës, gjatë eksportimit të mallrave në Serbi, tashmë shkojnë sipas, pra parimit të reciprocitetit ndërmjet dy vendeve dhe kështu pra është procesi i daljes nga, sigurisht, funksionimi i strukturave paralele dhe unë mund të numëroj edhe për marrëveshjet tjera, por besoj ju i keni parasysh këto dhe po ashtu dua ta njoftoj Parlamentin se ne kemi dorëzuar...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! A keni pyetje shtesë, zoti Aliu?

LIBURN ALIU: Natyrisht që përgjigja do të duhej të ishte konkrete, përgjigja po jepet këtu në formë të një procesi, unë jo më larg se dje i pashë tabela të Prishtinës "PR" në mes të Prishtinës. Pra, këtu bëhet fjalë për datën 1 nëntor, ju mund të përgjigjeni në këtë, në formë procesi, do të doja ta dija kështu: njohja, premtimi për njohjen e Serbisë që ka qenë, a do të jetë edhe ky një proces, pra akt i njohjes një proces shumëvjeçar apo si është puna?

Sepse, të gjitha premtimet kur të jepen me data, gjithmonë tash po është përgjigja e një procesi shumëvjeçar mbrapa asaj date.

KRYESUESI: Zëvendëskryeministre, e keni fjalën!

ZËVENDËSKRYEMINISTRJA EDITA TAHIRI: Deputet Aliu, zbatimi i marrëveshjeve nuk është një spektakël aksionesh, por është pikërisht një proces. Askund në botë nuk ndodh që arrihet një marrëveshje dhe prej nesërmit zbatohet plotësisht. Pikërisht është një proces i mundësive operacionale dhe afateve optimale.

Andaj, besoj se edhe ju gradualisht duhet kështu t'i kuptoni proceset, po jo me logjikën e spektakleve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputeti Haziri, pyetje për ministrin Slobodan Petroviq.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit, kryesues!

Cili është plani, zoti ministër i MAPL-së, për themelimin e komunave të reja me shumicë shqiptare, e në veçanti i rishikimit funksional të aneksit 3, plani i presidentit Ahtisari që rregullon pushtetin lokal?

KRYESUESI: Zoti zëvendëskryeministër Petroviq, e keni fjalën!

SLOBODAN PETROVIÇ: Hvala, gospodine predsedavajući!

Uvaženi zamenici premijera, ministri,

Poštovani narodni poslanici,

Uvaženi narodni poslaniče Haziri,

Pre svega se zahvaljujem na pitanju! Imajući u vidu da sam na ovo pitanje i pismeno odgovorio prošle nedelje, ali sam svakako spreman i sada da vam dam ponovni odgovor. Dakle, Ministarstvo za lokalnu samoupravu je pri završetku procesa osnivanja novih opština, predviđenih prema sveobuhvatnom predlogu plana za status Kosova predsednika, gospodina Martija Ahtisarija i Zakona o administrativnim granicama. Kao što već znate da na Kosovu, paket predsednika Ahtisarija i Zakon o administrativnim granicama ne predviđa osnivanje novih opština, osim onih što su osnovane, kao i osnivanje nove opštine severne Mitrovice. Međutim, Ministarstvo administracije i lokalne samouprave je počelo sa razmatranjem opcija o mogućnostima osnivanja drugih novih opština, koje nisu predviđene prema sprovedjenim zakonima. Mi kao Ministarstvo studiramo sve okolnosti, analizirajući i specifičnosti određenih naselja, da bi one bile u skladu sa Zakonom za administrativne granice, odnosno sa članom 9. 10. i 11.

Što se tiče funkcionalnog sagledavanja aneksa 3. Sveobuhvatnog plana predloga za status Kosova, paketa predsednika Ahtisarija i dispozicije Zakona o administrativnim granicama opština, o održivosti funkcionisanja novih opština, vlada se na osnovu gore navedenih dispozicija obavezuje da napravi jedno takvo sagledavanje. Šest meseci posle objavljivanja konačnih rezultata popisa stanovništva na Kosovu, jer je to jedan od ključnih razloga, odnosno i obaveza. Ministarstvo će biti spremno da preduzme sve mere za njihovu realizaciju, uključujući i konsultacije sa zajednicama. Ja sam potpuno siguran da ste vi bili u prilici da već vidite da je Ministarstvo za administraciju lokalne samouprave već krenulo u tom pravcu, i svakako kao i izmenu i dopunu zakonodavne

strategije Vlade i eventualno uključivanje izmene i dopune, koje se evidentiraju u toku razvoja procesa za osnivanje novih opština. Ono što mogu da potvrdim i kao ministar za lokalnu samoupravu, pre svega želim da vam se zahvalim na vašoj ulozi koju ste kao prvi ministar u Ministarstvu za lokalnu samoupravu napravili trasu za formiranje novih opština i da je vaša uloga bila jako značajna. Koristim priliku da se zahvalim i vama narodnim poslanicima, koji ste na tom polju dali veliki doprinos kroz adekvatne amandmane i zakone i ...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit!

A keni pyetje shtesë, zoti Haziri?

LUTFI HAZIRI: Zoti ministër,

Jemi në fundin e 3 vjeçarit të shpalljes së pavarësisë dhe aneksi është eksplicit, thuhet në periudhën 3 vjeçare pas shpalljes së pavarësisë, aneksi 3 rishikohet nga institucionet e Kosovës dhe nga Grupi Ndërkombëtar për Kosovën, i cili përfshin rolin kritik të Ministrisë së Pushtetit Lokal. Duke dashur t'i përmirësojmë përmirësuar të gjitha problemet teknike në implementim e sipër që evidentohen dhe duke pasur parasysh se edhe FSK-ja apo sektori i sigurisë e ka rishikimin e garantuar, kryeministri në verën e këtij viti është përgjigjur në pyetjen e njëjtë se në fund të këtij viti do të bëhet rishikimi. Jemi në fund të këtij viti e edhe më tutje po kërkohet afat shtesë për rishikim, po defunksionalizimi i disa institucioneve lokale po ndodh. Pyetja ime është konkrete, se problemi me komuna të reja me shumicë shqiptare dhe me pakica jo serbe siç janë: boshnjakët dhe të tjerët...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Po, rregullorja s'ta jep gjysmë minutë. Edhe 20 sekonda Lutfiut!

LUTFI HAZIRI: Pyetja ime është konkrete: Kur do të ndërmerri veprime konkrete si Qeveri për ta rregulluar çështjen e pushtetit lokal, sepse ka probleme serioze në funksionimin e këtyre institucioneve dhe a keni ndërmarrë, sepse Zhegra si komunë ka veprim të njëanshëm ta shpallë komunën atje, për shkak të neglizhencës dhe paqartësisë që keni shkaktuar ju si Qeveri?

KRYESUESI: Zoti ministër!

MINISTAR SLOBODAN PETROVIÇ: Zahvaljujem! Verovatno dobro znate da je jedan od osnovnih razloga, pre svega koji je vezan za zakonsku regulativu, da upravo krene proces, pre svega, i zahtev za formiranje nove opštine, jeste pre svega konačni izveštaj o popisu stanovništva, što je prvi osnov za formiranje nove opštine.

S druge strane, ono što je posebno značajno, ja verujem da ste vi to prepoznali u evo 6 godina aktivnosti, koje imam zajedno sa svojom strankom, da mi pre svega ljude delimo na one koje znaju i ne znaju, na dobre i loše, ne delimo ih na zajdenice, pogotovo u

proces decentralizacije, nešto što se ne deli na zajednice koje su na Kosovu i svakako želim da vas informišem da je 11 zahteva došlo u Ministarstvo lokalne samouprave za formiranje novih opština i svakako moje iskreno zalaganje jeste potvrda da ti ljudi imaju pravo da traže zahtev za formiranje nove opštine, kako bi se olakšao njihov život. Znači to je upravo i suština procesa da bi institucije bile bliže građanima, a moja posvećenost je i dalje takva da ću biti na tom polju gde ću zajedno sa svojim kolegama, zajedno verujem i sa vama i uopšte sa kosovskim društvom raditi na onom izazovu koji imamo svi zajednički, a to je da obezbedimo što bolji i kvalitetniji život naših građana. Zahvaljujem se!

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputetja Nazane Breca, pyetje për ministrin Ferid Agani.

NAZANE BRECA: Faleminderit!

I nderuari kryesues!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

I nderuari ministër Agani,

Kohë më parë është bërë një pyetje nga një deputete në lidhje me zgjedhjen e kryeinspektore në Ministrinë e Shëndetësisë, doktoreshës Arjeta Baraku, e cila në të njëjtën kohë është edhe në specializim.

Çka keni ndërmarrë ju, ministër në lidhje me këtë çështje? A ia keni ndërprerë specializimin, apo postin e kryeinspektore, sepse ligji nuk i lejon që të dy këto poste në të njëjtën kohë për shkak të specifikave dhe obligimeve që i ka posti i kryeinspektore.

KRYESUESI: Zoti ministër!

FERID AGANI: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

E nderuara zonja deputete,

Doktoresha Ardita Baraku është zgjedhur në detyrën e kryeinspektore shëndetësore të Republikës së Kosovës sipas procedurave ligjore të parapara me Ligjin nr. 03L-149 për Shërbimin civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores 02/2010 për procedurat e rekrutimit në Shërbimin civil të Republikës së Kosovës.

Ajo ka kontratë të rregullt pune në Ministrinë e Shëndetësisë për pozitën e kryeinspektorit. Ndërkaq, sa i përket specializimit ju sqaroj se doktoresha Baraku, shkollimin sepcialistik në fushën e shëndetit publik e realizon me financim vetanak dhe jo me mjete të Ministrisë së Shëndetësisë.

Njëkohësisht, dua t'ju informoj se ngritja profesionale e nepunësve civilë është e lejuar me nenin 35, paragrafi 1, 2 dhe 3 të Ligjit për shërbimin civil, ku thuhet se nepunësit civilë mund të autorizohen që të marrin pjesë programe speciale, arsimore jashtë

Shërbimit civil, me kusht që këto programe të jenë të rëndësishme për Shërbimin civil të Kosovës.

KRYESUESI: Faleminderit!

A keni pyetje shtesë, deputete Nazane Breca_

NAZANE BRECA: Zoti ministër, specializimi, koha e specializimit, domethënë, kur e kryen doktoresha edhe posti i kryeinspektore, domethënë, koha e punës janë në të njëjtën kohë, për shkak se ajo e ka specializimin, domethënë, në Institutin Kombëtar të Shëndetit Publik, e cila punon vetëm paradite.

Si është e mundur edhe pse e paska voluntare, që të njëjtën kohë t'i kryejë të dy këto obligime? Ajo sa e di unë e kryen specializimin vazhdon, specializimi që e ka ajo pasdite nuk mund të shkojë, se kish mund, p.sh. në qoftë se e paska voluntar edhe mbas orarit të punës si kryeinspektore. Si është e mundur në të njëjtën kohë t'i kryej këto dy poste, pozita?

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër veç një sekondë, e lus administratën që çështjet që s'janë për Parlamentin, të mos na vijnë kësi pyetje në Parlamentin e Kosovës, janë çështjet e administratës dhe Ligjit mbi funksionimin e shërbyesve civilë.

Zoti ministër, e keni fjalën!

MINISTRI FERID AGANI: E nderuara zonja deputete, Çështja e realizimit të programit sepcialistik është çështje e Komitetit për specializime, i cili është i ngritur nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë, konkretisht Komiteti për Specializime në lëmin e shëndetësisë publike.

Unë iu kam drejtuar me kërkesë kryeinspektore që të sjellë mendimin e Komitetit për specializime përkitazi me atë se a është në gjendje që të kryejë, të realizojë programin specialistik në pajtim me ligjin apo jo? Në bazë të mendimit të Komitetit për specializime në lëmin e shëndetësisë publike do të veprohej më tutje.

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputetja Time Kadrijaj, pyetje për ministrin Agani.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit!

Ministër, a mund të na sqaroni lidhur me rastin e tenderit me numër reference 206/ 029/ 111 për furnizim me penj kirurgjik dhe si është bërë përzgjedhja e kompanisë furnizuese dhe pse tenderin për këto barna e ka fituar operatori më i shtrenjtë?

KRYESUESI: Zoti ministër, e ke fjalën!

MINISTRI FERID AGANI: E nderuara zonja deputete,

Zyra e Prokurimit të Ministrisë së Shëndetësisë, ka udhëhequr procedurën e prokurimit, furnizimi me barna dhe material medicinal shpenzues nga lista esenciale e Ministrisë së Shëndetësisë, ritender me numër 206/11/029/111.

Njësia Llot 20 ka qenë furnizimi me penj kirurgjikal dhe kanë ofertuar gjithsej 11 kompani, që të mos i lexoj tash secilën prej tyre dhe me çmime të cilat kanë ofertuar. Zyra e Prokurimit e ka shpërblyer me kontratë operatorin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët “Liri Med” shuma e kontratës 921 mijë 872.30 euro. Lidhur me këtë prokurim 2 operatorë ekonomik kanë paraqitur ankesë, pra në organin shqyrtues të prokurimit, i cili i ka hedhur poshtë ankesat meqenëse pretendimet ankimore të tyre kanë qenë të paqëndrueshme.

Me vendim të organit shqyrtues të prokurimit, Ministria e Shëndetësisë ka vazhduar procedurat drejt dhënies së kontratës operatorit ekonomik “Liri Med”.

KRYESUESI: Faleminderit!

A ke pyetje shtesë, deputetja Kadrijaj?

TIME KADRIJAJ: Në një pyetje pak më herët që e ka bërë një deputet keni thënë se do ta hulumtoni këtë rast dhe do të jepni një përgjigje në Kuvend, por ju zoti ministër nuk e keni dhënë. Siç e cekët edhe ju, në këtë tender kanë konkurruar 11 kompani. Kompania e cila ka fituar tenderin është kompania e 8 me radhë, domethënë, janë radhitur sipas çmimit. Atëherë, kompania që ka fituar edhe kompania e parë dallimi në çmim janë diku 500 mijë euro. Ju kësaj kompanie ia keni dhënë tenderin për 3 vjet, domethënë, ju veç me këtë tender po i shkaktoni humbje Ministrisë së Shëndetësisë diku 1 500 000. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti ministër!

MINISTRI FERID AGANI: Zonja deputete, unë më duket isha i qartë në përgjigjen time të parë dhe ju e dini shumë mirë se vendimet e organit shqyrtues të prokurimit publik janë vendime të marra me një procedurë profesionale, juridike dhe me kompetencë të plotë ligjore. Ky organ i shqyrtimit prokurues e ka marrë një vendim dhe e ka kërkuar nga Ministria e Shëndetësisë që të vazhdojë në atë drejtim dhe të marrë vendimin e duhur.

Prandaj, mendoj se të kontestohet një vendim plotësisht ligjor nuk ka kuptim.

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputeti Liburn Aliu, pyetje për ministrin Dardan Gashi.

Ministri nuk është këtu, dëshironi ta bëni pyetjen?

Zoti Liburn Aliu e ka fjalën.

LIBURN ALIU: Do ta bëj pyetjen kur të vijë ministri.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Salih Morina, pyetje për ministrin Blerand Stavileci. Ministri nuk është, dëshironi ta bëni pyetjen?

Zotit Morina, fjalën!

SALI MORINA: Po, kryesues.

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Pyetja ime ka të bëjë për ministrin Blerand Stavileci. Sa është numri i të punësuarve në kontratë mbi vepër ose për shërbime të veçanta, cila është mënyra e pagesës së tyre, nga cili kod buxhetor dhe a është në kundërshtim pagesa e tyre me Ligjin për shërbimin civil, me Ligjin mbi menaxhimin e financave dhe me Ligjin mbi buxhetin e vitit 2011?

KRYESUESI: Faleminderit!

Zoti ministër e ke fjalën.

MINISTRI BLERAND STAVILECI: I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

Për shkak të vlugut të madh të punëve, veçanërisht në Njësinë e Pagesave e cila në të ardhmen do të jetë Agjenci e Pagesave që bën menaxhimin e aplikacioneve dhe kontrollin e tyre në terren, si dhe për shkak të limiteve të ndryshme në rekrutimin e punëtorëve, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, ka angazhuar një pjesë të punëtorëve me shërbime të veçanta, të cilët paguhen nga kodi organizativ për mallra dhe shërbime, sepse shumica prej tyre janë të angazhuar nëpër zyrat rajonale.

Marrëveshjet për shërbime të veçanta lidhen në bazë të nenit 12, paragrafi 4 të ligjit numër 03/L-149 për shërbimin civil, i cili thotë: “emërimet me afat të caktuar për një periudhë më të shkurtër se 6 muaj, do të bëhen në bazë të kontratave të quajtura marrëveshje për shërbime të veçanta, të cilat i nënshtrohen Ligjit për detyrime dhe për të cilat zbatohet një procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit, si dhe në bazë të Rregullores numër 07/2010 për emërimin e nëpunësve civilë”, përkatësisht nenit 3 ku parashihen instrumentet ligjore për emërimet në Shërbimin civil, përkatësisht paragrafi 2 i cili thotë: “ marrëveshje për shërbime të veçanta, të parapara në nenin 12, paragrafi 4 të Ligjit për shërbimin civil lidhen me afat të caktuar dhe jo më gjatë se 6 muaj.

Kohëzgjatja e këtyre kontratave për shërbime të veçanta bazohet në marrëveshje njëmuajore, pra jo më të gjata se një muaj dhe, siç e thashë edhe në fillim, pra të gjitha këto janë pjesë e Agjencisë së Pagesave, strukturë administrative, e cila jo vetëm në vendin tonë, po edhe në vende tjera është nga strukturat administrative më të nevojshme për absorbimin e fondeve strukturore nën komponentin e impardit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

A keni pyetje shtesë, zoti Morina?

Zoti Morina e ka fjalën.

SALI MORINA: Faleminderit, ministër! Do të thotë, në kontratë mbi vepër ose në kontratë për shërbime të veçanta, në Ministrinë tuaj keni të punësuar 31 persona, që ka të bëjë pikërisht edhe me zyrtarë të niveleve të ulëta si asistentë, e po ashtu shoferë të automjeteve dhe nuk përkojnë me kontratën në cilën kontratë të shërbimeve thotë:

ekspertë për nevoja të veçanta. Dhe po ashtu pagesat e tyre janë duke u ndodhur nga investimet kapitale, nga projekti i komasacionit të tokave në Gjakovë dhe kjo është në kundërshtim me të gjitha ligjet të cilat i përmenda më herët.

KRYESUESI: Ministër, e ke fjalën!

MINISTRI BLERAND STAVILECI: Faleminderit, edhe një herë!

Besoj se unë i dhashë sqarimet e duhura. Nuk është e vërtetë! Unë tregova se nga cili kod ata paguhen dhe nuk është e vërtetë se ka të tillë, mund të vini në Ministrinë tonë për t'i parë. Shumica prej tyre, pra janë pjesë e këtyre strukturave administrative që unë i përmenda, në veçanti Njësinë e Pagesave dhe për çfarëdo informacioni shtesë, pra mund të vini dhe të merrni në Ministrinë tonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka pyetje tjera. Konsideroj që koha për pyetje parlamentare është ezauruar.

Vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës, që është:

3. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur me 7 dhe 8 dhjetor 2011

Në sallë janë 76 deputetë.

Pyes deputetët, a ka ndokush vërejtje në procesverbalin paraprak? Nuk ka!

Atëherë, konstatoj se Kuvendi miratoi Procesverbalin e mbledhjes plenare të mbajtur më 7 dhe 8 dhjetor 2011.

Vazhdojmë me pikën e katërt të rendit të ditës, që është:

4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2012

Komisioni Funkcional për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2012 dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Edhe komisionet e përhershme e kanë shqyrtuar Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2012 dhe Kuvendit i kanë paraqitur raportet e tyre.

Ftoj kryetaren e Komisionit Funkcional për Buxhet dhe Financa, Safete Hadërgjonaj, që para deputetëve ta arsyetojë raportin me rekomandime. Zonjusha Safete e keni fjalën.

SAFETE HADËRGJONAJ: I nderuar, zoti nënkryetar i Kuvendit,
Të nderuar zëvendëskryeministra,
Të nderuar ministra,
Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës, si dhe ka shqyrtuar edhe të gjitha kërkesat që iu kanë drejtuar Komisionit për shqyrtim dhe në fund ka përgatitur amendamentet që ju, deputetë të nderuar, i keni sot në seancë.

Komisioni për Buxhet dhe Financa, në bashkëpunim me Projektin e bashkëpunimit ndërkombëtar gjerman GIZ, menjëherë pas miratimit në parim të Projektligjit për buxhetin, ka hartuar planin e veprimit për amendamentimin e Projektligjit.

Sipas këtij plani janë formuar tri grupe punuese, ku është respektuar kriteri pozitiv-opozitiv sipas Rregullores së brendshme të punës të Komisionit për Buxhet dhe Financa.

Grupet punuese i kanë shqyrtuar 86 kërkesa buxhetore, 8 amendamente të deputetëve dhe komisioneve parlamentare dhe 3 rekomandime të komisioneve funksionale, si dhe ka organizuar edhe 20 dëgjime buxhetore me organizatat e ndryshme buxhetore.

Të gjitha rekomandimet e grupeve punuese janë analizuar në Komisionin për Buxhet dhe Financa, ku edhe janë hartuar amendamentet të cilat janë votuar një nga një në Komision e po ashtu është miratuar edhe Raporti përfundimtar dhe i është rekomanduar Kuvendit që t'i miratojë ato me amendamente.

Bazuar në punën që është bërë në grupet punuese dhe në Komision, ndiej për obligim t'i falënderoj të gjithë anëtarët e Komisionit për Buxhet dhe Financa për angazhimin e përditshëm, korrektësinë gjatë punës dhe për profesionalizmin e treguar.

Për të gjitha ndryshimet që i kemi propozuar si amendamente, kemi pasur një qëndrim të përbashkët dhe nuk kemi pasur kundërshtime.

Edhe anëtarët e Komisionit nga opozita kanë marrë pjesë në mënyrë aktive në formulimin e amendamenteve dhe në ndryshimet që i kemi propozuar, bile edhe kanë qenë pjesë të propozimeve të cilat ne i kemi miratuar në Komision.

Prandaj, në emër të Komisionit, kërkoj që të gjitha amendamentet që sot ne i kemi prezantuar këtu, të miratohen.

Po ashtu falënderoj Projektin për bashkëpunim ndërkombëtar gjerman GIZ, për përkrahjen teknike dhe me ekspertë, si dhe Institutin Nacional Demokratik, për përkrahjen që na e ka dhënë në angazhimin e ekspertëve.

Të nderuar deputetë,

Komisioni për Buxhet dhe Financa, e vlerëson shumë nënshkrimin e Marrëveshjes me Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe kthimin në programet e tij, kështu që kemi qenë të kujdesshëm në mos ndryshimin e kufijve buxhetorë të cilët kanë qenë të harmonizuar me Fondin Monetar Ndërkombëtar.

Brenda këtyre kufijve të përcaktuar, kemi bërë përpjekje të bëjmë përmirësime të nevojshme, ashtu që të kemi një ndarje sa më të drejtë dhe më të mirë nëpër organizatat buxhetore, të nivelit qendror dhe lokal, si dhe në institucionet e pavarura që i raportojnë Kuvendit.

Kolegë deputetë,

Në emër të anëtarëve të Komisionit për Buxhet dhe Financa, më duhet të ngrejë këtu një çështje, që është ngritur disa herë nga ana e Komisionit për Buxhet dhe Financa – miratimi i Ligjit për pagat e funksionarëve të lartë publikë.

Mungesa e ligjit ka sjell konfuzitet në përcaktimin e pagave të zyrtarëve të lartë të institucioneve të pavarura, por edhe pakënaqësi të disa zyrtarëve të këtyre institucioneve.

Në mungesë të bazës ligjore, është e pamundur të bëhet harmonizimi i pagave të këtyre institucioneve të pavarura sipas kërkesës së tyre, gjë që shkakton pakënaqësi tek ata.

Komisioni për Buxhet e Financa rekomandon që sa më shpejt të miratohet Ligji për pagat e funksionarëve të lartë publikë. Nëse Qeveria brenda këtij viti nuk e sjell ligjin për miratim në Kuvend, Kuvendi të ngarkojë Komisionin funksional, të hartojë këtë ligj, ku do të bëhej kategorizimi i institucioneve të pavarura sipas rëndësisë së tyre, si dhe të përcaktohet statusi i të punësuarve, a janë të punësuarit në këto institucione shërbyes civilë që duhet t'i nënshtrohen Ligjit të shërbyesve civilë apo trajtohen ndryshe?

Dhe, krejt në fund, e theksoj edhe një herë se në Komisionin për Buxhet dhe Financa, me një votë kundër, është miratuar Raporti me rekomandime, andaj kërkoj nga të gjithë deputetët që t'i miratojnë amendamentet e propozuara dhe ta miratojnë si tërësi Ligjin e buxhetit për vitin 2012. Faleminderit për vëmendje!

KRYESUESI: Faleminderit! Sipas Rregullores, neni 58 paragrafi 1, të drejtë diskutimi kanë përfaqësuesit e komisioneve të përhershme. Nuk është paraqitur askush, në emër të komisioneve të përhershme.

Përfaqësuesit e grupeve parlamentare e kanë radhën.

Fjalën e ka kërkuar në emër të Grupit Parlamentar "Vetëvendosje" deputeti Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryesues!

Amendamentet të cilat na janë sjell përpara për Ligjin për buxhetin, në shumë raste po them, jo të gjitha, por në shumë raste e përmirësojnë këtë ligj deri diku. Domethënë e bëjnë më të mirë, veçanërisht të këto amendamentimet të cilat janë në pjesën tabelore të buxhetit ku në njëfarë forme disa padrejtësi në buxhetin fillestar janë adresuar, veçanërisht ndaj agjencive të pavarura dhe kështu me radhë.

Mirëpo, përgjithësisht, Grupi Parlamentar i Lëvizjes "Vetëvendosje" konsideron që me gjithë këto përmirësime të vogla, ky buxhet prapë nuk është i mirë dhe vërejtjet të cilat i kemi dhënë në leximin e parë të buxhetit, të gjitha ato qëndrojnë. Rrjedhimisht, Lëvizja

“Vetëvendosje” nuk mund ta votojë këtë buxhet “për”, si tërësi, edhe pse disa prej amendamenteve janë të pranueshme për ne. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të LDK-së nuk e kërkon fjalën askush, në emër të PDK- së, jo, SLS, jo. AAK, jo, 6+- jo.

Radha është e Qeverisë.

Qeveria nuk e ka kërkuar fjalën.

Radha është e deputetëve.

Deputetja Alma Lama e ka fjalën.

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryesues!

Me Rregullore na takon edhe në leximin e dytë të bëjmë komente. Unë do të thosha shkurtimisht vetëm këtë, që edhe sikur ky projektligj për buxhetin t’i adresonte të gjitha problemet e tjera dhe të ishte perfekt, nuk do ta kisha votuar vetëm për një arsye, sepse nuk ka marrë parasysh situatën tepër të rëndë në Spitalin Onkologjik, ku pacientët shkojnë me dhjetëra e me qindra dhe presin me radhë dhe nuk kanë ilaçe të duhura për t’u trajtuar.

Kjo është një gjendje tepër e rëndë dhe do ta kisha ftuar ministrin dhe kryeministrin të shkonin në këtë spital, ku pacientët ballafaqohen çdo ditë me situatë tepër të vështirë.

Jeta e tyre është në rrezik, sëmundja me të cilën ballafaqohen është sëmundje e cila shkakton vdekjen, kështu që Qeveria është dashur të jetë shumë më e ndjeshme, veçanërisht në lidhje me këtë.

Ne si Grup i Grave e kemi vizituar këtë spital dhe kemi parë se ka mungesë të mjeteve financiare për ta adresuar këtë problem dhe buxheti i këtij viti nuk e ka marrë parasysh këtë fakt. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Zenun Pajaziti!

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryesues!

Më lejoni që shkurtimisht t’ ju informoj se kam bërë disa rekomandime në emër të Komisionit për Zhvillim, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, kanë të bëjnë me buxhetin e këtyre agjencioneve të cilat janë të monitoruara drejtpërdrejt prej Kuvendit. Janë rekomanduar disa çështje që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me plotësimin e kriterëve që kanë të bëjnë me Raportin e Progresit, mendoj se do ta marrim ne përgjegjësinë për të gjitha ato që mund të jenë mangësi.

E dyta, unë kam bërë dy amendamente, të cilat nuk janë vetëm në emrin tim, janë po ashtu të mbështetura nga zonja Salihe Mustafa, Hydajet Hyseni dhe Nijazi Idrizi.

Dhe, më lejoni që vetëm shkurtimisht t’ ju informoj se qëllimi ka qenë që ta ndihmojmë edhe Komisionin për Buxhet dhe Financa dhe po ashtu Qeverinë që pak a shumë disa prej premtimeve që kanë qenë t’i pasqyrojë në buxhetin e këtij viti. Dhe më lejoni t’iu them që njëri prej propozimeve që ka të bëjë me lumin Mirusha në Gjilan, Komisioni e

ka marrë parasysh, por pjesërisht, unë personalisht nuk jam i kënaqur me shumën e cila është paraqitur për realizimin e këtij projekti.

Megjithatë, unë e tërheq amendamentin dhe po ashtu me pajtimin e deputetëve, me qëllim që të ketë një koordinim më të mirë edhe të komunës dhe Ministrisë së Ambientit, dhe po ashtu edhe me mbështetjen e Ministrisë së Financave, e cila është zotuar që nëse projekti shkon mirë, do të mbështetet gjatë vitit në vijim.

Po ashtu me një amendament tjetër që ka të bëjë me një studim të rrugës Dheu i Bardhë, Gjilan – Ferizaj, është një kërkesë e një numri të madh, jo vetëm e këtyre deputetëve, po edhe të një numri të madh të taksapaguesve mjaft të disiplinuar të asaj ane edhe qytetarëve të Preshevës e të Bujanocit që të ketë më në fund një studim për atë rrugë.

Kërkesa ime ka qenë vetëm të ndryshohet një kod, emërtimi i një kodi dhe kam marrë një përgjigje nga Ministria e Infrastrukturës se brenda atij kodi mund të fillojë studimi për këtë rrugë. Po ashtu, edhe nga Ministria e Financave që nëse ka nevojë për mjete shtesë, gjatë vitit do të qiten, unë mbetem me shpresë se këto dy projekte të realizohen gjatë vitit në vijim.

Dhe, kërkoj, po të isha thirrur nga komisioni në takimet e tyre të rregullta, me siguri do të ishin sqaruar këto amendamente dhe e kam pritur një ftesë nga Komisioni. Unë kërkoj që këto t'i tërheq dhe po ashtu mbetem me shpresë se Qeveria do t'i trajtojë të dy këto projekte që janë të rëndësishme për atë pjesë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! E drejta për të marrë pjesë në mbledhje të komisioneve është e rezervuar për të gjithë deputetët. Dhe, e dyta, pash reagime që s'duhet diskutuar. Të drejtën e fjalës ua jep të gjithë deputetëve Rregullorja, unë as s'ua jap as s'ua marr! Fjalën e ka deputeti Naser Osmani.

NASER OSMANI: Faleminderit, kryesues!

Është çështja e juaj qysh e drejtoni seancën, mirëpo neve si opozitë kjo na konvenon që të kemi një debat, thashë të përsëritur.

Çështja e leximit të dytë është çështja e votimit, prandaj kjo ishte ndërhyrja ime që mos të lënë hapësirë të diskutimeve të shumta. Por, meqenëse e mora fjalën, unë vetëm mund të them se Lidhja Demokratike e Kosovës e ka paraqitur variantin e vet për një buxhet ndryshe, i cili do të kishte edhe ndryshime në strukturën e buxhetit, domethënë, një buxhet alternativ, por meqenëse Qeveria, partia në pushtet realizon programe dhe qëllime, synimet e veta nëpërmjet buxhetit ka qenë e pamundur që kjo të realizohet.

Një që duhet ta them, është se Komisioni për Buxhet e Financa në shumë takime që ka pasur, ka pasur një kontribut të secilit anëtar të Komisionit, bile një kontribut të jashtëzakonshëm, por në veçanti ka pasur edhe një kontribut edhe një mirëkuptim dhe një tolerancë gjatë amendamentimit nga ministri i Financave dhe drejtori i Buxhetit, por meqenëse kemi koncepte të ndryshme politike, kemi programe të ndryshme politike, votimi do të jetë politik. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka tjerë të paraqitur për diskutim.

Atëherë, konstatoj se amendamentet 53, 54, të propozuar nga deputeti Zenun Pajaziti, janë tërhequr nga vetë kërkuesi dhe sipas radhës vazhdojmë me votimin e amendamenteve të propozuara. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim.

A dëshironi procedurë të përshpejtuar, meqenëse është ligj me rëndësi, apo doni me elektronikë? Atëherë, shkojmë vetëm për amendamentet të cilat duhet të votohen me elektronikë, i votojmë me elektronikë. Në sallë janë 105 deputetë.

Amendamenti 1.

Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

(Ndërhyrje)

Po, fol o burrë, kërkoje fjalën, mos më bën me duar!

A e ke kërkuar fjalën? Unë po ta jap fjalën, ti po thua s'dua të diskutoj.

(Ndërhyrje)

Fjalën e ke sa herë ta kërkojsh. Je kryetar i Grupit Parlamentar. Kërkoj falje, nëse s'të kam parë, por për reagime s'keni të drejtë, e keni të drejtën e fjalës. Vazhdo, e ke fjalën. Çfarë vërejtje ke?

Zoti Beqiri e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Faleminderit!

Ne sigurisht se mund të kemi reagime kur s'na e jepni fjalën. Unë e kërkoja, e ngrita dorën, por s'shikove, s'ka rëndësi kjo punë tash.

Ne kërkojmë që votimi të jetë elektronik.

KRYESUESI: Vazhdojmë. Amendamenti i parë. Besoj se nuk ka nevojë ta qesim në votim, për shumë arsye se është sipas Rregullores. Në qoftë se ka konsensus nga të gjithë që të votojmë me procedurë të përshpejtuar, e votojmë, në qoftë se s'ka, votojmë me elektronikë. Dhe shkojmë sipas Rregullores.

Amendamenti 1.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tani!

Faleminderit!

Konstatoj se me 66 vota "për", 23 abstenime, 6 vota "kundër", miratohet amendamenti 1.

Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi

Amendamenti 2.

Votojmë tani. Faleminderit!

Konstatohet se me 63 vota “për”, 28 abstenime, 1 “kundër”, miratohet amendamenti 2.

Amendamenti 3.

Votojmë tani.

Konstatohet se me 66 vota “për”, 1 “kundër”, 26 abstenime, miratohet amendamenti 3.

Amendamenti 4.

Votojmë tash.

Konstatohet se me 67 vota “për”, 1 “kundër”, 28 abstenime, miratohet amendamenti 4.

Në radhë është amendamenti 5.

Votojmë tash.

Konstatohet se me 64 vota “për”, 1 “kundër”, 29 abstenime, miratohet amendamenti 5.

Amendamenti 6.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 60 vota “për”, 12 “kundër”, 19 abstenime, miratohet amendamenti 6.

Amendamenti 7.

Votojmë tash:

Me 65 vota “për”, 2 “kundër”, 25 abstenime, miratohet amendamenti 7.

Amendamenti 8.

Votojmë tash:

Me 65 vota “për”, 10 “kundër”, 18 abstenime, miratohet amendamenti 8.

Amendamenti 9.

Votojmë tash:

Me 64 vota “për”, asnjë “kundër”, 28 abstenime, miratohet amendamenti 9.

Tani i kemi amendamentet në pjesën tabelore të projektligjit.

Votojmë Amendamentin 10.

Me 62 vota “për”, 3 “kundër”, 30 abstenime, miratohet amendamenti 10.

Tash votojmë amendamentin 11.

Me 63 vota “për”, 2 “kundër”, 27 abstenime, miratohet amendamenti 11.

Amendamenti 12.

Me 62 vota “për”, 1 “kundër”, 30 abstenime, miratohet amendamenti 12.

Amendamenti 13.

Me 63 vota “për”, asnjë “kundër”, 28 abstenime, miratohet amendamenti 13.

Amendamenti 14.

Me 64 vota “për”, asnjë “kundër”, 29 abstenime, miratohet amendamenti 14.

Amendamenti 15.

Me 63 vota “për”, asnjë “kundër”, 28 abstenime, miratohet amendamenti 15.

Amendamenti 16.

Me 76 vota “për”, asnjë “kundër”, 20 abstenime, miratohet amendamenti 16.

Amendamenti 17.

Me 67 vota “për”, asnjë “kundër”, 26 abstenime, miratohet amendamenti 17.

Amendamenti 18.

Me 66 vota “për”, asnjë “kundër”, 29 “abstenime”, miratohet amendamenti 18.

Amendamenti 19.

Me 63 vota “për”, 2 “kundër”, 28 abstenime, miratohet amendamenti 19.

Amendamenti 20.

Me 61 vota “për”, asnjë “kundër”, 30 abstenime, miratohet amendamenti 20.

Amendamenti 21.

Me 65 vota “për”, asnjë “kundër”, 30 “abstenime”, miratohet amendamenti 21.

Amendamenti 22.

Me 63 vota “për”, asnjë “kundër”, 30 abstenime, miratohet amendamenti 22.

Amendamenti 23.

Me 64 vota “për”, asnjë “kundër”, 29 abstenime, miratohet amendamenti 23.

Amendamenti 24.

Me 77 vota “për”, asnjë “kundër”, 18 abstenime, miratohet amendamenti 24.

Amendamenti 25.

Me 62 vota “për”, asnjë “kundër”, 23 abstenime, miratohet amendamenti 25.

Amendamenti 26.

Me 65 vota “për”, asnjë “kundër”, 26 abstenime, miratohet amendamenti 26.

Amendamenti 27.

Me 61 vota “për”, 1 “kundër”, 25 abstenime, miratohet amendamenti 27.

Amendamenti 28.

Më 61 vota “për”, asnjë “kundër”, 30 abstenime, miratohet amendamenti 28.

Amendamenti 29.

Më 60 vota “për”, asnjë “kundër”, 26 abstenime, miratohet amendamenti 29.

Amendamenti 30.

Me 61 vota “për”, asnjë “kundër”, 28 “abstenime”, miratohet amendamenti 30.

Amendamenti 31.

Me 64 vota “për”, 1 “kundër”, 27 abstenime, miratohet amendamenti 31.

Amendamenti 32.

Me 63 vota “për”, asnjë “kundër”, 29 abstenime, miratohet amendamenti 32.

Amendamenti 33.

Me 65 vota “për”, asnjë “kundër”, 24 abstenime, miratohet amendamenti 33.

Amendamenti 34.

Me 63 vota “për”, asnjë “kundër”, 28 “abstenime”, miratohet amendamenti 34.

Amendamenti 35.

Me 64 vota “për”, 1 “kundër”, 25 abstenime, miratohet amendamenti 35.

Amendamenti 36.

Me 62 vota “për”, asnjë “kundër”, 27 abstenime, miratohet amendamenti 36.

Amendamenti 37.

Më 63 vota “për”, asnjë “kundër”, 29 abstenime, miratohet amendamenti 37.

Amendamenti 38.

Me 62 vota “për”, asnjë “kundër”, 28 abstenime, miratohet amendamenti 38.

Amendamenti 39.

Më 63 vota “për”, asnjë “kundër”, 29 abstenime, miratohet amendamenti 39.

Amendamenti 40.

Me 64 vota “për”, 1 “kundër”, 32 abstenime, miratohet amendamenti 40.

Amendamenti 41.

Më 64 vota “për”, asnjë kundër”, 28 abstenime, miratohet amendamenti 41.

Amendamenti 42.

Me 64 vota “për”, asnjë “kundër”, 28 abstenime, miratohet amendamenti 42.

Amendamenti 43.

Me 61 vota “për”, asnjë “kundër”, 30 abstenime, miratohet amendamenti 43.

Amendamenti 44.

Me 62 vota “për”, asnjë “kundër”, 31 abstenime, miratohet amendamenti 44.

Amendamenti 45.

Me 64 vota “për”, asnjë kundër”, 30 abstenime, miratohet amendamenti 45.

Amendamenti 46.

Më 60 vota “për”, asnjë “kundër”, 25 abstenime, miratohet amendamenti 46.

Amendamenti 47.

Me 64 vota “për”, asnjë “kundër”, 30 abstenime, miratohet amendamenti 47.

Amendamenti 48.

Me 63 vota “për”, asnjë “kundër”, 28 abstenime, miratohet amendamenti 48.

Amendamenti 49.

Më 61 vota “për”, asnjë “kundër”, 29 abstenime, miratohet amendamenti 49.

Amendamenti 50.

Me 62 vota “për”, asnjë “kundër”, 31 abstenime, miratohet amendamenti 50.

Amendamenti 51.

Me 64 vota “për”, asnjë “kundër”, 32 abstenime, miratohet amendamenti 51.

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit)

Vazhdojmë!

Amendamenti 52, është i Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, pa përkrahjen e Komisionit funksional.

Kryetarja e Komisionit, deputetja Safete Hadërgjonaj e ka fjalën.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Ne kemi pasur një amendament nga Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale. Dhe gjatë shqyrtimit të këtij amendamenti, sepse kërkesa ka ardhur nga ministri i Shëndetësisë, ne kemi ftuar ministrin e Shëndetësisë në dëgjim buxhetor dhe bashkërisht, edhe me ministrin e Shëndetësisë, edhe me ministrin e Financave, jemi dakorduar që të hartohet Ligji për shëndetësi për të cilin janë kërkuar këto mjete dhe të bëhet një kalkulim i saktë i kostos buxhetore të këtij projektligji dhe në kalkulimin e saktë të kostos buxhetore, atëherë të shikojmë, qoftë në vlerësim të buxhetit dhe në faza të mëtutjeshme që të llogarisim koston buxhetore dhe mandej të përkrahet.

Për këtë moment, bashkërisht edhe me dy ministrat, jemi dakorduar që të mos përkrahet në këtë fazë të amendamentimit të buxhetit.

KRYETARI: Faleminderit! Kemi amendamentin 52. Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, pa përkrahjen e Komisionit funksional.

Ministër, urdhëro!

MINISTRI FERID AGANI: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar zoti kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Ministria e Shëndetësisë e ka bërë këtë kërkesë në Komisionin për Buxhet e Financa, duke pasur parasysh nevojën për mbështetjen e reformës së filluar të shërbimeve shëndetësore në vendin tonë dhe këtë e ka arsyetuar me koston e cila ekziston në deklaratën financiare të dorëzuar në Ministrinë e Financave, aktualisht.

Është fakt se kjo deklaratë financiare do të rishikohet më 27 dhjetor me ekspertët e Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe Bankës Botërore dhe do të kemi vlerësimin përfundimtar lidhur me koston e këtyre dy ligjeve.

Në Komisionin për Buxhet e Financa, unë e kam paraqitur kërkesën, e kam arsyetuar nevojën për realizimin e kësaj kërkeje, sepse me të vërtetë është e nevojshme që buxheti i Ministrisë së Shëndetësisë, të përforcohet me këto mjete në vlerë prej rreth 10 milionë eurove, në mënyrë që të mundësohet implementimi i ligjeve, të cilat priten të bëhen shumë shpejt në fillim të vitit të ardhshëm.

Prandaj, kjo ka qenë kërkesa ime e parashtruar në Komisionin për Buxhet e Financa dhe më tutje procesi i vendimmarrjes ka shkuar në këtë komision, sipas dinamikës së tyre.

KRYETARI: Edhe një herë, të lajmëruar nuk ka.

Është amendamenti 52, Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, pa përkrahjen e Komisionit funksional.

Votojmë tash:

Me 29 vota “për”, 42 “kundër”, 27 abstenime, nuk kalon amendamenti.

Atëherë, amendamentet 53, 54 u tërhoqën nga deputeti Zenun Pajaziti.

E kemi amendamentin 55.

Deputeti Nijazi Idrizi, pa përkrahjen e Komisionit funksional.

Votojmë tash:

Me 13 vota “për”, 48 “kundër”, 27 abstenime, nuk kalon.

Amendamenti 56 i deputetit Nijazi Idrizi, pa përkrahjen e Komisionit funksional.

Votojmë tash:

Me 11 vota “për”, 52 “kundër”, 26 abstenime, nuk kalon amendamenti 56 i deputetit Nijazi Idrizi.

Dhe, në fund, kemi amendamentin 57.

Votojmë tash:

Me 64 vota “për”, asnjë “kundër”, 32 abstenime, miratohet amendamenti 57.

Ju njoftoj se prezent kemi 112 deputetë.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2012, në tërësi.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 63 vota “për”, 47 “kundër”, asnjë abstenim, Kuvendi e miratoi Ligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2012.

Nëse jeni dakord, e bëjmë një pauzë për kafe.

Vazhdimi i seancës pas pauze

KRYETARI: Të nderuar deputetë, po fillojmë me punë.

Në radhë është pika e pestë e rendit të ditës:

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Qendrën Historike të Prizrenit

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional për Bujqësi, Pylltari, Mjedis, Planifikim Hapësinor e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar që ky projektligj të mos miratohet dhe t’i kthehet Qeverisë, për ripunim.

Ftoj ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, zotin Dardan Gashi, që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe arsyetojë Projektligjin.

Fjalën e ka kryeministri. Urdhëro, zoti kryeministër!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: I nderuar kryetar,

Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

Më lejoni që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, të paraqes një ekspozitë të Projektligjit për Qendrën Historike të Prizrenit.

Pakoja e Ahtisarit dhe neni 8 i Ligjit për zonat e veçanta të mbrojtura, Qendrën Historike të Prizrenit e konsiderojnë si zonë të veçantë të mbrojtur edhe për shkak të specifikave të saj.

Ky projektligj do t’i rregullojë aktivitetet brenda kësaj qendre duke ruajtur karakterin e saj kulturor, historik dhe fetar.

Përmes këtij projektligji themelohet Qendra historike e Prizrenit, menaxhimi i saj, mbrojtja, ruajtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore, fetare dhe historike të Qendrës Historike të Prizrenit, si qytet me vlera kulturore, historike, të interesit lokal, shtetëror dhe ndërkombëtar; rregullohen aktivitetet që do të ndërmerren në kuadër të

kësaj qendre dhe mundësohet funksionimi i kësaj qendre kulturore dhe historike në mënyrë të papenguar, themelohet Komiteti për trashëgiminë Kulturore të Prizrenit, roli i të cilit është të mbikëqyrë dhe këshillojë rreth zhvillimit të aktiviteteve në Qendrën Historike të Prizrenit, me qëllim të ruajtjes së trashëgimisë kulturore të saj, themelohet Zyra e Qendrës Historike të Prizrenit, detyrë e së cilës është t'i koordinojë veprimet që kanë të bëjnë me mbrojtjen, zhvillimin dhe promovimin e Qendrës Historike të Prizrenit, përfshirë asistencën ndërkombëtare, promovimin dhe zhvillimin e Qendrës Historike të Prizrenit si destinim turistik me një trashëgimi kulturore të shquar, shumetnike, nxjerrjes dhe shpërndarjes së informatave të sakta sa i përket Qendrës Historike të Prizrenit, përfshirë hartat informuese, listën e shërbimeve të ofruara, agjendat kulturore dhe reklamat.

Të nderuar deputetë,

Kosova në asnjë rrethanë nuk rrezikohet nga implementimi i plotë i dokumentit të Ahtisarit, të cilin e kemi pranuar dhe negociuar të gjithë bashkërisht, Kosova në asnjë rrethanë nuk rrezikohet duke afirmuar të drejtat e komuniteteve, Kosova mund ta dëmtojë veten vetëm me papjekurinë e vet politike.

Ky ligj është mënyra më e mirë për të respektuar trashëgiminë kulturore të gjitha komuniteteve, jo vetëm atë ortodokse, por edhe krishtere e myslimane, pra të gjithë besimtarëve në Kosovë, apo trashëgiminë kulturore të gjithë qytetarëve në Republikën e Kosovës.

Pra, edhe një herë, të gjithë e kemi negociuar dhe pranuar dokumentin e presidentit Ahtisari, në bazë të cilit edhe e kemi shpallur Kosovën të pavarur dhe sovranë, ndërsa tash të gjithë me participim në jetën institucionale, në bazë të dokumentit Ahtisari e kemi pranuar dhe e kemi si obligim shtetëror, obligim dhe qytetar, por edhe vullnet afirmativ tonin. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka kryetari i Komisionit, deputeti Nait Hasani.

NAIT HASANI: Faleminderit, kryetar!

Përsëritje kryeministër, zëvendëskryeministra, ministra,
Kolegë deputetë,

Sot për herë të dytë e kemi në lexim të parë Ligjin për Qendrën Historike të Prizrenit. Komisioni për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, në mbledhjen e mbajtur më 12. 9. 2011 për trajtimin e Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit, ka vendosur në mënyrë unanime që Ministrisë t'ia kthejë Ligjin për ripunim, për arsye se ky ligj është ligj politik, ka shkelje të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të paketës së Ahtisarit.

Ne si Komision kemi shqyrtuar këtë ligj dhe kemi propozuar që t'i kthehet Qeverisë. Ne si Komision i kemi marrë në konsideratë reagimet e qytetarëve të komunës së Prizrenit dhe peticionin më 10.000 nënshkrime kundër këtij ligji.

I kemi marrë parasysh edhe reagimet e Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturorë, i zgjedhur nga ky Kuvend. E kemi marrë parasysh se ky ligj nuk është në pajtim edhe me Konventën e UNESCO-s.

E kemi marrë parasysh edhe Deklaratën e Asamblesë së Prizrenit dhe reagimet e shoqërisë civile në Prizren, në kundërshtim për Ligjin për Qendrën Historike të Prizrenit.

Ne kemi marrë parasysh edhe kundërshtim e Ligjit që është me Kushtetutën e Republikës së Kosovës e me nenin 8 të Kushtetutës për shtetin laik dhe inkriminimin politik të bashkësive fetare në këtë ligj.

Ne e kemi marrë parasysh edhe paketën e Ahtisarit e cila kërkon që për Prizrenin, në aneksin V të trashëgimisë kulturore dhe fetare, në pikën 4.1.7 për zonat e mbrojtura, për Qendrën Historike të Prizrenit, thotë se duhet të përcaktohet nga organet komunale të Prizrenit, në bashkëpunim me KIN dhe do të përfshijë objektet e Kishës Ortodokse, objekte otomane, katolike, të... dhe objekteve të tjera të rëndësisë së veçantë.

Ne kemi pasur parasysh edhe plotësimin që e ka prurë për këtë ligj në Kuvend ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, më datën 2.12.2011, me amendamente për Komisionin dhe këto amendamente i kemi shqyrtuar, ku Ministria e keqpërdor Deklaratën e Asamblesë, ku thotë se përfaqësuesit e Kuvendit komunal janë zotëruar të tërheqin kundërshtinë e tyre të mëhershme, të thënë në deklaratën më 8.9.2011, në Prizren.

Me këtë ministri ka bërë një shkelje të rëndë të procedurës, sepse këtë deklaratë mund ta zhvleftësojë përsëri asambleja komunale, jo individët e saj. Në kontakte me ta, me përfaqësuesit e komunës së Prizrenit, ata thonë se nuk kanë hequr dorë nga kërkesa e tyre që ligji të jetë në shërbim për qytetarët e Prizrenit e jo kundër qytetarëve të saj.

Të nderuar deputetë,

Unë mendoj se ky ligj është në kundërshtim edhe me pakon e Ahtisarit, por për këtë nuk do të thotë se ne si Kosovë nuk duhet të kemi ligje të tilla që e mbrojnë trashëgiminë kulturore, e të bëjmë ligje të tilla për mbrojtje të trashëgimisë, por ne kemi nevojë për ligje dhe edhe Prizreni ka nevojë për ligje, por jo për këso ligje që bëjnë ndarjen etnike, kulturore e fetare të Kosovës.

Unë nuk jam për këto ligje që shqiptarët i lë pa të kaluar, pa trashëgimi, pa traditë, pa objekte të kulturës. Unë nuk jam për këso ligje që Kishën Ortodokse e konsideron objekt kulturi të serbëve në Ballkan. Unë nuk jam që Kishën Ortodokse e konsideron vetëm të serbëve në Prizren dhe kur nuk ka pasur serbë në Prizren, ku e gjithë kjo pjesë ka qenë shqiptare dhe e besimit ortodoks.

Unë mendoj se Kisha Ortodokse duhet të quhet Kishë Ortodokse e Kosovës, e jo Kishë Ortodokse e serbëve. Ne kemi dëshmi të mjaftueshme që e dëshmojnë këtë. Ne kemi materiale dhe arkiva, po ashtu të shumta që flasin për shqiptarët në shekuj dhe popullsinë e saj në këtë trevë. Ne kemi arkiva nga Dubrovniku, nga Konstatinopoja apo Stambolli i

sotëm, ku e ka pasur edhe qendrën Selia e Shenjtë e Kishës Ortodokse. Ne mendojmë se objektet e kultit nuk kanë etni. Ato janë objekte të gjithë atyre qytetarëve që jetojnë në atë qytet apo vend.

Unë mendoj se me këtë ligj po i ndalojmë shqiptarët të tregojnë afinitetin e tyre të besimit. Unë mendoj se qyteti i Prizrenit është qytet i tolerancës së besimeve dhe qytet i shumicës shqiptare që duhet të marrë në konsideratë që jetojnë aty me mbi 90% të popullsisë.

Ndryshimet në disa nene që i ka bërë Ministria, nuk janë çështje e plotë e ligjit. Ligjit duhet t'i ndërrohet karakteri politik, ligji që shndërrohet në ligj për qytetarët e Prizrenit e jo duke ia hequr karakterin fetar dhe duke e ndryshuar ligjin e mbrojmë qytetin e Prizrenit. Pra, unë dua të kem një ligj që ma mbron qytetin e Prizrenit.

E kuptoj edhe Ulërike Llunaçek me Rezolutën e saj për Kosovën dhe këtë rezolutë që flet për Ligjin e Prizrenit dhe Hoqën, por nuk e kuptoj politizimin e fesë me shtetin, që e bën Ulërike Llunaçek. Unë e di që ne duhet të ecim përpara edhe pa këto, e me shumë këso ligje, por sot po vuajmë nga ligjet e importuara që nuk po gjejnë zbatim në Kosovë.

Unë mendoj se ky ligj nuk i plotëson kushtet për një harmoni ndëretnike e fetare në Prizren.

Unë kërkoj që të respektohet vullneti i qytetarëve të Prizrenit, më 10.000 nënshkrimet e tyre, të respektohen organizatat joqeveritare dhe qytetarët e Prizrenit.

Unë kërkoj që ky ligj për hir të demokracisë së brendshme dhe miqve tanë evropianë të dalë në referendum në Prizren, sepse shtetet demokratike për asgjë bëjnë referendum, dhe ne këtë e kemi obligim t'ua mundësojmë qytetarëve tanë këtë vullnet.

Unë mendoj dhe kërkoj që të vijë ekipi i ekspertëve të UNESCO-s për një vlerësim të ligjit dhe trashëgimisë në Prizren.

Të nderuar deputetë,

Mendoj se gjeneratat tona do t'i vlerësojnë në rrethana të kohës vendimet tona politike, prandaj, vendimet tona do të vlerësohen nga e ardhmja, nga perspektiva.

Dhe krejt në fund, objektet e kultit të Kosovës, si xhamitë, kishat katolike dhe kishat ortodokse serbe, janë të qytetarëve të Kosovës dhe duhet të quhen Kisha Ortodokse e Kosovës, Kisha Katolike e Kosovës dhe Bashkësia Islame e Kosovës dhe në këtë ligj duhet të thuhet qartë në një nga nenet e këtij ligji.

Dhe për këtë, nëse vërtet na duan miqtë tanë, mund të na ndihmojnë që edhe Kosovën ta bëjmë vend të qytetarëve të saj dhe të besimit të saj.

Ne i respektojmë të tjerët, por duhet edhe të tjerët të na respektojnë neve dhe kulturën tonë shqiptare në Kosovë. Faleminderit!

KRYETARI: Tani është fjala e kryetarëve të grupeve parlamentare.
Në emër të Partisë Demokratike, fjalën e ka deputeti Adem Grabovci.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryetar!

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Kolegë të nderuar,

Ne për veti e kemi një ligj që e vlerësojmë si grup parlamentar tepër të rëndësishëm, por duke pasur parasysh të drejtën tonë kushtetuese dhe obligimet tona ndërkombëtare, ku Republika e Kosovës e ka të garantuar me Kushtetutë dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe fetare, në tërë territorin e Kosovës, duke konsideruar dhe njohur si trashëgimi kulturore të Kosovës.

Duke pasur parasysh nenin 9 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ku thuhet: “Republika e Kosovës siguron ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë së vet kulturore dhe fetare”, neni 58, ku, në mes tjerash, thuhet: “Republika e Kosovës do të promovojë ruajtjen e trashëgimisë fetare dhe kulturore të të gjitha komuniteteve”, por duke pasur parasysh edhe Ligjin për trashëgiminë kulturore, numër 02/L-88, nga hyrja dhe pothuaj të gjitha nenet e këtij ligji na bëjnë të ditur se trashëgimia kulturore e krijuar gjatë shekujve e deri në ditët tona, është pjesë e trashëgimisë kulturore të popullit të Kosovës.

Po ashtu edhe Ligji për zonat e veçanta të mbrojtura, ligji numër 03/L-039, neni 11 pika 11.2, në mes tjerash, thuhet: “Të gjitha ligjet tjera që kanë të bëjnë me trashëgiminë kulturore, garantojnë se trashëgimia kulturore që ndodhet brenda territorit të Republikës së Kosovës, është e popullit të Kosovës”.

Prandaj, duke i pasur parasysh të gjitha këto argumente, po edhe argumentin kryesor se ky ligj është pjesë e pakos së Ahtisarit, që realisht mund të themi se ky ligj është votuar në Parlamentin e Kosovës, që ka ardhur prapë si ligj i veçantë për t’u votuar, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e voton këtë ligj dhe i fton të gjithë deputetët që të gjykojnë drejt, arsyeshëm dhe pa asnjë frikë, vlerësojmë që e ardhmja pikërisht do të na japë të drejtë për vendimet tona të drejta që po i biem sot, ashtu siç janë dëshmuar edhe shumë vendime tjera të drejta që janë marrë në të kaluarën. Ju faleminderit!

KRYETARI: Në emër të LDK-së, deputeti Sali Morina e ka fjalën.

SALI MORINA: Faleminderit, kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Meqë ky ligj nuk ka pësuar asnjë ndryshim prej herës së parë dhe si i tillë ka ardhur prapë në Parlament nga Qeveria, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike nuk do ta votojë këtë projektligj dhe njëherit kërkon që ky projektligj t’i kthehet prapë Qeverisë. Faleminderit!

KRYTARI: Faleminderit, deputet!

Në emër të “ Vetëvendosjes”, deputeti Liburn Aliu e ka fjalën.

LIBURN ALIU: Të nderuar deputetë,

Po diskutojmë pra sërisht Projektligjin diskriminues për Qendrën Historike të Prizrenit, projektligjin e njëjtë që e diskutuam në verë dhe e refuzuam dhe e refuzuam, sepse ishte diskriminues.

Dhe pikërisht për t’u dëshmuar edhe një herë arroganca e Qeverisë ndaj Kuvendit, ky projektligj vjen pa asnjë ndryshim.

Ashtu diskriminues si ishte pa i marrë fare parasysh vërejtjet e dhëna në diskutimin e parë, që u mbajt këtu në Kuvend.

Tani së fundi na erdhën edhe ca propozime të reja për ndryshim nga Qeveria, ndryshime këto që vijnë si rezultat më shumë i reagimit të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, që është organ kompetent për trashëgiminë kulturore, qytetarëve përmes peticionit, kundërshtimit të artikuluar të OJQ-ëve nga Prizreni dhe vendimit të Kuvendit Komunal në Prizren. Pra, si rezultat i shqetësimeve, e shqetësimeve me të drejtë nga qytetarët e Kosovës, mirëpo, këto ndryshime nuk i marrin fare pothuaj gati aspak këto shqetësime, pasi këto ndryshime janë vetëm periferike dhe nuk kanë të bëjnë me ato ndryshime substanciale që kërkoheshin.

Kur hymë sot në ndërtesën e Kuvendit, ishin përfaqësuesit nga OJQ-ët e Prizrenit që përpiqeshin të na pajisnin me argumente kundër këtij projektligji, janë pra po ata që mblodhën peticionin dhe që vërejtjet e tyre të studiuara mirë dhe të artikuluar qartë po përpiqen të na i ofrojnë. Fatkeqësisht, deri më tani ata kanë hasur në vesh të shurdhër dhe rikthimi kështu i këtij projektligji është dëshmia më e madhe për këtë.

Unë tani nuk do të hyjë në detaje dhe t’i rilexoj vërejtjet nga seanca e kaluar, pasi ato janë të transkriptuara, por do të fokusohem vetëm në tri pika, në atë ky projektligj është diskriminues, që ky projektligj i thellon ndarjet etnike dhe fetare, dhe që ky projektligj nuk e mbron, por e cenon trashëgiminë kulturore.

Ky projektligj është diskriminues dhe si i tillë është në kundërshtim me Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, me konventat ndërkombëtare kundër diskriminimit dhe madje edhe në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Ky projektligj e vë si autoritet mbi Qendrën Historike të Prizrenit, Këshillin për zbatim dhe monitorim, autoritet ky që sipas pakos së Ahtisarit është kompetent vetëm për mbrojtjen e trashëgimisë fetare dhe kulturore serbe në Kosovë. Pra, në pakon e Ahtisarit thuhet shumë qartë, që KZM është kompetente vetëm për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe fetare serbe në Kosovë.

Jemi të vetëdijshëm se brenda Qendrës Historike të Prizrenit kemi trashëgimi kulturore dhe fetare edhe të komuniteteve tjera etnike dhe fetare. Një autoritet i tillë, me ato kompetenca të veçuara vetëm për serbët, nuk do të duhej të qëndronte mbi tërë Qendrën.

Qendra Historike e Prizrenit nuk është qendër vetëm e serbëve, nuk është qendër e serbëve.

Rrjedhimisht duhet ta kemi të qartë që një autoritet i tillë sipas nenit 20, pika 3, që është autoriteti final mbi tërë Qendrën, i jep ngjyrim të tillë komplet Qendrës Historike të Prizrenit.

Sipas këtij projektligji parashihet të themelohet një komitet prej 7 anëtarësh, 3 nga bashkësitë fetare, 3 nga shoqëria civile dhe 1 nga Zyra për Kthim e Komunitete në komunën e Prizrenit. Krejt këto natyrisht sipas pakos për shumë kë, të dashur të Ahtisarit.

Cilido nga këta anëtarë, në rast të mospajtimit me ndonjë çështje, ka të drejtë që duke kërkuar konsultime shtesë dhe duke bërë moratoriumin, ta dërgojë çështjen në KZM, e cila prapë po e përsëris, sipas nenit 20.3 është autoriteti final më i lartë mbi Qendrën.

Këtu pra qëndron edhe elementi tjetër i diskriminimit, pasi ankesa e cilitdo nga përfaqësuesit përfundon në autoritetin që është i anshëm, pra në KZM, i cili është kompetent vetëm për trashëgiminë serbe. Në KZM, mos të harrojmë se nuk kanë përfaqësues të vetë as Bashkësia Islame, as Kisha Katolike të cilët janë komitet dhe mund të dërgojnë ankesa. Pra, siç dihet, nga pakoja e Ahtisarit në KZM ka vetëm Kisha Ortodokse përfaqësuesin e vet. Për vetë faktin që ky është elementi tjetër, i cili e bën tejet diskriminues këtë projektligj.

Prandaj, me këtë diskriminim të hapur do të doja të them që komplet ky projektligj është në kundërshtim me të drejtat e njeriut dhe me këtë rast po shikoj pak nga zotërinjtë atje ndërkombëtarë lart që janë në ballkon dhe nga zotërinjtë tjerë që sigurisht po na shikojnë dhe e ndjekin këtë, meqë atyre që po e bëjnë presionin më të madh lidhur me këtë projektligj e që është diskriminues, dua t'iu them se ky është në kundërshtim edhe me vlerat dhe ligjet e vendeve prej nga ata vijnë. Dhe nuk kanë të drejtë të na imponojnë neve diçka të tillë, pra, urdhëroni bëni ligje në vendet tuaja diskriminuese, por nuk keni të drejtë të na impononi neve të bëjmë ligje diskriminuese në vendin tonë.

Ky projektligj thellon ndarjen në baza etnike për vet faktin se sipas këtij ligji së pari bëhet deformimi i historisë me qëllime politike nacionaliste dhe përmes trajtimit të trashëgimisë ekskluzivisht si pronë të kombit serb. Ky instrumentalizim nationalist i trashëgimisë kulturore është me pasoja të mëdha, sidomos për faktin që te këto monumente shqiptarët janë bashkëtrashëgimtarë bazuar në të kaluarën e tyre palokristiane, katolike, ortodokse.

Trashëgimia kulturore duhet të lirohet nga nacionalizmat e me këtë projektligj po vazhdon të trajtohet trashëgimia kulturore si mjet në duart e nacionalizmit serb.

Historia dhe monumentet kërkojnë trajtim shkencor dhe jo politik. Trajtimi politik i historisë dhe trashëgimisë kulturore, njerëzimit i ka sjell vetëm urrejtje e lufta në të kaluarën. Ne tani po duam që këto pikëpamje t'i kalojnë të kaluarës.

Të nderuar ndërkombëtarë, sërish, ju po na flisni tërë kohën për integrimet, ndërsa këtu po i stimuloni ndarjet. Flisni vazhdimisht kundër nacionalizmit dhe me këtë projektligj po synoni ta impononi përforsimin e nacionalizmit serb në Kosovë.

E treta, është që ky projektligj nuk e mbron trashëgiminë kulturore, por përkundrazi e cenon atë. Cenimi i trashëgimisë kulturore qëndron në faktin që mekanizmat e tillë të mbivendosur njëri mbi tjetrin për shkaqe politike e bëjnë jo funksionale, i bëjnë jo funksionale këto mekanizma. Trashëgimia kulturore mbrohet nga komuniteti dhe jo nga të izoluarit dhe nga instrumentalizimi nacionalist.

Një ndër elementet kryesore të mbrojtjes së trashëgimisë kulturore është rivitalizimi i saj, pra Qendra Historike e Prizrenit duhet të jetë në funksion të qytetarëve, të mundësojë zhvillim dhe jo të izolohej. Për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore duhet respektuar rregullat dhe konventat ndërkombëtare përkatëse.

Duhet të kemi parasysh që kemi të bëjmë me vlera botërore dhe duhet të jemi tejet të kujdesshëm si sillemi me to. Nuk mund të lejojmë që për trashëgiminë kulturore të Kosovës të vendosen ligje të motivuara politikisht e që për më keq janë si rezultat i kompromiseve politike.

Nëse sot faktori ynë politik qenka i dobët dhe i shantazhuar përball presioneve shoviniste të Serbisë, prapë sërish lart, kjo nuk duhet të keqpërdoret nga askush dhe monumentet të shndërrohen në instrumente të nacionalizmit.

Të nderuar deputetë,

Njëri nga argumentet pro këtij ligji, është ajo që përmendet në Raportin e Progresit. Unë dhe ju e kemi lexuar atë raport dhe e dimë fare mirë që aty nuk shkruan askund, ligj diskriminues për Qendrën Historike të Prizrenit, por vetëm Ligj për Qendrën Historike të Prizrenit. Dhe ligj për Qendrën Historike të Prizrenit është normal që duhet të ketë, ajo duhet të mbrohet.

Duhet të mos harrojmë pra, se absurdet e tilla janë votuar edhe më herët. E kemi rastin e Projektligjit të Hoqes, ku me këtë projektligj që është votuar këtu në Kuvend, këtij autoritetit KZM i jepet përgjegjësi për planifikimin rural. Autoritetit të KZM që është për trashëgimi përgjegjës i jepet kompetenca për planifikimin rural, kjo i bie sikur t'i japësh një institucioni të kulturës kompetenca për ndërtimtari apo diçka tjetër. Dhe këtë ligj, e kemi votuar këtu, ky ka ndodhur një absurd që është votuar këtu, në këtë Parlament.

Po ashtu, e kemi ligjin tjetër për zonat e veçanta të mbrojtura, që në pikën e parë të këtij ligji, ai është diskriminues, ku thotë, shumë qartë që ky ligj do të sigurojë mbrojtjen e manastireve ortodokse, kishave dhe vendeve tjera fetare si dhe vendeve historike e kulturore të një rëndësie të veçantë për komunitetin serb, si dhe për komunitetet tjera. Pra, zona të veçanta, me çfarëdo ligji ndërkombëtar, janë zona për trashëgiminë kulturore, ato nuk bëhen vetëm për ndonjë komb të caktuar apo veçanërisht diçka për dikë.

Pra, të mos harrojmë që absurde të tilla janë votuar këtu. Dhe, sot mos të harrojmë që ky është votim tani, votim në parim e që i bie parimisht jemi dakord me diskriminimin dhe sidomos për faktin që u rikthye i pandryshuar. Kjo është në kundërshtim, jam i bindur, me jetën tuaj dhe me veprimtarinë tuaj në të kaluarën.

Nuk mund të ketë presion nga askush që do të mund ta detyronte dikë të votojë këtë projektligj. Shumë thjesht, janë dhjetëra dokumente, konventa e deklarata ndërkombëtare kundër diskriminimit që e mbrojnë sot votën tuaj. Faleminderit!

Drejtimin e mbledhjes e merr zoti Xhavit Haliti, nënkryetar i Kuvendit

KRYESUESI: Zoti kryeministër e ka fjalën.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Të nderuar deputetë, Kabinet qeveritar, Qytetarë të dashur të Republikës së Kosovës, Propozimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës është në përputhshmëri të plotë me Kushtetutën dhe ligjet e Kosovës. Është në përputhshmëri të plotë me dokumentin e presidentit Ahtisari, në bazë të cilit e kemi shpallur Kosovën të pavarur dhe sovranë, në bazë të cilit jemi duke e konsoliduar shtetin me 85 njohje, jemi bërë edhe anëtar i Bankës Botërore, edhe e Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe i kemi hapur perspektivë të qartë dhe konkrete evropiane Republikës së Kosovës, ditë më parë, kur vendet e Bashkimit Evropian, në mënyrë unike, propozuan për Kosovën, dialogun për liberalizim të vizave, marrëdhëniet tregtare dhe kontraktuale me Bashkimin Evropian dhe anëtarësimin e shpejtë të Kosovës, në Bankën për Zhvillim dhe Rindërtim Evropian. Dhe këto propozime, kjo mikpritje dhe kjo mbështetje e komunitetit ndërkombëtar për Kosovën, nuk kanë ndodhur rastësisht, por falë angazhimit tonë të përbashkët për ndërtimin e Kosovës demokratike, por edhe shumetnike, me qeverisje të mirë.

Prandaj, të gjithë e kemi votuar dokumentin e presidentit Ahtisari, të gjithë e kemi votuar Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe unë e kam Kushtetutën këtu, mund ta lexojmë nen për nen, nëse dëshironi, po, po se ky Kuvend e ka aprovuar, prandaj nuk është shpikje e Qeverisë ky ligj. Unë dëshiroj t'ju ftoj të gjithëve që ashtu siç kemi marrë përgjegjësitë bashkërisht edhe në të kaluarën, se edhe ne kemi qenë si Parti Demokratike e Kosovës në opozitë kur janë aprovuar dokumentet e presidentit Ahtisari dhe i kemi aprovuar me vullnetin më të lartë, me përgjegjësinë më të lartë shtetërore. Tash është fat që i gjithë spektri politik duke respektuar institucionet që kanë dalë nga mandati i presidentit Ahtisari, janë në Parlamentin e Kosovës, prandaj ftesa ime, edhe një herë, për të gjithë ju është, para se gjithash për ata që pretendojnë të nxisin urrejtjen ndërqytetore, ndaleni këtë nxitje! Respektoni Kushtetutën dhe ligjet e Kosovës!

Nuk rrezikohet Kosova duke respektuar të drejtat e komuniteteve. Nuk është ky ligj vetëm për komunitetin ortodoks. Është Qendër Historike për të gjithë, edhe për krishterë edhe të besimit mysliman.

Nuk rrezikohet Kosova nga objektet e kultit. Ju lutem, mos shitni patriotizëm fallco! Deficitet e së kaluarës kurrkujt s'mund t'ia mbulojmë sot. Dhe ju lutem, mos nxitni urrejtje, mos mbillni frikë tek qytetarët! Ju ftoj për përgjegjësi shtetërore. Ne duam të ndërtojmë shtet. Nuk është koha e fushatës elektorale. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Replikë, zoti Liburn Aliu.

LIBURN ALIU: Që Lëvizja "Vetëvendosje" është kundër pakos së Ahtisarit, kjo është e qartë. Po ajo çka desha të referohem, pikërisht është ky projektligj, i cili bën ndarje në baza etnike dhe fetare.

Pakoja e Ahtisarit për të cilën po flisni, thotë shumë qartë: KZM ka të bëjë me mbrojtjen e trashëgimisë kulturore fetare serbe në Kosovë. Pra nuk thotë të trashëgimisë kulturore në përgjithësi. Thotë decidivisht për serbe. Dhe ky autoritet, sipas nenit 20.3 është autoriteti kryesor mbi komplet zonën. Ky është diskriminim. Në zonë kanë të drejtë ankese edhe Bashkësia Islame edhe Bashkësia Katolike. Ku e dërgojnë ata atë ankesë? E dërgojnë në KZM ku ata nuk kanë përfaqësues të vet, sepse KZM-ja është përgjegjëse vetëm për trashëgimi serbe. Ky është diskriminim i hapur. Kjo është shumë e qartë, është diskriminim i hapur dhe kjo është antikushtetuese dhe është në kundërshtim me të drejtat e lirive të njeriut. E ke nenin, ku thotë, kundër diskriminimit, neni shumë qartë thotë. Kushtetuta thotë shumë qartë se është kundër, nuk e lejon diskriminimin. Prandaj, ky projektligj është në kundërshtim me Kushtetutën, por edhe me kartat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Dhe janë pastaj edhe aspekte tjera që e bëjnë ndarjen në baza etnike fetare, për vetë faktin që komplet zona e trashëgimisë të ndryshme cilësohet nën ombrellën e trashëgimisë serbe.

KRYESUESI: Për replikë, zoti kryeministër!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Jo, është sqarim, se unë nuk përmend emra dhe replikë është vetëm kur përmendet emri. Prandaj, arsyetoje këtë.

Unë do ta respektoj Kushtetutën që e kemi aprovuar vetë dhe nuk jam ai i cili tash hap debate për diskutimet politike.

Edhe një herë ritheksoj, Kosova nuk ndërtohet me këtë frymë kërcënuese ndaj komunitetit ndërkombëtar që po prezantoni këtu, ju që folët pikërisht më herët.

Në anën tjetër, ju ftoj ta lexoni Kushtetutën dhe ligjet e Kosovës. Në anën tjetër, duke qenë pjesëmarrës në Kuvendin e Kosovës në zgjedhjet e lira dhe keni bërë mirë që keni hyrë në procesin zgjedhor, keni pranuar dokumentin e presidentit Ahtisari, Kushtetutën dhe ligjet e Kosovës dhe e keni obligim t'i respektoni, sepse edhe këtu ka një kornizë të sjelljes në Kuvendin e Kosovës dhe është obligim i të gjithëve, sepse edhe kur është kërkuar vota para qytetarëve e keni kërkuar për të respektuar Kushtetutën e Kosovës dhe se shteti i Kosovës fuqizohet dhe konsolidohet vetëm duke e respektuar Kushtetutën dhe

jo duke nxitur dhe krijuar urrejtje ndëretnike, apo për të pretenduar për të marrë një autoritet jokushtetues që dikush pretendon.

Prandaj, edhe një herë e theksoj, unë nuk jam pronar as i dokumentit të Ahtisarit, as i Kushtetutës së Kosovës, as i ligjeve të Kosovës, unë si kryeministër i Kosovës dhe Qeveria e Kosovës, kemi obligim dhe do ta respektojmë deri në përpikëri Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Prandaj, Kushtetuta duhet të na bashkojë, zbatimi i saj duhet të na bashkojë, jo të na ndajë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka më replika, kundërreplika përfundoi për çështjen. Domethënë, e pate fjalën. Me Rregullore nuk ke të drejtë për kundërreplikë tjetër. Fjalën e ka në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, deputeti Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Fillimisht, më duhet për herë të dytë në seancë plenare rresht të ngrit çështje serioze, është hera e dytë rresht që udhëheqësit e seancës ia japin fjalën Qeverisë, pa e përfunduar fjalën kryetarët e grupeve parlamentare. Kjo nuk është praktikë parlamentare, për shkak se duhet të presin grupet parlamentare në radhë për të folur, edhe përfaqësuesi i Qeverisë, qoftë ai edhe kryeministri i Kosovës, duhet pritur kryetarët e grupeve parlamentare ta përfundojnë fjalën, dhe atëherë të replikojnë.

Përkundër kësaj, ndodhi edhe replikë edhe kundër replikë dhe mendojmë se nuk është korrekte, ka ndodhur edhe herën e kaluar, po ndodh edhe tash. Do të kërkojmë zyrtarisht, a kjo është veç fjalë zyrtare që të mos ndodhë më.

Sa i përket ligjit për të cilin po diskutojmë, Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës deklaroi me sa vijon:

Ne mendojmë se plani i Ahtisarit duhet të implementohet për shkak se kemi dhënë premtim para katër vjetëve, që një gjë e tillë të ndodhë, dhe neve nuk na vjen keq për atë që e kemi bërë. Mendojmë se kemi bërë mirë atëherë dhe mendojmë se implementimi i këtij plani është i mirë edhe tash.

Sidoqoftë, duhet thënë se lidërshipi politik imponon edhe marrjen e përgjegjësive direkt para qytetarëve dhe para popullit të Kosovës. Lidërship politik nuk domethënë të fshehësh prapa insistimit të bashkësisë ndërkombëtare ose prapa planit të Ahtisarit. Lidërshipi politik domethënë të dalësh para Kuvendit të Kosovës dhe të thuhet që ne besojmë se ky ligj është i mirë për qytetarët e Prizrenit, për popullin e Prizrenit, për Prizrenin, për Kosovën.

Ne nuk e kemi dëgjuar kryeministrin e Kosovës sot të thotë kështu edhe mendojmë se është imperativ që propozuesi i një ligji të dalë në foltore dhe të thotë: “ unë që e kam propozuar këtë ligj, besoj se është i mirë.” Nëse ne e dëgjojmë propozuesin e ligjit të thotë kështu, ai propozues “rrezikon” të na e mbush mendjen që ndoshta edhe ta votojmë ligjin.

Çështje tjetër është aspekti i Qendrës Historike të Prizrenit. Mbrojtja e Qendrës Historike të Prizrenit, nuk duhet të nënkuptojë mbrojtjen e Kishës Ortodokse Serbe. Është diskriminues ky aspekt.

Ne prapëseprapë mendojmë se kemi mundësi që eventualisht ta përmirësojmë këtë ligj, në mënyrë që të gjitha komunitetet fetare, por jo vetëm ato, po edhe qytetarët e Prizrenit, ta ndjejnë se njëri prej qyteteve më të bukura, më historike dhe më të ndieshme në Kosovë, që është Prizreni, ta ndiejë këtë peshë të ligjit të vet.

Çështja e fundit që dua të them sot është kjo, opozita edhe ne si Aleancë për Ardhmërinë e Kosovës, nuk jemi të obliguar t'i mbështesim, as politikat, as ligjet e Qeverisë së Kosovës e aq më tepër nëse vetë partitë në pushtet, të cilat e kanë votuar këtë qeveri dhe të cilat duhet medoemos ta mbështesin cilëndo politikë të Qeverisë dhe cilindo ligj të Qeverisë, nuk tregojnë se janë unike, nuk tregojnë se i kanë të gjithë deputetët, edhe nëse prej vetë këtyre partive dalin zëra të cilët tregojnë diku patriotizëm, diku populizëm, diku populizëm lokal dhe që shkaktojnë konfuzitet te ne.

Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, edhe një herë, definitive është, nuk është e gatshme t'i mbështetë politikat qeveritare të cilat nuk i mbështet as vetë partia në pushtet. Nëse një gjë e tillë do të ndodhte ndryshe, ju them edhe një herë se asnjëherë nuk kemi hequr dorë, nuk na vjen turp për të kaluarën, mendojmë se kemi bërë mirë në të kaluarën, dhe do ta bëjmë të njëjtën gjë edhe në të ardhmen. Pra, po kërkojmë seriozisht që propozuesi i ligjit të dalë në foltore dhe të na thotë që beson vetë, jo pse i thonë ndërkombëtarët, jo pse i thotë plani i Ahtisarit, por le të na thotë se beson vetë se ky ligj është i mirë për Kosovën, për Prizrenin dhe për qytetarët e Prizrenit. Faleminderit!

KRYESUESI: Veç një moment, sepse edhe unë tash kam replikë! Unë jam tani në cilësinë e kryesuesit të seancës dhe dua të them që unë nuk i nënshtrohem asnjë lloj presioni në seancë prej kurrkujt hiq, nëse doni ta dini!

Rregullorja e Kuvendit e përcakton saktë, kryeministri i Kosovës e kërkon fjalën sa herë ta lyp ai. Unë nuk ia kam dhënë, ia kemi dhënë ne të gjithë kryeministrit këtë të drejtë me Rregullore.

Nuk ka qenë praktikë, është e vërtetë, që në pjesën e diskutimeve të kryetarëve të grupeve parlamentare, prandaj ne vazhdojmë.

A e deshët fjalën?

Fjalën e ka kryeministri!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Unë të falënderoj, i nderuari kryesues! Ashtu siç është me Rregullore, le të respektohet në përpikëri. Nëse është për të polemizuar kur të përmenden emrat, okej, është në Rregullore. Nëse parashihet që edhe në kontekst të diskutimit, OK pajtohem, jam i gatshëm për replikë.

Të nderuar deputetë,

I nderuar zoti Gjini,

Me vlerësimin tim për punën tuaj për dokumentin e presidentit Ahtisari mbi qëndrimin politik partiak për mua është Kushtetuta e Republikës së Kosovës, që u aprovua më 15 qershor 2008. E kemi aprovuar bashkërisht edhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, edhe Partia Demokratike, edhe e nderuara Lidhja Demokratike e Kosovës dhe të gjitha komunitetet.

Por, e falënderoj edhe "Vetëvendosjen" që kanë hyrë në proces të dokumentit të presidentit Ahtisari, përmes procesit elektoral dhe sot jeni të ulur në bankat e Parlamentit. Mendoj se ky është avancim.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, pra ka hyrë në fuqi më 15 qershor 2008, u nënshkrua më 9 prill 2008.

E nderuara Lidhje Demokratike e Kosovës, ju drejtova me një fjalor dhe respekti, sepse keni dhënë kontribut të madh për dokumentin e Ahtisarit. Dhe këtu shoh në bankë, në ulësen e parë, ulësen e dytë, të tretë, të katërt, plot anëtarë të delegacionit të Kosovës në Vjenë që kemi qenë bashkërisht, edhe presidenti Sejdiu, edhe të tjerët, ndërsa ne kemi qenë si opozitë, kështu që ju e keni pasur shumicën kur ne kemi ...

Por, ne mbi të gjitha kemi pasur interesa shtetërore, pra Kosova së pari dhe jo partia së pari.

Pastaj, edhe sot, duke e respektuar Kushtetutën e Kosovës, ne vëmë si qëllim të parë Kosovën, mbi interesat elektorale partiake. Dhe sot, qëndrimi kundër, ta zëmë i juaj personalisht Ardian, më fal, por singërisht është befasues për mua kur vetë ke punuar në këtë dokument dhe këto ligje janë aprovuar, e theksoj edhe një herë, më 15 qershor 2008, me Kushtetutë të Kosovës. OK! Unë ju kuptoj, keni qëndrim politik partiak kundër këtij ligji, është vendim i juaj, është e drejtë legale dhe legjitime. Por, për Kushtetutë jemi meritore të gjithë. Për dokumentin e Ahtisarit, jemi meritore të gjithë, kështu që së paku, sa i përket kësaj çështjeje, të jemi korrektë me opinionin publik, të jemi korrektë edhe me faktorin ndërkombëtar, por para se gjithash ky është obligim kushtetues dhe ligjor dhe jo presion ndërkombëtar.

Prandaj, e gjitha që kërkoj, sepse është e drejtë e secilit të votojë për ose kundër, po shihen pozicionimet partiake, i akceptoj por së paku mos thirrni për urrejtje, mos thirrni për urrejtje ndërqytetore dhe mos mbillni frikë!

Dhe, në të njëjtën kohë, ju ftoj, askush nuk e akceton atë patriotizëm falso për vota. Faleminderit!

KRYESUESI: Replikë, zoti Gjini!

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Mendoj se pyetja të cilën Aleanca e shtroi për kryeministrin Hashim Thaçi, ishte tepër e qartë, jo të na tregojë Kushtetutën, se në Kushtetutë nuk shkruan që duhet të bëhet ky ligj, por të na tregojë a beson kryeministri që ky ligj është i mirë për qytetarët e

Prizrenit, për Prizrenin dhe për Kosovën? Edhe me sinqeritetin më të madhin, Grupi Parlamentar i Aleancës nuk ka ardhur këtu për të bërë populizëm, edhe nuk po bën populizëm, nuk ka ardhur për të bërë patriotizëm edhe nuk po bën patriotizëm, por po do të tregojë që kush e merr përgjegjësinë për të qeverisur nuk bën të fshehet edhe t' i lyejë me kos krejt temat. A beson a nuk beson që ligji është i mirë për Prizrenin edhe për qytetarët e Prizrenit, është tepër thjeshtë? Faleminderit!

KRYESUESI: Fjalën e ka kryeministri Hashim Thaçi.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Unë do të kisha pasur dëshirë, i nderuar kryesues, i nderuari Gjini, që të kemi disa pyetje-përgjigje direkt edhe ju të hapni mikrofonin edhe unë që të sqarojmë opinionin publik. Ju pyetët se a beson kryeministri se kjo çështje është e drejtë? Gjithçka çka është kushtetuese dhe ligjore, unë besoj që është e drejtë.

Pyetja ime është- A keni marrë pjesë në procesin e negociatave në Vjenë për dokumentin e Ahtisarit, a jo? Po ose jo, pyetja ime është për ju Ardian Gjini, i nderuar deputeti i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës.

KRYESUESI: Unë jam i detyruar që ta interpretoj Rregulloren saktë, që ma të mos ia jep fjalën as kryeministrit deri sa të kryhet fjala e kryetarëve të grupeve...

Në qoftë se fillojmë kështu, atëherë po e vazhdojmë, pra. E vazhdojmë sa herë... shiko, kryeministri ka kërkuar ta sqaroj çdo çështje që ka të bëjë me ligjin dhe që ngritet nga deputetët. Një çështje të tillë na ia kemi miratuar, sipas Rregullores, kemi diskutuar dhe është e drejtë imja, e drejtë edhe e replikës e zotit Beqiri tani, e pastaj e zotit Gjini që e ka kërkuar.

Zoti Beqiri e ka fjalën, për replikë.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë vetëm shumë shkurt, pa dashur të polemizoj është në rend të ditës projektligji, Lidhja Demokratike e Kosovës është e vetëdijshme dhe qytetarët tanë. Ne kemi dhënë kontribut dhe do të japim kontribut vazhdimisht edhe kemi dhënë në shtetformim edhe në shtetndërtim të Kosovës, këtë s'ka nevojë askush të na e përmend, por një gjë duhet ta kemi të qartë, ne jemi parti opozitare, nuk jemi në Partinë Demokratike, ne jemi Lidhje Demokratike dhe i themi qëndrimet tona dhe qëndrimi ynë është thënë nga zoti Morina, më herët pa dashur tash të hyj në elaborim të, as të Kushtetutës, i dimë obligimet tona dhe ne konform bindjeve tona, programit tonë edhe i themi qëndrimet. Kaq, dhe nuk dëshiroj të polemizoj më me këtë punë.

KRYESUESI: Faleminderit!

Replikë, Adem Grabovci, në emër të grupit parlamentar.

ADEM GRABOVCI: Shef i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës.

Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, isha shumë i qartë, i kemi mbështetur në të kaluarën vendimet e drejta të Qeverisë së Republikës së Kosovës, që koha i ka vërtetuar se kanë qenë të drejta. E mbështesim edhe këtë dhe i bëjmë thirrje deputetëve, që të votojnë këtë ligj, sepse jemi të bindur se prapë koha do të na japë të drejtë. Dhe, Qeveria ka pasur dhe ka mbështetjen e fuqishme të Grupit Parlamentar të PDK-së, për të gjitha vendimet e drejta që i merr në dobi dhe në interes të qytetarëve të Kosovës.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti shef i Grupit Parlamentar!
Zoti Hashim Thaçi e ka kërkuar fjalën.

KRYEMINISTRI: Të nderuar deputetë,
Qytetarë të republikës së Kosovës,
Kabinet Qeveritar,

Unë dëshiroj të sqaroj se po shoh që është si objektivë, që të ndahet një komunitet i caktuar dhe komunitetet të gjitha tjerat, shqiptar dhe joserbët në një anë. Dëshiroj të theksoj se nga 104 objekte që mbrohen në këtë ligj, vetëm 11 janë të Kishës Ortodokse, të tjerat janë të ndryshme e ndër to edhe Shtëpia e Lidhjes së Prizrenit.

Dhe, lexone nen për nen Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Edhe një herë theksoj, pyetja ime ishte shumë direkte dhe e drejtpërdrejtë për deputetin e nderuar, zotin Gjini, siç është shumë direkte edhe për krejt deputetët e Lidhjes Demokratike që kanë punuar për dokumentin e Ahtisarit. A keni marrë vetë pjesë në këtë dokument, apo jo? Unë nuk po ju ftoj të votoni, punë e juaj, ju ftoj në fakt, por është vendim i juaj, por, në raport me Kushtetutë dhe ligje, mendoj se nuk duhet të ketë pozicion opozitë – pozitë. Gjithçka që e forcon dhe konsolidon shtetin, ju ftoj të dilni mbi interesat e ngushta partiake. Prandaj, vetë i keni kontribuar, keni bërë mirë, bashkë me neve, kemi qenë të gjithë në Vjenë, e kemi aprovuar dhe mirëpritur dokumentin e presidentit Ahtisari, nuk qenka këtu edhe zoti Shala, zoti Haziri qenka këtu, zoti Hyseni qenka ketu, Ardiani po edhe unë po, edhe të tjerët që s'janë këtu, të gjithë kemi qenë në Vjenë dhe të gjithë e kemi aprovuar dokumentin e Ahtisarit e pastaj edhe Kushtetutën dhe ligjet e Kosovës.

Kosova është shtëpia jonë e përbashkët dhe duhet ta ndërtojmë për të gjithë, në mënyrë të barabartë dhe afirmative, por në të njëjtën kohë le të kthehemi pak në retrospektivë.

Ju e dini se ka pasur edhe protesta të ndryshme kundër formimit të komunave të reja, kinse në baza etnike. Ju e dini se deri në vitin 2007-2008 edhe në Shtërpcë ka pas barrikada edhe në Graçanicë. Ku janë sot ato? Sot kemi zgjedhje të lira, fer, demokratike, kemi lidhship legjitim, bashkëpunim të shkëlqyeshëm mes institucioneve qendrore dhe lokale dhe tani po ndodhë edhe investimi për, apo privatizimi i Qendrës së Skijimit e do të ndodhin mbi 100 milionë investime. Ndërsa, në Graçanicë, gjithashtu, ju e dini lëvizjen e lirë, bashkëjetesën, investimet e Qeverisë e gjithashtu edhe nëpër komunat tjera. Përndryshe, përfaqësuesit e Lidhjes Demokratike të Kosovës e dinë edhe më mirë, se kanë udhëhequr këtë proces dhe unë i kam mbështetur, sikurse kam mbështetur edhe zotin Gjini.... Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Aliu, për replikë!

LIBURN ALIU: Unë po e kuptoj që kryeministri po përpiqet ta relaksoj temën, unë po dua të kthehem në temë në pikat konkrete. Për sa i përket avancimit të Lëvizjes “Vetëvendosje”, edhe ju edhe ne jemi të vetëdijshëm për avancimin e Lëvizjes “Vetëvendosje”, ajo po vërehet. Jam kundër këtij relaksimi, po dua të kthehem konkretisht në temë. Kur flasim për Kushtetutën, është neni 24 i Kushtetutës, i cili thotë: “Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.”. Pra, neni 24 është kundër diskriminimit, Kushtetuta, të cilën e ka miratuar ky Kuvend.

Tash, për sa i përket urrejtjes është pikërisht ligji, konkretisht, i cili e nxitë urrejtjen. Duhet ne mos ta votojmë këtë ligj, pikërisht, për shkak të integritetit. Jo të nxisim urrejtje, jo t’i japim privilegje të veçanta, jo Lidhjen e Prizrenit, ta trajtojmë si trashëgimi kulturore serbe, sepse, brenda zonës, për të cilën kompetent është organi vetëm për trashëgimi kulturore serbe, ndodhet ai objekt. Ai objekt ndodhet brenda asaj zone. Pakoja e Ahtisarit, shumë qartë edhe një herë po e potencoj, e definon kompetencën e KZM-së, e cila është kompetente mbi zonën. Pra, trashëgimi kulturore fetare serbe. Aty gjendet Lidhja e Prizrenit. Kjo nuk duhet të lejohet.

KRYESUESI: Faleminderit!

Zoti Gjini, replikë.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryesues!

Nuk kam pritur që do të shkojë kështu kjo temë. Seriozisht, kemi pritur që kryeministri do të tregojë a beson që ligji është i mirë apo jo?

A kam qenë unë në Vjenë? Po.

A e kam mbështetur planin e Ahtisarit? Po. Mendoj se kam bërë mirë. Unë nuk fshehna prapa presionit, mendoj se kam bërë mirë. Bile, kryeministri e ka udhëhequr takimin e parë, nese i kujtohet, ishte në opozitë atëherë. Edhe një gjë. Nuk bën të shkojë kështu edhe të provosh për t’ia bërë qejfin krejt dynjasë edhe të provosh për t’ia hequr fajin prej vetit në të njëjtën kohë. Duhet për të treguar a është sht i mirë ligji a jo? Unë u përgjigja në pyetjen e kryeministrit edhe ky duhet të përgjigjet. A beson që ligji është i mirë për qytetarët e Prizrenit, ku është në pushtet? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Përgjegja e kryeministrit!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: I nderuari Ardian Gjini, deputet, të falënderoj për sinqeritetin tuaj, para qytetarëve të Republikës së Kosovës. Është e vërtetë se të gjithë kemi qenë së bashku, sidomos PDK, LDK dhe AAK, bile me përfaqësimin më të lartë partiak, edhe në grupet politike edhe për reformim të pushtetit lokal, por, unë kam qenë në opozitë, por për hir të interesave shtetërore i kam tejkaluar interesat partiake dhe kam marrë pjesë në procesin negociator për statusin politik që rezultoi qëndrim i drejtë i Partisë Demokratike të Kosovës, me pjesëmarrje në proces. Kurgjë, kurgjë, së paku s’ju kemi lënë të gaboni dhe ndihem mirë.

Pyetja ishte konkrete, se a beson që është ligji i mirë apo jo? Gjithçka, që buron nga Kushtetuta dhe nga ligjet e Kosovës, pra, nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës, është në interesin e qytetarëve të vendit.

KRYESUESI: Faleminderit!
Zoti Haziri, replikë!

LUTFI HAZIRI: Nuk janë replikë, por përgjigje në pyetje kësaj here. Por, po e shfrytëzojmë të drejtën, sipas rregullores. Fakt është që procesi i bisedave të Vjenës për rregullimin dhe akomodimin e brendshëm në Kosovë, që ka të bëjë me komunitetet etnike, e ka mbërri objektivin e vet dhe ka sjellë datën e 17 Shkurtit. Kryeministri, po i ikë ta përmend datën e 17 Shkurtit, po e përmend 15 qershorin, Kushtetutën. Por, sidoqoftë, unë dua ta lexuoj sepse ka keqinterpretime edhe nga kolegët tjerë. Te aneksi i trashëgimisë pika 4.1.7 thotë kështu: “Zona e mbrojtur për Qendrën Historike të Prizrenit do të caktohet nga organet komunale të Prizrenit, në bashkëpunim me KIM-in dhe do të përfshijë objektet e Kishës Ortodokse, objekte otomane, katolike dhe objekte tjera...”, i numëron atje. Krejt problemi është kështu, se ish ministri i Ambientit, ish ministri i kaluar i Ambientit, që është ministër aktual në Qeveri për Administratë Publike e ka nisur gabim ligjin. Draftimi i ligjit dhe ligji në sponsor është dashur të jetë në Ministrinë e Kulturës, ku është trashëgimia kulturore dhe ku janë mekanizmat më të specializuar për ta ndërtur këtë ligj. Këtu ka qenë problemi im, sepse se a kemi ne obligim ndaj këtij ligji, a kemi obligim ndaj kësaj pakoje, natyrisht, që kemi dhe nuk bën t’i ikum kurrë, sepse, janë marrë edhe janë deklaruar njëanshëm për t’u implementur në shumicën e rasteve. Sa i përket pjesës së reformat e pushtetit lokal, mu po më vjen keq, kryeministër, që se ke shtyrë hala procesin, pushteti lokal duhet të vazhdojë të reforohet totalisht dhe të decentralizohet deri në atë pikë, që ka mundësi të jetë funksional. Faleminderit shumë!

KRYESUESI: Faleminderit!
Kundërreplikë, sqarim shtesë, kryeministri!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: I nderuar Haziri,
Kushtetuta e Republikës së Kosovës ka hyrë në fuqi më 15 qershor 2008. Ndërsa, kur Kuvendi i Kosovës e ka aprovuar dokumentin e presidentit Ahtisari, ju kujtohet edhe juve shumë mirë. Kushtetuta e Republikës së Kosovës është nënshkruar më 9 prill 2008, kryetari i Kuvendit Jakup Krasniqi.

Sa i përket reformimit të pushtetit lokal, ju e dini zoti Haziri, se edhe juve ju kanë akuzuar dhe unë ju kam mbrojtur gjithmonë, që po e copëtoni Kosovën, po e bëni xhepa-xhepa, edhe për Shtërpçë edhe për Klllokot edhe për Ranillug, prandaj t’i respektojmë standardet e njëjta, sikur ju kur keni qenë në pushtet sikur tash, apo sikur kur kemi qenë bashkë, që kemi bërë komunat në periudhën e koalicionit LDK-PDK. Ndërsa, edhe tash mendoj sa i përket këtyre reformave, përsëri, është e drejtë e çdo subjekti politik, të votuarit “për” apo “kundër”, por, askush nuk mund të kontestojë se kjo çështje është kushtetuese dhe ligjore e në të njëjtën kohë, sa i përket, po e përmendni presionin ndërkombëtar, pavarësia e Kosovës, edhe negociatat, që ka buruar dokumenti i

presidentit Ahtisari, kanë qenë të udhëhequra nga komuniteti ndërkombëtar me prezencën tonë e në të njëjtën kohë edhe pavarësia e Kosovës është shpallur në përputhshmëri të plotë me orientimet e komunitetit ndërkombëtar dhe në koordinim të plotë me komunitetin ndërkombëtar pjesëmarrës në procesin e negociatave për statusin politik të Kosovës. Dikush mundet të thotë se kemi pasur edhe presion për ta shpallur pavarësinë, por ne kemi pasur mbështetje për ta shpallur pavarësinë dhe sot e kemi Kosovën të pavarur dhe sovranë me mbikëqyrje, me mbështetje ndërkombëtare. Por, ky është obligim kushtetues dhe ligjor, që e ka Qeveria dhe propozimi është kushtetues dhe jo njëpartiak apo në baza të diskutimeve politike, që thjeshtë nuk i afrojnë komunitetet, ndonjëherë. Prandaj, unë ju ftoj, që mbi të gjitha të jemi së paku korrekt me njëri-tjetrin dhe të mos i ndajmë tash kush është patriot e kush është më pak. Të gjithë jemi, shyqyr, patriotë, krejt që jemi këtu, të të gjitha komuniteteve.

KRYESUESI: Në emër të Grupit Parlamentar Koalicioni Kosova e Re, deputetja Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, zoti kryesues!

Edhe një herë duhet tërhequr vërejtjen, se pikë së pari flasin shefat e grupeve, masandej jepet replika. Të lutem!

Përshëndetje për kryeministrin, zëvendëskryeministrat dhe ministrat, që janë sot prezent në këtë seancë!

Përshëndetje për të gjithë deputetët!

Duke marrë parasysh se Projektligji për Qendrën Historike të Prizrenit vjen herën e dytë në Kuvendin e Kosovës dhe duke marrë parasysh se ministria, e cila është sponzorizuese e këtij ligji, ka sjellë disa ndryshime, atëherë Grupi Parlamentar i Koalicionit për Kosovë të Re ka shqyrtuar këtë ligj dhe duke pas parasysh se edhe vetë pavarësia e Kosovës është vendosur mbi pakon e presidentit Ahtisari dhe Kushtetuta e Kosovës, do të thotë se në këtë projektligj gjatë shqyrtimit të dytë, Komisioni kompetent për këtë projektligj, duhet të bëjë dy ndryshime në amendamente të posaçme, dhe këtu shihet se ky ligj bazohet në Ligjin për zonat e veçanta të mbrojtura, i cili është miratuar me pakon e presidentit Ahtisari. Atëherë, presim që të ndryshohen dy nene të këtij ligji dhe ligji të jetë i zbatueshëm për një të ardhme të afërt, mirëpo, prapë se prapë, mbetet mundësia që ky Kuvend të bëjë plotësim-ndryshimin e këtij ligji edhe në të ardhmen.

Koalicioni për Kosovë të Re, duke marrë parasysh se Kuvendi është i obliguar të miratojë ligjet, të cilat dalin nga pakoja e presidentit Ahtisari, i jep përkrahje këtij ligji. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

SLS, kush është? Sasha Milosavljeviq!

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala, gospodine predsjedavajući!

Poštovana Vlado,

Drage kolege,

Samostalna liberalna stranka će glasati za Zakon o istorijskom centru Prizrena. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit!
Grupi Parlamentar “6+”, Duda Balje!

DUDA BALJE: Zahvaljujem!
Parlamentarna Grupa “6+” je detaljno analizirala Nacrt zakona o Istorijskom centru Prizrena i donela odluku da se radi o zakonu koji je zaštitnički nastrojen prema kulturnim objektima i čitavoj kulturnoj baštini Prizrena, a među njima kao najstarijima Džamija Sinan Paše, Džamija Emin Paše, Arasta džamija, Sozi džamija, zatim Adžiizababa teče, Halveti teče, Topukli alti česme, Česma Sinan Paše, Bin Paši, Tas česme, Česma šadrvana, ... Hamam Gazi Mehmet Paše, Stari beledije, Maraš mahala i mnogi drugi koji upravo Prizrenu daju epitet najlepšeg i najvećeg kulturnog centra u našoj zemlji a i šire.

U toku jučerašnjeg dana od strane predsedavajućeg Skupštine Prizrena dobili smo preporuke, koje sponzori zakona nisu uzeli u obzir, a koje mi podržavamo u potpunosti i za koje ćemo uložiti dodatne napore da se kao amandmani usvoje kroz funkcionalne komisije zadužene za dati zakon.

U nadi i iščekivanju da će zakon doneti najveće koristi gradu Prizrenu, njegovim stanovnicima i čitavoj državi, podržaćemo nacrt zakona. Zahvaljujem!

KRYESUESI: Faleminderit!

Konstatoh që diskutimet në emër të grupeve parlamentare janë ezauruar. Tani vazhdojmë me diskutimet e deputetëve.

Fjalën e ka deputeti Hydajet Hyseni.

HYDAJET HYSENI: Faleminderit, zoti kryesues!

Zonja dhe zotërinj deputetë,
I nderuar kryeministër,
Të nderuar ministra,
Isha madje në dilemë të diskutoja apo jo dhe për qëndrimin që do të mbaja. Nuk e dëshiroj, po nuk mund të mos ndikohem edhe nga mënyra se si po trajtohen e si po debatohen këto çështje aq të ndjeshme. Nuk besoj se do të ndikojnë në qëndrimin tim, por megjithatë ma imponojnë një sqarim.

Ky ligj është kthyer në Kuvend, pas një debati që kemi pasur në Kuvend. Në atë debat nuk është kontestuar nevoja e mbrojtjes së monumenteve kulturore - historike dhe të atyre fetare. Nuk do të ishte mirë që t'i imputohet Kosovës, as organit më të lartë ligjvënës të saj, as cilitdo grup parlamentar se ka pasur një synim të tillë, sepse në Kosovë nuk ka një qëndrim të tillë dhe ne të gjithë krenohemi me te. Për arsye politike, as nuk do të ishte mirë opozita të nxijë Qeverinë, por nuk do të ishte mirë as Qeveria të përpiqet të nxijë opozitën, sepse e nxijmë vendin tonë, nxijmë fytyrën tonë. Për më tepër, Qeveria na ka sjellë të njëjtin ligj, pa ndryshimet që janë bërë në Kuvend. Është

elementare edhe si obligim dhe është në ndihmën e Qeverisë që t'i merrte parasysh vërejtjet që janë bërë në këtë ligj. Nuk janë marrë dhe për pasojë ne kemi ardhur praktikisht në të njëjtën gjendje dhe nuk besoj se këtu duhet të ndihmojmë tash kualifikimet e diskualifikimet politike dhe ndarja në një tabor, që duhet të tregohet sa më radikal e sa më patriotik dhe tjerëve t'ua lehtësojë pastaj pozitën, që ata t'i akuzojnë për radikalizëm e patriotizëm, por as në një pozicion gjithnjë e më në modë për t'u dëshmuar sa më shumë si e kundërta, si sa më proevropian, sa më fleksibël, sa më pak kombëtar e tjera. As njëra, as tjetra nuk ndihmojnë dhe unë nuk lejoj që, te unë së paku, të ndikojë cilado prirje e politizuar, e fryrë dhe bukur shumë teatrale.

Nuk i duhet Kuvendit të Kosovës një qasje e tillë kalkulative, politizuese. Çështja është e thjeshtë. Mbrojtjen e monumenteve nuk e konteston askush, mbrojtjen e monumenteve të pakicave edhe më pak. Ka dëshmuar Kosova dhe ky Kuvend se është i gatshëm madje edhe të japë më tepër se sa që është normale, le të qëndrojmë në këtë pozicion. Nuk është kjo e kontestueshme, e kontestueshme është - a është në përputhje me këtë që kemi synim, ajo që na është sjellë? Dhe, mendimi është i përbashkët, se nuk është.

Kryeministri po tregon Kushtetutën dhe mua s'ma lejon mundësia këtu, koha e shkurtër, por do të doja që në një debat edhe me kryeministrin dhe me cilindo t'i sheshonim çështjet konkrete, sepse disa dispozita në këtë ligj janë në kundërshtim edhe me Kushtetutën, janë në kundërshtim edhe me dokumentin e Ahtisarit, janë në kundërshtim edhe me dokumentet universale, ta zëmë, me të cilat funksionon UNESCO-ja e tjera. Çka ka të keqe nëse ato kontestohen dhe çka ka të keqe, nëse ato korrigjohen, ju lutem!

Dokumenti i Ahtisarit, i cili ka shumë mangësi, nuk ka kërkuar ligj të veçantë për Zonën Historike të Prizrenit, nuk ka kërkuar ligj të veçantë për një komunitet dhe ligj të veçantë për komunitetet tjera, ka kërkuar që këto çështje të rregullohen me ligj. Dhe, ky Kuvend ka miratuar Ligjin për zonat e mbrojtura, ka miratuar ligjin për trashëgiminë kulturore dhe është e mjaftueshme. Por, ligji për zonat e mbrojtura ka pasur një dispozitë që në anglisht është thënë, duhet të ndërtohen, si është tekstualisht, s'e kam tekstin përpara, to be set forth a low, që në gjuhën shqipe është përkthyer: "duhet të rregullohen me një ligj", është përkthim i pasaktë.

Dhe, nga kjo është nxjerrë pastaj përfundimi se duhet të jetë një ligj tjetër dhe nga kjo është nxjerrë se duhet të jetë një ligj special. Çështje që janë kërkuar të rregullohen në atë pikë, janë të natyrës urbanistike dhe janë të trashëgimisë kulturore, që fare lehtë kanë mund të rregullohen me Ligjin për trashëgiminë kulturore dhe me Ligjin për planifikimin hapësinor.

Por, megjithatë, është interpretuar siç është interpretuar dhe ne e kemi tash edhe në Raport të Progresit, e tjera dhe këtu na duhet edhe një grimë realizëm, na duhet edhe një grimë fleksibilitet. Le të bëhet edhe ligj i veçantë. Megjithëse, pyetja shtrohet - pse u dashka ligj i veçantë për Prizrenin dhe jo, ta zëmë, për Gjakovën? Pse nuk u dashka një ligj i veçantë për Prishtinën, që po na ... edhe këtu te hundët tona. Por, megjithatë kemi hyrë, është në raporte, çka ka të keqe që të bëhet? Por, çka ka të keqe që edhe ai të amendamentohet dhe të përmirësohet? Ajo që mua më shqetëson është një ton që e dëgjoj

nga prezantuesit e ligjit, që e përjashton mundësinë e ndryshimit të ligjit. Nuk duhet të pajtohemi me një qasje të këtillë. Ky Kuvend ose duhet t'i miratojë ligjet duke i shqyrtuar dhe duke i ndryshuar e duke përmirësuar ku ka gabime, ose të mos na sillen fare. Le t'i miratojnë në mënyrat, qysh i kanë miratuar atëherë në fillim me Ahtisarin e tjera. Por, nëse ne duhet t'i shqyrtojmë, le të na lejohet mundësia që t'i përmirësojmë. Ose nëse kontestohet, konsiderohet se nuk e kemi mirë, le të na bindin siç u tha. Dhe, unë jam i bindur se mbi këtë bazë ne mund të ndërtojmë unitetin edhe të opozitës, edhe të pozitës edhe të shoqërisë civile dhe Kosova të dalë faqebardhë në një çështje të tillë, në të cilën historikisht ka dalë faqebardhë.

Kosova nuk lejon të zërë në thua në çështjet e pakicave, të të drejtave të pakicave, as nuk është mirë të lejojmë prirje të tilla, as që t'ia imputojmë Kosovës një imazh të tillë, që nuk e ka, as pjesërisht nuk e ka.

Prandaj, edhe propozimi im është i ngjashëm me propozimin e përfaqësuesit të komunitetit boshnjak, që meqë kanë ardhur edhe amendamente nga komuna e Prizrenit dhe Kushtetuta na obligon, që ta marrim parasysh edhe vullnetin e komunitetit atje, është demokratike që ligjin ta miratojmë në parim. Besoj që këtui pajtohet pastaj edhe opozita, por ta ndryshojmë sipas standardeve demokratike, sipas parimeve të UNESCO-s dhe ta bëjmë një ligj të mirë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Eqrem Kryeziu.

EQREM KRYEZIU: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Po kërkoj falje se pritët, por më gjuajti atje verdikti i popullit, lart, kështuqë pritët njëfarë lloj kohe deri sa erdha këtu.

E dyta, një koleg imi nga PDK-ja tha: "more diçka t'u ka shukatur zëri qetash, nuk je diçka në rregull - tha, unë të njoh me soj e sorollop, por qashtu i qetë nuk ke qenë bash". Ai e kishte bërë një vërejtje shumë me vend, fundi i fundit, se kjo është e vërtetë. Unë po mundohem ta gjej njëfarë lloj diskursi, që është i pranueshëm për të gjithë, pa marrë parasysh polarizimet krejt legale në demokraci partiake etnike e tjera, e tjera. Duke qenë se po kërkoj diskurs të tillë, besoni që nuk po jam aq i mençëm sa të flas shpesh, këtu është krejt problemi.

E tash t'i kthehemi projektligjit, që është këtu sot në rend dite. Të them të drejtën, definitivisht, edhe pse në Vjenë kanë qenë forcat premtuese të LDK-së, nuk kam qenë unë, por sidoqoftë unë i mbështet ato gjëra. Edhe nuk kam fjalë se me zotin Gjinin pajtohem plotësisht, edhe me zotin kryeministër pajtohem plotësisht, se këto janë obligime ndërkombëtare që kemi marrë bashkë me Planin gjithëpërfshirës të presidentit Ahtisari.

Problemi mbetet për t'u shpjeguar, pse ky shqetësim në komunitetin e caktuar shqiptar? Pse? A mundet dikush ta komentojë? Unë po përpiqem ta interpretoj, duke u betuar se nuk jam frymëzues i reagimeve, vetëm po interpretoj ato pse ndodh kjo? Me gjasë, tash mbetet te ky Parlament të vendosë a është e vërtetë a jo, vetëmevete, se s'ke qysh ta

thuash me rezoluta. Me gjasë, komuniteti shumicë ka njëfarë lloj droje se ende ka albanafobi ataviste institucionale. Në qoftë se e thashë mirë, e falënderoj Zotin, se bajagi të mbrapshta janë këto fjalë. Jo, jo, më duket që mirë i shqiptova.

Shikoni, tash një miqtë tanë ndërkombëtar bëjnë gjoja që s'po shohin, edhe ne kombëtarët, gjoja kishe s'po dimë. Nuk ka nevojë kur të ndërtojmë ligje të një republike demokratike të luajmë symbyllazi. Dhe, të them të drejtën, meqë po përpiqemi të gjejmë një diskurs të pranueshëm për të gjithë, mu nuk më pengon pse dikush ka albanofobi. Mua më vjen keq, por është punë e tij, unë nuk mund t'ia nderroj mentalitetin, por pse unë të jem peng i atyre qarqeve albanofobike, ataviste, me ligje, unë këtë nuk po mund ta kuptoj. Sepse, Qendra Historike e Prizrenit është çelësi kryesor për përparimin e atij qyteti, meqë turizmi është karta e tij kryesore. Bashkë me universitetin, për të cilin sigurisht që kryeministri Thaçi e ka meritën dhe ia kam përmendur edhe kur kemi pasur luftë elektorale, jo veç tash. Pra, në qoftë se ti ia lë në dorë perin e Arianës, nga mitologjia greke, atëherë ti po rrezikon praktikisht ta paralizosh zhvillimin ekonomik të atij qyteti. Për këtë arsye, pra, po plani i Ahtisarit, pajtohem me Gjinin dhe me kryeministrin, por të gjenden modalitete që të mos krijohen nuanca aparthejdi, nuk ka shans, nuk ka kuptim.

Një Zot e di se komuniteti shqiptar është duke bërë gjithçka që është e mundshme ta harrojë të kaluarën, por nuk do të dëshironim që ato t'i fusim në dispozita ligjore. Pengesat e qarqeve të caktuara albanofobike, institucionale, ataviste, dikush mund të thotë, pse a ka të atilla? Po bëjmë shaka ne, a? Jo, që ka, po mundohen natë e ditë bre, qysh të ta nxijnë jetën. Nuk dëshirojmë të jemi peng i këtyre gjërave, s'ka nevojë, përndryshe nuk besoj se një pjesëtar, i vetmi një pjesëtar i mazhorancës, i shkon mendja ta cenojë sot legalisht ose zyrtarisht pronën, qoftë të Kishës Ortodokse, qoftë të dikujt tjetër.

Tani për Prizrenin, pati një tollovi të madhe të popujve të ndryshëm për ta shpallur Jerusalem të tyre. E përgëzoj kryeministrin, që në një moment edhe ky e pati kurajën, që nuk i mungon, tha: "Jo bre, tha, edhe për neve është Jerusalem". Po, me këtë projektligj, po duket se ky Prizreni do të jetë një Jerusalem i modelit grek, sepse ka një martesë ndërmjet pushtetit laik dhe religjioz.

Unë, të them të drejtën, jam simpatizues i hatashëm i kulturës greke. Si tha Fishta: "rrnofshin klasikët grekë". Për mua madje, jo vetëm klasikët, po edhe këndej, mirëpo ta marrësh modelin grek në këtë sahat kritik, ku është Greqia sot, me të vërtetë nuk është shumë premtuese.

Kështu që, unë me të vërtetë po them, me kënaqësinë më të madhe do të ndihmoja, do të jepja kontributin tim, edhe pse nuk jam aq i mençëm që të modifikojmë, që të shkojë pakoja e Ahtisarit në vend, por edhe mos të lihen jehonat e tilla. Në qoftë se dikush me mua ose me Ismetin, se ai është shef, s'ka nevojë me mua, le t'ia mbushë mendjen Ismetit se këtu është çdo gjë në rregull, unë them, po kërkoj falje edhe po ju them ditën e mirë, madje jo veç atyre, por edhe juve. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Goran Marinković.

GORAN MARINKOVIĆ: Hvala, predsedavajući!

Poštovani premijeru,

Poštovani ministri,

Poštovane kolege poslanici,

Kosovo je poznato bogatom raznolikošću tradicionalnih spomenika, uključujući tu srpske pravoslavne crkve, katoličke crkve, džamije, tvrđave, mostove i ostalo. Ovi lokaliteti su deo kulturnog nasleđa, koje doseže daleko van granica današnjeg Kosova. Oni odražavaju bogatu istoriju i kulturnu raznolikost Kosova, kao i Balkanskog regiona. Kosovske institucije su se obavezale da će štititi i promovisati kulturno i versko nasleđe od značaja za sve zajednice, koje sada žive na Kosovu. I moram napomenuti da je kulturno nasleđe zaštićeno i Ustavom i sveobuhvatnim predlogom za rešenje statusa.

U aneksu 5. jasno je definisano koje su i obaveze države oko verskog i kulturnog nasleđa na Kosovu. Zaštita verskog i kulturnog nasleđa na Kosovu takođe je deo akcionog plana za evropsko partnerstvo, koje utvrđuje prioritete za evropsku budućnost Kosova. Nove aktivnosti oko vrednih spomenika i lokaliteta reguliše preko osnivanja zaštitnih zona. Zaštitne zone imaju za cilj očuvanje kulturnog nasleđa i njegovo istorijsko okruženje. Važnost ovog nacrt zakona je da predviđa, reguliše i da određuje odgovorne autoritete za regulisanje i upravljanje Istorijskim centrom Prizrena, a kao zaštićeno područje da da zaštitu kulturnog i verskog nasleđa, kao i da kontroliše razvoj ovog istorijskog centra.

Poštovana gospodo poslanici, pred nama je nacrt zakona koji treba da reguliše i spreči zabranjene građevinske delatnosti, kao i sve delatnosti kojima se menja obličje sredine, kao i aktivnosti koje će rezultirati trajnu promenu morfologije terena. Moram napomenuti da je Nacrtom zakona o Istorijskom centru Prizrena u drugom poglavlju jasno definisano zabranjenje delatnosti i opasnosti sa kojom bi se Istorijski centar Prizrena susreo ako se ovaj nacrt zakona ne bi usvojio. S toga, gospodo, mi kao poslanici ovog Parlamenta moramo da pokažemo odgovornost i ozbiljnost i da se ne bavimo predrasudama kao šta je i čije je, da li je to srpsko ili albansko, da li je to Srpska pravoslavna crkva ili džamija, nego da smo s pravom izabrani predstavnici naroda i da se možemo ozbiljno nositi sa problemima koji su sada ispred nas.

S toga vas, gospodo poslanici, molim da podržimo ovaj nacrt zakona i pokažemo odgovornost i ozbiljnost i sačuvamo kulturno nasleđe, jer je ono deo nas i naše kulture. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Muhamet Mustafa.

MUHAMET MUSTAFA: I nderuari kryesues,

I nderuari Kabinet qeveritar,

Ne kemi një ligj para vetës, i cili meriton vëmendjen tonë, për shkak të rëndësisë së tij dhe për shkak të implikimeve të tij politike, sociale dhe kulturore.

Më lejoni të them 2-3 mendime lidhur me prapavijën e këtij ligji. Është fakt se ne kemi obligime me pakon e Ahtisarit që të kujdesemi për ruajtjen e trashëgimisë serbe dhe me ligjet tona mos të rrezikojmë atë trashëgimi për të cilën është i interesuar komuniteti serb, sepse këtu duhet të jemi pak të kujdesshëm. Unë i kuptoj plotësisht ata deputetë, kanë të drejtë që kisha ortodokse serbe, ne duhet të dimë që edhe shqiptarët kanë kishë ortodokse dhe ajo kishë ortodokse është autoqefale, e pavarur edhe nga grekët, edhe nga të tjerët.

Prandaj, janë çështje të cilat kërkojnë pak një debat më të stërholluar që njerëzit mos të preken për arsye se edhe në Kosovë kemi shqiptarë ortodoks dhe ekziston një trashëgimi ortodokse e shqiptarëve. Prandaj, duhet të jemi të kujdesshëm që këto gjëra t'i analizojmë me përgjegjësi.

Çështja tjetër në prapavijën e këtij ligji është nevoja e madhe që Qendra Historike e Prizrenit të mbrohet, ajo është goditë ka kohë ndoshta edhe para përfundimit të luftës në Kosovë, por sidomos pas luftës nga stihia e cila ka kapluar ndërtimin dhe mos respektimin e planeve urbanistike. Po të bisedosh me secilin prizrenas, ai do ta shprehë brengën se nga ndërtimi i egër dhe jo urban qytetarët e Prizrenit janë të prekur thellë. Por, prapavijë e këtij ligji është edhe një draft i cili është diskutuar këtu dhe i cili është kthyer që të diskutohet me qytetarët e Prizrenit, që të diskutohet me shoqërinë civile, që të diskutohet në Qeveri dhe që të diskutohet me ICO-në. Dhe unë kam besuar se i tërë ky kontekst do të ketë parasysh dhe do të gjendet një zgjidhje. Pra, jam i befasuar që ICO-ja, Qeveria, ministria përkatëse, komisioni përkatës i Kuvendit nuk kanë mundur të gjejnë një zgjidhje të pranueshme. Unë s'di a janë takuar këta njerëz mes veti, a i kanë shqyrtuar këto propozime? Duket se kjo nuk ka ndodhur, duket se ka munguar kultura debatit dhe mirëkuptimit, duket se në vend të komunikimit demokratik dhe të përgjegjshëm, ka dominuar logjika e imponimit, logjika e numrave, të sigurohen numrat dhe gishtat.

Më lejoni të theksoj se në këto çështje të ndjeshme, kjo logjikë është e fundit që duhet të vjen në shprehje, e fundit është logjika e imponimit. E para, është debati demokratik, e para është debati i përgjegjshëm. E mendoj se këtu na s'kemi pasur sa duhet durim që të gjejmë zgjidhje. Më lejoni të them gjithashtu se unë nuk besoj se pakoja e Ahtisarit dhe kërkesat e qytetarëve të Prizrenit dhe të Kuvendit Komunal të Prizrenit dhe të shoqërisë civile të Prizrenit janë kaq diametralisht kundër sa që s'mund të gjenden zgjidhje të pranueshme. Unë besoj se kjo mund të zgjidhet.

Prandaj, nuk duhet të vijmë me një konfrontim të tillë dhe të vijmë tash jo patriotizmi, jo pakoja, jo Kushtetuta, jo këto. Të gjitha ato qëndrojnë, por Kushtetuta, ja pakoja dhe të gjitha ato duhet të zbatohen në mënyrë krijuese dhe të përgjegjshme në kuadër të debatit demokratik dhe arritjes së një konsensusi minimal në shoqëri. Jo me imponime, s'ka nevojë me imponime. Ne në qoftë se duhet për të imponuar, imponojmë se kemi obligim me pakon e Ahtisarit. Nuk është kjo punë vullnetare tash a e zbatojmë pakon a jo. Pakon duhet ta zbatojmë se është në themel të pavarësisë së Kosovës, mirëpo s'duhet përdorur pakon dhe kundër çdo vërejtje demokratike t'ia qesim pakon para hundëve njerëzve. Pakoja lejon mundësinë për debat, pakoja lejon mundësinë për t'i gjetur zgjidhjet, jo të bllokohen zgjidhjet, jo të vendosen zgjidhjet me diktat.

Në këtë drejtim mendoj se duhet të bëjmë përpjekje që ligjin ta përmirësojmë, patjetër. Në pikën 4, në pikën neni 5 pika 2, madhësia e zonës, unë nuk jam arkitekt, nuk kam mundur të shoh krejt çka rrokë, gjitha ajo listë e monumenteve është në rregull, por sipërfaqja ndoshta mund të jetë problematike për zhvillimin e aktiviteteve biznesore. Do të kisha dashur që kjo çështje të analizohet. Neni 5, mendoj se duhet të riformulohet patjetër dhe unë propozoj tekstin, Komitetin, pikën 4, riformulim i tërësishëm. “Komiteti duhet të kërkojë pajtimin e bashkësive përkatëse fetare”, bashkësive përkatëse fetare, jo vetëm një bashkësie, por bashkësive përkatëse fetare !për aktivitetet që do të bëhen në pronat e tyre brenda Qendrës Historike të Prizrenit”.

Kryeministri e tha se prej 100, sa kenë 104, 11 janë, domethënë janë edhe tjerat, atëherë duhet kërkuar edhe prej bashkësive tjera. Kur është në pyetje prona e tyre, duke respektuar, duhet të mbetet teksti, “duke respektuar edhe obligimet që dalin nga pakoja e Ahtisarit”.

Neni 20, KZM-ja, unë mendoj se këtu me të drejtë po ngritet pak problemi i KZM-së, se KZM-ja ka të bëjë vetëm me zonat e veçanta që kanë të bëjnë me serbët. Qendra Historike e Prizrenit po interferon edhe me objektet dhe zonat që s’lidhen vetëm me serbët, prandaj këtu po bëhet një hibrid i cili duhet të rishqyrtohet dhe të zgjidhet. Unë besoj se mund të zgjidhet dhe do të duhej që këto çështje të analizohen dhe mos të futemi në kesi lloj debati prej të cilit mund t’ju them se po më dhemb koka, kur po shoh mënyrën qysh po i diskutojmë çështjet serioze. Këto janë çështje serioze dhe kërkojnë qëndrim serioz. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Rexhep Selimi.

REXHEP SELIMI: Faleminderit, zoti kryesues!

Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” dhe mes përfaqësuesve të saj veç se i dha argumentet dhe argumentoi pse ne e kundërshtojmë këtë ligj, i mbështetur në argumente. Dhe, normalisht që përfaqësuesit e mazhorancës tash shpresën kryesore e kanë dhe mbështetjen e tyre e kanë te numrat. Ne e mbështesim te argumentet dhe mendojmë që argumenti duhet të fitojë para numrave. Sidoqoftë, mua më kujtohet shumë mirë edhe kërcënimi i kryeministrit kur është miratuar Ligji për Hoçën. Ai pati thënë që së shpejti do ta keni këtu edhe Ligjin për Prizrenin, që do të thotë qysh atëherë e ka pasur ndërmend që të mos e ndryshojë asnjë presje të këtij ligji, me gjithë vërejtjet e mëdha që janë bë për këtë ligj.

Ligji u rikthye në Parlament, u rikthye pa asnjë ndryshim, në ndërkohë edhe pse para këtij rikthimi kishte reagime, atje reagimi i qytetarëve të Prizrenit po vazhdon me 10 000 nënshkrime të tyre, me koalicionin e OJQ-ve të Prizrenit, atje po vazhdojnë kundërshtimet gjithnjë e më intensive, sepse gjithnjë e më tepër po e shohin që ky ligj nuk është në interesin e tyre, nuk është në interesin e qytetarëve, përkundrazi është në disfavor të qytetarëve.

Dhe, shpeshherë këtu dëgjojmë, e dëgjojmë shpeshherë që ne nuk duhet të kemi frikë të miratojmë këso ligjesh. E kemi dëgjuar që këtu është thënë edhe ne nuk duhet të kemi

frikë as nga bisedimet edhe me Serbinë. Edhe në fakt, unë po e kuptoj që vërtet këta s'po kanë frikë para atyre që vërtet do të duhej të frikoheshin, para qytetarëve të vendit. Këta kanë frikë vetëm nga të tjerët, asnjëherë nuk kanë frikë nga qytetarët. Dhe, mendoj që nga një gjë që nuk do të duhej të kishin frikë këta, është nga mendimi i qytetarëve dhe shprehja e lirë e tyre. Nëse, nuk i kanë marrë parasysh edhe reagimit të OJQ-ve, të qytetarëve dhe reagimet e 10 000 nënshkrimeve, pse atëherë kanë frikë këta nga referendumi, pse nuk e kthejnë në referendum këtë ligj?

Pra, këta kanë frikë nga referendumi dhe nuk kanë frikë nga ndëshkimi i qytetarëve të Prizrenit dhe të Kosovës në përgjithësi. Në anën tjetër, unë mendoj që këtu nuk po kihet parasysh as vullneti i qytetarëve të Prizrenit, po nuk po kihet parasysh as komisioni, i cili veç e ka dhënë mendimin e vet që dy herë që është “kundër” këtij projektligji dhe ka argumentuar që ky projektligj nuk shkon në interesin e qytetarëve të Prizrenit.

Në anën tjetër, mendoj që u përmend edhe ndarja e komuniteteve, një komunitet veç, ndarja e komuniteteve tjera veç. Unë po mendoj që pikërisht ky ligj ndan komunitetet atje. Nëse është për t'u ndarë, ky ligj i ndan komunitetet, i ndan serbët sepse i favorizon si të tillë dhe i mohon të gjithë të tjerët, duke e mohuar edhe historinë e tyre. Dhe unë mendoj që mohimi i historisë shqiptare, duke bërë ligjërimin e padrejtë të një historie të rrejshme serbe në Kosovë, pikërisht kjo është ndarja dhe dezintegrimi i komuniteteve atje.

Ajo çka është për t'u theksuar këtu edhe për t'u çuditur është deklarimi bosh i mazhorancës, një pjese të mazhorancës, kuptohet, ndaj të ashtuquajturave obligimeve ndërkombëtare. Kuptohet që obligime ndërkombëtare kemi të gjithë, por ne duhet ta kemi parasysh se nuk mund të kemi obligime ndërkombëtare para se të kemi edhe obligime kombëtare dhe njëkohësisht nuk mund të jemi ndërkombëtar, para se të jemi kombëtar. Pra, nëse paska obligime ndërkombëtare, që unë mund të pajtohem deri njëfarë shkalle, ku janë obligimet kombëtare? Duke hequr dorë nga çdo obligim kombëtar, nuk mund të kesh obligim ndërkombëtar. Kështu që duke e rrënuar gjithçka çka është kombëtare në këtë vend, gjithsesi nuk mund të jetë ndërkombëtare, pra nuk mund ta respektosh komunitetin ndërkombëtar duke e mohuar komunitetin kombëtar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Gërbeshi e ka fjalën.

EMIN GËRBESHI: Faleminderit, kryesues!

Projektligji për Qendrën Historike të Prizrenit është tërësisht politik. Kosova ka një legjislacion të mjaftueshëm për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe fetare etj., dhe ky ligj është i tepërt. Janë disa arsye që mua më bëjnë që mos ta votoj këtë ligj. Ndër arsyet kryesore janë se ky projektligj bie në kundërshtim me interesat e qytetarëve të Prizrenit, arsye e dytë është se projektligji i tillë është antihistorik, sepse e ngrit institucionin e kishës mbi institucionet tjera në Prizren dhe arsye e tretë është se ky projektligj është edhe anti njerëzor dhe anti human, sepse provokon besimet tjera fetare, kur dihet se në Kosovë gjithmonë ka pasur një tolerancë fetare.

Ne tash nuk jetojmë në kohë të mesjetës dhe në kohëra të kaluara që të hartojmë, që të pranojmë e të votojmë ligje të tilla, prandaj unë edhe njëherë deklarohej “kundër” një ligji të tillë dhe do të votojë “kundër”. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Lama e ka fjalën.

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Projektligji për Qendrën Historike të Prizrenit i cili u votua “kundër” radhën e kaluar, është proceduar nga Qeveria e Kosovës sërish në Kuvend pa pësuar asnjë ndryshim. Kjo është një shaka me rolin e Kuvendit.

Mos miratimi as në parim i një projektligji nga ana e deputetëve flet për një dokument të papranueshëm, ku edhe amandamentimi është i pamjaftueshëm. Si pasojë, është detyrë e sponsorizuesit që të marrë parasysh këtë fakt dhe të ulët sërish për të ripunuar projektligjin. Në rastin konkret, kjo nuk ka ndodhur, duke dëshmuar kështu mungesë të plotë serioziteti. Personalisht, problemin më të madh nuk e shoh tek zonat e mbrojtura të veçanta, por tek lista e objekteve që përfshin këto zona.

Mbi çfarë kriteresh është përcaktuar pronësia e një objekti kulturor apo fetar apo monumenti të kulturës se i përket një komuniteti të caktuar. Kjo është dilema më e madhe në të cilën politikanët e Kosovës disa vite më parë nuk e morën parasysh, përkundrazi ia dhanë mundësinë e përvetësimit njërit prej komuniteteve këtu në Kosovë. Në këtë mënyrë u transformua historia dhe kultura, u ndryshua emri i trashëgimisë dhe sot kemi edhe ligje që kërkojnë të betonojnë njëherë e mirë këtë trashëgimi të transformuar.

Vijmë tek projektligji aktual. Natyrisht që është mirë të mbrohen zonat historike, të mos lejohen ndërtime pa kritere, të parandalohet shkatërrimi apo transformimi i tyre, mirëpo krijimi i institucioneve paralele për ta përmbushur këtë detyrë, më duket i papranueshëm. Trashëgimia kulturore mbrohet me Ligjin për ruajtjen e trashëgimisë kulturore, i cili është miratuar në Kuvend, ekziston edhe Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës, i cili përbëhet nga ekspertët më eminentë të kulturës.

Krijimi i një komiteti paralel më duket krejtësisht i panevojshëm dhe që i përket logjikës paralele, theksoj disa herë këtë. Por, ajo që është më e papranueshme për mua personalisht, është cenimi i laicitetit të institucioneve të Kosovës. Përbërja e komisionit nga priftërinj dhe hoxhallarë më duket tallje me vlerat mbi të cilat është ndërtuar shteti i Kosovës. Merreni me mend tani që nëse dikush kërkon të ndreq shtëpinë e vetë, të rregullojë një çezmë apo të lyej një mur, të dërgojë kërkesën e tij në një tavolinë ku janë ulur njerëz të veshur me petka fetare, veladonë e fustanella. Ata të vendosin për një të drejtë elementare që qytetarët në shtetin e Kosovës ia kanë besuar institucioneve laike. Merreni me mend sikur ky komision të thotë “jo”. Si mund të ndjehen qytetarët përballë një përgjigje të tillë, të mos flasim pastaj për vështirësitë e jashtëzakonshme praktike për të marrë një vendim. Kalimi nga një komision në tjetrin do të marrë shumë, shumë kohë për gjëra shumë të thjeshta të cilat mund të jenë edhe emergjente.

Me një fjalë, në rast se një ligj bëhet për të vënë rregull në një çështje të caktuar dhe për t'ua lehtësuar jetën qytetarëve, projektligji aktual bën pikërisht të kundërtën. Ndërsa, për sa i përket Ministrisë së Ambientit, e cila është sponzorizuese e këtij ligji, bën mirë të marrë masa për pastrimin e lumit që kalon përmes Prizrenit, i cili është kthyer në kosh plehrash dhe i jep qytetit historik e kulturor një pamje të shëmtuar dhe akulturore. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka kërkuar ministri Gashi, për disa sqarime shtesë.

DARDAN GASHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Zoti kryeministër,

Kolegë të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Sa i përket pastrimit të lumit në qytetin e Prizrenit, projekti ka filluar që 2 javë, i financuar nga Qeveria, pra, nëpërmjet Ministrisë së Mjedisit.

Po ashtu, sa i përket amandamentimit ose jo të këtij ligji ose ndryshimit ose jo prej qysh ka ardhur herën e kaluar, e përmendi edhe kryetari i komisionit përkatës se Qeveria ka dërguar amandamente e propozime për amandamentimin, sidomos për nenin 18.4. i cili ka qenë ai nen që është kritikuar më së shumti edhe nga qytetarët e Prizrenit edhe nga ju këtu, do të thotë ne i kemi dërguar veçse kërkesën për amandamentim.

Sa i përket komisionit, që u përmend këtu hoxhallarët e priftërinjtë, natyrisht në atë komision nuk ka dhe nuk do të ketë as hoxhallarë, as priftërinj. 6 anëtarët e komisionit vijnë nga shoqëria civile, kurse një nga komuna. 3 prej tyre përzgjidhen nga komuniteti fetar, mirëpo nuk janë anëtarë të kishës apo të bashkësisë islame. Do të thotë, nuk është ashtu siç thoni ju. Po ashtu, sa i përket referimit tek Këshilli zbatues dhe monitorues, çdo pronar duke inkuadruar pronarët, pra, do të thotë edhe të shtëpive private atje dhe menaxherët, do të thotë menaxhuesit ose ata që e kanë në menaxhim objektin, siç është Kisha Ortodokse Serbe ose Bashkësia Islame ose Kisha Katolike, kanë të drejtë që të referohen vetëm atëherë kur objektet janë në pyetje të tyre, pronat e tyre, jo pronat e të tjerëve ose aktivitetet tjera në zonën e Qendrës Historike.

Pra, këtu është një keqkuptim shumë i madh, secili nga 104 objektet mund të referohet në rastet kur shkelet ligji ose mbrojtja që i është dedikuar aty. Do të thotë, edhe aty që përmendi deputeti Gjini, natyrisht ligji në përgjithësi dedikohet mbrojtjes së strukturës historike të qytetit, qytet i fundit që ka mbetur me një strukturë historike në Kosovë. Ju e dini fare mirë se çka ka i ndodh qyteteve tjera, duke inkuadruar këtu edhe kryeqytetin, ku nuk ka më asnjë zonë historike, as në Prishtinë, as në Pejë e qytetet tjera. Ky ligj, me këtë ligj do të thotë është koha e fundit që të mbrohet ajo pjesë, përndryshe edhe ajo do t'i nënshtrohet një shkatërrimi si gjithë pjesa tjetër e Kosovës.

Andaj, ju kisha lutur që të shikoni me vëmendje ligjin, se shumica e temave që janë nxjerrë këtu, nuk qëndrojnë dhe ju lus që ta konsultoni ligjin si duhet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Glauk Konjufca.

GLAUK KONJUFCA: Rikthimi i këtij projektligji skandaloz për Prizrenin nga Qeveria e Republikës së Kosovës është kulmi i jo seriozitetit. Edhe vetë komisioni përkatës ka propozuar që ky projektligj t'i kthehet Qeverisë, krejt populli po e kundërshton këtë projektligj, dhjetëra mijëra nënshkrime janë mbledhur nga shoqëria civile e qytetarët e Prizrenit kundër këtij projektligji e prapëseprapë Qeveria është e vetmja që po ngul këmbë për miratimin e tij dhe krejt kjo vetëm e vetëm se kështu thotë Ahtisari.

Ky projektligj nëpërmjet eksteritorialitetit që ia bën Prizrenit, po ia bën atij atë që decentralizimi dhe ndarja ia kanë bërë qytetit të Mitrovicës. Kujt po i konvenon një Mitrovicë kulturore në Prizren. Unë mendoj që këtë ligj e ka kërkuar Serbia, sepse Serbia është ajo që mitin e identitetit kombëtar e ka ngritur mbi uzurpimet dhe falsifikimet ndaj popujve tjerë, e sidomos ndaj shqiptarëve përgjatë shekujve.

Ky projektligj është në funksion të historiografisë së gënjeshtërt serbe për Kosovën si “djep i Serbisë”, sepse nëpërmjet këtij projektligji i jepet qendra e qytetit të Prizrenit Kishës Ortodokse me seli në Beograd. Autoriteti qendror i Komisionit për Zbatim dhe Monitorim është Kisha Ortodokse e Serbisë. Kur ishte në Prizren, përpara një viti, ish zëvendëskryeministri serb Bozhidar Xhelij, lëshoi deklaratën se Prizreni është “zemra e Serbisë”. Këtë gjë ai e tha pasi doli nga liturgjia e ceremonisë të Krishtlindjeve ortodokse nga Kisha e Gjergjit Shenjtë, të udhëhequr nga Peshkopi Teodosie.

Ky institucion kishtar është selia e asaj që quhet dioqeza e Rashkës - Prizrenit dhe e Kosovës e Metohisë. Pra, gjithçka përpiket të na e kujtojë ringjalljen e një perandorie të përvetësuar mesjetare, atë të Car Dushanit, e cila lindi në Rashkë, por më vonë kryeqytetin e bëri në Prizren. Ne duhet të jemi “kundër” këtij projektligji, sepse ai i shërben kësaj politike hegjemoniste, e cila i shtrembëron të vërtetat historike, si dhe i kthen ato në armë vdekjeprurëse të cilat ishin përgjegjëse për tragjeditë e mëdha të popujve të Ballkanit, e ne këtë e dimë më së miri.

Miti serb se Kosova është zemra e Serbisë çoi në kasaphanën më të madhe në Evropë mbas Luftës së Dytë Botërore. Prandaj, duhet ta ndjejmë si përgjegjësi historike që t'ia mbyllim njëherë e mirë rrugën kësaj propagande, e cila përjetësisht e mban gjallë urrejtjen dhe potencialisht e ushqen dhunën. Serbia është një ndërtesë e ngritur nga përvetësimet obsesive të figurave historike jo serbe. Kështu, ata po përpiqen ta uzurpojnë edhe Konstantinin e Madh, një ilir nga Nishi, vetëm pse sot Nishi është në Serbi, pas pastrimit etnik të shqiptarëve atje.

Kam pasur rastin ta kem në dorë rastësisht një leksikon serb të vitit 1967. Merreni me mend, para 44 vjetësh, vetëm para 44 vjetësh, aty heroi ynë kombëtar Gjergj Kastrioti-Skënderbeu quhet kështu “Gjuragj Kastriotiq”. Kur historia falsifikohet hiq më larg se para 44 vjetësh, po çka mund të thuhet për shekuj të tërë e deri te beteja e Kosovës apo Konstantini i Madh. E njëjta vlen për historiografinë serbe për Kosovën në përgjithësi, si dhe për trashëgiminë kulturore të Kosovës, në veçanti.

Nuk mund të ketë rehati në Kosovë pa ndryshim të politikës së Serbisë, por nuk do të ketë kurrë ndryshim të politikës hegjemoniste të Serbisë pa u zhbërë miti serb për Kosovën, si “zemra e Serbisë” dhe “djepi historik” i saj. Prandaj, unë ju ftoj që t’i themi “jo” kësaj politike helmuese, duke mos e votuar këtë projektligj që e zhvesh Kosovën nga e vërteta historike dhe shkencore.

Uzarpimi që Serbia ia ka bërë kulturës dhe historisë sonë është çimentuar kur këto objekte janë vulosur si zyrtarisht serbe dhe ju ka dhënë nën autoritet të plotë Kishës Ortodokse me seli në Beograd. Edhe historia, edhe populli i Kosovës, edhe qytetarët e Prizrenit, edhe shoqëria civile e këtij qyteti bëjnë thirrje të fuqishme që të mos miratohet një ligj i tillë, i cili do ta bllokonte tërësisht funksionimin normal të Prizrenit, e sidomos qendrës së tij.

Shoqëria civile e Prizrenit ka paralajmëruar që nëse ky ligj miratohet, atëherë do ta qojë çështjen në Gjykatën Kushtetuese për shkak të diskriminimit ndaj bashkësive tjera fetare dhe favorizimit të bashkësisë ortodokse serbe. Ne inkurajojmë këtë iniciativë, nëse ndodhë, dhe do ta mbështesim atë plotësisht.

Çështja është e thjeshtë. Le t’i kthehemi temës faktike, pse është diskriminues ky ligj? Sepse këshilli që ka për t’u krijuar, ky komisioni në nivel të qendrës, ta zëmë ashtu qysh tha ministri, qysh e shpjegoi që ka për të pasur një kontest, ta zëmë, ndërmjet përfaqësuesit që është zgjedhur prej Kishës Ortodokse Serbe dhe atij të Bashkësisë Islame, përfaqësuesit të Bashkësisë Islame. Nëse ky përfaqësues i Bashkësisë Islame, çështja nuk mund të zgjidhet në atë komisionin në nivel të qendrës, që është në nivel të Prizrenit, atëherë kjo çështje ka për të shkuar në nivel të Komisionit për Zbatim dhe Monitorim.

Atëherë, shtrohet pyetja kështu: a do të përfaqësues aty bashkësia islame? Nuk do të ketë dhe gjithçka, të drejtën e vetos ka për ta pasur Kisha Ortodokse Serbe. Këtu duhet kuptuar ju pse po i themi ne diskriminues. Nuk është kurrëgjë për inati, por është diskriminues dhe, si rrjedhim, kanë të drejtë qytetarët e Prizrenit ta dërgojnë në Gjykatë Kushtetuese.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Agim Kuleta.

AGIM KULETA: I nderuar zoti kryesues,

Zonja dhe zotërinj deputetë,

Një prej arsyeve kryesore që përdoren për të justifikuar domosdoshmërinë e miratimit të Projektligjit për Qendrën Historike të Prizrenit, është edhe ai se ky ligj përbën një hap drejt përmbushjes së obligimeve që dalin nga pakoja e Ahtisarit, e rrjedhimisht edhe një hap drejt heqjes së mbikëqyrjes së pavarësisë së vendit.

Kjo është shumë e vërtetë dhe është plotësisht për t’u besuar, sepse vërtet edhe pak hapa kanë mbetur drejt heqjes së kësaj mbikëqyrjeje. Mirëpo, në këtë rast ekziston edhe një e vërtetë tjetër, e cila nuk duhet harruar. Këta hapa që kanë mbetur për t’u bërë janë vërtet pak, por janë dërmues për këtë pavarësi të cilës synohet t’i hiqet mbikëqyrja. Dje u

serbizua Hoça e Madhe, sot përmes presioneve të ndryshme po tentohet të serbizohet Prizreni, nesër në komunën e re të veriut të Mitrovicës do të rrumbullakohet procesi i serbizimit të kësaj pjese të Kosovës, përtej Ibrit.

Kur nga pjesë kaq të mëdha të territorit të saj Kosova krijon varësi, atëherë çfarë pavarësie po mbetet realisht për t'u mbikëqyrur. Edhe faktori ndërkombëtar e di se atëherë nuk ka çka të mbikëqyrë, sepse kështu siç është duke shkuar, çdo ditë e më tepër pavarësia jonë e fituar nga shteti serb po shndërrohet në varësi nga serbët brenda shtetit të Kosovës. Megjithatë, unë nuk do të zgjatem në argumentimin faktik të dëmeve të këtij projektligji, nuk do të flas për dobësitë apo përparësitë e tij, sepse konsideroj se kjo gjë është shumë e qartë për secilin nga ne dhe nuk është përmbajtja e projektligjit ajo që i vë sot deputetët, përkatësisht deputetët e caktuar të koalicionit qeveritar para dilemës morale. Ajo që i vë ata para kësaj dileme është pozicioni në mes asaj që është vullneti i tyre dhe asaj që është vullneti i shefit të tyre.

Po të varej votimi nga vullneti i lirë i shumicës së deputetëve të këtij Kuvendi, ky projektligj nuk do ta kishte rastin kurrë të përjetonte kënaqësinë e të shndërruarit në ligj. Pra, rreziku i votimit të këtij projektligji nuk vjen nga padituria, mosnjohja apo paaftësia për ta vlerësuar atë drejtë, rreziku vjen nga mundësia e divorcit eventual me moralin nga mundësia e braktisjes së vetëdijshme të ndërgjegjes, nga një arratisje e planifikuar, nga kjo ndërgjegje për shkak të një presioni jo parimor nga njerëz të caktuar.

Ajo që dua të ua rikujtoj, ju kolegë të nderuar të koalicionit qeveritar, është një gjë që të gjithë e dimë, një gjë që për të gjithë ne dikur ka pasur kuptim të madh, e sot duket se ka humbur krejtësisht peshën, e ajo është liria. Njeriu lind i lirë dhe vdes i tillë. Ai që prej lindjes së tij është i dënuar i përjetshëm i lirisë, ai vetëm në një rast mund ta humb këtë liri, kur vendos vetë ta dorëzojë atë. Pra, kur lirinë e tij e shfrytëzon për t'ia mohuar vetës atë dhe këtë e bën ose nga frika ose nga interesi. Dhe në momentin kur vendos të heq dorë nga liria, ai ka vendosur të heq dorë edhe nga qenia e tij.

Atëherë, ai nuk është më vetvetja, por është hija e dikujt tjetër. Në përgjithësi në situata të vështira, sidomos në politikë, prirja e njeriut për të hequr dorë nga parimet e drejta duket sikur është më e fuqishme se sa kurajoja për t'u përballur me pasojat e tyre. I njëjti rast është edhe sot këtu. Ju jeni të lirë të vendosni se çka do të bëni me lirinë tuaj për të vendosur vetë. Do ta përdorni atë, apo do ta dorëzoni atë.

Unë për ju kam vetëm një këshillë: mos e bëni atë që nuk do ta bënin prindërit tuaj të ndershëm dje, mos e bëni atë për të cilën do të turpërohen fëmijët e tuaj të pafajshëm nesër. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Kasolli.

AFRIM KASOLLI: Faleminderit, i nderuar kryesues!
Të nderuar deputetë,

Projektligji për Qendrën Historike të Prizrenit, të cilin po e ri diskutojmë sot, thuajse në mënyrë eklatante shpërfaq karakterin ahistorik, mjerimin kulturor dhe deficitin mendor qytetar ku është katandisur kjo Qeveri.

Kohë më parë, pikërisht në këtë Kuvend pata lexuar reagimin e një sërë organizatash joqeveritare që veprojnë në qytetin e Prizrenit, kur na ish servuar ky projektligj në një seancë plenare, pikërisht mbi mangësitë që ishin identifikuar në këtë projektligj. Mirëpo, asnjëra nga brengat që artikuloheshin në atë reagim, thuajse nuk u morën në konsideratë dhe, për më tepër, ato i injorua plotësisht. Ndërkaq, sot, përpos atij reagimi, kemi edhe nënshkrimin e një peticioni të më se 10 000 qytetarëve drejtuar Kuvendit të Kosovës, me ç'rast i bëjnë thirrje legjislativit të vendit që përsëri të mos e miratojë këtë projektligj.

Atëherë, shtrohet pyetja se kujt i shërben ky projektligj, derisa një shoqëri e tërë në atë qytet, ekspertë, si dhe njohës serioz të çështjeve kulturore dhe historike janë deklaruar kundër këtij projektligji. Pra, a mos injorimi i vullnetit politik të qytetarëve të atij vendi përbën pikërisht esencën e këtij projektligji. Kështu, me mënyrën se si është hartuar dhe si po bëhet përpjekje që të miratohet ky projektligj, përpos që i injoron këto shqetësime qytetare, ai po ashtu shpërfill edhe vlerësimet kompetente kulturore dhe në fund bie në kundërshtim me standardet tashmë të pranura universalisht, e që kanë për qëllim krijimin e premisave adekuate për konservimin e trashëgimisë kulturore.

Pra, rrjedhimisht, si pasojë e kësaj logjike dhe në sajë të kësaj strategjie arrihet që, më në fund, edhe vetë struktura onnipotente e mekanizmave sundues të deritanishëm të mos jetë me një strukturë që qëndron mbi shoqërinë tonë, por të transformohet nga roli i saj mbikëqyrës formal, në përmbajtjen normative dhe premisë ligjore të rendit politik dhe kuadrit juridik të vendit. Prandaj, dhe ndarjet e deritanishme vertikale ndërmjet këtyre aperatureve sundues të shoqërisë, tani transformohen në diferencime horizontale mbi një sfond bazik krejtësisht tjetër dhe kryesisht mbi nuancat fetare dhe religjioze, veçori kjo që të paktën deri më tani i ka munguar qytetit të Prizrenit, megjithëse këtu duhet shtuar se që nga koha kur ka filluar hartimi dhe sponzorimi i këtij projektligji, tashmë në qytetin e Prizrenit kanë filluar të shfaqen edhe shkëndijat e para që prodhojnë skizma shoqërore mbi kategoritë religjioze.

Pra, shprehur me kategoritë tjera, kjo situatë iu përngjason dy rendeve të ndryshme simbolike. Kështu, ajo që ka qenë deri më tani mbi neve, jashtë neve dhe kundër neve, me këtë projektligj hyn brenda nesh dhe promovon forca të reja diabolike në kuadër të rendit tonë shoqëror, pasojat e të cilave do të jenë të paparashikueshme për vitet në vijim.

Por, pa hyrë në analiza të mëtutjeshme të detajuara lidhur me pasojat negative që prodhon ky projektligj, sepse shumica e tyre u thanë tashmë këtu, po i vëmë në spikamë vetëm disa nga anomalitë qenësore që e karakterizojnë esencën e këtij projektligji.

E para, siç kanë vënë në dukje shumë hulumtime serioze në këtë sferë, vetë neni 3 i projektligjit është në kundërshtim me konventat e UNESCO-s, në të cilat trashëgimia fetare klasifikohet si monument dhe nuk bëhet ndarje e trashëgimisë kulturore dhe fetare dhe seria e tyre skandaleve vazhdon më tej. Përkundër faktit se ky projektligj quhet si

Projektligj për Qendrën Historike të Prizrenit, si i tillë ai nuk përmban vlera historike, pra si një përcaktues që një objekt të vlerësohet dhe përcaktohet si monument i trashëgimisë kulturore. Rrjedhimisht, ky karakter ahistorik i tij ka bërë që në këtë përkufizim të përfshihen vetëm ndërtesat dhe komplekset me vlera urbane, kulturore, fetare, artistike dhe ekonomike, por të zhveshura nga përmbajtja e tyre historike.

Kundërthëniet e tilla e bëjnë që ky projektligj po ashtu të jetë në kolizion edhe me ligjet tjera në vendin tonë, si ai për trashëgiminë kulturore apo edhe për Ligjin për planifikim hapësinor dhe, si i tillë, ky projektligj më në fund tjetëron edhe njërin prej vlerave qenësore të qytetit të Prizrenit. Ajo zhbën edhe karakterin urban të asaj pjese, ashtu siç e kanë përjetuar qytetarët e Prizrenit, si sferë me interes publik dhe nacional të përbashkët, me të cilin është identifikuar trashëgimia shekullore dhe kujtesa kolektive.

Rrjedhimisht, administrimi i asaj zone futet nën kontrollin e një komuniteti me përfaqësues fetar, duke prodhuar mure të reja ndarëse, kurse kulmi i këtij degradimi arrin me nenin 18 pika 4, kur komiteti duhet të kërkojë pajtimin e kishës ortodokse për çdo aktivitet i cili prek “pronat e kësaj kisha”. Dhe me këtë përkufizim, pikërisht pjesa më e madhe e asaj njësie urbane tjetërohet në pronë fetare, duke e privilegjuar një entitet fetar, në dëm të substancës politike dhe qytetare. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! S’ka më të paraqitur, përfaqësuesi i Qeverisë, kryeministri e ka fjalën!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, i nderuari nënkryetar i Parlamentit, zoti Haliti!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Ju falënderoj shumë për debatin korrekt dhe konstruktiv prej deputetëve që u tregua. Gjithashtu, kuptoj edhe debatet apo prezantimet komplet të përcaktimeve të ngushta të kornizave partiake, i kuptoj pozicionet.

E theksoj edhe njëherë gjitha atë që sot Qeveria e Republikës së Kosovës po bën, është propozimi i këtij draft ligji në përputhshmëri me Kushtetutën e Kosovës dhe ligjet e Kosovës dhe dokumentin e presidentit Ahtisari. Pra, Kjo duhet të jetë e qartë për të gjithë ne, gjithë opinionin publik kosovar, për këdo që kanë votuar.

Dokumenti i presidentit Ahtisari, e ritheksoj edhe njëherë, është meritë e të gjithë neve, është negociuar nga të gjithë ne, e më vonë i përqaftuar edhe nga ata që s’kanë negociuar. Por, i falënderoj edhe ata që kanë treguar reflektim për t’u integruar në procesin normal, demokratik, kushtetues dhe ligjor. Por, edhe sot mendoj që nuk është në interesin e askujt që për shkak të motiveve politike dikush të sulmohet, e dikush të pretendojë të prezantohet apo të rri në sallë sikur nuk ka ndodhur asgjë në këto 4-5 vjetët e kaluara.

Gjithë ky sukses që kemi arritur si shtet i Kosovës, është produkt i një pune në proces dhe jo i një vendimi të shpejtë. Tani, më 17 shkurt të vitit të ardhshëm bëhen 4 vjet nga shpallja e Kosovës shtet i pavarur dhe sovran. Në vitin e ardhshëm është viti,

planifikojmë që do të jetë viti i përmbylljes së pavarësisë së mbikëqyrur, viti i konsolidimit dhe forcimit edhe më të madh të shtetit tonë. Ky vit ishte viti i hapjes së perspektivës evropiane, i agjendës konkrete unike evropiane për Republikën e Kosovës dhe mënyrën më të sinqertë të mundshme të falënderoj të gjitha grupet parlamentare, edhe opozitare, për pjesëmarrjen e tyre në grupet punuese për integritet evropian dhe reformën zgjedhore. Mendoj se kështu ne kemi dërguar mesazhin më të mirë të mundshëm në Bruksel se për çështje të rëndësishme kapitale, nacionale, shtetërore ne punojmë bashkë. Prandaj, më lejoni në emër tim personal dhe të Qeverisë të Republikës së Kosovës, t'ju falënderoj.

Tani ndalemi konkretisht në projektligjin. Këtu e kishim një prezantim prej më të përgjegjshmeve shtetëror, por në të njëjtën kohë edhe etiketime që nuk shkojnë me kulturën dhe etikën e komunikimit parlamentar, e në të njëjtën kohë u pretendua të ndryshohen faktet dhe realitetet e së kaluarës. Prandaj, për hir të transparencës para opinionit publik, përgjegjësisë shtetërore që e kemi të gjithë, edhe unë si kryeministër i Kosovës ndiej obligim që këtë proces, natyrisht, të zbërthejmë se si kemi ardhur deri këtu.

Edhe një herë dëshiroj të falënderoj të gjithë mazhorancën për mbështetje të plotë për diskutimet e tyre korrekte, për shqetësimet gjithashtu që ngritën për t'u përmirësuar më tepër çka mund të përmirësohet në projektligj dhe për mua janë mirëkuptuese, do të bëjmë gjithçka që është e mundur, por edhe në të njëjtën kohë falënderoj që kanë mirëpritur dhe votuar dokumentin e presidentit Ahtisari, Kushtetutën dhe ligjet e Kosovës. Edhe Lidhjen Demokratike të Kosovës të Kosovës e falënderoj për kontributin që ka dhënë për dokumentin e presidentit Ahtisari, për diskutimet këtu që u prezantuan, por edhe dëshiroj të shpreh mospajtimin tim me qasjen që nuk mund të ndryshojmë faktet dhe realitetet e së kaluarës me politikën elektorale aktuale. Prandaj, falënderoj shumë zotin Lutfi Hazirin për pjesëmarrjen e tij aktive, dinamike në procesin e dokumentit të presidentit Ahtisari për reformimin e pushtetit lokal. Falënderoj zotin Ismet Beqiri për idetë e tij që si ish kryetar i komunës së Prishtinës, gjithashtu ka dhënë ide interesante në atë kohë, ndërsa gjithashtu falënderoj zotin Hyseni, që kemi punuar bashkë edhe në Ekipin e unitetit, edhe në takimet tona në Vjenë, gjithashtu edhe deputeten Vjosa Osmani për kontributin. Sinqerisht po ua them, në Ekipin e unitetit që na ke ndihmuar me pjesëmarrjen tuaj, me këshilla, ju falënderoj shumë! E falënderoj ministrin Sadri Ferati, që për tri vitet e tëra bashkërisht kemi punuar për reformimin e pushtetit lokal dhe krijimin e komunave të reja, që kanë ndryshuar për të mirë shtetin e Kosovës dhe marrëdhëniet ndëretnike, por në të njëjtën kohë nuk mund pa e falënderuar edhe ekselencën e tij, Eqrem Kryeziun, që ka marrë pjesë drejtpërdrejt në Grupin punues kushtetues dhe ka qenë një mbështetës impresionues për të gjithë, e falënderoj duke mos e harruar zonjën Teuta Sahatqiu, që gjithashtu me pjesëmarrjen e saj dhe të partisë ORA, ka qenë shumë korrekte dhe e përgjegjshme, por meritat e LDK-së nuk përmbyllen këtu. Nuk mund të mos e kujtoj meritën dhe mbështetjen dhe kontributin e ish-presidentit Sejdiu dhe të kryetarit aktual Isa Mustafës, që ka marrë pjesë në mënyrë shumë aktive, në shumë grupe punuese në Vjenë për nxjerrjen e dokumentit të presidentit Ahtisari, kështu që jeni kontribuues të fuqishëm.

(Reagime)

Ju e dini, unë kam dëshirë të shpërndajë meritat dhe jo ti individualizoj, prandaj nuk mundem të mos e falënderoj zotin Gjini, Ahmetin, gjithashtu, zotin Shala dhe gjithë Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës, e në të njëjtën kohë edhe Lëvizjen “Vetëvendosje”, që është bërë pjesë e pakos së Ahtisarit, që e respekton Kushtetutën dhe ligjet, prandaj ky është emancipim, por në të njëjtën kohë kuptoj kritikën, se ju keni qenë në atë kohë kundër. keni hyrë në të, tashmë, ia pafshim hairin, këqyrë qysh jeni strukur...!

(Ndërprerje)

KRYESUESI: E ke fikë vetë, se nuk ta ka ndalë askush. Mikrofonin, regjia!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: ...Po a jeni kundër apo jo, ju jeni në parlament, punoni me dokument të Ahtisarit, ia pashit hairin edhe ju, dhe këqyreni liderin e juaj se si është mbyllur, nuk flet hiq, kështu që ia pafshi hairin edhe ju! Prandaj, deputetë të nderuar, në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, ju ftoj ta votoni këtë Projektligj, i cili është në përputhshmëri me Kushtetutën dhe ligjet e Kosovës. Ju faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Konstatohet se në sallë janë 101 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për ta votuar, në parim, Projektligjin për Qendrën Historike të Prizrenit.

Votojmë, tani. Ju faleminderit!

Konstatohet që me 56 vota “për”, 42 vota “kundër”, 2 abstenime, Kuvendi miratoi Projektligjin për Qendrën Historike të Prizrenit. Ju faleminderit!

A doni ta shtyjmë seancën për nesër, apo doni të vazhdojmë? Atëherë, pika e gjashtë e rendit të ditës. Nëse doni të vazhdojmë, atëherë uluni dhe të mbajmë qetësi! Kemi 15 minuta pauzë!

Vazhdimi i seancës pas pauze

KRYESUESI: Të nderuar deputetë, deputete!

I nderuar Kabinet i Qeverisë,

Shpresoj që kemi mundësi ta vazhdojmë seancën. Në sallë janë 64 deputetë.

Vazhdojmë me pikën e gjashtë të rendit të ditës, që është:

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për bujqësi organike

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, komisioni funksional ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime, për shqyrtim në parim.

Ftoj ministrin e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, zotin Stavileci, që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe arsyetojë projektligjin.

MINISTRI BLERAND STAVILECI: Ju faleminderit, i nderuari kryesues!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar kolegë të Kabinetit qeveritar,

Bujqësia organike është një sektor në rritje të vazhdueshme dhe qëllimi kryesor i këtij projektligji është që të krijojë bazë ligjore të zhvillimit të qëndrueshëm të prodhimitarisë organike, duke siguruar funksionimin efikas të tregut, konkurrencën e drejtë dhe duke mbrojtur interesat e konsumatorëve. Kjo synohet të arrihet nëpërmjet stimulimit të një prodhimtarie të larmishme bujqësore, e cila iu përgjigjet kërkesave të konsumatorëve duke zbatuar procese që ruajnë mjedisin, shëndetin dhe mirëqenien e njerëzve dhe të kafshëve.

Në këtë projektligj përcaktohen shumë qartë objektivat dhe parimet për të gjitha fazat e prodhimit të produkteve organike, mënyrat e përgatitjes, mënyrat e shpërndarjes dhe kontrollit të këtyre produkteve, si dhe mënyrat e përdorimit të indikatorëve që u referohen etiketimit të prodhimeve organike.

Fushëveprimtaria e këtij projektligji është të krijojë infrastrukturën e përshtatshme ligjore për çështjet që kanë të bëjnë me ndërmarrjen e masave dhe veprimeve në baza profesionale, për rritjen e cilësisë së prodhimitarisë bujqësore organike. Ligji aktual nuk ka gjetur zbatueshmëri për shkak të hyrjes në fuqi të rregulloreve të reja të Bashkimit Evropian që i referohen planifikimit dhe proceseve biologjike në bazë të sistemeve biologjike. Dhe, në këto sisteme përdoren vetëm burime natyrore, ku kultivimi i bimëve bëhet në bazë të praktikave të shfrytëzimit të qëndrueshëm dhe të parimeve të vendeve të Bashkimit Evropian.

Projektligji qëndron në harmoi të plotë me ruajtjen e resurseve natyrore dhe adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me krijimin e një strukture komplete të bazuar në parimet e legjislacionit bazë të BE-së, prandaj miratimi i tij është i një rëndësie të veçantë për këtë fushë, sepse mbron bujqësinë organike dhe promovon ndërgjegjësimin e konsumatorit për çështjet e cilësisë së ushqimit. Ju faleminderit për vëmendje!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Tani, pas prezantimit, fjalën e ka kryetari i Komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari, Mjedis, Planifikim Hapësinor, zoti Hasani.

NAIT HASANI: Ju faleminderit, kryesues!

Përsëndetje, kryeministër!

Komisioni e ka shqyrtuar Projektligjin për bujqësinë organike, me datën 16.11.2011, dhe i rekomandon Kuvendit që ta miratojë në parim Projektligjin për bujqësinë organike. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Përfaqësuesit e grupeve parlamentare ose kryetarët. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, deputeti Njazi Idrizi.

NJAZI IDRIZI: Ju faleminderit, kryesues!

I nderuari kryeministër,

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Bujqësia organike është sistem i prodhimit organik që e promovon biodiversitetin, ndikon në ruajtjen e natyrës, nxitë zhvillimin ekonomik të vendbanimeve rurale dhe mbi të gjitha furnizon popullsinë me ushqim të shëndetësishëm dhe të sigurt. Prodhimi i produkteve organike kërkon aktivitet të shtuar e kujdes të madh dhe si i tillë vlerësohet shumë.

Prodhimi dhe përpunimi organik ka disa specifika. Prodhuesit kanë kualitet të lartë, prodhohen në harmoni ndërmjet prodhimit bimor dhe shtazor, përdoren metoda biologjike dhe mekanike, ruhet biodiversiteti, evitohet ndotja e mjedisit, përdoren ambalazhet të biodegradueshme, sigurohet një cilësi jetese për popullsinë dhe sjellë interes ekonomik për prodhuesit.

Kosova ka kushte natyrore të përshtatshme për zhvillimi e bujqësisë organike. Për fat të mirë, kjo prodhimtari ka mbijetuar dhe prodhohet në mënyrë ekstensive tradicionale në zonat malore dhe kodrinore. Kjo përvojë është shumë e mirë për prodhuesit e ardhshëm.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e mbështet këtë Projektligj dhe mendon që kontributin e vet ta japë në aktivitetet e ardhshme të punës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit,

Në emër të Grupit parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, deputeti Morina.

SALI MORINA: Ju faleminderit, kryesues!

Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike ka shqyrtuar këtë Projektligj dhe në parim e mbështetë. Njëkohësisht parasheh një vërejtje, për të cilën MEF-i e ka bërë një analizë lidhur me deklaratën financiare, kur thuhet se neni 37 duhet të fshihet dhe po ashtu tek neni 36, ku parasheh programin kombëtar për bujqësi. Njëkohësisht ky nen parasheh shtimin e stafit dhe po ashtu parasheh implikime buxhetore, por besoj që ministri i Bujqësisë, në bashkëpunim me ministrin për Ekonomi dhe Financa do ta zgjidhin këtë problem dhe do ta japim kontributin tonë në leximin e dytë. Ju faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Grupi Parlamentar “Vetëvendosje”, deputeti Aliu.

LIBURN ALIU: Edhe Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” do të votojë pro Projektligjit, në parim, pra për bujqësinë organike. Natyrisht, jemi për zhvillimin e bujqësisë organike, tani në mënyrë intensive, dhe e përkrahim plotësisht.

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, deputetja Kadrijaj.

TIME KADRIJAJ: Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, e ka shqyrtuar këtë Projektligj dhe do ta përkrahë, në parim. Kontributin tonë do ta japim përmes përfaqësuesit tanë në komisionin përkatës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Deputetja Lama!

SEVDIJE LAMA: Ju faleminderit, i nderuari zoti kryesues!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Bujqësia organike është sektori që ofron përfitime me interes për shëndetin e njeriut dhe mbrojtjen e mjedisit, ndërkohë që është provuar se ka ndikime pozitive mbi ekonominë rurale nga pikëpamja e krijimit të të ardhurave dhe diversifikimit të veprimtarive ekonomike. Grupi Parlamentar i Koalicionit për Kosovën e Re e përkrah në parim Projektligjin për bujqësi organike. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Grupi parlamentar SLS, deputeti Milosavljeviq.

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala, gospodine predsedavajući!

I Poslanička grupa Samostalne liberalne stranke razmatrala je Nacrt zakona o organskoj poljoprivredi i mi ćemo u načelu podržati ovaj zakon. Hvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Grupi parlamentar “6+”, deputeti Demiri.

RASIM DEMIRI: Hvala, predsedavajući!

I Parlamentarna grupa „6+“ je razmatrala i analizirala ovaj Nacrt zakona o organskoj poljoprivredi i mi ćemo u načelu podržati ovaj zakon.

KRYESUESI: Ju faleminderit! deputetët të tjerë nuk janë paraqitur. Përfaqësuesi i Qeverisë, dëshiron fjalën shtesë? Jo. Atëherë, kërkohet deklarimi me votim për miratim në parim të Projektligjit për bujqësinë organike. Në seancë janë prezentë 72 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatitën për votim. Votojmë, tani. Ju faleminderit!

Konstatohet se me 70 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për bujqësi organike.

Vazhdojmë me pikën e shtatë të rendit të ditës:

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për arkivat

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, komisioni funksional ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime, për shqyrtim në parim.

Atëherë, zoti Bukoshi do ta paraqes ligjin.

BUJAR BUKOSHI: Shpresoj se pas debatit lidhur me Projektligjin për Prizrenin dhe këtë projektligj të cilin do ta prezantoj para jush, zonja deputete dhe zotërinj deputetë, që të mos marrë kohë. Bëhet fjalë për Projektligjin për arkivat që është miratuar nga Qeveria, më 9.11.2011.

Ky projektligj siguron rregullat bazë për funksionimin efektiv të shërbimit arkivor në institucionet e Kosovës, si dhe ndryshimin e disa dispozitave kundërthënëse të këtij ligji në fuqi. Ky Projektligj për arkivat i adresohet Qeverisë dhe administratës në nivelin qendror dhe lokal, institucioneve ligjdhënëse dhe gjyqësore, Zyrës së Presidencës, Prokurorisë, personave fizikë dhe juridikë që kryejnë detyra publike apo operojnë me fonde publike sipas ligjeve të Republikës së Kosovës për të cilat përcaktohen detyrimet ligjore për krijimin, ruajtjen dhe shfrytëzimin e pasurisë arkivore.

Në bazë të këtij Projektligji do të përcaktohen normat, standardet dhe afatet kohore për ruajtjen, si dhe shfrytëzimin e materialit arkivore nga institucionet përkatëse. Projektligji për arkivat krijon pra një infrastrukturë ligjore më të avancuar në përputhje me praktikën e vendeve të zhvilluara evropiane. Ky Projektligj është në përputhje të plotë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me standardet e Bashkimit Evropian. Ju propozoj që këtë projektligj ta miratoni. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti zëvendëskryeministër!

Tani, sipas Rregullores, fjalën e ka kryetari i komisionit funksional, Idriz Vehapi.

IDRIZ VEHAPI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

I nderuari zoti kryeministër, ministra,

Të nderuar deputetë,

Komisioni funksional e ka shqyrtuar Projektligjin për arkivat, me ç'rast ka vlerësuar se projektligji i plotëson të gjitha kriteret dhe standardet sipas nenit 54 të Rregullores së Kuvendit dhe njëkohësisht i rekomandojmë Kuvendit për miratim, në parim. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Tani, përfaqësuesit e grupeve parlamentare ose kryetarët e tyre. Në emër të Grupit parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, deputetja Izmaçu.

XHEVAHIRE IZMAKU: Ju faleminderit, kryesues!

I nderuari kryeministër,

Të nderuar ministra,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka shqyrtuar në parim Projektligjin për arkivat. Mendojmë se është një ligj i hartuar mirë, një ligj racional i cili rregullon statusin e të gjitha arkivave në institucionet e Republikës së Kosovës. Në këtë fazë do ta mbështesim, ndërsa vërejtjet eventuale do t'i japim në komisionet funksionale. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, deputeti Sadri Ferati.

SADRI FERATI: Ju faleminderit, i nderuari kryesues!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë,

Edhe në Grupin Parlamentar atë LDK-së e kemi shqyrtuar këtë projektligj, i cili rregullon fushën e arkivimit si në nivel qendror, ashtu edhe lokal, si dhe funksionalizimin e Agjencionit kombëtar për arkivat. Ne në komisionin funksional do ta japim kontributin tonë. Posaçërisht në këtë ligj nuk është paraparë ndonjë avancim në aspektin e digjitalizimit, qoftë të pasqyrave apo edhe të materialeve, por kontributin tonë do të vazhdojmë ta japim nëpër grupe. Sot në parim e përkrahim dhe do ta votojmë këtë projektligj.

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, deputeti Afrim Kasolli.

AFRIM KASOLLI: Ju faleminderit, kryesues!

Edhe Lëvizja “Vetëvendosje” e mbështet në parim Projektligjin për arkivat.

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, deputetja Teuta Haxhiu.

TEUTA HAXHIU: Ju faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e ka shqyrtuar projektligjin në fjalë, të cilin e përkrah në parim dhe kontributi ynë do të jepet përmes komisioneve përkatëse. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar Koalicioni Kosova e Re, deputetja Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Ju faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Grupi Parlamentar i Koalicionit për Kosovë të Re e ka shqyrtuar Projektligjin për arkivat. Duke marrë parasysh se ky projektligj është i hartuar relativisht mirë, pasi edhe hartuesit e tij do të kenë pasur mundësinë më të lehtë për arsye se ky ligj ka qenë edhe përpara, vetëm me një emërim tjetër, Ligji për arkivat dhe lëndët arkivore, i cili do të shfuqizohet me hyrje në fuqi të këtij ligji të ri, siç parashihet në dispozitat kalimtare përfundimtare. Po, as në pjesën e arsytimit të projektligjit dhe as në materialin shoqërues nuk jepen sqarime dhe argumente pse po miratohet në ligj i ri, ndërsa ekziston një ligj

cili për shkak të zbrazëtirave dhe kundërthënies ka pësuar ndryshime dy herë nga qeveria e kaluar. Ndoshta esenca e komplet këtij ligji është Agjencia Shtetërore e Arkivave, që do të duhej të ishte një agjenci e themeluar nga Kuvendi dhe jo nga Qeveria, siç parashihet me nenin 3, në mënyrë që t'i shmanget çfarëdo ndikimi negativ që mund të ketë në ndonjë moment të caktuar një grupim politik.

Duke marrë parasysh se ne mund të kemi ndryshime dhe plotësime gjatë amendamentit të këtij projektligji, Grupi Parlamentar i Koalicionit për Kosovën e Re e përkrah në parim Projektligjin për arkivat.

KRYESUESI: Ju faleminderit! Grupi Parlamentar SLS, Boban Todoroviq.

BOBAN TODOROVIC: Hvala, gospodine predsedavajući! Parlamentarna grupa Samostalne liberalne stranke razmotrila je ovaj Zakon o arhivama. Saglasni smo sa njim i galascemo „za“. Hvala!

KRYESUESI: Hava! Ju faleminderit! Grupi parlamentar “6+”, deputetja Balje

DUDA BALJE: Nakon analize Nacrta zakona o arhivama, Parlamentarna grupa „6+“, donela je odluku da podrži zakon. Hvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Deputetja Mustafa e ka fjalën.

SALIHE MUSTAFA: Ju faleminderit, kryesues!

I nderuari kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe pse jemi të lodhur, besoj se diskutimet e tona do t'i ndihmojnë komisionit funksional gjatë amendamentimit të këtij projektligji të rëndësishëm.

Ky projektligj është projektligj i rëndësishëm së veçantë, i cili përcakton rregullat për organizimin dhe funksionimin e shërbimit arkivor në institucionet e Republikës së Kosovës. Megjithatë, projektligji ka nevojë për plotësime. Për shembull, neni 5, detyrat dhe përgjegjësitë e agjencisë. “Agjencia është institucion i cili pranon, evidenton, ruan dhe publikon materialin arkivor”, duhet të jetë: “Agjencia është institucion i cili hulumton, gjen, pranon dhe evidenton”. Gjithashtu, te neni 9, institucionet të cilat mund të zhvillojnë arkiv vetanak në kuadër të fushëveprimtarisë së tyre, mendoj se edhe Agjencia shtetërore për mbrojtjen e të dhënave personale, duhet të ketë mundësi të zhvillojë arkiv vetanak.

Gjithashtu, te paragrafi 3 i nenit 9, në rast kur institucionet e paraqitura në paragrafin 2 të këtij neni, nuk posedojmë hapësirë të nevojshme për arkivimin, ruajtjen dhe mbrojtjen e materialit arkivor nga dëmtimi apo asgjësimi, atëherë institucionet e lartcekura ia afrojnë materialin e tyre për arkivim Agjencisë. Mendoj se duhet të precizohet se në bazë të cilave rregulla duhet të arkivohet dhe shfrytëzohet, në bazë të institucionit që i ofron

agjencisë për ruajtjeje të përkohshme apo angjenciionit. Në bazë të rregullave të arkivit, dokumentacioni është publik, ndërsa për institucionin mund të jetë konfidencial.

Gjithashtu, te neni 10, ofrimi dhe arkivimi i materialit arkivor. Ofrimi i materialit arkivor për pranim në Agjenci bëhet më së voni pas kalimit të afatit prej 30 viteve, nga momenti i krijimit të materialit. Duhet të sqarohet më shumë pasusi i fjalisë, momenti i krijimit të materialit, sepse ka lëndë që zgjasin me vite, prej fillimit dhe mbarimit, për shembull kartelat shëndetësore.

Gjithashtu, mendoj se duhet t'i shtohet një paragraf i ri në këtë nen, në rastet e jashtëzakonshme kur rrezikohet lënda arkivore të poseduesi ose nuk ka kushte për ruajtje, afati për dorëzim duhet të shkurtohet. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Nuk ka të tjerë të paraqitur, prandaj po hyjmë në procesin e votimit. Në sallë janë prezentë 69 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë, tani! Ju faleminderit!

Konstatohet se me 67 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për arkivat.

Vazhdojmë me pikën e tetë të rendit të ditës:

8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për parkun kombëtar “Sharri”

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni funksional ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime, për shqyrtim në parim.

Ftoj ministrin e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, zotin Dardan Gashi, që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe arsyetojë projektligjin.

MINISTRI DARDAN GASHI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Zoti kryeministër,

Kolegë të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Në vazhden e ndërtimit të infrastrukturës së re ligjore në fushën e mjedisit dhe planifikimit hapësinor, e veçanërisht në zgjidhjen e problemeve të mbrojtjes së natyrës në Republikën e Kosovës, para nesh sot kemi 2 projektligje: Projektligjin për parkun kombëtar “Sharri” dhe Projektligjin për parkun kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”.

Ligji për parkun kombëtar “Sharri” është i nevojshëm për së paku dy arsye. Së pari, sepse mbrojtja adekuate e kësaj zone nuk ka qenë e mundur për shkak të mos harmonizimit të ligjit për këtë park, i miratuar në vitin 1986. me dispozitat e sotme ligjore të Republikës së Kosovës. Së dyti, për arsye se këtij parku i shtohet pjesa prej mbi 20.000 hektarë, që i përket komunës së Dragashit, me anë të së cilës hapësira e këtij parku rritet në mënyrë të ndjeshme.

Shpallja e Sharrit park kombëtar, në kuadër të legjislacionit të Republikës së Kosovës, do të krijojë bazën ligjore që kjo zonë të mbrohet, ruhet, përparohet dhe zhvillohet dhe do të jetë një bazë e fortë për zhvillimin e turizmit malor dhe investimeve në ngritjen e kapaciteteve turistike. Me këtë do ta përmbushim detyrimet që dalin nga legjislacioni vendor dhe konventat, marrëveshjet dhe direktivat ndërkombëtare për mbrojtjen e natyrës.

Ligji është hartuar në harmoni me Ligjin për mbrojtjen e natyrës dhe standardet e Bashkimit Evropian, projektligjet po ashtu në harmoni të plotë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Projektligji nuk përmban elemente diskriminuese, se për zbatimin e këtij Projektligji nuk nevojiten mjete të konsiderueshme buxhetore pasi që ekziston Drejtoria për administrimin e parkut kombëtar “Sharri”, me qendër në Prizren.

Projektligji nuk ndërhyjnë në projekte ekzistuese, apo prejudikon projekte të mundshme turistike. Këto çështje do të rregullohen me planet përkatëse hapësinore, prandaj ju lus që ta miratoni këtë ligj sot. Ju faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Pas prezantimit, hapi debatin në parim. Ftoj kryetarin e komisionit funksional, zotin Nahit Hasani që ta thotë fjalën e tij në emër të komisionit.

NAIT HASANI: Përshëndetje, kryesues!

Kryeministër!

Komisioni ka shqyrtuar në parim Projektligjin për parkun e “Sharrit”. Është pajtuar që të shkojë dhe të miratohet në parim, meqë është një ligj me një hapësirë të territorit shumë voluminoz. Ne kemi kërkuar dhe kërkojmë që ky ligj të trajtohet në mënyrë më adekuate. Ka 4 nene i gjithë ligji, për shkak të shtesave, sepse aty i shtohet, Parkut të “Sharrit” i shtohen edhe 24.000 hektarë, por ne kemi ashtu që edhe në Ligjin që do të vijë pas për “Bjeshkët e Nemuna” kemi pikërisht çështjen e denacionalizimit të pronave. Këtu duhet ta kemi kujdesin, të cilin kanë për ta pasur shqetësimin e qytetarëve mandej, por në parim ne kërkojmë që të miratohet dhe gjatë kohës së amendamentimit, shqyrtimit, do ta amendojmë ligjin atje sa kemi mundësi ta rregullojmë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Tani radhën e kanë përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, deputeti Njazi Idrizi.

NJAZI IDRIZI: Ju faleminderit, kryesues!

Sharri i ka ndarë banorët e Kosovës nga ata të Tetovës, Gostivarit, Dibrës dhe Kukësit. Është masivi që ndanë malin më të lartë të shqiptarëve. Këtu janë zhvilluar panairët ndërkombëtare të gjësë së gjallë që në mesjetë, ku janë vlerësuar dhe kanë marrë tituj të veçantë. Edhe sot një varg i traditave të tilla ruhen nga banorët e atjeshëm.

Deri 100 vjet më parë, në këto hapësira kanë kullotur me qindra mijëra krerë bagëtish, të cilat pastaj në karvanë janë nisur për të dimëruar në fushat e Selanikut, duke krijuar mirëqenie për banorët tanë. Edhe sot në një formë tjetër këto vlera kanë filluar të zënë

vend edhe ne duhet ti ofrojmë mbështetjen institucionale për të mirën e popullsisë që ka arritur të mbijetojë atje.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe kërkon që të miratohet. Ne do të punojmë në fazat e ardhshme për ta arsyetuar sa më mirë këtë projektligj.

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, Afërdita Berisha - Shaqiri

AFËRDITA BERISHA- SHAQIRI: I nderuar kryesues,
Kryeministër, ministra,
Të nderuar deputetë,

Parku Kombëtar “Sharri” përfshinë sipërfaqen prej 53.469 hektarë dhe shtrihet në territorin e komunave: Dragash, Prizren, Suharekë, Shterpcë dhe Kaçanik. Kufijtë e përcaktuar me këtë projektligj, në projektligjin e propozuar sigurohen parakushtet për ruajtjen e tërësishme të natyrës në territorin e parkut kombëtar “Malet e Sharrit”, përkatësisht larmisë biologjike dhe pejsazhore, si dhe shfrytëzimit të qëndrueshëm të të mirave të natyrës.

Nevoja për nxjerrjen e këtij projektligji është se Ligji për parkun nacional “Mali Sharri”, i vitit 86, bazuar në Ligjin për mbrojtjen e natyrës të vitit 76, nuk është harmonizuar me ligjet të cilat janë në fuqi, si dhe vendosja e sistemit të mbrojtjes së natyrës duhet të jetë kompatibil me ligjet e BE-së, me standardet dhe praktikën.

Sipërfaqja aktuale sipas Ligjit të vitit 1986, është 39.000 hektarë. Pas matjeve në terren, kjo sipërfaqe rezulton të jetë më e vogël. Kërkojmë nga Ministria të paraqesë gjatë shqyrtimit të mëtejshme arsyeshmërinë profesionale për zgjerimin në 53 469 hektarë.

Në parim, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, në lexim të parë s e përkrah këtë projektligj, në mënyrë që të japim kontributin tonë në komision gjatë ekspertizave të mëtejshme dhe dëgjimit publik me qytetarët dhe akterët tjetër relevant, në mënyrë që ky ligj të jetë në favor të qytetarëve të Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, deputeti Aliu.

LIBURN ALIU: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Edhe Grupi Parlamentar Lëvizja “Vetëvendosje”, do ta përkrahë, do ta votojë Projektligjin për parkun nacional “Sharri”. Konsiderojmë që edhe pjesa që do t’i shtohet parkut aktual “Sharri”, është po e njëjta vazhdimësi e të njëjtit park, me të njëjtat vlera, prandaj në këtë aspekt kjo pjesë i plotëson kriteret që të bëhet pjesë e parkut “Sharri”.

Problemi është se do të duhej që të respektoheshin çdo herë idetë, kur bëhet fjalë për këto projektligje, të shikohet motivi se prej nga vijnë këto projektligje. Pra, jo të

plotësohen kriteret e kuotat që mund të vijnë nga lart, nga komisionet evropiane kështu, por thjeshtë të shikohen kushtet konkrete në terren, e që me këtë rast këto plotësohen. Për sa i përket parkut nacional, duhet gjithmonë të kemi parasysh që për ta shpallur një park nacional dhe për ta mbajtur, për ta mirëmbajtur si të tillë, duhet punë mjaftë, duhen analiza të shumta, të cilat mendoj se tani për tani për këtë... janë të plotësuara, por duhen domosdo dhe instrumentet tjera të cilat implementojnë dhe e bëjnë mbrojtjen. Pra, ne sot kemi plan hapësinor për parkun “Sharri”, i cili plan hapësinor është mjaft i detajuar, por duhet të kemi parasysh se kur nuk ka instrumente të implementimit dhe të kontrollit, atëherë i kotë është edhe plani, i kotë është edhe projektligji, i kotë bëhet edhe ligji. Shembull, sot e kemi rastin e degradimit të natyrës, siç është rasti në Prevallë, e kështu me radhë.

Po ashtu, duhet të kihet parasysh në element tjetër, është elementi i qytetarëve që jetojnë atje. Pra, është e domosdoshme të bëhet vetëdijesimi i qytetarëve që jetojnë brenda parkut nacional, pasi ata duhet të trajtohen si pjesë e parkut, kultura e tyre, mënyra e jetesës, pronat dhe të gjitha këto janë begati të cilat vetëm sa ia shtojnë vlerën parkut, dhe nëse ata nuk vetëdijesohen se parku është edhe në të mirën e tyre, atëherë ata nuk do të mund të jenë mbrojtësit kryesorë të parkut. Realisht, mbrojtësit kryesorë të një parku janë vetë qytetarët, të cilët edhe përfitojnë nga ai park, sepse ndihen pjesë e tij.

Prandaj, është e domosdoshme që edhe çështja e parkut, edhe e kriterëve duhet të shikohen përmes kriterëve konkrete që plotësohen dhe sidomos përmes prizmit të interesit të qytetarëve, i cili në këtë rast ndërlidhet edhe me interesin e vet parkut. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Grupi Parlamentar Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, deputeti Burim Ramadani.

BURIM RAMADANI: Faleminderit, kryesues!

Ne pajtohemi që në parim ta mbështesim dhe ta miratojmë projektligjin dhe duke pasur parasysh se mbrojtja e natyrës është vërtet e rëndësishme, ne do të kërkojmë që në Komision të kemi vërtet kujdes në shqyrtimin e projektligjit para leximit të dytë, që çfarëdo lloj problemi që mund të dalë gjatë zbatimit të tij, të evitohet para se të miratohet përfundimisht ligji. Faleminderit!

KRYESUESI: Koalicioni Kosova e Re, deputetja Sevdije Lama.

SEVDIJE LAMA: Faleminderit, i nderuari zoti kryesues!

Për ta zhvilluar një ambient i cili ka pasuri natyrore, fillimisht ai region duhet të jetë i mbrojtur me ligj, qoftë me mbrojtje të veçantë, apo me shpalljen park nacional. Problemet me të cilat ballafaqohemi në natyrë, në përgjithësi në ato zona ku ka pasuri natyrore, siç është mali Sharr, siç janë ndërtimet e pakontrolluara, shfrytëzimi i pakontrolluar dhe papërgjegjësia për rezervat natyrore, hedhja e mbeturinave gjithandej e tjerë. Me vënien e një regjioni në mbrojtje të ligjit, të gjitha këto probleme do të tejkalohen.

Duhet ta përkrahim për konservimin dhe mbrojtjen e biodiversitetit të maleve të bukura të asaj ane dhe në këtë mënyrë do të forcohet mbrojtja dhe zhvillimi i turizmit.

Ka dy komponentë kryesore, ajo e mbrojtjes dhe zhvillimit të qëndrueshëm, ku do të mbrohen vlerat natyrore që rrallë kund gjenden. Në anën tjetër, do të bëhet një zhvillim i qëndrueshëm, ku do të shtohen komponentët ekonomikë, siç është ajo e turizmit, e cila do t'u sjellë benificione të mëdha banorëve lokal. Do të bëhet promovim turistik i kësaj ane, si dhe do të jetë e mbrojtur për gjeneratat e ardhshme.

Grupi Parlamentar i Koalicionit për Kosovën e Re e përkrah në parim këtë projektligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Grupi Parlamentar SLS, deputeti Todoroviq.

BOBAN TODOROVIĆ: Zahvaljujem, gospodine predsedavajući!

Parlamentarna grupa Samostalne liberalne stranke razmatrala je Nacrt zakona o nacionalnom parku „Šar“, smatramo da je izuzetno bitan Zakon za našu zajednicu, kao i za sve zajednice i u načelu ćemo podržati Nacrt zakona o nacionalnom parku „Šar“. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit!

Grupi Parlamentar “6+”, deputeti Demiri.

RASIM DEMIRI: Hvala, predsedavajući!

Parlamentarna Grupa „6+“ je razmatrala i analizirala Nacrt zakona o nacionalnom parku „Šar“. U vezi utvrđivanja prve, druge i treće zaštićene zone na području Prevalac u Župi, opština Prizren i području Gore, opština Dragaš postoje komplikacije. U mestu zvano Prevalac, koje je u prostoru nacionalnog parka „Šar“ i dalje je prisutna divlja izgradnja.

Parlamentarna grupa „6+“ dostaviće svoje predloge na usvajanje u komisijama do drugog čitanja. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit!

Fjalën e ka kërkuar deputetja Emilija Rexhepi.

EMILIJA REDŽEPI: Zahvaljujem, predsedavajući!

Poštovani predstavnici Vlade,

Poštovani poslanici,

Molimo vas da ozbiljno shvatite Nacrt zakona o nacionalnom parku „Šar“. Da se razmatra pojedinačno svaka zona, da se od strane ministra objasni na kojoj nadmorskoj visini se nalaze pojedinačno te zone, jer teritorija Župe, odnosno vrhovi Šar planine, konkretno naselje Gornje Ljubinje, Donje Ljubinje, Manastirica i Planjane i ostala sela koja se nalaze na toj teritoriji upravo su pod zaštitu nacionalnog parka.

Poštovani ministre,

Ta teritorija nam je upravo strateško mesto za našu buduću planiranu opštinu i molim vas da objasnite sve štetne posledice koje možemo u Nacrtu zakona rešiti od sad, ili možda na neki član ili amandman, reči.

Zatim, recite nam molim vas, šta će biti sa dosadašnjom uzurpacijom zemljišta na Prevalcu, da li će se zaustaviti ilegalna izgradnja dosadašnjih vikendica, kakva će biti legalizacija tih objekata, kakva će biti zdravstvena zaštita te teritorije i kakav će biti ekonomski razvoj te teritorije? Zahvaljujem se!

KRYESUESI: Faleminderit!
Fjalën e ka kërkuar deputeti Mursel Halili.

MURSELJ HALILJI: Zahvaljujem, gospodine predsedavajući!

Gospodine predsedniče Vlade,
Zamenici,

Uvaženi gospodo ministri,
Članovi i kolege poslanici,

Ja imam jedno legitimno pravo jer dolazim iz tog kraja, iz kraja opštine Dragaš, i obzirom da ovaj Nacrt zakona uglavnom obuhvata taj regjion, i sam ministar, uvaženi resorni ministar je rekao da se Nacionalni park „Šari“ proširuje na 20 hiljade hektara na tom prostoru. Delim zabrinutost koju je i gospođa Emilija, koleginica rekla. Ja bih želeo da vas pozovem da ne bi došlo do uznemirenja građana na tom prostoru, resorno ministarstvo, gospodin ministar i svi ostali dođu, organizuju javne debate, pričaju sa građanima, da im razjasne šta donosi nacrt zakona, šta se dobija, a ne bi želeo da kažem šta se gubi, jer u svakom slučaju obzirom da postoji poseban tretman kod ovog nacrta zakona kada sutra bude i zaživi, da će imati poseban režim u tom delu. Naravno, delim zabrinutosti oko toga gde će te zone da budu obzirom da gledajući kartu koja je tu, obuhvata region Opolja, opštine Dragaš, tu se spominje selo Buče, zatim ceo region opštine Dragaš, Gorski deo, pa vas molim da razjasnimo konkretno detalje oko ovog nacrta zakona da bi ljudi bili spokojni. U tom smislu mi se slažemo da će doći do razvoja tog regiona, nama to godi i oberučke prihvatamo takvu ideju, ali takođe želimo da znamo šta sa njim može da se “izgubi”. Prema tome, ja ću u načelu podržati ovaj nacrt zakona, ali vas molim gospodine ministre da organizujete javne debate, dođete na teren da razgovarate sa ljudima, da objasnimo taj ceo proces i da sve to bude u okvirima zakona. Hvala, još jednom!

KRYESUESI: Faleminderit!
Zoti ministër, e keni fjalën që të sqaroni, se deputetë tjerë nuk ka të paraqitur!

MINISTRI BLERAND STAVILECI: Natyrisht që i kuptoj shqetësimet e deputetëve. Mirëpo, ky ligj nuk e përcakton zonimin dhe mënyrën se si zonohet dhe në çfarë zona do të ndahet zhvillimore, do të thotë, pjesa e re që i ngjitet malit “Sharr” ashtu siç nuk i përcakton edhe për Ligjin e ardhshëm që kemi për të diskutuar për Bjeshkët e Nemuna, zonimi do të bëhet në bashkëpunimin me komunitetin lokal, me komunat përkatëse dhe do të vjen këtu prapë për votim në këtë Kuvend. Kështu që shqetësimet që i keni sot, i

kuptojmë, mirëpo ato do të vinë në Kuvend pas zonimit që do ta bëjmë bashkërisht me komunitetin lokal. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Nuk ka të tjerë të paraqitur. Tani vazhdojmë me votim për miratimin në parim të Projektligjit për parkun kombëtar “Sharri”.

Në mbledhje janë prezentë 71 deputetë.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tani! Faleminderit!

Konstatohet se me 68 vota “për”, një abstenim, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për parkun kombëtar “Sharri”.

Kërkohej nga komisioni funksional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit të shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

Pika e nëntë e rendit të ditës:

9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për parkun kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, komisioni funksional ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime, për shqyrtim në parim.

Ftoj ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, zotin Dardan Gashi, që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe arsyetojë projektligjin.

Kisha kërkuar, zoti ministër, që të bëni një sqarim shtesë, edhe unë po ta bëjë një kërkesë. Është një dilemë se këto parqe nacionale a do t’ua nacionalizojnë njerëzve tokat, a do t’ju merren pyjet që janë pronë private e tyre apo si është puna dhe po mendoj që është një shqetësim i madh i cili ka bërë që në legjislaturën e kaluar të mos kalojë ky ligj. Faleminderit!

DARDAN GASHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Zoti kryeministër, kolegë të Kabinetit,

Deputetë të nderuar,

Do të thotë, baza ligjore e këtij ligji e njëjta si ajo e parkut kombëtar “Sharri”, andaj po e kursej kohën dhe po hy drejtë në disa specifika të këtij parku.

Sa i përket Projektligjit për parkun kombëtar “Bjeshkët e Nemuna” vlen të veçohet se kjo zonë me bukuri natyrore, me florë dhe faunë të veçantë, fatkeqësisht i është nënshtruar një tendencë të shkatërrimit nga ndërtimet e egra dhe prerjeve ilegale të pyjeve. Andaj, me shpalljen e kësaj zone park kombëtar, është momenti i fundit që ky territor të futet në mbrojtjen e shtetit para se të dëmtohet në masë të pariparueshme.

Me miratimin e këtij ligji, Kosova do të pajiset me parkun e dytë kombëtar dhe po iu afrohet standardeve evropiane, ku shtetet obligohen që së paku 10% të territorit të tyre ta vënë në mbrojtjen e tillë.

Për shkak të përkufizimeve buxhetore, parku “Bjeshkët e Nemuna” do të menaxhohet nga Drejtoria ekzistuese e parkut kombëtar “Sharr” me anë të një departamenti të veçantë deri në krijimin e kushteve për një rregullim tjetër.

Pra, duke u përgjigjur pra edhe në pyetjen e kryesuesit, Ligji në asnjë mënyrë nuk i prekë pronat, pronat private mbetin, do të vazhdojnë të mbetin pronë private.

Po ashtu, ky ligj nuk e përcakton as zonimin e këtyre pjesëve, do të thotë, ajo që e thashë më herët sa i përket pjesës së Dragashit, parkut kombëtar “Sharr”, në bashkëpunim me pronarët e tokave, me komunitetin lokal, me komunat përkatëse, Ministria do të përpilojë Planin hapësinor, ku do të vendoset zonimi dhe po ashtu edhe ai ligj do të vjen këtu në Kuvend për t’u diskutuar dhe për të vendosur dhe votuar në këtë Kuvend.

Andaj, shqetësimet sa u përket pronave janë të panevojshme, sepse ky ligj i vë vetëm në mbrojtje sa i përket ligjit të natyrës, kurse prona mbetet e atyre që kanë edhe sot. Faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër!

Tani fjalën e ka kryetari i Komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari dhe Mjedis e Planifikim Hapësinor, deputeti Nait Hasani.

NAIT HASANI: Faleminderit, kryesues!

Përshëndetje, kryeministër!

Komisioni ka shqyrtuar Projektligjin për parkun “Bjeshkët e Nemuna” dhe me datën 29 ka marrë vendim që Kuvendit t’ia prezantojë dhe të kërkojë ta votojë, në parim.

Po, neve na ka ardhur një shkresë nga një takim me banorët e komunitetit të Rugovës, që iu kanë drejtuar edhe ministrisë, na janë drejtuar edhe neve si komision, nga komuna e Pejës, nga shoqëria civile, nga 15 fshatra të asaj ane kanë kërkuar dhe kërkojnë që të trajtohet më mirë kjo çështje për shkak se ata mendojnë që nuk është trajtuar mirë, nuk është mbajtur një debat, nuk është kërkuar që ata të marrin pjesë ose t’i japin sugjerimet e tyre. Ata kanë kundërshtimin në nenet e këtij ligji për zonat të cilat do t’i ketë ose zonimet. Kanë po ashtu vërejtjet për denacionalizimin e pronave. Dje me këta në takim kam treguar që ky ligj nuk prek çështjen e pronave të tyre, vetëm e bën një menaxhim më të mirë të tyre. Por, çështja është që, mendoj që me këtë ligj duhet të trajtohen më mirë, për shkak se për të tretën herë vjen ky ligj këtu dhe nuk kemi mundësi ndoshta ta kalojmë pikërisht sepse ata banorë janë shqetësuar për vijën e kufirit, janë shqetësuar për pronat e tyre edhe kërkojnë që të ketë dikush t’i garantojë ata dhe kush do ta menaxhojë parkun, do të menaxhohet nga ministria, nga komuna apo nga komuniteti, janë shqetësime të cilat unë besoj që gjatë kohës që do ta kemi në shqyrtim ligjin, besoj që do të mund bashkë me ministrinë, nëse na duhet edhe ndihma e Qeverisë, po ashtu, që ta harmonizojmë dhe ta

miratojmë këtë ligj i cili është i nevojshëm. Por, mendojmë, besoj që ky ligj nuk është në paketën e Ahttisarit, që ndoshta na duhet me obligim.

KRYESUESI: Faleminderit!

Tani radhën e kanë përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Në emër të Grupit parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, deputeti Idrizi.

NIJAZI IDRIZI: Faleminderit, kryesues!

Bjeshkët e Nemuna janë vlerë për Kosovës, Ballkanin dhe njerëzimin. Për shkak të shtrirjes së tyre, kërkohet edhe angazhim ballkanik për ta marrë në mbrojtje. Prandaj, edhe kohë më parë ato janë propozuar që të merren në mbrojtje nga të tria shtetet dhe të emërtohet si “Park i paqes”.

Në kuptimin kombëtar, parku përfshinë zona të banuara me shumicë nga shqiptarët në Mal të Zi dhe në të dy vendet e kombit tonë. Pikërisht në kurrizin e këtij mali është vendosur perdja e hekurt për t’i izoluar dhe ndarë përfundimisht njerëzit.

Malet që i përbëjnë Bjeshkët e Nemuna kanë qenë po thuaj se të pakalueshme dhe, si të tilla, vazhdojnë të mbeten edhe sot. Njerëzit e Plavës e të Gucisë janë po thuaj se të ndarë nga ata të Deçanit, Tropojës dhe Thethit.

Parku përmban një shans që kjo pengesë të kthehet në të kundërtën, në faktor bashkimi për banorët e atjeshëm. Është interes kombëtar dhe i integriteteve që t’i lidh njerëzit e ndarë, duke ua thyer atyre këtë perde të hekurt.

Sfida jonë mbetet të mendojmë rreth shkallës së kufizimeve që do të shkaktojmë në përdorimin e burimeve të pasura natyrore sepse, siç jeni në dijeni, Bjeshkët e Nemuna paraqesin masivin malor më të begatshëm në Ballkan, me prani të mbi 1500 llojeve deri më tani të hulumtuara të bimëve, edhe pse ky numër ende nuk është definitiv, sepse hulumtimet po vazhdojnë edhe më tej.

Debati për shpalljen e këtij parku, të këtij vendi park, në mes të palëve në interes, deri tani po bëhet në dy ekstreme, pro dhe kundër shpalljes.

Për çudi, kësaj radhe segmentet e ministrisë, bujqësisë dhe popullsia lokale janë bërë bashkë dhe të parët po e dekurajojnë popullsinë lokale, duke i thënë se ky ligj do t’i kufizojë ata në shfrytëzimin e resurseve të veta.

Dëshiroj ta theksoj faktin se edhe njerëzit janë pjesë e biodiversitetit dhe se ata kufizohen që ta bëjnë jetën e tyre sipas mënyrës së vet si pjesë, atëherë pikërisht ky ligj duhet t’i marrë në mbrojtje.

Për më shumë, Qeveria që e ka sjellë këtë projektligj, duhet t’u japë garanci, por duhet të fillojë edhe me ndarjen e subvencioneve dhe me granteve, me qëllim që jeta e banorëve që do të jenë pjesë e parkut, të përmirësohet. Këta banorë do të bëjnë një mrekulli të madhe duke i shërbyer vendit, jo diversitetit dhe zhvillimit global, atyre duhet t’ju

ndihmohet për t'i përdorur në mënyrë të qëndrueshme drunjtë, blegtorinë, frutat e bimëve, bimët mjekësore e të tjera.

Stanet, bleshkët dhe fillimet e jetës në këto zona, që ruajtën banorët aty, duhet të vazhdojnë që ta përbëjnë truallin më të rëndësishëm të parkut, bashkë me copëzat e Kanunit të grisur, shenjat e të cilëve kanë ngelur këtu. Tëbanat jo vetëm që nuk duhet të ndihen të kërcënuara, por duhet të shërbejnë si modele të qëndrueshme të infrastrukturës së ardhshme. Këtu duhet të gjejnë vend edhe eposi i lashtë i traditës tonë, si pjesë e rëndësishme e biodiversitetit e cila është gllabëruar në shumë vende.

Ministria e Mjedisit me të gjitha palët e interesit duhet të vendos e rivendos kritere shumë të qarta për zonimin e parkut. Ne dëshirojmë që ta shpallim park këtë zonë, që ta përmirësojmë jetën e banorëve atje.

Të gjithë ne e kemi të qartë se këto burime natyrore janë në radhë të parë për banorët e asaj ane. Me transparencë të plotë duhet të vendosen të gjitha zonat e paarrtshme në zonën strikt të mbrojtjes, zonat që i përmbajnë pasuritë e biodiversitetit dhe të cilat nuk i cenojnë të drejtat e pronarëve.

Me këtë projektligj ne po afrojmë një mundësi të madhe për ta ndërprerë shkatërrimin mizor të pyjeve që ka filluar në disa vite në Deçan, Pejë, Istog.

Ju e dini, të nderuar deputetë, se ka disa vite që të gjithë ne po diskutojmë për ta ndaluar këtë katastrofë, duke përdorur edhe mjete të sofistikuara të vrojtimit e të infrastrukturës.

Nga këtu u bëjmë me dije popullsisë së Rugovës e të Pejës se zërat e përhapur atje se çdo gjë do t'ju ndalohet, nuk janë të vërteta. Vetëm shkatërrimi barbar ilegal i pyjeve do të ndalohet. Ne kërkojmë nga ekspertët që të jenë më transparentë, komunikimi me këta njerëz dhe grupet e interesit duhet të jetë i hapur dhe pa sherr.

Të nderuar deputetë,

Jemi para një sfide që t'i shërbejmë kombit dhe gjeneratave të ardhshme. Nëse arsyeja dhe dija do të dominojnë procesin, atëherë ne do të jemi në rrugën e duhur.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike do ta votojë në parim këtë projektligj dhe ne do ta japim kontributin tonë në punën e mëtutjeshme.

KRYESUESI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, deputeti Morina.

SALIH MORINA: Faleminderit, kryesues!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe Lidhja Demokratike e Kosovës ka shqyrtuar këtë projektligj dhe në parim do të mbështes. Njëkohësisht paraqesim shqetësimet e qytetarëve, të banorëve të Rugovës, ku pikërisht është çështja e pronës. Po, meqë ministri në këtë rast e sqaroi çështjen e pronave

të tyre, atëherë kërkesë edhe e tyre ka qenë, por kërkesë edhe e imja është që kjo çështje të rregullohet me ndonjë nen të veçantë, në leximin e dytë, do të thotë, nga ana edhe e komisionit, po ashtu edhe të ekspertëve që do të marrin pjesë në përpunimin e këtij ligjit. Dhe, gjithashtu, është shqetësuese edhe çështja e menaxhimit me parkun kombëtar, ku banorët e Rugovës kërkojnë që me këtë park të menaxhojnë jo vetëm Ministria dhe Qeveria, por të menaxhojë edhe komuna dhe po ashtu të menaxhojnë edhe organizatat joqeveritare dhe konsideroj se një ligj i tillë është i mirëseardhur duke marrë për bazë pasojat shkatërruese që kanë qenë deri më tani në Bjeshkët e Nemuna, shkatërrimi sidomos i pyjeve, degradimi i pyjeve në përgjithësi.

Prandaj, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike në parim e voton dhe do të japim kontributin tonë gjatë shqyrtimit të dytë. Faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, deputeti Aliu e ka fjalën.

LIBURN ALIU: Faleminderit, kryesues!

Po ashtu edhe Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” do ta përkrahë në parim shpalljen park për Bjeshkët e Nemuna.

Kur flasim për Bjeshkët e Nemuna, prapë duhet t’i kemi parasysh si një ndër vendet që i ka vlerat e veçanta në Ballkan për turizmin malor dhe është jashtëzakonisht e domosdoshme që këto vlera të ruhen dhe të mbrohen e të shfrytëzohen maksimalisht në funksion të qytetarëve dhe në funksion përgjithësisht të Kosovës.

Prandaj, është e domosdoshme që këto vlera të mbrohen. Gjendja aktuale në Bjeshkët e Nemuna është e rëndë me qenë se prerjet ilegale janë duke ndodhur masivisht dhe po e degradojnë në vazhdimësi natyrën atje.

Pra, është e domosdoshme që të ndodhë një mbrojtje kundrejt këtij procesi degradues dhe është tejet e nevojshme që të ketë një ligj i cili Bjeshkët e Nemuna i shpall park si dhe i mbron ato.

Kur flasim për problemet konkrete në lidhje me këtë park, do të doja të thosha që problemet të cilat janë shndërruar në pengesa për parkun nacional “Bjeshkët e Nemuna”, pak a shumë fajin e kanë te vetë Ministria, për të vetëm arsye që nuk ka ndodhur sqarimi i nevojshëm i popullatës përgjatë kohës.

Deri më tani ka pasur debate të organizuara kryesisht në Pejë dhe kryesisht me banorët të cilët jetojnë në Pejë, por janë me origjinë rugovas. Mendoj që do të duhej të sqaroheshin mirë qytetarët e Kosovës të cilët jetojnë në atë pjesë dhe tani në këtë periudhë të dimrit është vështirë t’i gjesh, sepse ata shumica e atyre bëjnë jetë sezonale në Pejë dhe Rugovë.

Pasi sqarimi i tyre e mundëson mbrojtjen e Bjeshkëve të Nemuna dhe mundëson funksionimin e këtij parku, duhet ta kemi parasysh që po i sqaruar mjaftueshëm

qytetarët, atëherë ata vetdisohen për nevojën e këtij parku, pasi do të kenë vetëm përfitime nga kjo.

Pse nuk ka ndodhur deri më tash ky sqarim, është fakti që edhe ligji është mjaftë i shkurtër edhe i thjeshtë dhe, në anën tjetër, nuk ka ndodhur një analizë më detale, qysh është rasti i parkut “Sharri”. Pra, nuk ka ndodhur një analizë e cila do t’u prezantohej konkretisht banorëve të asaj ane dhe do t’ju sqarohej që nga parku nacional “Bjeshkët e Nemuna” ata do të kenë vetëm përfitime. Pra, duhet ta kemi të qartë që turizmi gjithnjë në rritje, turizmi malor në atë pjesë është i pamundshëm pa qytetarë që jetojnë në atë pjesë. Ata e bëjnë të mundshëm atë turizëm, e bëjnë të mundshëm për faktin që e mirëmbajnë parkun dhe për faktin që janë pjesë e tij me kulturën, traditat nga e kaluara e kështu me radhë.

Pra, tani në këto momente do ta kemi mjaftë vështirë. Ata kanë probleme me pronat, është po ashtu problemi i kufirit, i cili prapë duhet të sqarohet që ky ligj nuk ka të bëjë me pronat e tyre dhe nuk ua prekë fare pronat dhe problemet, kontestet që janë gjyqësore do të trajtohen në të ardhmen. Dhe në ato zona, për shembull, ku janë zonat e dyta, atyre prapë do t’ju lejohet edhe shfrytëzimi i pyjeve, por natyrisht një shfrytëzim i kontrolluar i pyjeve.

Të gjitha këto elemente që janë elemente pozitive dhe ndikojnë në zhvillimin e turizmit dhe ekzistimin e këtij parku, tamam ashtu si duhet, të gjitha varen nga sqarimi në të ardhmen që do të mund t’ua bëjmë ne qytetarëve, tani si komision, e që kemi mjaftë pak kohë dhe periudhën e kemi mjaftë të papërshtatshme, sepse është periudhë e dimrit. Funksionimi apo implementimi varet pikërisht nga organizimi dhe pjesëmarrja e qytetarëve të kësaj ane në këtë park. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, deputetja Kadriaj.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Edhe Bjeshkët e Nemuna janë pjesë e Kosovës dhe ato duhet të mbrohen. Shqetësim edhe për neve si grup parlamentar ka qenë mos të dalë problem me zonimin. Edhe ne i kemi marrë për bazë shqetësimet e banorëve të komunës së Pejës, të fshatrave të Rugovës dhe të kuvendit komunal se çka do të bëhet me pronat private të qytetarëve në ato zona ku do të shpallet park nacional të Bjeshkëve të Nemuna.

Po ashtu, në këtë ligj duhet të specifikohet se kush e harton planin hapësinor të parkut kombëtar, kush e harton planin e menaxhimit dhe a do të jenë komuna dhe komuniteti pjesë përbërëse e këtyre elementeve? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar Koalicioni Kosova e Re, deputetja Sevdije Lama.

SEVDIJE LAMA: Faleminderit, i nderuari zoti kryesues!

Të gjitha studimet shkencore profesionale kanë konstatuar se zona e Bjeshkëve të Nemuna plotëson të gjitha kushtet dhe kriteret e të gjitha dokumenteve kombëtare dhe ndërkombëtare për ruajtjen e natyrës për park kombëtar.

Vlerat potenciale turistike, vlerat kulturore dhe historike, vlerat natyrore në zbulim e sipër, përfshirë 148 lloje shpendësh, 8 lloje peshqish, 13 lloje ujë tokësorësh, 10 lloje rrëshqitësish, 37 lloje gjitarësh, 129 lloje fluturash e tjera. Flora dhe fauna, bukurit pejsazhore janë parakusht për shpalljen e një vendi park nacional.

Në anën tjetër, degradimi dhe shkatërrimi i zonës, që konsiderohet perla natyrore e Kosovës, ka marrë përmasa shqetësuese sidomos në dekadën e fundit.

Mungesa e investimeve, prerjet dhe degradimet e pyjeve, shfrytëzimi i pakontrolluar i resurseve natyrore, rrezikimi i llojeve endemike dhe relikte të bimëve dhe shtazëve, ndotja e tjera janë emëruesi i përbashkët i Bjeshkëve të Nemuna dhe shkaktarë që kanë zbehur perspektivën për një jetë më të mirë të banorëve të zonës.

Qeveria e Kosovës duhet të mobilizojë mekanizmat kompetent që të analizojë aspektet që e bëjnë zonën e Bjeshkëve e Nemuna zonë specifike, të sigurojë banorët se me shpalljen park kombëtar ajo do të jetë me qytetarët dhe jo mbi qytetarët. Zona me interes të veçantë me planin hapësinor të Kosovës do të ketë prioritet në fushën e investimeve kapitale dhe përmirësimit të jetës.

Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor duhet të forcojë kapacitetet institucionale, të bëjë transparent hapat e deritashëm të vendimmarrjes, të fillojë menjëherë një fushatë intensive për informimin dhe vetëdijësimin e publikut për parkun kombëtar.

Komunat duhet të mos vendosin barrierë të komunikimit dhe bashkëpunimit në mes autoriteteve qendrore dhe qytetarëve, të krijojnë programe për ofrim të shërbimeve dhe mundësive.

Qytetarët të mos mbajnë qëndrim negativ ndaj parkut kombëtar, me gjithë kampanjën negative deri tani. Jeta brenda ligjit është siguri, ndërsa jeta brenda parkut është privilegj dhe mundësi. Duhet të pozicionohen qartë, a duhet të jetojnë si deri sot, apo duan diçka të re dhe të mirë në jetën e tyre.

Për arsytet që i ceka më lartë, Grupi Parlamentar i Koalicionit për Kosovën e Re e përkrah në parim Projektligjin për parkun kombëtar “Bjeshkët e Nemuna” Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar SLS, deputeti Todoroviq.

BOBAN TODOROVIC: Zahvaljujem, gospodine predsedavajući!

I Parlamentarna grupa Samostalne liberalne stranke razmatrala je ovaj Nacrt zakona i podržaćemo ga u načelu.

KRYESUESI XHAVIT HALITI: Faleminderit!

Unë desha t'i them dy fjalë lidhur me ligjin në fjalë, me qenë se kam marrë pjesë edhe në një debat që është zhvilluar në Pejë për këtë.

Unë nuk e shoh ligjin të realizueshëm nga vetë qytetarët e Rugovës, veçanërisht të cilëve një pjesë e madhe e tokave u është uzurpuar tani, do të thotë, nga kufiri i Malit të Zi, ka rënë nën pjesën ku ka qenë kufiri tradicional. Ata kanë ankesa se tokat e tyre, kullosat e tyre janë marrë nga Qeveria e Malit të Zi dhe nga ushtria e Malit të Zi janë pushtuar. Kështu e trajtojnë ata. Domethënë, nga pjesa e maleve që quhet "Mokna" dhe deri në pjesën që kufizohet me kufirin e Malit të Zi – Shqipëri, kufiri është rrudhë i Kosovës. Kjo është një çështje.

Çështja e dytë është se ne po flasim për parkun nacional dhe ruajtjen e maleve, por realisht ne duhet urgjentisht të nxjerrim një ligj për ruajtjen e maleve, për mos prerjen e tyre, sepse ato janë po thuaj se në degradim e sipër nga mos kujdesi i institucioneve të Kosovës dhe askush nuk e di se kush është kompetent për ruajtjen e tyre dhe askush nuk e kryen detyrën ashtu siç duhet, as Policia e Kosovës, as rojet e pyjeve.

Çështja e këtij ligji duhet të përfshijë patjetër ruajtjen e pjesës, ta quajmë, nëse doni turistike, nëse doni jetike për turizmin malor dhe për jetën e njerëzve atje, rrjedhën e 4 lumenjve të cilat kanë filluar të degradohen dhe ta humbin kuptimin e lumenjve që e kanë pasur dikur. Po e them, kanjoni i Lumit Bistrica ose Lumi i Bardhë duhet të jetë pjesë pa tjetër e këtij parku nacional, ashtu siç do të duhej edhe Bistrica e Deçanit dhe në veçanti do të duhej ruajtur ujëvarat e Drinit të Bardhë të cilat kanë qenë bukuri e Kosovës dhe, realisht, përmes projekteve pa leje, do ta quaja, të cilat kanë implikime ligjore në Kosovë, janë degraduar në masën e cila nuk i tërheqë njerëzit më tash ta vizitojnë atë burim të lumit.

Prandaj, në qoftë se nuk futen këtu dhe nuk parashihen investime të paktën për qarkullim rrugor në këmbë për turizëm malor dhe për t'ju ofruar qytetarëve të Rugovës dhe të asaj ane që të zhvillojnë turizmin malor, nuk e besoj që do ta ketë vlerën si ligj me 4 nene ose 5 nene, sa mund t'i ketë. Faleminderit!

Nuk ka të tjerë të paraqitur. Përfaqësuesi i Qeverisë a dëshiron ta marrë fjalën?

DARDAN GASHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Edhe një herë, pra, shqetësimet që i pati edhe kryesuesi, edhe deputetë të ndryshëm që morën fjalën, ky ligj pra është vetëm ligj kornizë për ta futur në mbrojtje të shtetit një territor dhe nuk e prekë pra pronësinë, kurse të gjitha çështjet tjera do të zgjidhen me planin hapësinor, i cili do të votohet në Kuvend. Faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Faleminderit!

Në sallë janë 65 deputetë.

Pra, vazhdojmë deklarimin me votim për miratimin në parim të Projektligjit për parkun "Bjeshkët e Nemuna".

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tan! Faleminderit!
Konstatohet se me 62 vota “për”, një “kundër” dhe një abstenim, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për parkun kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”.

Kërkohet nga komisioni funksional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

Pika e dhjetë e rendit të ditës është:

10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për deminimin humanitar

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni funksional ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime, për shqyrtim në parim.

Ftoj ministrin e Forcës së Sigurisë, zotin Agim Çeku, që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe arsyetojë projektligjin.

MINISTRI AGIM ÇEKU: I nderuar kryesues,
I nderuari kryeministër, zëvendëskryeministra, ministra,
Të nderuar deputetë,
Bazuar në nenin 10.2, paragrafi c), të Ligjit numër 03/L-046 për Forcën e Sigurisë së Kosovës, detyrë e Forcës së Sigurisë së Kosovës ndër të tjera është të kryej shkatërrimin e mjeteve shpërthyes.

Po ashtu, me vendimin e Qeverisë numër 04/139, të datës 12.8.2010, Ministria për Forcën e Sigurisë ka pranuar të gjitha përgjegjësitë dhe detyrat për asgjësimin e mjeteve të pashpërthyer në territorin e Republikës së Kosovës.

Prandaj, sot para jush paraqes Projektligjin për deminim humanitar, i cili projektligj ka për qëllim përcaktimin e rregullave për deminim humanitar në Kosovë.

Kjo lëmi deri më tani nuk ka qenë e rregulluar me dispozita përkatëse ligjore.

Çështjet të cilat i adreson ky projektligj kanë të bëjnë kryekëput me deminimin humanitar, institucionet kompetente për deminim, kushtet dhe kriteret për akreditim, suspendim dhe anulim të licencave të organizatave të cilat merren me aktivitetin e deminimit humanitar.

Pos definimit të aktiviteteve të deminimit humanitar, projektligji precizon edhe veprimtarinë dhe kompetencat e Qendrës koordinuese për deminim në kuadër të Ministrisë së Forcës së Sigurisë së Kosovës, si dhe koordinimin në mes të institucioneve vendore për ndërmarrjen e veprimit të dominimit, si dhe kushtet dhe kriteret për akreditim të subjekteve që fitojnë të drejtë të ushtrojnë këtë veprimtari në territorin e Republikës së Kosovës.

Projektligji për deminimin humanitar nuk krijon implikime financiare për buxhetin e Republikës së Kosovës. Kjo shihet edhe nga deklarata financiare e lëshuar nga Ministria e Financave.

Projektligji është hartuar në bashkëpunim me këshilltarët e NATO-s dhe është në përputhshmëri me standardet IMAS, që do të thotë standarde ndërkombëtare për aksion ndaj minave, si dhe ka formën dhe strukturën që përdoret për hartimin e legjislacionit të Kosovës.

Projektligji nuk ka elemente diskriminuese. Prandaj, me qëllim të përmbushjes së obligimeve ligjore që dalin nga neni 10.2 i Ligjit numër 03/L-046 për Forcën e Sigurisë së Kosovës, si dhe me qëllim të rregullimit të çështjes së deminimit humanitar me akt ligjor, Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës e përkrah miratimin e këtij Projektligji për deminimin humanitar. Ju faleminderit, për vëmendje dhe për mbështetje!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër!

Tani ftoj raportuesin e Komisionit funksional për Punë të Brendshme dhe Siguri, është paraqitur deputeti Fatmir Xhelili.

FATMIR XHELILI: Faleminderit, kryesues!

Përshëndetje për Kabinetin,

Të nderuar deputetë,

Komisioni, në mbledhjen e vet të mbajtur më 6 dhjetor, e ka shqyrtuar në parim këtë projektligj dhe i ka rekomanduar Kuvendit që ta miratojë pasi i plotëson të gjitha kriteret prej nenit 54 të paragrafit dhe të Rregullores së Kuvendit për këtë ligj.

Gjithashtu, edhe në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike propozoj që të miratohet ky projektligj, në parim, pasi i plotëson të gjitha kriteret të parapara nga neni në fjalë. Anëtarët e grupit tonë do të participojnë në komisionin në fjalë që ky ligj të jetë sa më cilësor dhe sa më kualitativ. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Tani grupet parlamentare e kanë radhën. Më duket që zoti Xhelili foli edhe në emër të grupit.

Fjalën e ka në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, kryetari i Grupit Parlamentar, zoti Beqiri.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Grupi Parlamentar i LDK-së në parim e mbështet këtë Projektligj për deminim humanitar dhe kontributin do ta japim përmes deputetëve tanë në komisionet përkatëse. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, fjalën e ka deputeti Rexhep Selimi.

REXHEP SELIMI: Faleminderit, zoti kryesues!

Në fakt, ministri tha që ky ligj nuk diskriminon. Desha ta di, a është në përputhje me paketën e Ahtisarit? Ishte veç një shaka!

Gjithsesi, ky ligj është shumë i nevojshëm për Forcat e Sigurisë së Kosovës. Pra, ky ligj rregullon një aktivitet që veç e ka kryer Forca e Sigurisë së Kosovës dhe veç e ka në projekte të zhvillimit të saj. Si të tillë, do ta përkrahim në parim dhe do ta japim kontributin tonë në komision. Gjithsesi do ta përkrahim. Faleminderit!

KRESUESI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, deputeti Burim Ramadani.

BURIM RAMADANI: Faleminderit, kryesues!

Ne e përkrahim në parim dhe në tërësi projektligjin. Normalisht se vlerësojmë që është me rëndësi dhe po ashtu e përshëndesim edhe punën që është bërë në këtë projektligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Të tjerët nuk janë paraqitur!

S'ka të paraqitur për të diskutuar lidhur me këtë ligj.

Zoti ministër, doni fjalën shtesë? Jo.

Nuk kemi kuorum. Nuk ka deputetë për të votuar.

Nesër vazhdojmë në orën 10:00.

E mërkurë, më 21.12. 2011,

Drejton seancën: Nënkrjetari i Kuvendit të Kosovës, zoti Xhavit Haliti

KRYESUESI: Të nderuar deputetë,

Ju lus që ti zëni vendet, sepse koha është që ta fillojmë seancën, jemi me vonesë për 20 minuta.

Të nderuar përfaqësues të Qeverisë,

Deputetë,

I vazhdojmë punimet e mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovë, të filluar dje, për pikat e mbetura.

Konstatoj se në sallë janë të pranishëm 62 deputetë.

Vazhdojmë me pikën e dhjetë të rendit të ditës: - **Shqyrtimi i parë i Projektligjit për deminimin humanitar** (ka mbetur të bëhet vetëm votimi).

Po, para se të vazhdoj, dua të shpreh një shqetësim për mediat, të cilat po raportojnë nga Kuvendi gabimisht dhe me porosi. Dje, unë nuk ia kam marrë askujt fjalën për replikë, ndërsa kundër replikë ka të drejtë ai i pari, sipas Rregullores. I vetmi njeri që mund të ankohet, është nënkryetari i Kuvendit, Sabri Hamiti, për të tjerët nuk qëndron. Po them, në mua mund të ankohet. Prandaj, nuk e shoh të arsyeshme, mediat duhet t'i referohen rregullores dhe pastaj të shkruajnë, mos ta dezinformojnë opinionin.

Kemi mbetur te votimi i ligjit.

Lus deputetët që të përgatiten për votim, votojmë tani! Faleminderit!

Konstatohet që me 51 vota “për”, 1 abstenim dhe 1 “kundër”, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për deminimin humanitar.

Kërkohej nga komisioni funksional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t’i paraqesin raportet me rekomandime.

Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, fjalën e ka kërkuar kryetari i Grupit, zoti Beqiri.

ISMET BEQIRI: Faleminderit shumë, zoti kryesues!

Me qenë se u lidh me media, dëshiroj edhe një herë ta them atë që nuk ka pasur paraqitje korrekte të mediave rreth procedurave të votimit, pikërisht për dy projektligje, edhe të buxhetit, edhe të Projektligjit për Qendrën Historike të Prizrenit. Unë po e them publikisht, po e them edhe një herë, ka qenë dhe nuk është mirë në mënyrë selektive të thuhet këta kanë votua “për”, këta “kundër”, në kuptimin e asaj se s’e kanë thënë drejt. Edhe një herë po e përsëris, LDK-ja dje për të dy këto projektligje ka qenë “kundër”, po e konfirmoj edhe një herë dhe nuk është korrekte mjetet e informimit të mos informojnë drejt, ato që nuk kanë informua drejtë, nuk po e them për të gjitha. Prandaj, po e them edhe një herë, LDK-ja nuk e ka përkrahur buxhetin për vitin e ardhshëm dhe nuk e ka përkrahur Projektligjin për Qendrën Historike të Prizrenit. Kjo është për hir të korrektësisë ndaj mjeteve të informimit dhe qytetarëve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Është e drejtë jo vetëm e grupit, por edhe deputetëve të sqarojnë, në fund të fundit, votën “pro” ose “kundër”, pse e kanë dhënë dhe pse nuk e kanë dhënë.

Në emër të grupeve parlamentare nuk ka të paraqitur. Janë dy deputetë, nuk kemi debat. Faleminderit!

Vazhdojmë me pikën njëmbëdhjetë të rendit të ditës, që është:

11. Shqyrtimi i parë i Projektkodit Penal të Republikës së Kosovës

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, komisioni funksional ka shqyrtuar Projektkodin Penal dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime, për shqyrtim në parim.

Ftoj përfaqësuesin e Qeverisë, në këtë rast zëvendëskryeministrin zotin Bukoshi, që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe arsyetojë Projektkodin Penal.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI BUJAR BUKOSHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë nga Kabineti qeveritar,

Zoti zëvendëskryeministër dhe zoti ministër,

Edhe të tjerët që nuk janë këtu,

Të nderuara deputete,

Të nderuar deputetë,

Më lejoni që të paraqes para jush për miratim Projektkodin Penal të Republikës së Kosovës.

Është angazhim direkt i Ministrisë së Drejtësisë në plotësimin e infrastrukturës ligjore në fushën e drejtësisë penale, si dhe eliminimin e disa zbrazëtive dhe mangësive ligjore në këtë fushë.

Legjislacioni penal i Republikës së Kosovës ka për detyrë të mbrojë pavarësinë e shtetit dhe tërësinë e territorit të tij, dinjitetin, të drejtat dhe liritë e njeriut, rendin kushtetues, pronën, mjedisin, si dhe të drejtat e tjera dhe vlerat shoqërore të garantuara me Kushtetutën tonë dhe me të drejtën ndërkombëtare, mbrojtja e të cilave nuk do të mund të realizohej pa dhunën penalo - juridike.

Kodi Penal i Republikës së Kosovës përbën njërin nga ligjet bazike të sistemit juridik në Republikën e Kosovës. Ai është i hartuar në pajtim me procedurën për hartimin e legjislacionit dhe në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse për zbatim, si Gjykata supreme, prokurori i shtetit, me profesorë të fakultetit juridik, avokatë si dhe ekspertë të institucioneve ndërkombëtare.

Projektkodi Penal i Republikës së Kosovës është miratuar nga Qeveria, më 10 tetor të këtij viti dhe përmban 35 kapituj me gjithsej 442.

Në këtë Projektkod Penal të Republikës së Kosovës janë përfshirë edhe institute të reja të së drejtës penale, janë inkorporuar dhe sanksionuar vepra të reja penale, si dhe janë bërë të gjitha ndryshimet e nevojshme kushtetuese dhe ligjore në Republikën e Kosovës. Të gjitha ndryshimet e bëra janë harmonizuar me konventat përkatëse të së drejtës evropiane dhe ndërkombëtare.

Një rëndësi e veçantë i është kushtuar sundimit të shtetit ligjor dhe garantimit të të drejtave të secilit shtetas të Republikës së Kosovës. Projektkodi i ri përmban risi në fushën e përfshirjes së veprave të reja penale, të cilat janë konsideruar të rrezikshme për shoqërinë dhe të nevojshme për mbrojtjen e rendit kushtetues në Republikën e Kosovës.

Unë po mundohem që këtë prezantim ta bëjë në një version më të shkurtër, se kam marrë një material, ndoshta edhe për ta kursyer edhe kohën tuaj.

Për mbrojtjen dhe rendin kushtetues dhe garantimin e sigurisë të Kosovës janë paraparë gjithsej 18 nene të reja që sanksionojnë një sërë veprash të dënueshme.

Me projektkodin penal parashihet edhe dënimi me burgim të përjetshëm për vepra penale që paraqesin shkallë të lartë të rrezikshmërisë për qytetarët dhe rendin kushtetues dhe ligjor të Kosovës.

Hyrja në fuqi e Kodit Penal të Republikës së Kosovës do të përcillet edhe me ndryshime përkatëse në ligjet që ndërlidhen me këtë fushë, e në radhë të parë ndryshimet në Kodin e Procedurës Penale dhe Ligjin për ekzekutimin e sanksioneve penale.

Të nderuar deputetë,

Duke marrë parasysh rëndësinë e këtij Projektkodi Penal për rregullimin dhe plotësimin e infrastrukturës ligjore në fushën e drejtësisë penale, eliminimin e zbrazëtimeve dhe mangësive ligjore në këtë fushë, si dhe edhe me qëllim të avancimit të standardeve më të larta sa i përket sundimit të ligjit, në përmbushje edhe të obligimeve dhe të sfidave nga Raporti i Progresit i Komisionit Evropian, ju propozoj që ta miratoni këtë Projektkod Penal. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti zëvendëskryeministër Bukoshi!

Pas prezantimit, ftoj për diskutim në parim. Fjalën e ka kryetari i Komisionit funksional për Legjislacion, deputeti Arben Gashi.

ARBEN GASHI: Faleminderit!

Komisioni për Legjislacion e ka trajtuar Projektkodin Penal dhe i rekomandon seancës që ta aprovojë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Kryetarët ose përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, fjalën e ka deputeti Behar Selimi.

BEHAR SELIMI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka shqyrtuar Projektkodin Penal dhe mendojmë se projektkodi është punuar mirë, ka arritur t'i plotësojë zbrazësitë dhe mungesat që janë identifikuar në praktikën juridiko - penale gjatë zbatimit tash e 7 vjet të Kodit aktual Penal në fuqi.

Gjithashtu, vlerësojmë se projektkodi që po e shqyrtojmë ka arritur t'i qartësojë shumicën e paqartësive që janë krijuar nga zbatimi alternativ i dispozitave juridike të rregulloreve të administratës së përkohshme dhe të Kodit Penal në fuqi.

Gjithashtu, mendojmë se aprovimi i Kodit Penal i jep bazën e qartë juridike përpjekjeve të institucioneve tona për sundim të ligjit, rritje të efektivitetit dhe të sistemit të drejtësisë dhe është mundësi e mirë që të kthehet besimi në sistemin e drejtësisë, ndërkohë që kemi po ashtu propozime konkrete, të cilat propozime do të jenë pjesë të procesit të amendamentimit gjatë punës nëpër komisione dhe grupe punuese, që do të thotë se përfaqësuesit e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike do të japin kontributin me propozime konkrete në komisionin funksional.

Gjithashtu, mendojmë se përmes këtij Projektkodi është rast i mirë që përfundimisht të sqarohet dhe të rregullohet juridikisht çështja e konfiskimit të pasurisë së fituar përmes veprës penale dhe kështu të bëhet pjesë e Kodit Penal, pa pas nevojë që të punojmë konkretisht në ligje të reja, meqë edhe është fjala për një emërtim që nënkupton kod penal, që nënkupton kodifikim të normave juridiko - penale dhe kështu kursejmë edhe në kohë dhe u japim mundësi institucioneve tona që të mos kenë paqartësi apo dilema në luftë kundër krimit të organizuar.

Ne do ta votojmë në parim dhe inkurajojmë edhe deputetët tjerë që ta miratojnë në parim. Faleminderit, zoti kryesues!

KRYESUESI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, deputeti Gashi.

ARBEN GASHI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, mund të them se Projektkodi Penal është një ligj i rëndësishëm i cili rregullon një sferë të rëndësishme të jetës dhe të shoqërisë dhe sidomos me vepra që kanë të bëjnë me denueshmërinë e tyre - veprat penale. Në këtë rast mund të them se ka një qasje më të avancuar në aspektin e dënimit të veprave penale kundër trupit, jetës dhe shëndetit. Po ashtu, në kategorinë e veprave penale tjera është rritur edhe masa e dënimit dhe masa maksimale e dënimit është ndryshuar. Besoj që ka pasur një qasje pozitive në këtë kuptim, sepse kemi pasur vepra shumë të rënda penale të cilat normalisht janë dënuar shumë pak dhe besoj që do të duhet të ketë ndikim pozitiv në sistemin juridik të Kosovës.

Po ashtu, sa i përket aspekteve procedurale, është shumë e rëndësishme që ne të shohim se si këto vepra mund të ndiqen proceduralisht dhe si duhet të realizohen të drejtat e qytetarëve të cilat janë shkelë nëpërmjet dënimeve të cilat aplikohen nëpërmjet këtij kodi.

Unë mendoj që jemi në një situatë kur ne duhet të shohim Kodin Penal dhe në kuadër të Kodit Penal të shohim edhe masat alternative të dënimit dhe t'i parashohim të gjitha ato vepra të cilat nuk janë paraparë më herët. Janë kategori të ndryshme të veprave penale të cilat parashihen me këtë kod dhe të cilat duhet normalisht të jenë vepra të denueshme.

Veprat e mashtrimit dhe mashtrimi elektorale është njëra prej veprave penale që parashihet me këtë kod dhe janë vepra të denueshme. Besoj që është një arritje e mirë, sepse ne kemi një fenomen shoqëror që është shndërruar realisht në fenomen shoqëror fakti se po vidhet sistemi elektorale dhe si rezultat i kësaj po prodhohen produkte politike si rezultat i manipulimit dhe vjedhjes. Prandaj, ne me sistem duhet t'i ndalojmë dhe t'i dënojmë ata që merren me këto vepra, që i realizojnë këto vepra penale. Dhe, po ashtu, elemente tjera të mashtrimit dhe elemente të vjedhjes së pronës publike dhe shumë elemente të veprave penale janë paraparë me këtë. Mirëpo, duhet të shohim se cilat janë masat e dënimit, masa minimale dhe masa maksimale. Duhet të shohim që këto masa minimale dhe maksimale të jenë sa më adekuate, në mënyrë që të çojmë mesazhin e drejtpërdrejtë sepse, në fund të fundit, sistemi juridik e ka një qëllim. Qëllimi kryesor është parandalimi, jo ndëshkimi. Edhe ky Kod Penal ka për qëllim parandalimin e veprave penale, në mënyrë që të mos kemi njerëz të cilët në mënyrë të përsëritshme bëjnë vepra penale apo ata që mendojnë se mund të realizojnë vepra penale dhe, si rezultat, mund të mos dënohen apo mos të ndëshkohen nga sistemi juridik.

Prandaj, mendoj se duhet të thuhet qartë dhe në kod të parashihen qartë veprat penale të denueshme dhe denueshmëria e zbatueshme dhe sistemi juridik funksional, të gjitha këto janë jo vetëm kodi si i tillë, se kodi si i tillë mund të jetë i mirë, në qoftë se nuk ndërtohet edhe sistemi i zbatimit të kodit, Kodi i Procedurës Penale dhe po ashtu sistemi i gjykatave funksionale, të cilat në kohën e duhur japin edhe masën e duhur dhe sistemi i riedukimit,

sistemi i burgjeve dhe të gjitha këto janë sistem zinxhiror të cilat duhet të funksionojnë në mënyrë që të kemi prej masës ndëshkimore deri te masa e riedukimit për personat që e kanë krye vepër penale, duhet i tërë sistemi juridik të funksionojë. Prandaj, mendoj se si shoqëri dhe si parlament duhet të kemi një qasje pozitive, në mënyrë që këto pjesë të rëndësishme të shtetit të së drejtës të jenë të zbatueshme edhe në vendin tonë.

Prandaj, në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, unë them se ne do ta përkrahim këtë kod. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes "Vetëvendosje", deputetja Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, kryesues!

Është shumë keq që po shqyrtohet Projektkodi Penal, përderisa ministri i Drejtësisë nuk gjendet këtu, sepse ai po thirret që ka bërë kod modern, kështu që duhet të jetë këtu kur shqyrtohet Kodi Penal.

Mirëpo, kodi që na keni sjellë në Kuvend nuk do ta arrijë efektin e duhur, pra mbrojtjen e shoqërisë, luftimin e kriminalitetit, mbrojtjen e të drejtave të njeriut të garantuar me kushtetutë, ligj dhe me të gjitha konventat tjera për të drejtat e njeriut, pasi që gati në çdo kapitull kemi hasur shumë vërejtje, duke filluar nga ato teknike e deri te ato përmbajtjesore, të cilat domosdoshmërisht duhet të amendamentohen, bile disa nene edhe duhet të hiqet në tërësi.

Do të filloj me vërejtjet që ne i konsiderojmë më problematike në këtë Projektkod. Fillimisht, emërtimi i nenit 410, pra thirrje për rezistencë, për ne është shumë shqetësues. Mirëpo, përmbajtja e këtij neni është edhe më shqetësuese. Ja pse? Maksimumi që mund të përfshihet në një kod penal është mosbindja ndaj policit, mospërgjigje ndaj thirrjes për të ndaluar nga polici e të ngjashme me këto. Nuk ka vepër penale kështu në përgjithësi, me termin që nuk është aspak i natyrës penale - rezistencë, për më tepër - thirrje. As njëra. as tjetra nuk përbëjnë veçmas shkaktim të veprës penale.

Për më tepër, e drejta e protestës, e rezistencës, e thirrjes për protestë e rezistencë është një nga të drejtat tashmë të sanksionuara ndërkombëtarisht. Çfarë do të ndodhte, për shembull, me të drejtën për grevë urie? Ajo është thirrje për rezistencë, a përbën ajo vepër penale dhe organizatori i saj a është subjekt i veprës penale? Sepse pika një e këtij neni thotë: "Kushdo që thirret të tjerët për rezistencë apo mosbindje ndaj vendimeve apo masave të ligjshme të nxjerra nga organi apo zyrtari kompetent, dënohet me burgim deri 3 vjet". Cilat janë këto vendime apo masa të ligjshme ndaj të cilave nuk lejohet thirrja për mosbindje apo rezistencë? Për shembull, veteranët e luftës sot nuk janë të bindur me ligjin që miratoi Kuvendi dhe nëse protestojnë kundër tij, sipas këtij neni nënkupton që ata janë duke konsumuar vepër penale dhe organizatori i tyre do të mund të dënohej me burgim deri në 3 vjet.

Shembull tjetër. Nëse studentët bëjnë thirrje për protestë për vendimet e Rektoratit, për të cilat nuk bien në dakord, a janë duke konsumuar edhe ata vepër penale? Ky nen është kopjim pikë për pikë i nenit të Kodit të përkohshëm Penal të miratuar në kohën e UNMIK-ut dhe

riaktualizimi i tij edhe në këtë kod tregon për një keqkuptim të lartë ose keqdashësi po aq të lartë.

Vetëm në pika të tilla të një kodi penal një qeverisje mund ta shpalosë konceptin e saj për liri civile e politike. Ministria e Drejtësisë ka gjykuar të na propozoj një nen, i cili është paraqitje e qartë e rendit policor që parapëlqen Qeveria në fjalë.

Ndërkohë që pika 2 po e këtij neni thotë: “Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni rezulton me vështirësi të mëdha apo pamundësi të zbatimit të vendimit, masës apo veprimit zyrtar të ligjshëm, kryesi dënohet me burgim prej 6 muaj deri në 5 vjet”. Në pamje të parë, përmbajtja e kësaj pike është tërësisht e paqartë. Por, në fakt, me të synohet që të sigurohet presion i mjaftueshëm policor ndaj çfarëdolloj forme të protestës civile e politike. Domethënë, nëse zyrtari kompetent ka vështirësi të shtuar në aplikimin e vendimit a masës së ligjshme, atëherë masa e dënimit shtohet edhe më tej. Si ka menduar kjo Qeveri që do të qeverisë duke arrestuar të gjithë protestuesit apo grupimet civile politike të cilat nuk bien dakord me ligjet, vendimet apo masat ligjore?

Le të mos mendojë askush se ky nen shkon apo do të mund të aplikohet në variante të strukturave ilegale në veri apo kudo tjetër në Kosovë, sepse ky nen në këtë variant ka qenë deri më tash dhe nuk ka shkuar asnjëherë në asnjë variant në aplikim të tillë.

Pak a shumë këto struktura de facto nuk i mbulon Kodi Penal. Ky nen duhet hequr nga Projektkodi Penal sepse shkel rënd çdo formë republikane të lirisë. Çdo qytetar, grupim apo organizim ka të drejtë të bëjë thirrje për rezistencë, për mos bindje dhe për protestë. Kjo është një e drejtë e mbërritur me sakrificë nga miliona individë, shembulli i të cilëve e ka bërë që në secilën konventë të të drejtave të njeriut të sanksionohet kjo e drejtë.

Më pastaj, neni 28 paragrafi 3, thekson se “Personi që tenton të kryejë vepër penale, dënohet si të kishte kryer vepër penale, por dënimi mund të zbutet”. Nëse lexohet neni 28 në tërësi, vërehet qartë se tentimi dhe kryerja e veprës penale dallojnë në esencë, sepse me tentim pasoja nuk është shkaktuar, vetëm se është ndërmarrë veprimi, kurse kryerja e veprës penale nënkupton veprimin dhe shkaktimin e pasojës.

Në këtë nen thuhet se “gjykata mund ta zbutë dënimin”. Gjithashtu, edhe në shumë nene tjera i është lënë gjykatës të vendosë ta zbusë ose jo dënimin. Kjo duhet të ndryshojë, sepse kemi rrezik nga keqpërdorimi eventual i gjykatësit ndaj të pandehurve të ndryshëm, apo ndonjë preferencë e gjykatësit e cila mund të reflektojë në zbutjen e dënimit ndaj të pandehurit. Gjithashtu, kjo dispozitë lë mundësinë që gjykatësi ta arsyetojë vendimin e tij më të butë në këto dispozita. Pra, i lejon subjektivizëm gjykatësit.

Në nenin 94, thuhet se “Personi i dënuar me burgim të përjetshëm mund të lirohet me kusht pasi të ketë mbajtur 30 vjet nga dënimi i shqiptuar me burg”. Pasi që veç është vendosur që me këtë kod tash e tutje të parashihet dënimi me burgim të përjetshëm, edhe pse nuk e dimë se në bazë të cilave përfundime ka ardhur deri te futja e këtij dënimi, pasi që ekspertët vendorë nuk e kanë propozuar një gjë të tillë, mendojmë se duhet të përcaktohet qartë se kur personi i dënuar me burgim të përjetshëm mund të lirohet nga dënimi me kusht.

Në të gjitha kodet e shteteve janë të parapara kushtet se kur mund të lirohet me kusht personi i dënuar me burgim të përjetshëm dhe ne mendojmë që është e domosdoshme që të parashihen kushtet edhe në këtë kod.

Në nenin 112, parashihet falja. Ne mendojmë se duhet të futet patjetër edhe amnistia, sepse është instituti i së drejtës romake, tradicional dhe shumë demokratik, por vërehen tendencat që të fshihet ky fakt, duke e kamufluar me faljen. Nuk dihet arsyetimi se pse po hiqet amnistia. Është akt më i gjerë që nxirret nga Kuvendi, që largon dyshimet eventuale për përdorje të autoritetit që në këtë rast mundet me u përdorur për faljen. Shkurt, duhet të ekzistojë dhe nuk ka arsye pse të mos ekzistojë një institut mjaft i vjetër dhe i rëndësishëm i të drejtës penale. Në nenin 120, ku janë paraparë përkufizimet, pothuaj se në shumicën e tyre kemi vërejtje, mirëpo unë do të përqendrohem vetëm në disa prej tyre, për shembull pika 25, pra e nenit 120, duhet të hiqet vija kufitare dhe të mbetet vetëm kufiri.

Gjithashtu, në nenin 145 thuhet: “kalimi i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijës kufitare”. Duhet të jetë: “kalimi i pa autoriozuar i kufirit shtetëror”.

Neni 169, kontrabandimi me emigrantë dhe neni 170, trafikimi me njerëz, mendojmë që këto dy vepra penale duhet bashkuar në një të vetme, sepse janë një lëmsh i paparë, edhe ashtu ka shkaktuar probleme nëpër gjykata dhe institucionet të cilat merren me këtë pjesë. Edhe një argument shtesë, sepse kontrabandohet vetëm malli, njeriu trafikohet. Në asnjë fjalor, as literaturë nuk trajtohet ndryshe kjo shprehje, përveç se për mallin.

Gjithashtu, neni 182, kanosja dhe neni 183, ngacmimi, duhet të parashihet si një vepër penale, duke i kombinuar, sepse ngacmimi si vepër penale, si është menduar të parashihet, është shumë qesharak. Dikush kanoset për vdekje, por nuk mund të ngacmohet për vdekje.

Neni 186, sulmi. Kushdo që me dashje përdorë forcën ndaj personit tjetër, pa pëlqimin e atij personi, dënohet me gjobë ose me burgim deri në 3 vjet. Cili është sulmi me pëlqim? Edhe sulm pa dashje, nuk ka. Fillimisht duhet të parashihet se çfarë është sulmi dhe dispozita duhet të jetë: “Kushdo që përdorë forcën ndaj personit tjetër, dënohet me gjobë ose me burgim deri në 3 vjet”. Por, pasi të definohet sulmi e jo medoemos sulm, do të thotë forcë. Forca dhe sulmi janë kategori të ndryshme.

Përveç vërejtjeve të lartcekura, të cilat kishin të bëjnë me mungesë të dispozitave të rëndësishme, pastaj me kundërthënie në mes neneve, po ashtu ne kemi identifikuar joproporcionalitet me peshën e kryerjes së veprës penale. Ja pse? Neni 127 thekson se “kushdo që me qëllim të rrezikimit të rendit kushtetues apo sigurisë së Republikës së Kosovës, me përdorim të dhunës apo me kanosje të dhunës, pengon një apo më shumë nga personat e caktuar nga neni 125 e që janë Presidenti, Kryeministri e tjerë në ushtrimin e detyrës zyrtare, dënohet me burgim prej 3 deri 10 vjet”. Kurse te veprat penale kundër shëndetit publik, neni 270, thekson: “Kushdo që me ndonjë materie të dëmshme i ndotë artikujt ushqimorë që përdoren nga njerëzit apo kafshët dhe kështu rrezikon jetën apo shëndetin e njerëzve, dënohet me burgim deri 3 vjet”. Si rrjedhojë e

kësaj, vërehet qartë se ky kod jep dënim shumë më të lartë për pengim të kryerjes së detyrës së përfaqësuesve të lartë, bile i bënë ata edhe të paprekshëm, se sa për lëndim të rëndë trupor ose dëmtim të rëndë të shëndetit të qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Përveç këtyre vërejtjeve që i përmenda, ka edhe shumë të tjera që kanë të bëjnë me vepra penale kundër të drejtave të votimit, kundër të drejtave në marrëdhënie të punës, gjithashtu te krimi i organizuar, vepra penale kundër ekonomisë, si dhe duhet të shtohen veprat penale - mosdeklarimi i pasurisë dhe deklarimi i rrejshëm i pasurisë, pasi që kjo është kërkesë edhe shoqërisë civile.

Përfundimisht, Lëvizja “Vetëvendosje” nuk mendon që përmes këtij Kodi Penal të përforcojë pushtetin edhe ashtu të përforcuar të pushtetarëve, andaj ne do të votojmë kundër, përderisa qytetarëve me këtë Kod Penal nuk u garantohet mbrojtja e merituar e të drejtave dhe e lirive të njeriut. Gjithashtu, krejt në fund, shqetësuese për ne është se qysh një kod miratohet me shumice të thjeshtë të votave. E marrë vetëm një shembull të Shqipërisë. Në Shqipëri, 90 deputetë duhet të votojnë për Kodin Penal, kështu që ne duhet të votojmë me 30 ose 40 vota për Kod Penal që të miratohet. Pra, kjo duhet të ndryshohet, sepse është shumë shqetësuese.

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, zoti Gjini e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Ju faleminderit, zoti nënkryetar!

Disa çështje, mendojmë se qëllimi i këtij Projektkodit të ri Penal fillimisht ka qenë që të përmirësohet sistemi legjislativ në Kosovë dhe sistemi penal, fundi i fundit, dhe në anën tjetër një qëllim filozofik prapa këtij ka qenë që sa më pak njerëz në Kosovë ta marrin Ligjin në duart e veta, do të thotë që të funksionojë ligji, që t’i besojmë sensit filozofik të sundimit të ligjit dhe të mos ketë të tillë që, duke mos i besuar Ligjit, duke mos qenë të kënaqur qoftë me sanksionet, qoftë me provizionet tjera, e marrin ligjin në duart e veta. Mendoj se një përparim i vogël është bërë, mirëpo ka pasur pak sundim të gjitha këtyre efekteve.

Ne si grup do ta votojmë Projektkodin Penal të ri, mirëpo me disa vërejtje të cilat me siguri që do të pasojnë edhe më tutje gjatë punës në komision dhe në grup parlamentar.

Po ashtu do të shtoj se po duket se është kthyer në një praktikë, e cila nuk është shumë frytdhënëse në aspektin e informimit të publikut dhe të masave, kjo praktikë është që për çdo ndryshim të ligjit, të sillet komplet ligji i i ri ose kodi i ri. Mendojmë se debati kishte për të qenë shumë më i fokusuar, edhe publiku, edhe njerëzit të cilët do ta zbatojnë Kodin praktikisht do të ishin shumë më tepër të edukuar me qëllimet e këtij projekt kodi, sikur i vjetri të amendohej dhe të dihej saktë se çka po ndryshojmë nga i vjetri në të riun, përpos aspekteve tjera që kanë të bëjnë, duke i apstrahuar aspektet e terminologjisë, të gjuhës e tjera, e tjera.

Çështje tjetër është, u përmend më përpara, mungesa ministrit të Drejtësisë. Ne mendojmë se Projektkodi Penal është ndër ligjet më të rëndësishme të cilat i voton Kuvendi i Kosovës në vitin 2011, dhe në kushte normale nuk do të ishte dashur të ketë asnjë arsye, ama edhe një herë po them, asnjë arsye që vet ministri i Drejtësisë të mos jetë këtu, e pse jo edhe kryeministri. Mendoj se kjo neglizhencë domethënë në këtë drejtim nuk ka aq shumë të bëjë ndoshta me atë se a votohet apo jo, sepse e dinë se i kanë votat, mirëpo ka të bëjë me respektin që i bëhet gjithë trupit të njerëzve të cilët kanë për t'u marrë me këtë ligj, të cilët kanë për ta implementuar këtë ligj, të gjithë qytetarëve të Kosovës, por para së gjithash edhe vetë Kuvendit.

Sidoqoftë, prapë se prapë mendojmë se Projektkodi Penal duhet të votohet, mendojmë se duhet t'i bëjmë disa ndryshime, por këto janë çështje të cilat me siguri se do të marrin pak më shumë kohë në komision. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, deputetja Novobrdaliu.

SUZAN NOVOBRDALIU: Ju faleminderit, kryesues!

Edhe Koalicioni për Kosovë të Re e ka shqyrtuar Projektkodin Penal të Republikës së Kosovës. Të njëjtin në parim e përkrahim, mirëpo mendojmë se ka nevojë në disa nene të amendamentohet dhe këtë kontribut ne do ta paraqesim në komisionin përkatës. Ju faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar SLS, zoti Halili.

MURSELJ HALJILLI: Zahvaljujem, gospodine predsedavajući!

Uvaženi članovi Vlade,

Gospodo poslanici,

Parlamentarna grupa Samostalne liberalne stranke je razmatrala ovaj Nacrt zakona, tekst Nacrta zakona tačnije, i na stanovištu smo da ima nekoliko grešaka kako pravopisnih, tako i sadržajnih. Mi ćemo u ovom izlaganju izneti ta naša zapažanja i naravno daćemo dati doprinos u radu parlamentarnih komisija.

Na početku smatram da ovakav jedan ozbiljan sistematski zakon treba da sadrži odredbe tipa: Nema krivičnog dela niti kazne bez zakona i nema kazne bez krivice. To su postulati svakog demokratskog društva i u tom smislu mislim da ovaj zakon treba da sadrži takve odredbe. Takođe odredbe ili poglavlja koja govore o važenju krivičnog zakonodavstva Kosova za učinioce krivičnih dela izvršenih u inostranstvu, važenje krivičnih zakona Kosova za strance koji čine krivična dela u inostranstvo, trebalo bi da budu u početnom delu ovog zakona, jer su veoma bitna. One se nalaze negde pri kraju, ali kažem zbog same sadržine, odnosno suštine, to bi trebalo da bude na početku.

Osnovne odredbe, primedba je da u članu 4. se definišu krivične sankcije, međutim one se ponavljaju i u članu 42, mislim da je to suvišno. U članu 7, gde se definiše krivično delo, smatramo da su reči: „nezakoniti akt” ne adekvatni i mislim da bi bolja definicija

bila da je krivično delo „protiv pravni akt“. U tom članu trebalo bi da drugi stav bude definisan na sledeći način, znači nema krivičnog dela ukoliko je isključena protivpravnost ili krivica, i ako postoje sva obeležja krivičnog dela određene zakonom.

Takođe, u članu 8. stav 1. krivično delo može biti učinjeno činjenjem ili propusom. Smatram da je reč „propust“ neadekvatna i zamena za tu reč bila bi: „nečinjenjem“. Takođe, u članu 9, trebalo bi definisati „saučesnika“ kada on vrši krivično delo i mislim da bi formulacija bila sledeća: „saučesnik je krivično delo učinio u vreme kada je radio i bio dužan da radi“, znači i to je veoma bitno.

U članu 10. stav 1., „da se nastavi u celini i delimično“, znači ceo tekst ostaje ali „u celini i delimično“ je potrebno da se definiše. U drugom stavu, „krivično delo u pokušaju izvršeno na onom mestu“ i dalji tekst bi trebalo da se zameni sledećim: „na mestu gde je posledica po njegovom mišljenju trebalo da nastupi ili je mogla da nastupi“ a negde je želeo nastupanje posledice. Takođe smatramo da u članu 12. stav 2. trebalo da se preformuliše, preformulišu reči: „nezakoniti, stvarni i neposredan napad“ u sledećoj rečenici. Znači, „istovremeni protivpravni napad“.

U stavu 4, trebalo bi da stoji zarez, kada se nastavlja, recimo „kada izvršilac prekorači granice“, mislim da je to potrebno.

U članu 14. umesto naslova „nasilje ili pretnja“ trebalo bi da stoji „sila i pretnja“ jer su to dve različite stvari.

Uz člana 17. krivično odgovornost bi trebalo da se zameni rečju: „krivica“

U članu 19. „izvršenje krivičnih dela u stanju upijenosti“, smatramo da bi trebalo da stoji „skrivena neuračunljivost“ i definicija „lice je krivično odgovorno“, pa trebalo bi da stoji „krivica se utvrđuje prema vremenu neposredno pre dovođenja u takvo stanje“, jer nije definisana kada se utvrđuje krivica.

U članu 43. gde su definisane glavne kazne, mi imamo ozbiljnu primedbu što se tiče stava 1.1. kazna doživotnog zatvora, smatramo da bi trebalo da se preformuliše u neku vremensku kaznu, a ne doživotnog zatvora, jer smatramo i razni penolozi su definisali da možda ova reč nije adekvatna za to. Mi predlažemo da i u radu funkcionalnih komisija da se nađe bolji termin koji će moći da bude i u dužem vremenskom periodu, možda 50-100 godina.

Takođe treba definisati „uslovni otpust“, to nije učinjeno, zatim u članu negde 48. gde se definiše zamena kazne društveno korisnim radom, mislim da bi trebalo da stoji i „oduzimanje vozačke dozvole“ ali to je propisano u članu 68. ovog Nacrta zakona, ali sasvim je druga formulacija zašto se oduzima vozačka dozvola. Smatramo da treba da postoji mera oduzimanja vozačke dozvole za učinioce krivičnog dela u vezi sa čijim izvršenjem ili pripremanjem je korišćeno vozilo, znači može se izreći kazna oduzimanje vozačke dozvole.

Kod člana 49. Alternativne kazne, mislimo da je adekvatnija reč je „mere upozorenja“, i smatramo kada smo rekli sadržinski, odnosno kada neka poglavlja nisu adekvatna, smatramo da kod odmeravanja kazne povrata, ublažavanje kazne, odnosno vađenje od kazne i poravnanje učinioca oštećenog, sticaj krivičnih dela, uračunavanje pritvora i ranije kazne da to treba malo bolje regulisati.

Smatramo da je potrebno bolje definisati obavezno psihijatrijsko lečenje u zdravstvenim ustanovama, obavezno psihijatrijsko lečenje na slobodi, obavezno lečenje od alkoholizma i od narkomana.

Takođe u članu 73. gde postoji naslov: „računanje kazne“, mislim da je prikladnija reč „odmeravanje kazane“, i u glavi 9. gde je „rehabilitacija i objavljivanje informacija“, ove dve reči objavljivanje informacije, trebalo bi da budu zamenjene rečima: „davanje podataka“, i naravno jedna konstatacija što se tiče rehabilitacije, smatramo da je veoma potrebno da stoji da se „rehabilitacijom se ne dira u prava trećih lica koja se zasnivaju na osudi“.

Takođe smatramo da u članu 189. definicija: „učešće u tuči“, trebalo bi „učešće“ rečju da se zameni „učestvovanje u tuči“. Takođe, u članu 191. „napuštanje nepokretnih lica“, trebalo bi umesto „nepokretnih“, „nemoćnih lica“. Uskoro završavam, samo da dodam još dva tri predloga. Krivična dela protiv prava i sloboda lica, mislim ovo „lica“ da se zameni „čoveka“ i „građanina“ i u članu 192. piše, kaže: „kršenje jednakosti građana i stanovnika“ trebalo bi da se zameni: „povreda ravnopravnosti“, mislim da je prikladnija reč.

Takođe, u članu 195. „nezakonito lišenje slobode“, mislim da „zakonito“ da se zameni rečju: „protivpravno“. I na kraju, u članu 220. „povreda prava iz radnog odnosa“, i u tom delu bi trebao „i prava iz socijalnog osiguranja“, mada u jednom delu postoji takva odredba. Mislim da je to u jednom kontekstu trebao da se raspravlja.

U svakom slučaju, naša parlamentarna grupa će podržati ovaj Nacrt zakona u načelu. Hvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit!
Koalicioni „6+“, fjalën e ka zoti Rasim Demiri.

RASIM DEMIRI: Zahvaljujem, predsedavajući!
Parlamentarna grupa „6+“ je analizirala Nacrt zakona o krivičnom zakonu koji je mnogo značajan za naše društvo. Daćemo svoj doprinos kroz rad u komisiji i podržaćemo zakon u načelu. Zahvaljujem!

KRYESUESI: Ju faleminderit!
Sipas radhës, tani deputetët e kanë fjalën. Zoti Bajrami e ka fjalën.

ARSIM BAJRAMI: Ju faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit!
I nderuari zëvendëskryeministër Bukoshi, ministër Mujota,

Të nderuar deputetë,

Unë do t'i jap disa komente të përgjithshme, 2 vërejtje parimore dhe 3 konkluzione për leximin e dytë.

Nuk do mend se Kodi Penal paraqet një të arritur të madhe për sistemin legal në Kosovë, në mënyrë të veçantë për jurisprudencën penale dhe fakti që ai është përgatitur një kohë të gjatë, tregon se sa ka qenë serioze përgatitja e këtij Kodi, sepse është një ndër ligjet kryesore të Republikës së Kosovës, ndër 5 ligjet më të rëndësishme të Republikës së Kosovës dhe është mirë që ky kod po e zëvendëson Kodin e përkohshëm, i cili nuk ka qenë i plotë, sepse është prurë në kohën kur Kosova nuk ka qenë shtet dhe nuk ka përfshirë disa vepra penale tipike, kështu që unë vlerësoj që Kodi Penal është i harmonizuar me jurisprudencën moderne evropiane, ka një gjuhë të mirë. Është i sistemuar jashtëzakonisht mirë, pjesa materiale kryesisht merret me institutet e të drejtës penale, duke i përshkruar veprat penale dhe elementet e përgjegjësisë penale, kurse pjesa e posaçme është e sistemuar mirë në kaptina që përbëjnë vepra penale tipike.

Unë do i jap dy vërejtje parimore, të cilat do t'i përpunoj pastaj në Komisionin e ligjeve, ku do të shqyrtohet në leximin e dytë, si komision funksional, dhe ato vërejtje kanë të bëjnë me kaptinën e parë të veprave penale, e përmendi edhe zëvendëskryeministri Bukoshi, është një e arritur, se ky Kod Penal për herë të parë përbën veprat penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës dhe janë paraparë disa vepra penale.

Unë do të ndalem në dy, në të cilat do të propozoj amendamente dhe në leximin e dytë. E para është në nenin 121, ku bëhet sulmi ndaj rendit kushtetues. Është bërë një përshkrim i figurës së kësaj vepre penale, janë bërë dy elemente. Unë do të propozoja edhe elementin e tretë, sepse në elementin e parë është, aksenti është vë kryesisht te cenimi i rendit kushtetues dhe cenimi i institucioneve kushtetuese apo rrënimi i rendit kushtetues dhe rrënimi i institucioneve kushtetuese.

Te paragrafi i dytë, është parandalimi i vendosjes së rendit kushtetues dhe tendenca për të imponuar një sistem të ri të huaj kushtetues apo juridik në Republikën e Kosovës. Këto dy elemente përmban kjo, figura e veprës penale nuk është e plotë, do të duhej ta ketë edhe elementin e tretë, që unë do ta propozoj si amendament, ku parashihet se “secili që cenon rendin kushtetues me dhunë apo me kanosje, cenon vlerat fundamentale kushtetuese të Republikës së Kosovës, pavarësinë e Kosovës, sovranitetin, karakterin demokratik të Kosovës, karakterin unik dhe karakterin demokratik, do të dënohet jo më pak se 10 vjet”.

Faktikisht, futja e këtij elementi e plotëson intencën e ligjvënësit që të rregullohet mirë vepra penale – cenimi i rendit kushtetues, ashtu siç është bërë me dy elemente, nuk është e plotë dhe unë do ta propozoj amendamentin me të cilin kjo vepër penale do të plotësohet, sepse disa kushtetua e kanë këtë dhe Ligji Penal i Kosovës duhet ta ketë.

Propozimi i dytë lidhet po ashtu me një vepër penale të kësaj kategorie, pra që është nënshkrimi i kapitullimit dhe okupimit. Është një vepër re penale, e lexova me shumë

kujdes përshkrimin dhe unë do të propozoj edhe ndërrimin e emrit të kësaj veprë, por edhe plotësimin e kësaj veprë dhe kjo vepër nuk duhet të quhet: “nënshkrimi i kapitullimit dhe okupimit”, por “tradhtia ndaj shtetit”, pra tradhtia ndaj shtetit është një vepër tipike penale kundër shtetit, kundër forcave të armatosura, për faktin se Komisioni Kushtetues i cili tanimë ka përmbyllë amendamentimin kushtetues, e ka rregulluar institutin e tradhtisë së shtetit, e ka rregulluar sepse shumë kode penale dhe shumë kushtetuta veprën penale të tradhtisë të shtetit e sanksionojnë dhe në përshkrimin e kësaj veprë penale, nuk është përshkrim i plotë, sepse si element i vetëm të okupimi është vetëm pranimi i gjendjes së okupimit, kushto që pranon okupimin, pa marrë parasysh pozitën shtetërore, pa marrë parasysh a është ushtar i thjeshtë i thjeshtë a është komandant i Forcave të Armatosura, dënohet jo më pak se 10 vjet.

Tradhtia nuk bëhet vetëm me pranim okupimi, por bëhet edhe me veprime tjera, edhe me lënien e forcave të armatosura pa komandë supreme apo me forma tjera, kështu që në komisionin funksional do të propozojmë amendamente. Unë personalisht do të propozoj disa amendamente të vepra penale kundër rendit kushtetues, në mënyrë që kjo pjesë e ligjit të jetë shumë e plotë dhe të jetë jashtëzakonisht precize.

Dhe tani të jap tri rekomandime. Rekomandimi i parë është që krahas këtij Kodi Penal, që është i ri, të punohet edhe në Kodin e Procedurës Penale, i cili organikisht ndikohet nga miratimi i këtij ligji.

Fakti që jurisprudenca penale po bën dy kode të mira, është jashtëzakonisht e mirë dhe nuk bëjmë kurrgjë vetëm me Kodin Penal, në qoftë se nuk e harmonizojmë edhe Kodin e Procedurës Penale me disa elemente të reja që lidhen me shtetësinë e Kosovës, sepse këto ligje në të cilat unë kam punuar menjëherë pas luftës në vitin 2000, disa vjet, janë punuar në një kontekst politik kur Kosova nuk ka qenë shtet i pavarur dhe kanë pasur disa kufizime ndërkombëtare dhe ato kufizime i ka edhe Kodi i Procedurës Penale.

Rekomandimi i dytë, angazhohem që rreth këtij Kodi Penal të zhvillohen debate të gjëra publike, të karakterit profesional dhe angazhohem që menjëherë komisioni funksional të fillojë të bëjë planin e punës, në mënyrë që brenda 6 javëve apo eventualisht me një kohë shtesë, të fillojë procesi i amendamentimit me përfshirjen e gjerë të publikut, të opinionit profesional dhe akademik për shkak se kodet penale nuk ndryshojnë çdo vjet, po ndryshojnë një herë në dekadë dhe ky ligj të plotësohet dhe të ndryshohet.

Dhe, rekomandimi i tretë, e dëgjova edhe kolegun përfaqësues të partive politike që i përmendi disa vërejtje. Unë kam vërejtur shumë dobësi në përkthimin e këtij ligji në gjuhën serbe. Disa vërejtje që i dha kolegu më herët, nuk janë probleme në tekstin në gjuhën shqipe, teksti në gjuhën shqipe nuk i ka ato pengesa dhe janë mirë, por nuk e di kush i ka përkthyer, disa terma që janë përkthyer, e kanë humbur kuptimin dhe angazhohem që jashtëzakonisht të punohet në një përkthim të mirë, sepse institutet e të drejtës penale duhet të përkthehen jashtëzakonisht mirë për t'u kuptuar dhe për të evituar cilindo keqkuptim.

Marrë në tërësi, unë e vlerësoj këtë Kod si një arritur të madhe, një të arritur të madhe për Kosovën dhe jam i sigurt se me procesin e amendamentimit, Kosova do ta ketë një ligj me standarde të larta dhe një ligj i cili i duhet Kosovës për të avancuar sistemin e jurisprudence penale dhe luftën kundër krimit të organizuar dhe kundër veprave penale. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Deputetja Alma Lama e ka fjalën.

ALMA LAMA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Më lejoni të them që së pari është mirë që është marrë parasysh, janë marrë parasysh rekomandimet e Komisionit Evropian për heqjen e shpifjes, e cila më parë sanksionohej si veprë penale. Mirëpo, nga ana tjetër, ky Kod Penal me disa nene të tij mundëson që t'i shndërrojë mediat fajtorë kujdestarë. Ky Kod Penal në dispozitat e posaçme mbi përgjegjësinë penale për veprat penale të kryera me anë të mediave, neni 37 lë të hapur mundësinë e inkriminimit të kryeredaktorëve dhe botuesve në rast të publikimit të informatave.

Janë katër pyetje të cilat unë i ngrejë në këtë rast. Së pari, pse duhej përfshirë në Kodin Penal ky kapitull, së dyti, kujt i janë referuar, së treti, media është pushtet në vete dhe është e papranueshme që të ndryhet kaq ashpër, pasi kjo ndërhyrje është sulm ndaj lirisë së mediave dhe, së katërti, ka kundërshtime ndërmjet normave juridike në këtë kapitull.

Është e çuditshme se si nuk është përcaktuar në këtë Projektligj se për çfarë lloj informatash bëhet fjalë, pra në lidhje me këtë nen. Janë ato që rrezikojnë jetën e një personi, janë ndërhyrje në një situatë të caktuar në ndryshimin e rrethanave dhe të ngjarjeve apo janë nxjerrja e një sekreti shtetëror, pra ku përfundon kufiri i punës së gazetarit dhe ku fillon implikimi i tij në veprën penale. Në rast se bëhet fjalë për publikimin e një sekreti shtetëror, kemi shembuj të shumtë dhe shumë domethënës që mund t'i referohemi, p.sh. rastin e botuesit të Wikileaks, i cili nuk mund të ndëshkohet për publikimi e të dhënave, por ligji ndëshkon atë që ka nxjerr të dhënat sekrete.

Por, praktika gazetareske njihet edhe raste të tjera, p.sh. në Amerikë kur gazetarët janë dënuar për nxjerrje të sekretit shtetëror. Kjo në fakt është një nga çështjet për të cilat po luftojnë organizatat e gazetarëve në të gjithë botën dhe gjithnjë e më shumë po pamundësohet dënimi i gazetarëve, sepse ndeshen me parimin e lirisë së shprehjes. Në të shkuarën kemi pasur edhe në Kosovë ndëshkim gazetarësh për mos kallëzim të burimit të informacionit.

Domethënë, kemi degradim të parimeve të lirisë së shprehjes dhe abuzim me atë se çfarë konsiderohet sekret shtetëror. Në të gjitha pikat e këtij neni nuk ka asgjë të sqaruar vetëm konfuzitet dhe unë mendoj se duhet të fshihet plotësisht, sepse i tillë si është, është një goditje e drejtpërdrejtë në lirinë e mediave. Pra, është në kundërshtim të plotë me nenin 40 të Kushtetutës së Kosovës, ku thuhet se liria e shprehjes është e garantuar, është në kundërshtim me vlerat e lirisë dhe jam e bindur që edhe Komisioni Evropian do ta kundërshtojë fuqishëm këtë nen.

Në fakt, unë do dëshiroja një shpjegim nga sponzorizuesi në lidhje me këtë nen, mirëpo ai nuk është këtu dhe nuk besoj se zëvendëskryeministri mund të na sqaroj se pse është futur ky nen në Kodin Penal? Në fakt është një nen tepër skandaloz, unë sugjeroj dhe do ta amendamentoj që ky nen të fshihet plotësisht.

Një çështje tjetër ku dua të ndalem është kapitulli i 7, i cili titullohet “konfiskimi i dobisë pasurore të fituar me anë të kryerjes së veprave penale”. Besoj që tani që e lexova edhe juve ju tingëllon e pakuptimtë ky togfjalësh, pra dobia si term abstrakt nuk mund të konfiskohet, por konfiskohet pasuria.

Edhe ky kapitull duhet të rishkruhet në këtë mënyrë: “konfiskimi i pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme”, por përveç vërejtjeve në gjuhën e përdorur dhe mendoj që është përkthyer gabim, Kuvendi i Kosovës, mendoj që duhet të nxjerrë një ligj të veçantë për konfiskimin e pasurisë së vënë në mënyrë të paligjshme për shkak të rëndësisë që ka një ligj i tillë për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar.

Futja në këtë Kod Penal edhe kjo do të ishte një version, mirëpo ashtu se si është dizajnuar është krejtësisht sipërfaqësore. Meqë Qeveria deri tani nuk e ka marrë një iniciativë të tillë për të bërë ligj të veçantë, Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” duke shfrytëzuar të drejtën për nisma legislative, do ta marrë nismën për bërjen e një ligji të tillë, ndërsa, vërejtjet që u lexuan më lartë do t’i kthejmë amendamente. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputeti Bekim Haxhiu e ka fjalën.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit!

I nderuar kryesues,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Fillimisht dua të përgëzoj Ministrinë e Drejtësisë për punën e shkëlqyer të bërë në këtë Projekt Kod Penal të Kosovës, e cila ka marrë parasysh të gjitha zbrazëtirat dhe vështirësitë e evidentuara gjatë zbatimit të Kodit Penal nga ana e institucioneve përgjegjëse në këtë fushë dhe në veçanti vërejtjet e

prokurorëve dhe gjykatësve të Republikës së Kosovës, si dhe rekomandimet dhe përvojat ndërkombëtare në këtë fushë. Në këtë projekt Kod Penal paraqitet një punë e mirë ekspertëve dhe duke u bazuar në këtë dhe në veçanti duke u bazuar në nenin 1 të këtij projekt kodi, kërkoj që në këtë projekt Kod Penal të përfshihen edhe dënimet për dy dukuri prezente në shoqërinë tonë, huliganizmin dhe shpifjen.

Për huliganizëm mendoj se duhet të parashihen dënime të menjëhershme dhe të qarta, ngase është dukuri prezente si huliganizëm në sport, huliganizmi politik dhe huliganizmi ndaj institucioneve. Andaj, dënimet dhe veprimet huligane duhet të jenë pjesë e këtij projekt kodi. Gjithashtu, edhe shpifja duhet të jetë pjesë e këtij kodi penal, ngase ishte edhe në kodin e kaluar, kjo me qëllim të promovimit të një shoqërie tolerante dhe demokratike në Kosovë, përmes respektimit të standardeve ndërkombëtare për të drejtat e ... si dhe të lirisë së shprehjes dhe parandalimin e gjuhës së shpifjes dhe fyerjes.

Kuvendi i Kosovës ka miratuar në vitin 2006 Ligjin civil kundër shpifjes dhe fyerjes, në të cilin ligj parashihen kompensimet efektive dhe të përshtatshme për personat të cilëve u është dëmtuar reputacioni nga shpifja dhe fyerja, mirëpo nuk parasheh dënime të rrepta për ata të cilët shpifin. Duke u bazuar në nenin 4 të Ligjit civil kundër shpifjes dhe fyerjes, ku një person ka të drejtë të kërkojë përmes procedurës gjyqësore të ndalë shpifjen dhe fyerjen dhe kur sot shpifja vazhdon të bëhet mjet i luftës kundër personaliteteve të caktuara, mendoj që personat të cilët qëllimisht shpifin duhet të dënohen përmes Kodit Penal dhe të kërkojnë kompensimin përmes Ligjit civil kundër shpifjes dhe fyerjes.

Të nderuar kolegë deputetë, për t'ju argumentuar se shpifja duhet të jetë pjesë e Kodit Penal, po e përmend vetëm njëherë nga shumë shpifjet që u lansuan kundër meje. Ju e dini se subjekt politik, anëtar i këtij Parlamenti ka shpifur se djali im i palindur ka organizuar votime të shumëfishta. Ju e dini që unë kam vetëm 2 vajza dhe për këtë shpifje unë kam paditur në bazë të ligjit në fuqi, por duke parë se shpifja është bërë veprim i përditshëm i subjekteve të caktuara politike duke mos kursyer as individin e as familjen, konsideroj se shpifja duhet të përfshihet në Kodin Penal që shpifësit të marrin dënimin e merituar.

Duke vlerësuar punën e ekspertëve dhe të Ministrisë së Drejtësisë e mbështes këtë projekt kod penal. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Të paktën është mirë që gjatë shqyrtimit të ligjeve t'i përmbahemi rendit të ditës. Nuk ka tjerë të paraqitur.

Zoti zëvendëskryeministër, a dëshironi fjalën shtesë apo? Faleminderit!

Zoti Bukoshi e ka fjalën.

BUJAR BUKOSHI: Ju faleminderit edhe për këtë debat, që për mua është po ashtu i vlefshëm. Me gjithë respektin edhe vogëlsinë time karshi profesionistëve që merren me këtë fushë edhe te të cilët unë kam besim edhe njëherë t'ju përkujtoj se kjo është një punë edhe një prezantim i një produkti semifinal. Unë nuk do të isha as unë i lumtur që të kalonte i tërë Kodi Penal sot edhe të kryhej puna, por unë e di se edhe këto grupet funksionale, grupet parlamentare do të vazhdojnë t'i japin vërejtjet e tyre.

Mendoj se është një rrugë e mirë për t'u kryer kjo punë ashtu si duhet, por janë disa postulate elementare për të cilat nuk duhet çfarë profesionalizmi është ajo element, postulati është se bëhet fjalë për një kod, për një çështje shumë serioze për mua, për funksionimin e shtetit, i cili natyrisht nuk funksionin pa dhunë penale, juridike. Çështja është kjo dhunë në të cilin tani arbitri, shteti si arbitër e ushtron që ai të zbutet ose të frenohet, të mos abuzojë. Kjo është për mua esenca edhe nuk është esenca a është prezent ministri i Drejtësisë këtu tash nuk qenka as korrekte nga unë se nuk qenka zoti Gjini këtu ta pyes edhe atë tash se pse nuk është edhe ai këtu prezent?

Domethënë, është një paragjykim banal, jo substancial sikur që i dhanë vërejtjet, domethënë, Grupi Parlamentar i LDK-së, zoti Gashi, të "Vetëvendosjes" brengat që i

shprehën. Kjo është për mua esenciale, domethënë arbitrariteti i shtetit të reduktohet për fat siç tha zoti Bajrami, kjo punë është bërë, është një punë e përbashkët e bazuar në kautelat e jurisprudencës moderne evropiane, jo asaj amerikane se në Shtetet e Bashkuara të Amerikës është edhe ligji, dënimi kapital me vdekje, në karrige elektrike etj.

Prandaj, unë edhe njëherë kërkoj falje që unë e dhashë atë versionin tim të shkurtuar, domethënë leximi ishte versioni i shkurtuar për të mos i lodhur deputetët me një lexim ritual ta quaj ashtu, por prapë ky nuk është ritual, mendoj se është një çështje shumë serioze, Kodi Penal është një punë serioze për një shtet, sa marrë vesh unë në jurisprudencë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Bukoshi!

Tani do hyjmë në procesin e votimit në parim të Projektligjit Penal të Republikës së Kosovës. Në mbledhje janë 72 deputetë, lus që të përgatitemi për votim. Votojmë tani.

Faleminderit! Konstatoj që me 52 vota “për”, 1 abstenim dhe 8 vota “kundër”, Kuvendi miratoi në parim Projektkodin Penal të Republikës së Kosovës.

Kërkohej nga Komisioni funksional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit, ta shqyrtojnë Projekt Kodin Penal të Republikës së Kosovës dhe Kuvendit t’i paraqesin raportet me rekomandime.

Pika e 12 e rendit të ditës është:

12. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për financimin e subjekteve politike

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për financimin e subjekteve politike të Kuvendit dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Ftoj kryetaren e Komisionit Funksional për Buxhet dhe Financa, deputeten Safete Hadërgjonaj, që para deputetëve ta arsyetojë raportin me rekomandime.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Komisioni për Buxhet dhe Financa, menjëherë pas miratimit në shqyrtim të parë të Projektligjit për financimin e subjekteve politike, ka formuar grupin punues, i cili e ka shqyrtuar në detaje Projektligjin për financimin e subjekteve politike. Amendamentet me propozimet që janë dhënë nga grupi punues janë formuluar në Komision dhe janë miratuar një nga një.

Njëzëri Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka miratuar raportin me rekomandime të cilin e kanë deputetët, kështu që në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, kërkoj nga të gjithë deputetët që ta votojnë raportin me rekomandimet të Projektligjit për financimin e subjekteve politike.

KRYESUESI: Faleminderit!

Vazhdojmë me votimin e amandameteve të propozuara sipas radhës së paraqitur në raportin e Komisionit funksional. Po votojmë amendamentet një nga një me procedurë të shpejtë, po mendoj nuk ka nevojë që të votojmë me elektronikë.

Amendamenti 1.

“Kundër”, s’ka.

Abstenim, s’ka.

Miratohet.

Amendamenti 2, është i kryetarëve të grupeve parlamentare, me përkrahjen e komisionit funksional.

“Kundër”, s’ka.

Abstenim, s’ka.

Miratohet.

Amendamenti 3.

“Kundër”, s’ka.

Abstenim, s’ka.

Miratohet.

Amendamenti 4.

“Kundër”, s’ka.

Abstenim, s’ka.

Miratohet.

Amendamenti 5. dy propozime, komisioni funksional, pa përkrahjen e Komisionit për Legjislacion.

Votojmë me elektronikë.. E qesim në fillim këtë të komisionit funksional. Votojmë tani, për komisionin funksional, amendamentin ”a”, sipas Rregullores.

Me 54 vota “për”, 6 vota “kundër”, 2 abstenime.

Miratohet.

Amendamenti 6.

“Kundër”, 7 vota.

Shumica janë “për”.

Miratohet.

Amendamenti 7.

“Kundër”, s’ka.

Abstenim, s’ka.

Miratohet.

Amendamenti 8.

“Kundër” janë 7 vota.

Miratohet.

Amendamenti 9.

“Kundër”, s’ka.

Abstenim, s’ka.

Miratohet.

Amendamenti 10.

“Kundër”, s’ka.

Abstenim, s’ka.

Miratohet.

Amendamenti 11.

“Kundër”, 7 vota janë.

Miratohet.

Amendamenti 12.

“Kundër”, s’ka.

Abstenim, s’ka.

Miratohet.

Votojmë tekstin e projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara. Në sallë janë 76 deputetë.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë, tani!

Konstatoj që me 73 vota “për”, 2 abstenime, asnjë “kundër”, Kuvendi miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për financimin e subjekteve politike.

Pika e 13- të e rendit të ditës është:

13. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndihmë juridike falas

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar Projektligjin për ndihmë juridike falas dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuar.

Ftoj kryetarin e Komisionit Funksional për Legjislacion, deputetin Gashi që para deputetëve të shqyrtojë raportin me rekomandime.

ARBEN GASHI: Faleminderit!

Unë po flas në emër të Komisionit dhe pastaj vazhdoj në emër të Grupit që të mos humbim kohë, nëse jeni dakord.

Atëherë, Komisioni e ka shqyrtuar këtë çështje dhe ky ligj vjen për herë të 4 me sa më kujtohet. Problemi kryesor ka ndodhur se komisioni ka përkrahur ligjin në variantin e parë, ka bërë amendamentet si komision funksional, mirëpo ka ndodhur problemi kur Komisioni për Buxhet dhe Financa ka kundërshtuar ligjin, sepse Ministria e Financave ka thënë që ka komplikime financiare dhe nuk mund të ketë përkrahje financiare.

Me insistimin e Kuvendit dhe kryesisë së Kuvendit është kërkuar që Komisioni për Legjislacion, Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe Ministria e Drejtësisë të ulen dhe të shohin se cilat janë mundësitë e eliminimit të problematikave që janë identifikuar në aspektin buxhetor.

Ne jemi ulur dhe kemi diskutuar, mirëpo nuk kemi mund të arrijmë një situatë ku do të ishim të gjithë të një mendimi. Problemi qëndron këtu, te deklarata financiare, ligji si i tillë nuk ka komplikime të mëdha financiare dhe mund të kalojë, mirëpo deklarata financiare ka një komplikim ku thuhet se sqarimet që kanë ardhur nga Ministria e Drejtësisë është se disa zyra eksperimentale të themeluara nga UNDP-ja, është bërë një marrëveshje mes UNDP-së dhe Ministrisë së Drejtësisë se këto zyra të hyjnë në kuadër të këtij ligji dhe kjo ka kosto financiare, janë diku 5 zyra dhe ka kosto financiare, kjo kosto financiare është e papërbalueshme sipas Ministrisë së Financave.

Diskutimi që kemi pasur me Ministrinë e Drejtësisë ata kanë qenë dakord që këto zyra të mos hyjnë pastaj në kuadër të këtij ligji dhe kostoja e ligjit të jetë normale dhe e përballueshme. Mirëpo, Ministria nuk e ka tërhequr deklaratën financiare. Në këtë rast kemi ardhur në një situatë ku ne nuk kemi pasur se çka të bëjmë tjetër edhe Komisioni për Buxhet dhe Financa ka propozuar amendamente, të cilat nuk i ka përkrah Komisioni për Legjislacion.

Sepse, janë amendamente të cilat ndërhyjnë në strukturën e ligjit dhe në përmbajtjen e institucionit, dëmtojmë përmbajtjen e institucionit. Prandaj, kemi dy lloj amendamentesh, amendamentet e Komisionit funksional dhe amendamentet e Komisionit për Buxhet edhe Financa, të cilat ndërhyjnë në strukturën e ligjit dhe dëmtojnë përmbajtjen e ligjit dhe po ashtu për pasojë dëmtojnë funksionalitetin e institucionit.

Prandaj, në këtë situatë jemi sot ku kemi dy lloj amendamentesh. Kjo është situata ku unë flas në emër të Komisionit, si kryetar i Komisionit. Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike mund të them se ne kemi përkrahur ligjin në leximin e parë dhe në leximin e dytë dhe kemi kërkuar që ligjin të aprovohet dhe të shihen mundësitë se si gjinden burimet financiare që ky ligj të zbatohet.

Tash, jemi në një situatë ku kemi dy lloj amendamentesh, në qoftë se amendamentet e Komisionit për Buxhet edhe Financa kalojnë, atëherë Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, mendon se ky ligj bëhet i pazbatueshëm dhe si pasojë Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike nuk e përkrah në tërësi ligjin, nuk e përkrah amendamentin e Komisionit për Buxhet edhe Financa dhe po ashtu, për pasojë, as ligjin në tërësi. Faleminderit!

KRYESUESI: Vërtet është shqetësues mënyra se si do të procedojmë në Parlament, përderisa nuk ka pasur harmonizim dhe nuk ka pasur renditje të amendamenteve, të cilat do të votohen dhe unë po parashikoj prapë që cilido variant që të votohet nuk do të del mirë ligji.

Megjithatë, jam i detyruar që të procedoj sipas Rregullores.

Fjalën e ka deputetja Safete Hadërgjonaj, kryetarja e Komisionit për Buxhet dhe Financa.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit!

Komisioni për Buxhet dhe Financa ka qëndrim tjetër. Ndryshimet të cilat janë bërë nga ana e Komisionit për Buxhet dhe Financa nuk e ndryshojnë strukturën e ligjit. Unë i kisha lutur të gjithë deputetët që vërtet t'i shikojnë amendamentet dhe t'i shikojnë nenet se si kanë qenë në ligj dhe nëse i shikojnë me vëmendje se çka është paraparë në nene dhe çka është bërë me amendamente nga ana e Komisionit për Buxhet dhe Financa, atëherë shihet që nuk është ndërhyrë në strukturën e ligjit, por janë eliminuar disa implikime buxhetore të cilat kanë qenë pjesë e neneve të Ligjit për ndihmë juridike falas.

Ju kisha lutur vetëm le ta lexojnë me kujdes dhe do të shohin këtë. Ne në Komision për Buxhet dhe Financa jemi pajtuar njëzëri që këto amendamente të shikojnë dhe nëse miratohen të gjitha amendamentet e Komisionit për Buxhet dhe Financa nuk ndërhyj në amendamentet të cilat i ka propozuar Komisioni për Legjislacion. Janë amendamente ku Komisioni për Legjislacion nuk ka bërë amendamente, me përjashtim të një amendamenti i cili nuk ka të bëjë fare me amendamentin që e ka propozuar Komisioni.

Unë dua që nëse deputetët kanë durim ta paraqes mënyrën e punës në tërësi që ka bërë Komisioni për Buxhet dhe Financa. Është e vërtetë që në shqyrtim të dytë është për herë të tretë ky projektligj. Komisioni për Buxhet dhe Financa, në mbledhjen e datës 25.7.2011, pasi që ka shqyrtuar Projektligjin nr. 04 L/017 për ndihmë juridike falas, ka vlerësuar se projektligji përmban implikime buxhetore shtesë e cila kosto dhe numër shtesë i punëtorëve nuk janë të përfshirë në buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2011 dhe në kornizën afatmesme të shpenzimeve për vitin 2012-2014.

Duke vlerësuar koston e lartë buxhetore, sidomos kërkesën e lartë për rritjen e numrit të punëtorëve për implementimin e këtij projektligji nga Komisioni për Buxhet dhe Financa është rekomanduar që projektligji të mos miratohet në seancën e datës 29.7.2011, por të shtyhet për më vonë ku do të mbahet një takim i përbashkët me Komisionin Funkcional për Legjislacion, sponsorizuesin dhe përfaqësuesit nga Ministria e Financave për të harmonizuar qëndrimet dhe për të bërë ndryshimet në nenet e caktuara ku kanë implikime buxhetore.

Kuvendi në seancat plenare të datës 29.7.2011 dhe 14.10.2011, në të cilat është shqyrtuar Projektligji për ndihmë juridike falas, ka nxjerrë vendime sipas të cilëve ka kërkuar që komisionet përkatëse, Ministria e Financave dhe Ministria sponsorizuese, t'i harmonizojnë qëndrimet lidhur me implikimet buxhetore të projektligjit dhe i njëjti më pas të procedohet për shqyrtim të dytë në Kuvend.

Komisioni për Buxhet dhe Financa në bazë të vendimit të Kuvendit në mbledhjen e mbajtur, më datën 25.10.2011, në praninë e kryetarit të Komisionit për Legjislacion, përfaqësuesve të Ministrisë së Financave dhe përfaqësuesve të Ministrisë së Drejtësisë, ka shqyrtuar Projektligjin nr. 04/L-017 për ndihmë juridike falas dhe vlerësoi se dispozitat e projektligjit nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë, në përjashtim të nenit 15 pika 1.3. nenit 20 paragrafi 1 dhe 3, të nenit 22 paragrafi 2.2. dhe nën paragrafi 2.3. dhe neni 37 paragrafi 1 dhe 2 dhe neni 39.

Komisioni vlerësoi se amendamentimi i dispozitave të neneve të përmendura, jo vetëm që do të shmangë implikimet buxhetore shtesë në implementimin e këtij ligji, por edhe do të bëjë harmonizimin e këtij ligji me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë dhe ligjeve tjera në çështjet e përcaktimit të pagave dhe buxhetit për agjencinë dhe Këshillin për ndihmë juridike.

Me ndryshimet e propozuara në amendamentin 2 është rekomanduar që të fshihen dispozitat ku thuhet thuajse pagat e anëtarëve të Këshillit caktohen sipas dispozitave të brendshme të Kuvendit, të cilat dispozita nuk ekzistojnë. Duke pasur për bazë nenin 40.7 të projektligjit, sipas të cilit numri i të punësuarve të Komisionit për Ndihmë Juridike falas, kalon në agjencion, me amendamentin 3, që i referohet ndryshimit në nenin 22 nënparagrafi 2.3 është shmangur mundësia e propozimit të të punësuarve të rinj në strukturën organizative të agjencisë, nga ana e drejtorit ekzekutiv dhe punësimet e reja do të varen nga buxheti i miratuar i agjencisë.

Me amendamentin 4, ndryshimet e propozuara në nenin 37, është rregulluar, që agjencia të financohet nga buxheti i Republikës së Kosovës dhe buxheti i agjencisë, sikur i çdo organizate buxhetore të propozohet dhe miratohet në pajtim me procedurat e përcaktuara me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.

Ky propozim është në pajtim me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi.

Po ashtu në amendamentin 5, që ka dhënë Komisioni për Buxhet, është propozuar të fshihet neni 39, i cili parasheh se agjencia mund të financohet nga të hyrat vetjake, pasi që mënyra e shfrytëzimit të mjeteve vetjake, rregullohet me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.

Komisioni për Buxhet dhe Financa duke vlerësuar të rëndësishëm miratimin e Projektligjit për ndihmë juridike, konsideron se miratimi i amendamenteve, të propozuara nga Komisioni për Buxhet dhe Financa, arrin që t'i shmangë ndikimet buxhetore shtesë, në zbatimin e këtij ligji dhe në të njëjtën kohë bëhet harmonizimi i këtij ligji me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë dhe ligjet tjera, në bazë të të cilave bëhet përcaktimi i pagave dhe buxhetit të agjencisë.

Të gjitha këto amendamente, që i ka propozuar Komisioni për Buxhet dhe Financa, nuk ka pasur amendamente në këto nene nga ana e Komisionit për Legjislacion dhe unë ju them me kompetencë se nuk ndërhyhet në strukturën e Projektligjit për ndihmë juridike falas.

Prandaj, këto amendamente të Komisionit për Buxhet, janë miratuar njëzëri nga të gjithë anëtarët e Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe kërkoj që të miratohen edhe këto.

KRYESUESI: Faleminderit!

Zoti Gashi e ka edhe një herë fjalën në emër të Komisionit, por janë paraqitur në emër të grupeve parlamentare, Zoti Beqiri.
Vazhdo, zoti Gashi!

ARBEN GASHI: Faleminderit!

Unë veç një sqarim shtesë desha.

Ne kemi bërë vërejtje edhe kur është bërë leximi i parë, se ligji ka probleme sa i përket deklaratës financiare dhe është thënë që duhet të kalohet dhe është kaluar.

Amandamentet që janë propozuar nga Kuvendi, asnjë nuk ka implikime financiare, po thotë edhe vetë zonjusha kryetare e Komisionit për Buxhet dhe Financa. Problemi është se të gjitha ato që i përmendi ajo direkt ndikojnë në strukturën e ligjit dhe në strukturën e institucionit. Diskutimet dhe konsultimet, që i kemi pasur me Ministrinë janë dhe konkluzioni i tyre është, që komplikimet financiare dhe implikimet financiare vijnë nga këto 5 zyra rajonale të zhvilluara nga UNDP-ja, të cilat janë një marrëveshje që mund edhe të anulohet.

Tash në këtë rast, pse ne ta dëmtojmë ligjin me këto ndërhyrje të arbitrare të Komisionit për Buxhet dhe Financa? Unë jam i bindur që me këtë ndërhyrje pamundësohet veprimtaria normale e këtij institucioni. Nëse ne mendojmë që të kemi një institucion funksional, me të gjitha këto ndërhyrje që janë bërë, thotë që nuk ka pasoja në institucion. Si s'ka pasoja në institucion, kur ke ndryshuar strukturën, ke bërë prerje strukturore, ke bërë prerje buxhetore, ke bërë prerje financiare, prerje të të punësuarëve dhe nuk ndryshohet struktura? Kjo është pasojë jashtëzakonisht e madhe dhe si i tillë ligji bëhet i pazbatueshëm.

Gjithsesi, është e Kuvendit, le të vendosë Kuvendi se çka do të bëjë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

E ka fjalën deputetja Safete Hadergjonaj.

SAFETE HADËRGJONAJ: Është çështja, që unë ju thashë që nuk ndikohet në strukturën e projektligjit, por nuk mund të shkohet me disa gjëra të cilat kanë qenë në projektligj. Megjithatë, ne si Komision për Buxhet dhe Financa nuk kemi marrë ndonjë raport nga Komisioni për Legjislacion, që nuk janë pranuar amendamentet, të cilat i ka dhënë Komisioni për Buxhet. Unë nuk e di nëse këto amendamente të Komisionit për Buxhet dhe Financa janë shqyrtuar në Komisionin për Legjislacion, sepse ne nuk kemi pranuar raport kthyes nga Komisioni për Legjislacion, se nuk janë pranuar amendamentet e Komisionit për Buxhet.

KRYESUESI: Faleminderit!

Fjalën e ka zoti Beqiri, në emër të Grupit Parlamentar.

ISMET BEQIRI: Zoti kryesues, faleminderit!

Duke qenë dëshmitarë të gjithë ne, të këtij konfuzioni që ekziston dhe mosharmonizimi të dy komisioneve, që janë, realisht funksionale dhe të rëndësishme, ne si grup parlamentar

e besoj se edhe kolegët tjerë, propozojmë që kjo të shtyhet, të hiqet nga rendi i ditës votimi, pa u sqaruar këto moskuptime dhe pa pasur çdo gjë të qartë, është shumë e pakuptueshme ta votojmë një projektligj, gjegjësisht një ligj, i cili nesër do t'i ketë këto dilema dhe paqartësi. Dhe nuk është vendi, mendoj megjithatë, që tash t'i shpjegohet një komisioni profesional, një komisioni tjetër që është po ashtu profesional, se a priset në këtë rast struktura e projektligjit?

Këto punë duhet të rregullohen më herët dhe fjala e komisioneve është fjalë e komisioneve dhe si të tilla duhet t'i përmbajmë. Në këtë rast Komisioni kompetent, që e thotë këtë, Komisioni për Legjislacion, pa dashur tash të dal në krah të këtij ose të atij, unë propozoj zoti kryesues, që me kolegë me mirëkuptim të shtyhet ky votim dhe të harmonizohen këto dhe të na vijë në seancën tjetër vijuese teksti i harmonizuar i këtyre neneve dhe amendamenteve, në mënyrë që ta votojmë pastaj të gjithë, përndryshe ne nuk do ta votojmë, gjegjësisht do të votojmë "kundër". Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Ky është mocion në procedurë. Kërkoj deklarinimin me radhë të kryetarëve të grupeve parlamentare, lidhur me mocionin e ngritur.

Zoti Adem Grabovci, e keni dëgjuar mocionin. Cili është mendimi i Grupit Parlamentar?

ADEM GRABOVCI: Ne dëgjuam edhe fjalën e kryetares së Komisionit, sqarimet ishin shumë të qarta për të gjithë deputetët, megjithatë, unë u bëj thirrje komisioneve, që vërtet le të kryejnë punën e vet në komisionet përkatëse dhe mos t'i qesin deputetët në pozita të palakmueshme.

Unë për hir që ky ligj, rëndësinë e tij që ka, ne kërkojmë që komisionet t'i harmonizojnë qëndrimet e veta dhe për hir të asaj kërkojmë që të shtyhet për seancën e radhës.

KRYESUESI: Faleminderit!

Nga Grupi Parlamentar "Vetëvendosje" lidhur me mocionin fjalën e ka Albulena Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Mund të shtyhet deri sa të bien në dakord komisionet, mirëpo vetëm edhe një çështje desha t'ia konfirmoj zonjës Hadërgjonaj, që ne e kemi shqyrtuar rekomandimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa në Komision, sepse po shprehet sikur po dyshon për këtë gjë. Gjithashtu, kryesues të lutem, unë nuk u shpreha asnjëherë, në rregull. Ne nuk mendojmë që projektligji për ndihmën juridike falas nuk do të arrijë efektin e duhur me rekomandimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa, pra, nuk do ta arrijë efektin e duhur. Ligjit i janë hequr implikimet buxhetore. Ligji si ligj ka qenë shumë i mirë në shqyrtim të parë, për atë edhe e kemi votuar, është dashur që të gjenden mjetet për të qenë i implementueshëm. Kështu si është nuk mendoj se do t'i plotësojë nevojat e qytetarëve.

Andaj, edhe nëse kalon mocioni, nëse prapë vjen rekomandimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa, kështu si është, ne nuk do ta votojmë. Faleminderit!

KRYESUESI: Mendimi juaj është që duhet ta tërheqim ligjin, ta qojmë në rishqyrtim. Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, deputeti Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit!

Kjo ishte arsyeja pse e kërkoja fjalën, mendoj se duhet të mbështetet mocioni dhe të shtyhet për një seancë tjetër. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, deputetja Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, nënkryetar!

Përshëndetje për të gjithë deputetët!

Duke marrë parasysh të dy rekomandimet e dy komisioneve parlamentare dhe duke parë që kanë nevojë akoma të harmonizohen, Grupi Parlamentar i Koalicionit për Kosovë të Re, përkrah mocionin që në një seancë të radhës të vijë edhe një herë projektligji me amendamente. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Grupi Parlamentar i SLS, deputeti Milosavljeviq!

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala, gospodine predsjedavajući!

I parlamentarna grupa Samostalne Liberalne Stranke se slaže da se ova mocija odloži za neku od narednih sednica.

KRYESUESI: Faleminderit!

Nga “6+”, zoti Kinolli.

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Edhe Grupi Parlamentar “6+” e mbështet mocionin. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Votojmë formalisht qëndrimin e grupeve parlamentare, për tërheqjen e ligjit, me qëllim që të harmonizohet edhe një herë në komisionet përkatëse. Votojmë formalisht, pra.

Kush është “për”? Faleminderit!

“Kundër”? 2 janë .

Faleminderit!

Vazhdojmë me pikën e katërmëdhjetë të rendit të ditës, që është:

14. Shqyrtimi i dytë i projektligjit për të huajt

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar Projektligjin për të huajt dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Ftoj raportuesin e Komisionit FunkSIONAL për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë, deputetin Rexhep Selimi, që para deputetëve ta arsyetojë raportin me rekomandime.

REXHEP SELIMI: Faleminderit, zoti kryesues!

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së ka bërë punën e duhur dhe ia ka paraqitur Kuvendit raportin me rekomandime për ligjin për të huajt, të cilin njëzëri, njëkohësisht ftojme që ta mbështesni dhe ta votoni me votën tuaj, pra. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Selimi!

Vazhdojmë me votimin e amendamenteve të propozuara, sipas radhës së paraqitur në raportin e Komisionit FunkSIONAL. Kemi 44 amendamente. Sa kemi në sallë? 76 deputetë janë në sallë.

Amendamenti 1.

“Kundër”? S’ka.

“Abstënim”? S’ka.

Miratohet.

Amendamenti 2.

“Kundër”? S’ka.

“Abstënim”? S’ka.

Miratohet.

Amendamenti 3.

“Kundër”? S’ka.

“Abstënim”? S’ka.

Miratohet.

Amendamenti 4.

“Kundër”? S’ka.

“Abstënim”? S’ka.

Miratohet.

Amendamenti 5.

“Kundër”? S’ka.

“Abstënim”? S’ka.

Miratohet.

Amendamenti 6.

“Kundër”? S’ka.

“Abstënim”? S’ka.

Miratohet.

Amendamenti 7.
“Kundër”? S’ka.
“Abstenim”? S’ka.
Miratohet.

Amendamenti 8.
“Kundër”? S’ka.
“Abstenim”? S’ka.
Miratohet.

Amendamenti 9.
“Kundër”? S’ka.
“Abstenim”? S’ka.
Miratohet.

Amendamenti 10.
“Kundër”? S’ka.
“Abstenim”? S’ka.
Miratohet.

Amendamenti 11.
“Kundër”? S’ka.
“Abstenim”? S’ka.
Miratohet!

Amendamenti 12.
“Kundër”? S’ka.
“Abstenim”? S’ka.
Miratohet.

Amendamenti 13.
“Kundër”? S’ka.
“Abstenim”? S’ka.
Miratohet.

Amendamenti 14.
“Kundër”? S’ka.
“Abstenim”? S’ka.
Miratohet.

Amendamenti 15.
“Kundër”? S’ka.
“Abstenim”? S’ka.
Miratohet.

Amendamenti 16.
“Kundër”? S’ka.
“Abstenim”? S’ka.
Miratohet.

Amendamenti 17.
“Kundër”? S’ka.
“Abstenim”? S’ka.
Miratohet.

Amendamenti 18.
“Kundër”? S’ka.
“Abstenim”? S’ka.
Miratohet.

Amendamenti 19.
“Kundër”? S’ka.
“Abstenim”? S’ka.
Miratohet.

Amendamenti 20.
“Kundër”? S’ka.
“Abstenim”? S’ka.
Miratohet.

Amendamenti 21.
“Kundër”? S’ka.
“Abstenim”? S’ka.
Miratohet.

Amendamenti 22.
“Kundër”? S’ka.
“Abstenim”? S’ka.
Miratohet.

Amendamenti 23.
“Kundër”? S’ka.
“Abstenim”? S’ka.
Miratohet.

Amendamenti 24.
“Kundër”? S’ka.
“Abstenim”? S’ka.
Miratohet.

Amendamenti 25.
“Kundër”? S’ka.
“Abstenim”? S’ka.
Miratohet.

Amendamenti 26.
“Kundër”? S’ka.
“Abstenim”? S’ka.
Miratohet.

Amendamenti 27.
“Kundër”? S’ka.
“Abstenim”? S’ka.
Miratohet.

Amendamenti 28.
“Kundër”? S’ka.
“Abstenim”? S’ka.
Miratohet.

Amendamenti 29.
“Kundër”? S’ka.
“Abstenim”? S’ka.
Miratohet.

Amendamenti 30.
“Kundër”? S’ka.
“Abstenim”? S’ka.
Miratohet.

Amendamenti 31.
“Kundër”? S’ka.
“Abstenim”? S’ka.
Miratohet.

Amendamenti 32.
“Kundër”? S’ka.
“Abstenim”? S’ka.
Miratohet.

Amendamenti 33.
“Kundër”? S’ka.
“Abstenim”? S’ka.
Miratohet.

Amendamenti 34.
“Kundër”? S’ka.
“Abstenim”? S’ka.
Miratohet.

Amendamenti 35.
“Kundër”? S’ka.
“Abstenim”? S’ka.
Miratohet.

Amendamenti 36.
“Kundër”? S’ka.
“Abstenim”? S’ka.
Miratohet.

Amendamenti 37.
“Kundër”? S’ka.
“Abstenim”? S’ka.
Miratohet.

Amendamenti 38.
“Kundër”? S’ka.
“Abstenim”? S’ka.
Miratohet.

Amendamenti 39.
“Kundër”? S’ka.
“Abstenim”? S’ka.
Miratohet.

Amendamenti 40.
“Kundër”? S’ka.
“Abstenim”? S’ka.
Miratohet.

Amendamenti 41.
“Kundër”? S’ka.
“Abstenim”? S’ka.
Miratohet.

Amendamenti 42.
“Kundër”? S’ka.
“Abstenim”? S’ka.
Miratohet.

Amendamenti 43.
“Kundër”? S’ka.
“Abstenim”? S’ka.
Miratohet.

Amendamenti 44.
“Kundër”? S’ka.
“Abstenim”? S’ka.
Miratohet.

Tani, pas votimit të amendamenteve, votojmë tekstin e projektligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara. Në sallë janë 74 deputetë.
Lus regjinë dhe juve deputetë, të votojmë tani! Faleminderit!

Konstatohet që me 68 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, Kuvendi miratoi Ligjin për të huajt. Faleminderit!

Vazhdojmë me pikën e pesëmbëdhjetë të rendit të ditës:

15. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për azilin

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar Projektligjin për azilin dhe Kuvendi i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Ftoj raportuesin e Komisionit FunkSIONAL për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të Forcës së Sigurisë së Kosovës, deputeten Musliu, që para deputetëve ta arsyetojë raportin me rekomandime.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, zoti kryesues!

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së e ka shqyrtuar projektligjin për azilin dhe deputetëve u ka paraqitur raportin, kështu që ftoj të gjithë deputetët, që ta miratojnë këtë ligj, sepse i plotëson të gjitha standardet evropiane dhe është shumë i përshtatshëm që të implementohet në Kosovë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Projektligji ka 21 amendamente.

Vazhdojmë me votimin një nga një.

Amendamenti 1.
“Kundër”? S’ka.
“Abstenim”? S’ka.
Miratohet.

Amendamenti 2.
“Kundër”? S’ka.

“Abstenim”? S’ka.
Miratohet.

Amendamenti 3.
“Kundër”? S’ka.
“Abstenim”? S’ka.
Miratohet.

Amendamenti 4.
“Kundër”? S’ka.
“Abstenim”? S’ka.
Miratohet.

Amendamenti 5.
“Kundër”? S’ka.
“Abstenim”? S’ka.
Miratohet.

Amendamenti 6.
“Kundër”? S’ka.
“Abstenim”? S’ka.
Miratohet.

Amendamenti 7.
“Kundër”? S’ka.
“Abstenim”? S’ka.
Miratohet.

Amendamenti 8.
“Kundër”? S’ka.
“Abstenim”? S’ka.
Miratohet.

Amendamenti 9.
“Kundër”? S’ka.
“Abstenim”? S’ka.
Miratohet.

Amendamenti 10.
“Kundër”? S’ka.
“Abstenim”? S’ka.
Miratohet.

Amendamenti 11.
“Kundër”? S’ka.

“Abstenim”? S’ka.
Miratohet.

Amendamenti 12.
“Kundër”? S’ka.
“Abstenim”? S’ka.
Miratohet.

Amendamenti 13.
“Kundër”? S’ka.
“Abstenim”? S’ka.
Miratohet.

Amendamenti 14.
“Kundër”? S’ka.
“Abstenim”? S’ka.
Miratohet!

Amendamenti 15.
“Kundër”? S’ka.
“Abstenim”? S’ka.
Miratohet.

Amendamenti 16.
“Kundër”? S’ka.
“Abstenim”? S’ka.
Miratohet.

Amendamenti 17.
“Kundër”? S’ka.
“Abstenim”? S’ka.
Miratohet.

Amendamenti 18.
“Kundër”? S’ka.
“Abstenim”? S’ka.
Miratohet.

Amendamenti 19.
“Kundër”? S’ka.
“Abstenim”? S’ka.
Miratohet.

Amendamenti 20.
“Kundër”? S’ka.

“Abstënim”? S’ka.
Miratohet.

Amendamenti 21.
“Kundër”? S’ka.
“Abstënim”? S’ka.
Miratohet.

Votojmë tekstin e ligjit me amendamentet në tërësi. Në sallë janë 68 deputetë. Votojmë tani!

Me 63 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstënim, Kuvendi miratoi Ligjin për azilin.

Pika e gjashtëmbëdhjetë e rendit të ditës, është:

16. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për sigurinë e përgjithshme të produkteve

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar Projektligjin për sigurinë e përgjithshme të produkteve dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Ftoj kryetarin e Komisionit Funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, deputetin Pajaziti, që para deputetëve ta arsyetojë raportin me rekomandime.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryesues!

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, me datën 25 nëntor e ka shqyrtuar Projektligjin për sigurinë e përgjithshme të produkteve, të propozuar prej Qeverisë dhe përfundimisht më datën 19 dhjetor ka vendosur që Kuvendit t’i paraqesë këtë raport. Duke falënderuar të gjithë deputetët, që kanë punuar në të gjitha komisionet dhe ekspertët në hartimin e këtij projektligji, i ftojme deputetët që ta votojnë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Vazhdojmë me amendamentet.

Amendamenti 1.
“Kundër”? S’ka.
“Abstënim”? S’ka.
Miratohet.

Amendamenti 2.
“Kundër”? S’ka.
“Abstënim”? S’ka.
Miratohet.

Amendamenti 3.
“Kundër”? S’ka.
“Abstenim”? S’ka.
Miratohet.

Amendamenti 4.
“Kundër”? S’ka.
“Abstenim”? S’ka.
Miratohet.

Amendamenti 5.
“Kundër”? S’ka.
“Abstenim”? S’ka.
Miratohet.

Amendamenti 6.
“Kundër”? S’ka.
“Abstenim”? S’ka.
Miratohet.

Amendamenti 7.
“Kundër”? S’ka.
“Abstenim”? S’ka.
Miratohet.

Amendamenti 8.
“Kundër”? S’ka.
“Abstenim”? S’ka.
Miratohet.

Amendamenti 9.
“Kundër”? S’ka.
“Abstenim”? S’ka.
Miratohet.

Amendamenti 10.
“Kundër”? S’ka.
“Abstenim”? S’ka.
Miratohet.

Amendamenti 11.
“Kundër”? S’ka.
“Abstenim”? S’ka.
Miratohet.

Amendamenti 12.
“Kundër”? S’ka.
“Abstenim”? S’ka.
Miratohet.

Amendamenti 13.
“Kundër”? S’ka.
“Abstenim”? S’ka.
Miratohet.

Amendamenti 14.
“Kundër”? S’ka.
“Abstenim”? S’ka.
Miratohet!

Amendamenti 15.
“Kundër”? S’ka.
“Abstenim”? S’ka.
Miratohet.

Amendamenti 16.
“Kundër”? S’ka.
“Abstenim”? S’ka.
Miratohet.

Amendamenti 17.
“Kundër”? S’ka.
“Abstenim”? S’ka.
Miratohet.

Amendamenti 18.
“Kundër”? S’ka.
“Abstenim”? S’ka.
Miratohet.

Amendamenti 19.
“Kundër”? S’ka.
“Abstenim”? S’ka.
Miratohet.

Amendamenti 20.
“Kundër”? S’ka.
“Abstenim”? S’ka.
Miratohet.

Amendamenti 21.
“Kundër”? S’ka.
“Abstenim”? S’ka.
Miratohet.

Amendamenti 22.
“Kundër”? S’ka.
“Abstenim”? S’ka.
Miratohet.

Amendamenti 23.
“Kundër”? S’ka.
“Abstenim”? S’ka.
Miratohet.

Amendamenti 24.
“Kundër”? S’ka.
“Abstenim”? S’ka.
Miratohet.

Votojmë tekstin e projektligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara. Në sallë janë 70 deputetë. Votojmë tani!

Konstatohet se me 66 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, Kuvendi miratoi Ligjin për sigurinë e përgjithshme të produkteve.

Vazhdojmë me pikën e shtatëmbëdhjetë të rendit të ditës, që është:

17. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Qeverinë e Republikës së Kosovës

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar Projektligjin për Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Zoti Idriz Vehapi e ka fjalën.

IDRIZ VEHAPI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Për këtë projektligj, raportues ka qenë i caktuar deputeti Sadri Ferati dhe me sa pash, ai nuk qenka këtu, atëherë unë në emër të Komisionit edhe të Grupit Parlamentar, po raportoj.

Komisioni Funkcional i ka shqyrtuar projektligjin, gjithsej ka dhënë 11 amendamente, po ashtu edhe komisionet e përhershme i kanë shqyrtuar të gjitha nenet dhe amendamentet. Tri komisione të përhershme, nuk kanë pasur vërejtje, me përjashtim të Komisionit për

Legjislacion. Vërejtjet e Komisionit për Legjislacion kanë qenë për amendamentin 10 dhe 11. Për amendamentin 11, kemi marrë rekomandimin në plotëni nga Komisioni për Legjislacion, ndërkaq për amendamentin 10 kemi bërë një riformulim ndryshe nga amendamenti para se ta shqyrtojë Komisioni i përhershëm. Ne si Komision, njëzëri e kemi përkrahur projektligjin me amendamente, po ashtu edhe si Grup Parlamentar e përkrahim për votim. Faleminderit!

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit)

KRYESUESI: Fjalën e ka kërkuar zoti Hamiti.

SABRI HAMITI: Faleminderit, zoti nënkryetar Haliti!

Në shqyrtimin e parë të këtij projektligji, i cili është mbajtur në seancë plenare, më 22 shtator 2011, kam folur në këtë foltore për këtë ligj, duke e konsideruar si ligj të rëndësishë së veçantë, e konsideroj edhe tani.

Duke e respektuar dhe konsideruar si ligj të veçantë, kam thënë që do të votoj për të dhe kam votuar atë ditë. Pastaj, kam thënë që duhet patjetër që të bëhen amendamente dhe për të qenë më konkret, atëherë thosha që po i formuloj amendamentimet, sepse kam vërejtur që në leximin e parë kanë ndodhur të jepen ide të mira për ligjet, por të mos shndërrohen në amendamente nga komisionet. Ka ndodhur pikërisht kjo.

Unë tash dola ta deklaroj pse e kam votën “kundër” këtij ligji qysh është edhe me këto amendamentimet 10 janë, a 11, të cilat janë krejt formale, s’thonë kurrëgjë, ka mund të jetë edhe pa to, por janë, nuk do të merrem me to.

Unë, po e ritheksoj, pse? Pse tash them jam ” kundër”? Nuk është marrë parasysh një amendamentim që ka të bëjë me nenin 1.3.2 dhe që ka të bëjë me strukturën e Qeverisë, sepse ka mbetur hapur prej 1 deri në pa kufi dhe qeveri, sipas këtij ligji mund të mbarohet qeveri me 13 ministra, po mundet edhe me 30, sipas nevojë, që është një absurd dhe s’ka pasur kurrfarë nevojë të mbetet kështu. Përkundrazi, ne kemi një amendament atje të Komisionit që kanë qenë të kufizuar ministrat pa portofol 2, kanë thënë edhe këtu të jenë, mos të kufizohen me 2.

Amendamentimi tjetër është që unë kam kërkuar që kodet dhe rregulloret sipas këtij ligji të bëhen brenda 3 muajsh, është kërkuar 6 muajsh, domethënë, të pritët 6 muaj.

I katërti, ka pasur të bëjë me domosdoshmërinë, me obligimin e anëtarëve të Qeverisë që të jenë në Parlament në seanca plenare dhe të komisioneve dhe sidomos kur shqyrtohen aktet e Qeverisë, qofshin akte qeverie, qofshin nënligjore. Ju e dini çka, që e shihni qysh po duket sot këtu edhe e kuptoni se çka kam kërkuar unë. Nuk është marrë parasysh.

Tjetër është neni 35.1, ku thuhet: “Qeveria disponon dhe shfrytëzon pasurinë e Republikës së Kosovës”. Unë kam thënë dhe kam propozuar: “vetëm duke marrë pëlqimin nga Kuvendi i Republikës së Kosovës”, dhe mund t’ju them që janë dy diskutues që kanë diskutuar strikt në këtë frymë dhe ata janë Hydajet Hyseni dhe

Muhamet Mustafa. Nuk është marrë parasysh, që është fundamentale e Qeverisë, sa qeveris një qeveri pasurinë e Republikës së Kosovës. Por, jo pakufishmërisht, pa qenë, pa marrë pëlqimin nga Kuvendi, sepse është organi më i madh përfaqësues që merr përgjegjësitë nga zgjedhësit për të dhënë një leje të qeverisjes të pasurisë totale të Kosovës.

Edhe një nen, edhe një tjetër pse unë them prapë nuk më lejon që ta votoj, është problemi i nenit 27.10, që ka të bëjë me aktet ligjore të Qeverisë, akte që marrin fuqinë ligjore për gjithë Kosovën. Atje është një nen shumë i paqartë. Nuk mundet një akt qeveritar të marrë fuqinë e ligjit për gjithë Kosovën, duhet të caktohet data për sa kalon në Kuvend, sepse mund të bëhet. Këtu përmendet një 45 ditë, është një akt ligjor që do të marrë fuqinë e ligjit dhe pa e marrë këtë, vepron 45 ditë, në cilindo shtet, mund të prodhojë vendime dhe çudira që nuk mund të kthehen prapaktheu, siç thuhet, pas 45 ditësh, mund të thuash ishte gabim dhe s'ndodhi kurrëgjë.

Unë, zoti kryesues, dola ta deklaroj votën time publikisht “kundër”, sepse jam unë që në këtë foltore, më 22 shtator... e kam përkrahur këtë ligj. Faleminderit!

Drejtimin e seancës e merr kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Komisionit për Legjislacion, deputeti Gashi e ka fjalën.

ARBEN GASHI: Faleminderit, kryetar!

Këtu nga kryetari i Komisionit që e ka një emër të gjatë, zoti Vehapi u tha që Komisioni për Legjislacion ka bërë dy vërejtje dhe ka gjetur 2 amendamente që janë në kundërshtim me Kushtetutën, amendamenti 10 dhe amendamenti 11.

Amendamenti 10 parashihte që agjencitë shtetërore të parapara edhe me ligje të veçanta, me vendim qeverie, ose me vendim të kryeministrit, mund të shuhen ose të riorganizohen.

Komisioni ka konstatuar se kjo është në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, sepse vendimet e Kuvendit po anulohen me vendim të kryeministrit, ose me vendim të Qeverisë, kushdo që të jetë ai kryeministër, sepse po flasim për Ligjin për Qeverinë jo për individin.

Amendamenti 11, po ashtu e ka pasur të shkruar, dhe thoshte se Rregullorja aktuale në fuqi do të jetë e zbatueshme deri në masën sa nuk është në kundërshtim me këtë ligj. Kush e përcakton masën, qysh përcaktohet masa, çka është masa? Dhe ky amendament është hequr, është mirë që është hequr nga Komisioni funksional, mirëpo amendamenti 10 është riformuluar dhe riformulimi i tij, tash po shohim që është i pakuptimtë dhe besoj që mund të shkaktojë probleme, një formulim i gjatë, i pakuptimtë, i paarsyeshëm dhe i pazbatueshëm.

Ky amendament është dashur të hiqet normalisht, mirëpo Komisioni funksional po ashtu ka bërë një veprim i cili realisht është i paarsyeshëm.

Në këtë rast Komisioni nuk ka mund të mbledhet dhe nuk e ka diskutuar, sepse Komisioni funksional i ka dërguar një shkresë Komisionit për Legjislacion dhe i thotë se janë marrë parasysh të gjitha vërejtjet që janë bërë nga Komisioni për Legjislacion. Tash po shohim këtu se vërejtjet janë marrë kryesisht parasysh.

Prandaj, unë po flas edhe si deputet tash, në tërësi ligjin do ta votoj “kundër”, e po ashtu edhe ky amendament është i papranueshëm për mua. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputetja Alma Lama e ka fjalën.

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryetar!

Një fjali e kam. E kam një vërejtje për mënyrën se si ne po votojmë. Nuk jemi këtu në lojëra shpejtësie. Për shembull, ligji i cili kaloi për financimin e partive politike, nuk e morëm vesh për çka votuam “pro” dhe për çka votuam “kundër”.

Është shumë e rëndësishme të theksojmë që në këtë ligj, Komisioni Evropian ka sugjeruar parandalimin të konfliktit të interesit të kompanive të cilat e kanë të ndaluar faktikisht të japin donacione kur marrin tenderë publikë. Unë nuk e di se si kam votuar për atë ligj dhe dua të them që unë e mbështes, në rast se është konstatuar vota, dua ta bëj publike votën time tani, pra është “pro” amendamentit të Komisionit për Integritet Evropian. Kam parasysh që shumica këtu nuk e di për çka kanë votuar. Një.

E dyta, për sa i përket ligjit, jo me të vërtetë duhet të shohim edhe dhjetë sekonda për t’i votuar amendamentet këtu është periudhë shumë e shkurtër. Nuk po arrijmë për ta kuptuar se për çfarë po votojmë.

Për sa i përket Ligjit për Qeverinë, nuk është përcaktuar numri i ministrive se sa mund të krijojë Qeveria, domethënë, sa ka numër të ministrive dhe mendoj që është aktualisht në kabinetin aktual, janë 19, domethënë, është lënë sërish mundësia e hapur e abuzimit me numrin e ministrive, ndërkohë që ka vende të tjera, të cilat numrin e ministrive e kanë të sanksionuar me kushtetutë. Mendoj se sikur edhe të gjitha nenet tjera të ishin në rregull, kjo e bën të papranueshme Ligjin për Qeverinë. Faleminderit!

KRYETARI: Deputete, sa i përket pjesës së parë, grupet parlamentare para se të vijnë në seancë duhet ta dinë çka po votojnë dhe nuk ka nevojë koha në seancë të jetë më e gjatë se që është, prandaj urdhëroni kryeni punët tuaja në grupet parlamentare, merrni vesh në grupe parlamentare, sepse amendamentet janë krijuar brenda dy muajve dhe ka pasur kohë secili komision, secili anëtar i komisionit ta njoftojë grupin e vet se ku e ka dhënë pëlqimin e ku s’e ka dhënë pëlqimin.

Prandaj, mendoj që nuk është në rregull të thuhet tash se deputetët kanë votuar dhe ata s’e dinë e dikush e di çka ka votuar. Mendoj që kjo mënyrë e të shprehurit është gabim,

secili deputet e ka vullnetin dhe e ka të drejtën e vet për të votuar dhe s'kemi të drejtë t'i themi po di apo s'po di të votojë. Është pra çështje e përgjegjësisë së secilit, dhe është përgjegjësi individuale.

Fjalën e ka deputeti Afrim Kasolli.

AFRIM KASOLLI: Faleminderit, kryetar!

Unë në emër të Lëvizjes "Vetëvendosje", vetëm dua të deklarojmë se ne do të votojmë kundër këtij projektligji, për shkak të faktit se edhe përkundër ndryshimeve që janë bërë dhe amendamenteve, këto ndryshime i konsiderojmë vetëm kozmetikë, dhe jo përmbajtësore dhe substanciale.

Sa i përket amendamenteve, do të thotë, këto nuk i konsiderojmë shumë të rëndësishme, këto amendamente që i kemi, për to mund edhe të abstenojmë, por Ligji pikërisht nuk e kufizon çështjen më kyçe të organizimit të Qeverisë, pikërisht atë të kufizimit të numrit të ministrive dhe do të kemi të njëjtën situatë sikur e patëm këto ditë kur madje edhe kryeministri i vendit nuk e di se sa zëvendësministra i ka, por a do të vazhdojë kjo praktikë e abuzimit të organizimit të Qeverisë?

Po ashtu, ky projektligj lë shumë zbrastësira sa i përket Qeverisë në dorëheqje dhe për fund, po ashtu, nuk jep garanci se do të ndryshohet Rregullorja e punës së Qeverisë, si dhe Rregullorja për nivelin e pagave për anëtarët e Qeverisë dhe anëtarët e Kabinetit, raportin mujor për shpenzimet e telefonave apo të komunikimit të cilat hartohen nga Departamenti i teknologjisë informative, të dhënat e detajuara për kodin e veçantë ekonomik për shpenzimet e reprezentacionit dhe Rregulloren për kompensim të vizita zyrtare jashtë vendit.

Prandaj, në emër të Lëvizjes "Vetëvendosje" ne deklarojmë se do të votojmë kundër këtij projektligji.

KRYETARI: Mos i ngatërmoni ligjet tjera me këtë ligj, se çështja e shpenzimeve rregullohet me ligje tjera, jo me Ligjin për Qeverinë. Dhe, nuk e di, këtu të gjitha komisionet, rekomandimet i kanë dhënë pozitive dhe pse nuk i keni pasur kundërshtitë në emër të grupeve parlamentare dhe amendamentet të jenë në emër edhe të komisioneve të tjera?

Urdhëro, Afrim, shkurt!

AFRIM KASOLLI: Sa i përket kundërshtimit, ajo mund të dokumentohet. Është e protokolluar në procesverbal, madje edhe vetë përfaqësuesi i Qeverisë – i kryeministrit më ka thënë: ti a ke ardhur këtu me vërejtjet tuaja t' i mbushesh vetëm procesverbalet apo të bësh punë për Qeverinë? Kështu që kjo është e dokumentuar, mund të dokumentohet që e kam kundërshtuar pikërisht këtë aspekt, ku kam kërkuar kufizimin e numrit të ministrive, kështu që kjo mund të verifikohet në dokumentet e Kuvendit.

Natyrish, edhe në çështje tjera, nuk kam kundërshtuar ... Po, e kam lexuar Kushtetutën, por Kushtetuta nuk thotë për t'i pasur 40 zëvendësministra.

KRYETARI: Ju lutem! Është përgjegjësi e koalicionit qeverisës, në fund të fundit, për ta bërë Qeverinë. Kjo çështje është dashur të precizohet në Kushtetutë dhe në Kushtetutë s'e kemi.

Fjalën e ka deputeti Lutfi Haziri.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, zoti kryetar!

Koha në të cilën ka ardhur ky ligj dhe mënyra se si po vjen deri në miratim, mendoj se është e panevojshme. Nën një, zakonisht eksperiencat që i kanë shtetet edhe brenda BE-së, tregojnë qartë se shumica e shteteve nuk kanë ligj të veçantë për Qeverinë, po i adaptohen ligjeve apo kushtetutës së vendeve përkatëse.

Nën dy, përvoja regjionale që shihet, e ka Maqedonia dhe Serbia, të cilat ligjin e miratojnë para emërimit të Kabinetit. Para emërimit të kabinetit ligji vjen, i cili përcakton saktë numrin e ministrave, zëvendëskryeministrave, zëvendësministrave dhe miratimi i atij ligji pamundëson qeverinë pastaj brenda kohës për ta ndryshuar.

Kjo nuk ka ardhur në Kosovë, nuk ka ardhur as në pjesën e ndryshimeve eventuale, që parashihen, as nuk është përcaktuar struktura të qeverisë. Realisht për ligjet, gjendja aktuale e qeverisë e cila në Kosovë ka filluar me 11 ministra, ka përfunduar më 19. Me një zëvendës-kryeministër, ka shkuar me 6 zëvendëskryeministra dhe praktikisht sot janë mbi 270 emërimet politike që bëhen brenda Kabinetit qeveritar.

Mendoj se ligji si i tillë e ka humbur rëndësinë më, ose duhet të kthehet në moment kur Qeveria hyn në rishikim total, ose ta lënë një mundësi krejt tjetër kur emërohet një kabinet tjetër qeveritar, sepse s'pengon kurrgjë e as s'ndihmon ky ligj kurrgjë, përveç se e përlligj gjendjen aktuale dhe realisht kompetencat i ka të përshkruara me Kushtetutë.

Këtu jepet në administrim pasuria që është problematike, duhet parë kush është përgjegjës për menaxhim të saj dhe nën dy, si strukturë këtu ka vetëm njëjës dhe shumës dhe absolutisht si strukturë nuk definojnë kurrgjë tjetër.

KRYETARI: Faleminderit!

Deputeti Ismet Beqiri e do fjalën.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti kryetar!

Ju erdhët në ndërkohë, dhe zoti Hamiti, profesori, i paraqiti ato që i ka thënë edhe më herët.

Unë propozoj në emër të Grupit që pikërisht për katër amendamente që janë shumë të rëndësishme që i tha edhe Lutfiu dhe disa të tjerë që nuk po i kontestojnë, unë propozoj që pikërisht për nevojën e futjes së këtyre amendamenteve dhe që në start e kemi thënë dhe jemi që të përkrahet Projektligji për Qeverinë, por me mungesën e këtyre amendamenteve, realisht mbetet diçka për të cilën ne nuk mund ta pranojmë, sepse

zhvishemi si Kuvend në mundësinë e caktimit të numrave, thjesht të Qeverisë. Dhe, kjo përbërjes së Kabinetit, thjesht kjo nuk bëhet për një qeveri, po mendohet jo për emra që këtu me të drejtë u tha, nuk po flas për emra, por zoti kryetar, kërkesa do të thotë është jona që paraqesim mocion që kjo të shtyhet e plotësohet dhe në seancën e radhës ne do ta përkrahim, në të kundërtën, ne nuk do ta votojmë këtë projektligj.

Thjesht, janë katër amendamente shumë substanciale që mund ta bëjnë përmirësimin e këtij projektligji, jo që e dëmtojnë, po e pasurojnë dhe e bëjnë funksional dhe pse jo e ruajnë edhe rolin e vet të Kuvendit nga i cili zgjidhet Qeveria.

Prandaj, nëse ato mund të futen sot si amendamente, ose të shkojnë në lexim, mund të jetë edhe leximin i tretë dhe me dakordim të komisioneve ne pastaj do t'i përkrahim edhe amendamentet edhe projektligjin në tërësi, përndryshe ne duhet të votojmë kundër. Faleminderit, zoti kryetar!

KRYETARI: Faleminderit!

Muhamet Mustafa e ka fjalën, dhe le të përgatitet edhe një herë kryetari i komisionit funksional.

MUHAMET MUSTAFA: Ju faleminderit, zoti kryetar i Kuvendit!

Unë mendoj se është bërë fare pak përpjekje që ky projekt i ligjit të përmirësohet në harmoni me diskutimin shumë të pasur që ka qenë në Kuvend. Ndoshta edhe ne e kemi një pjesë të përgjegjësisë, se nuk i kemi formuluar amendamentet në mënyrë precize që t'i çojmë në komisione, prandaj duhet të jemi edhe vetëkritikë këtu, mirëpo nuk na ndihmon as vetëkritika, nëse ne e lejojmë të kalojë një ligj i cili nuk e rregullon një çështje fundamentale e cila është objekt i kritikave.

Ne e dimë se në të gjitha analizat dhe raportet e jashtme, sidomos raportet e progresit e kanë problematizuar fuqinë e Kuvendit dhe raportet, Kuvend – Qeveri.

Ky ligj nuk e zgjedh këtë problem, bile mund të them shkon edhe një hap më mbrapa se deri më tash.

Prandaj, unë jam për atë që ne mos të ngutemi, le të jetë leximi i tretë, le të harmonizohen këto gjëra.

Për shembull, neni 16 thotë: Përgjegjësia e ministrave:”hartojnë dhe mbikëqyrin zbatimin e politikave të Ministrisë”. Ministrat janë përgjegjës për politikën e Kuvendit dhe të Qeverisë, prandaj ministrat duhet t'i mbajnë përgjegjës për situatën në përgjithësi në dikasteret përkatëse dhe duhet ta definojnë mirë përgjegjësinë e ministrave edhe obligimet e tyre.

Raporti Kuvend – Qeveri, mirë është, amendamenti veç e ka propozuar titullin e raporteve Kuvend – Qeveri, por s'ka përmirësuar kurrëgjë në përmbajtje. Ka mbetur përmbajtja ashtu si ka qenë. Ne nuk mund të zgjedhim me titull problemin i cili është esencial në funksionimin e ekzekutivit dhe legjislatorit.

Prandaj, këtu gjithsesi duhet të dihet që Qeveria i raporton dhe përgjigjet para Kuvendit në baza vjetore dhe sipas kërkesave të Kuvendit mbi bazë të Rregullores së Kuvendit mbi realizimin e politikave dhe programet e saj dhe situatën e përgjithshme në vend.

Thotë, Qeveria i përgjigjet sipas ligjit dhe Kushtetutës, po në rregull, por në qoftë edhe sipas ligjit, atëherë ky ligj e rregullon përgjegjësinë e Qeverisë. Në qoftë se është ligji mbi Qeverinë, në këtë ligj duhet të definohet përgjegjësia e Qeverisë.

Dhe çështja, që e ngriti profesor Hamiti, është shumë esenciale. Qeverisja me pasuri, thotë: “Qeveria apo institucioni i autorizuar nga ajo”, merre me mend, mund një institucion të autorizohet, “disponon dhe shfrytëzon pasurinë”. Kjo është e pakuptimtë. Ne mund të themi se Qeveria e menaxhon shfrytëzimin e pasurive natyrore duke i marrë parasysh ligjet dhe vendimet e Kuvendit të Kosovës. Nuk mund Qeveria të disponojë, të autorizojë agjenci që ta shfrytëzojnë pasurinë natyrore.

Prandaj, këto janë çështje shumë esenciale dhe në qoftë se ne sot nuk mund t'i formulojmë këto amendamente, më mirë është që të merremi vesh që të hyjnë, këto tri- katër çështje, që janë esenciale. Faleminderit!

KRYETARI: Regjia, fjalën kryetarit të komisionit, deputetit Idriz Vehapi.

IDRIZ VEHAPI: Faleminderit, shumë!

Unë për hir të opinionit dhe të deputetëve këtu e dini se Komisioni funksional është i përbërë prej deputetëve të gjitha partive politike dhe unë dua të them që raportues për këtë ligj ka qenë deputeti Sadri Ferati.

(Ndërhyrje)

Për mua ka lidhje ta theksoj këtu, për ju ndoshta s'ka. Dhe amendamente ka paraqitur vetëm deputeti Sabri Hamiti, në seancën plenare kur është bërë leximi i parë. Kjo është e vërtetë.

Profesor Muhamet Mustafa nuk ka paraqitur amendamente, ka diskutuar për Projektligjin në leximin e parë dhe, se si paraqiten amendamentet, është Rregullorja e Kuvendit dhe unë i kisha lutur ata që nuk e kanë lexuar nenin 57, le ta lexojnë dhe le të kuptojnë se si paraqitet amendamenti dhe cilat janë afatet edhe Komisioni funksional pastaj është i detyruar të marrë parasysh amendamentin dhe ta shqyrtojë.

Tani jemi në leximin e dytë, unë thashë, janë 11 amendamente që i ka bërë Komisioni funksional. Kanë qenë prezentë deputetët e të gjitha subjekteve politike dhe të gjitha amendamentet në Komision janë votuar njëzëri. Kjo është situata për Projektligjin për Qeverinë.

Sa i përket amendamenteve që i ka dhënë profesor Sabri Hamiti, ne kryesisht, kuptohet raportuesi dhe deputetët tjerë, kemi pasur parasysh nenin 96 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës për strukturën e Qeverisë, që unë mund ta lexoj nëse është e nevojshme:

“Ministritë dhe organet tjera ekzekutive themelohen sipas nevojës për kryerjen e funksioneve brenda kompetencave të Qeverisë”. Ne në këtë jemi bazuar dhe nuk e kemi kufizuar numrin e anëtarëve të Qeverisë. Faleminderit, shumë!

KRYETARI: Urdhëro, deputet Hamiti!

SABRI HAMITI: Zoti kryetar, faleminderit!

Zoti kryetar i komisionit, faleminderit që ma dhe shansin t’i shpjegoj edhe pak sendet.

Unë e njoh shumë mirë Rregulloren, se jam këtu në katër legjislatura. Vend më i madh e më i fortë të paraqiten amendamentet se në seancë, nuk ka. Sepse, edhe atë që po thoni ju, keni votuar, Komisioni i tëri bashkë, ju bëftë mirë! Shumë mirë që jeni bërë një zë bashkë, mua kjo s’më pengon, por edhe ai bashkallak i juaji, nëse s’e voton Kuvendi, është nulë – zero, kështu që harroje Rregulloren, i di të gjitha unë ato.

Prandaj, dola edhe sot që këtu ta riaktualizoj çështjen që unë e mendoj fundamentale. Dhe, harroni ligjet, sepse është bërë një zakon nëpër mendë të hartohen ligjet duke pasur parasysh jo kryeministrin aktual, jo ministrat e resorëve. Nuk kanë të bëjnë veç me këtë qeveritë. Kjo farë sëmundje, ekziston prej fillimit. Ne po bëjmë ligj sistemor për një Qeveri të Kosovës dhe unë në këtë kuptim po flas për të. Cilado qoftë ajo garniturë që bën qeveri të Kosovës, duhet t’i përgjigjet Kuvendit në dy-tri pikat të cilat i theksova unë, sepse përndryshe, qeveritë bëhen arbitrare, dhe deri të bien në mend për ta hequr, sherri bëhet i madh.

Këtu është pse unë po insisto, s’ka të bëjë me një qeveri ose me filanin, ose me një ministri, ose fistekun.

Edhe numri, ju e cituat atë ligj – të 96-in. Citoni edhe 93-shin, të fillimit, po ekziston logjika e punëve, sepse lexoni ju nenin 3 - çka ju thotë. Atje ju kufizon, nëse është me 13 – çka ndodhë? Pse ju kufizon? Se është prapë një pjesë e Kushtetutës së Kosovës që përfaqësimin e ka të detyruar në Qeveri.

Unë nuk po e prek atë, po edhe tjetrën herë kam thënë – proporcionet, se ju e di që jeni të shkencave ekzakto, e dini. Ti mund ta bësh 1 me 2, dhe 100 me 200, është njësoj, po ta bësh 100 me 200, s’ke t’u japësh bukë. Kështu që, unë po shoh logjikisht që ka njëfarë mirëkuptimi për idetë që i kam unë. Nëse ju mendoni se ka mundësi të rishihen, merret, tërhiqet ai komision, i sheh, është krejt e drejtë kjo vazhdojmë me ligjet tjera, ose lihet për një herë tjetër, por nuk ka nevojë për formalitete e të mos bëjmë punë të mira. Ky është qëndrimi im. Faleminderit shumë! Po, ajo a ka qenë, se ju thatë Sadriu... mua s’më bën përshtypje ajo, a ka qenë Sadriu atje. Ky është Kuvend. Ne po bëjmë ligje për Kosovën, jo për grupe parlamentare. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Një herë po ia jap fjalën kryetarit të Grupit Parlamentar, zotit deputet Adem Grabovci.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryetar!

Ne jemi duke diskutuar për Ligjin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, duke pasur parasysh rëndësinë dhe qëllimin tonë të mirë që të kemi vërtet një ligj sa më të mirë, sa më të kompletuar, unë kisha kërkuar, kryetar mirëkuptim prej të gjithëve dhe kisha kërkuar një pauzë të shkurtër që ne t'i harmonizojmë këto qëndrime dhe ky ligj të ecën dhe të jetë i pranueshëm për të gjithë.

(Ndërhyrje)

Unë, po kërkoj Idriz, një pauzë të shkurtër!

KRYETARI: Nëse doni, secilit deputet do t'ia jap fjalën.

Deputeti Idriz Vehapi e ka fjalën.

IDRIZ VEHAPI: Kryetar, faleminderit shumë që më dhatë mundësinë...

Edhe deputetëve, të gjithë tjerëve po iu drejtohem, po edhe profesorit, po. Për mua ka rëndësi përbërja e komisioneve dhe e njerëzve që i udhëheqin ato grupe, ka rëndësi, sepse e çmoj punën e secilit.

Dhe unë thashë, veçova se jemi në leximin e dytë, përpos profesorit Hamiti që ka dhënë amendamente në lexim të parë, tjetërkush nuk ka dhënë amendamente, as konform Rregullores, as konform dokumenteve tjera.

Po dua të them edhe diçka, le ta harrojmë dikush se vetëm dikush i kupton rregulloret ose dokumentet tjera të Qeverisë ose të Kuvendit, i kuptojnë edhe tjerët.

Unë po them edhe një herë, ato amendamente që i kemi dhënë në projektligj i kemi votuar të gjithë njëzëri. Pra, të gjitha amendamentet dhe të gjithë. Faleminderit shumë!

KRYETARI: Faleminderit!

(Ndërhyrje)

Jo, unë e kam një rend të ditës këtu, do të shkoj sipas radhës.

(Ndërhyrje)

Po, mocionin e kryetarit të Komisionit, e kemi si mocion.

Kush është për ta bërë një pauzë deri në orën 14:00?

Atëherë, kush është “për”?

Shumica!

A ka “kundër”?

Pauzë ka kërkuar, mocionin kemi të drejtë ta qesim në votim, Kuvendi vendosi.

Pra, një pauzë deri në orën 14:00.

Vazhdimi i seancës pas pauze

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Po fillojmë seancën. Në sallë janë prezent 73 deputetë.

E kam një sqarim, sa i përket Rregullores për qasjen e mediave në Kuvend. Rregullorja është e përgatitur nga Administrata dhe është miratuar nga Kryesia dhe mendim kundër në Kryesi nuk ka pasur, andaj i kisha lutur përfaqësuesit e grupeve parlamentare mos ta politizojnë një çështje e cila konsideroj se është mbi bazën e normave që duhet të ekzistojnë dhe mbi bazën e standardeve. Ne shpesh po thirremi në standarde dhe konsideroj se Rregullorja e Punës e Kuvendit është mbi bazën e standardeve që ekzistojnë në të gjitha parlamentet edhe të rajonit, edhe të Bashkimit Evropian.

(Ndërhyrje)

E kam fjalën për Rregulloren lidhur me qasjen e gazetarëve në Kuvend. Sa i përket qasjes së gazetarëve në Kuvend, është miratuar Rregullorja nga Kryesia, pa ndonjë mendim të kundërt, nga përfaqësuesit e grupeve parlamentare në Kryesi

Çështje tjetër, pa debat. E keni harxhuar debatin. Unë, shqip po flas! Sa i përket ligjit: - Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nga disponimi i diskutimeve dhe nga gatishmëria, po më duket, e gjithë deputetëve, e lamë këtë çështje për t'u konsultuar dhe për ta miratuar në Vitin e Ri 2012.

A jeni dakord?

Kush është “për”? Faleminderit!

A ka “kundër”? Faleminderit!

Me shumicën e votave, shtyhet miratimi i Ligjit për Qeverinë e Republikës së Kosovës.

Vazhdojmë me pikën e radhës:

18. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për dhënien e dekoratave nga Presidenti i Republikës së Kosovës

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për dhënien e dekoratave nga Presidenti i Republikës së Kosovës dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Ftoj kryetarin e Komisionit funksional për Legjislacion, deputetin Arben Gashi, që para deputetëve ta arsyetojë raportin me rekomandime.

(Ndërhyrje)

Mirë, atëherë deputeti Gashi ia delegon përgjegjësinë deputetit Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Zoti e bekoftë! Faleminderit, shumë!

Komisioni për Legjislacion i ka paraqitur amendamentet, të cilat janë miratuar edhe nga Grupi punues, edhe nga Komisioni, me përkrahje edhe të komisioneve tjera.

Amendamenti 8, është propozim nga Komisioni për Buxhet e Financa, të cilin e falënderojmë që për herë të parë e kanë bërë një propozim konstruktiv dhe që bie në harmoni edhe me Komisionin për Legjislacion dhe ju ftojme që edhe këtë amendament ta votoni, kështu që mund të procedoni dhe ky ligj duhet të miratohet. Faleminderit!

KRYETARI: Mendoj se nuk ka nevojë për kryetarë të grupeve parlamentare. Do të shkojmë amendament për amendament.

Amendamenti 1.

A ka ndokush “kundër” për amendamentin 1?

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Amendamenti 2.

A ka “kundër”? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Amendamenti 3.

A ka “kundër”? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Amendamenti 4.

“Kundër”, nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Amendamenti 5.

“Kundër”? Nuk ka.

Abstenim, nuk ka.

Miratohet.

Amendamenti 6.

“Kundër”? Nuk ka.

Abstenim, nuk ka.

Miratohet.

Amendamenti 7.

A ka “kundër”? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Amendamenti 8.
A ka “kundër”? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka.
Miratohet.

Amendamenti 9.
“Kundër”, nuk ka.
Abstenim? Nuk ka.
Miratohet.

Tani, prezentë kemi 88 deputetë. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash tekstin në tërësi.

Konstatohet se me 72 vota “për”, 4 “kundër”, asnjë “abstenim”, Kuvendi miratoi Ligjin për dhënien e dekoratave nga Presidenti/Presidentja e Republikës së Kosovës.

Vazhdojmë me pikën e radhës:

19. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për organizmat e modifikuar gjenetikisht

Komisioni parlamentar për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor e ka shqyrtuar Projektligjin për organizmat e modifikuar gjenetikisht dhe Kuvendit i ka rekomanduar që ky projektligj të mos miratohet në shqyrtim të dytë.

Ftoj kryetarin e komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, deputetin Nait Hasani, që para deputetëve ta arsyetojë raportin me rekomandime. Fjalën e ka deputeti Nait Hasani.

NAIT HASANI: Përsëritje, kryetar!

Komisioni më 12 dhjetor ka dhënë rekomandimin që Qeverisë ose Ministrisë t’i kthehet apo të mos miratohet ky ligj për shqyrtimin e dytë, me arsyetimin se eksperti ynë që e kemi pasur, ai na ka dhënë sugjerimet se ky ligj nuk i plotëson kushtet për miratim.

Ky ligj e ka vetëm një fushë të zbatimit të tij, ndërsa tri fushat tjera të organizmave nuk i plotëson, kështu që eksperti ynë ka kërkuar që të kthehet dhe bashkë me Ministrinë jemi pajtuar që të kthehet ky ligj për harmonizim dhe plotësim të mëtijshëm. Nëse ka nevojë, mund ta lexoj edhe raportin e ekspertit, por besoj se kjo është e mjaftueshme.

KRYETARI: Ne, mbështetemi në raportin e Komisionit. Mirë, atëherë ta kemi një votim formal.

Kush është për kthimin e këtij projektligji Qeverisë? Shumica absolute.
A ka “kundër”? Nuk ka.

Konstatohet se Kuvendi miratoi rekomandimet e Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor që Projektligji për organizmat e modifikuar gjenetikisht të mos miratohet në shqyrtimin e dytë dhe t'i kthehet Qeverisë.

Vazhdojmë me pikën e radhës:

20. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij, me amendamentet e propozuara.

Ftoj kryetarin e Komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, deputetin Nait Hasani, që para deputetëve ta arsyetojë raportin me rekomandime. Fjalën e ka deputeti Nait Hasani!

NAIT HASANI: Përhëndetje, kryetar!

Komisioni e ka shqyrtuar Projektligjin për shitjen e banesave ose të drejtën banesore, e ka amendamentuar këtë ligj dhe i ka pasur parasysh edhe analizat e ekspertit dhe të komisioneve dhe kemi arritur në përfundim se ky ligj i plotëson të gjitha kushtet për vazhdim në seancë, në lexim të dytë. Ne i kemi amendamentuar me 4 amendamente dhe kërkojmë që të procedohet për Kuvend dhe të miratohet.

KRYETARI: Faleminderit! Për diskutim është paraqitur deputeti Goran Marinković.

GORAN MARINKOVIĆ: Hvala, predsjedniče!

Komisija za prava i interese zajednica, na sednici održanoj 18.11.2011. godine razmatrala je Nacrt zakona br. 04/952/L-61 o prodaji stanova za koje postoji stambeno pravo, sa predloženim amandmanima. Funkcionalna komisija za poljoprivredu, šumarstvo, ruralni razvoj i prostorno planiranje je preporučila povlačenje Nacrta zakona iz dalje procedure i vraćanje Nacrta zakona predlažu.

Bazirajući se na angažovanje i spoljnu ekspertizu eksperta Evropske komisije, koji je radio na ekspertizi zakona u vremenu od 24 do 28.10.2011. godine, a u skladu sa članom 65.3 Poslovnika Skupštine i delokruga rada komisije koji se odnosi na prava i interes zajednica, Komisija je konstatovala i procenila da se izmenom više od 50% zakonske materije i stambene imovinsko-pravne odnose kojim se uređuje ovaj nacrt zakona ne postiže cilj zakona, pa s toga preporučuje da se Nacrt zakona vrati predlažu.

Moram da napomenem da i ostale stalne komisije nisu donele i dale zeleno svetlo da ovaj zakon dođe na Skupštinu. Hvala!

KRYETARI: Fjalën e ka kryetari i Komisionit, Nait Hasani, pastaj Liburn Aliu.

NAIT HASANI: Po, kryetar,

Ne kemi qenë dhe kemi marrë raportin e Komisionit funksional për Komunitete dhe në raport, në pikën e parë të raportit thuhet që ky ligj nuk i cenon të drejtat e pakicave në Kosovë. Dhe, në pikën e dytë, po ashtu ky ligj thotë se ka ndryshime.

Eksperti i cili i ka bërë këto ndryshime, e që e kemi pasur drejtpërdrejt në takim, bashkë me kolegen, edhe Safetja ka qenë kryetare e Komisionit për Buxhet, ai na thotë neve që ky ligj nuk i cenon të drejtat e pakicave, kështu që çdo ligj tjetër dhe çdo pjesë tjetër është e arsyeshme e fuqive politike në Kuvend ta miratojnë ligjin.

Prandaj, deri sa ky ligj nuk i cenon të drejtat e pakicave, unë kërkoj që ky ligj të votohet, të miratohet, sepse nuk është kundër askujt. Prandaj, nëse ky ligj kthehet kështu, në këtë formë, atëherë ligjet tjera janë shumë të cënueshme, shumë janë të diskriminuese. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti, Liburn Aliu e ka fjalën! Le të përgatitet Arben Gashi!

LIBURN ALIU: Po, edhe Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” është njëjtë që ky projektligj të futet në votim, të mos shtyhet. Si Komision e kemi trajtuar. Po ashtu, pajtohem me të njëjtën vërejtje që e dha deputeti Nait Hasani. Aty thotë shumë qartë se nuk i cenon të drejtat e komuniteteve dhe rrjedhimisht nuk ka arsye pse të shtyhet, prandaj ai duhet të hidhet në votim menjëherë.

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti, kryetari i Komisionit për integritet evropian, Lutfi Haziri!

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, kryetar!

Vetëm sa për konfirmim, Komisioni për Integritet Evropian e ka trajtuar mbi bazë të komisionit funksional me amendamente dhe në asnjë rast nuk bie ndesh me acqui communautaire apo standardet tjera që parasheh mandati i Komisionit për Integritet Evropian. Pra, mund të procedohet.

KRYETARI: Faleminderit! Arben Gashi, kryetar i Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi.

ARBEN GASHI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Komisioni për Legjislacion e ka shqyrtuar këtë ligj me kujdes të veçantë dhe ka konstatuar se ky ligj nuk bie në kundërshtim me ligjet tjera pozitive në Kosovë dhe, për pasojë, nuk bie në kundërshtim as me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe i ka rekomanduar seancës që ta aprovojë. Faleminderit!

KRYETARI: Urdhëro, Adem! E ka fjalën kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, Adem Grabovci.

ADEM GRABOVCI: Grupi Parlamentar i PDK-së e përkrah kërkesën që ky ligj të shtyhet për seancën e radhës.

KRYETARI: Tash e kemi një mocion dhe ne e votojmë mocionin e pastaj e votojmë ligjin. Do të thotë, ky është rendi. Shikojeni Rregulloren, unë nuk jam i obliguar për t'ua dhënë arsyetimin. Pra, e kemi mocionin e një grupi parlamentar dhe ne e qesim në votim. Dhe, nëse i merr votat, e shtyjmë.

Atëherë, shkojmë në votim elektronik. Ju lutem, nuk ka më fjalë! E kemi mocionin, pa debat.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe e votojmë kërkesën e kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike për ta shtyrë ligjin. Votojmë tash! Shikoni, deputetë, unë jam këtu dhe kryetari e ka të drejtën për ta interpretuar Rregulloren. Prandaj, ju lus ta lexoni Rregulloren dhe kjo ju tregon shumë mirë kush e interpreton Rregulloren.

Për mocionin kanë votuar 36 deputetë, “kundër”, 46, 1 ka abstenuar, mocioni nuk shkon. Ne shkojmë në votimin e amendamenteve. Edhe amendamentet do t'i votojmë me elektronikë.

Amendamenti 1.

Konstatohet se me 61 vota “për”, 13 “kundër”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 1.

Amendamenti 2.

Me 64 vota “për”, 11 “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 2.

Amendamenti 3.

Me 62 vota “për”, 9 “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 3.

Amendamenti 4.

Edhe amendamenti 4, me 65 vota “për”, “kundër” 9, 1 abstenim, miratohet.

Tani e votojmë Ligjin në tërësi. Votojmë, tash!

Me 68 vota “për”, 12 “kundër”, asnjë abstenim, Kuvendi e miratoi Ligjin për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore.

Ju falënderoj!

Jemi në procedurë të votimit dhe kisha kërkuar të jeni më të disiplinuar. Vazhdojmë me pikën e radhës:

21. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij, me amendamentet e propozuara.

Ftoj raportuesin e Komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të Forcës së Sigurisë së Kosovës, deputetin Anton Quni që para deputetëve ta arsyetojë raportin me rekomandime. Deputet, e ke fjalën!

ANTON QUNI: Faleminderit, zoti kryetar!

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të Forcës së Sigurisë së Kosovës, në bashkëpunim dhe në konsultime me Ministrinë e Punëve të Brendshme, përfaqësuesit e EULEX-it, ICITAP-it dhe të tjerë jemi dakorduar që në këtë projektligj të ndërhyjmë me gjithsej 8 amendamente, andaj kërkojmë që këto amendamente të votohen, duke besuar se Ligji do të jetë i implementueshëm, funksional dhe praktik. Faleminderit!

KRYETARI: Jemi në procedurë të votimit, deputetët nuk duhet të lëvizin shumë dhe, kur t'i votojmë amendamentet, mos bëni zhurmë se pastaj po ankoheni, nuk po dimë çka po votojmë!

Amendamenti 1.

A ka kundër?

Abstenime? Nuk ka.

Miratohet amendamenti 1.

Amendamenti 2.

A ka kundër? Nuk ka.

Abstenim, nuk ka.

Miratohet.

Amendamenti 3.

A ka kundër? Nuk ka.

Abstenim, nuk ka.

Miratohet.

Amendamenti 4.

A ka kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Amendamenti 5.

A ka kundër?

Abstenime? Nuk ka.

Miratohet.

Amendamenti 6.

A ka kundër? Nuk ka.

Abstenim, nuk ka.

Miratohet.

Amendamenti 7.
A ka kundër? Nuk ka.
Abstenim, nuk ka.
Miratohet.

Amendamenti 8.
A ka kundër? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka.
Miratohet.

Tani e votojmë Ligjin në tërësi.
78 deputetë janë prezent në sallë. Votojmë, tash!

Me 69 vota “për”, 2 “kundër”, 2 abstenime, Kuvendi miratoi Ligjin për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror. Faleminderit!

Vazhdojmë me pikën e radhës:

22. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për sportin

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për sportin dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij, me amendamentet e propozuara.

Ftoj kryetarin e Komisionit funksional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, deputetin Idriz Vehapi, që para deputetëve ta arsyetojë raportin me rekomandime.

IDRIZ VEHAPI: Faleminderit, zoti kryetar!
Të nderuar deputetë,
Komisioni funksional e ka shqyrtuar Projektligjin dhe ka i ka dhënë amendamentet e tij. Po ashtu, këtë projektligj e kanë shqyrtuar edhe komisionet e përhershme, të cilat nuk kanë dhënë vërejtje.

Projektligji i përmban gjithsej 10 amendamente. Amendamenti 6 dhe amendamenti 9 i kanë nga 2 propozime, njëri është i Komisionit, me përkrahje ,dhe propozimi i dytë është i deputetit Bekim Haxhiu, që nuk e ka pasur përkrahjen në Komision.

Dhe, një përmirësim. Amendamenti 10 është i propozuar nga deputeti Bekim Haxhiu dhe e ka pasur përkrahjen e komisionit funksional. Faleminderit!

KRYETARI: Atëherë, votojmë amendament për amendament.

Amendamenti 1.
“Kundër”? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.
Miratohet.

Amendamenti 2.
“Kundër”? Nuk ka.
Abstenim, Nuk ka.
Miratohet.

Amendamenti 3.
“Kundër”? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka.
Miratohet.

Amendamenti 4.
“Kundër”? Nuk ka.
Abstenime? Nuk ka.
Miratohet.

Amendamenti 5.
“Kundër”? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka.
Miratohet.

Amendamenti 6.
I kemi dy propozime, Komisioni funksional dhe deputeti Bekim Haxhiu, pa përkrahjen e komisionit funksional. Urdhëro, fjalën e ka deputeti Bekim Haxhiu!

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Amendamenti i propozuar nga ana ime ka të bëjë me rregullimin e çështjes së pronësisë së stadiumeve të futbollit dhe kjo çështje mendoj se do të duhej të zgjidhej për shkak se në formën çfarë unë kam propozuar në amendamentin 6 dhe jo në formën çfarë e ka propozuar komisioni. Arsyeja është për shkak se pronësia e objekteve dhe mjediseve sportive përcaktohet me ligj në fuqi, në bazë të asaj çfarë e ka përcaktuar komisioni, me çka ne kemi deri tash të paraparë, sidomos që kjo çështje nuk është e rregulluar në këtë formë dhe duke pasur parasysh se ky Parlament tani ka në shqyrtim edhe Ligjin për RTK-në dhe në bazë të Ligjit për RTK-në parashihet që pronësia e Radiotelevizionit të Prishtinës t’i jepet një entiteti tjetër – tani Radiotelevizionit të Kosovës, ndërsa te çështja e stadiumeve të futbollit nuk kemi ndryshim të pronësisë për shkak se klubet e futbollit Prishtina, Trepça, Liria, Besa janë prej vitit 1922 e tutje pronarë dhe menaxhues të stacioneve të futbollit, prandaj nuk kemi ndryshim të njësisë dhe do të ishte mirë që në formën e propozuar nga unë kjo çështje të kalojë dhe të ketë përkrahjen e këtij Kuvendi, me qëllim që t’i jepet një mundësi e investimeve edhe në këtë fushë, e cila deri tani ka mbetur e papërgatitur për arenën ndërkombëtare.

Mendoj që do të ishte mirë që tani këto stadiume të kenë një pronar dhe një përkatësi të definuar qartë me anë të këtij ligji dhe prapëseprapë i mbetet komisionit gjegjës, Komisionit për Arsim e Kulturë, bashkë me Ministrinë e Sportit që të merret me këtë problem në të ardhmen. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Krahasime nuk është mirë të bëhen. Deputetët i kanë amendamentet dhe do të votojnë sipas bindjeve të tyre. Sipas radhës, ne e qesim amendamentin e propozuar nga komisioni funksional dhe votojmë tash, amendamentin 6/a.

Me 56 vota “për”, 8 “kundër”, 2 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 6/a.

Amendamentin 7,

I propozuar nga deputeti Bekim Haxhiu, me përkrahjen e komisionit funksional. Votojmë tash!

Me 57 vota “për”, 15 “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 7.

Amendamentin 8, i Komisionit funksional.

Me 63 vota “për”, 2 “kundër”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 8.

Amendamentin 9,

Kemi dy propozime: të komisionit funksional dhe deputetit Bekim Haxhiu, pa përkrahjen e komisionit funksional. Fjalën e ka deputeti Bekim Haxhiu, mundësisht shkurt.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Problemi i paraqitur në ligj mendoj se do një thellim më të gjerë dhe një përkrahje vërtet të deputetëve për shkak se ka të bëjë me propozimet të cilat do ta luftojnë një dukuri prezente në sportin e Kosovës, që ka të bëjë me huliganizmin.

Unë edhe në Projektligjin për Kodin Penal më herët kam parashtruar si amendamente në diskutimin tim që të përfshihen edhe në Kodin Penal të Kosovës dënimet për persona të cilët bëjnë delikte në sport dhe të cilët vërtet po e dëmtojnë sportin e Kosovës dhe në veçanti anëtarësimin në organizmat ndërkombëtarë dhe po ua marr vetëm nja dy pika, të cilat janë të propozuara këtu dhe të cilat mendoj se do të përfshihen edhe në Kodin Penal dhe është mirë që të jenë pjesë edhe e Ligjit për sport dhe ka të bëjë me hedhjen, për shembull, të gjësendeve në fushë, ku personat të cilët bëjnë delikte të tilla dënohen me 200 e më tepër euro, apo edhe personat të cilët i ndërprejnë aktivitetet garuese, të cilët do të duhej të dënoheshin me 6 muaj burgim, e cila pastaj do të parashihet edhe me Kodin Penal të Kosovës.

Kërkoj përkrahje nga ky Kuvend që kjo dukuri negative, huliganizmi në sport, të sanksionohet me Ligjin për sport dhe me Kodin Penal të Kosovës dhe për këtë do të kërkoja përkrahje nga ana e Kuvendit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Dëgjua arsyetimin. Megjithatë, ne i kemi dy propozime dhe ne e votojmë propozimin e komisionit funksional, dhe votojmë tash, me elektronikë:

Me 58 vota “për”, 13 “kundër”, 1 abstenim, Kuvendi miratoi amendamentin 9 të komisionit funksional.

Vazhdojmë. E kemi edhe një amendament.

Amendamenti 10.

Votojmë tash:

(Mungon konstatimi i rezultatit të votimit të amendamentit 10)

Me 69 vota “për”, 2 “kundër”, 1 abstenim, Kuvendi miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për sportin. Faleminderit!

Në vazhdim, kemi:

23. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural dhe Mjedis e Planifikim Hapësinor për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për tokën bujqësore

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor e ka mbikëqyrur zbatimin e Ligjit për tokën bujqësore dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime.

(Ndërhyrje)

Mirë! Faleminderit! Pra, më parë e votuam amendamentin 10, tash e votojmë Ligjin në tërësi dhe votojmë tash:

Regjia, e votojmë ligjin në tërësi – Ligjin për sportin, ndryshimet!

Faleminderit, edhe një herë po them. Me 69 vota “për”, 2 “kundër”, asnjë abstenim, Kuvendi i miratoi ndryshimet dhe plotësimet në Ligjin për sportin.

Për pikën 23, fjalën e ka Nait Hasani.

NAIT HASANI: Faleminderit, kryetar!

Në emër të Komisionit, për raportin flet Nijazi Idrizi. Unë flas në emër të Grupit Parlamentar.

KRYETARI: Kush e ka fjalën? E ka fjalën deputeti Nijazi Idrizi!

NIJAZI IDRIZI: I nderuari kryetar,
Të nderuar deputetë,

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, në bazë të nenit 73 të Rregullores së Kuvendit e ka mbikëqyrur zbatimin e Ligjit Numër 02/26 për tokën bujqësore dhe në mbledhjen e mbajtur më 29.11.2011, pasi shqyrtoi procesin e mbikëqyrjes, vendosi që Kuvendit t'i paraqet këtë:

REKOMANDIM

Për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit mbi tokën bujqësore.

Bujqësia në vendin tonë është aktivitet më i rëndësishëm ekonomik, ku shumica e fermerëve sigurojnë ekzistencën për ekonomitë familjare në toka bujqësore. Rreth 25% të GDP dhe rreth 16% të eksportit me rreth 30% të punësuarve arrihet nga ky sektor.

Mbrojtja dhe shfrytëzimi i qëndrueshëm i tokës bujqësore është interes strategjik i Kosovës, për arsye se ajo mund të japë efekte të shumëfishta për zhvillimin e sektorit agro-rural, hapjen e vendeve të reja të punës dhe krijimin e mirëqenies për popullsinë.

Për shkak të brengave të institucioneve dhe të opinionit të gjerë për aktivitetet e paligjshme që po zhvillohen në tokën bujqësore, Komisioni për Kujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, në mbledhjen e mbajtur më 3 maj 2011 vendosi ta mbikëqyrë zbatimin e Ligjit Numër 2002/26 për tokën bujqësore, si dhe të themelojë Grupin e punës.

Komisioni ka hartuar Planin e veprimit për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit, të cilin e ka realizuar gjatë periudhës maj-tetor 2011.

Gjatë kësaj periudhe janë realizuar një varg vizitash në terren, takime me institucione qendrore, komunale dhe me institucione të tjera, si dhe ka organizuar dëgjim publik.

Mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit për tokën bujqësore ka pasur për qëllim vlerësimin e nivelit të zbatimit të Ligjit për efektet që i ka dhënë ai për kujdesin ndaj tokës bujqësore. Raporti është i bazuar në të gjeturat nga terreni, në të dhënat e grumbulluara nga palët në interes, si ato publike, të shoqërisë civile, ndërmarrjet private dhe organizatat ndërkombëtare.

Në kuadër të këtij vlerësimi, Komisioni ka bërë vlerësimin e kornizës së politikave, vlerësimin e kornizës ligjore, vlerësimin e kornizës institucionale dhe të resurseve njerëzore. Metodologjia nëpërmjet të cilës janë realizuar aktivitetet e mbikëqyrjes janë këto: hartimi i pyetësorit për Ministrinë e Bujqësisë, për komunat, organizimin e takimeve të rregullta të grupit të punës; vizitat e ndryshme nëpër komuna, Ministri të Bujqësisë, Ministri të Mjedisit, Agjencionit Kadastral të Kosovës, Fakultetin e Bujqësisë, Veterinarisë, Institutin Bujqësor të Pejës, e tjera. Po ashtu, edhe në stratin e lumit Drin, organizimin e dëgjimit publik me të gjitha palët në interes për të dëgjuar opinionit të tyre rreth zbatimit të këtij ligji.

Gjatë mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit, Komisioni ka hasur në vështirësi të mëdha për grumbullimin e të dhënave të nevojshme, pasi që Ministria e Bujqësisë dhe shumica e komunave nuk i posedojnë ato të dhëna dhe për këtë arsye nuk iu kanë përgjigjur pyetësorëve të dërguar nga Komisioni.

Duke marrë parasysh të gjeturat në infrastrukturën ligjore nga vizitat e realizuara në terren, nga raportet e ndryshme për shfrytëzimin e tokës bujqësore, Komisioni ka konstatuar se Ligji për tokën bujqësore është duke u zbatuar shumë pak dhe me këtë rast nxjerr këto përfundime dhe lëshon këto përfundime:

1. Ligji për tokën bujqësore paraqet bazën e mjaftueshme ligjore për shfrytëzimin dhe mbrojtjen e tokës bujqësore, ndërsa zbatimi i tij mbetet brenga kryesore e tij.
2. Udhëzimi administrativ Numër 33 për zbatimin e Ligjit për planifikimin hapësinor, për elementet themelore të planit zhvillimor të komunës nuk përcakton në mënyrë adekuate çështjet e planifikimit rural.
3. Udhëzimi administrativ Numër 41/26 për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore nuk është i harmonizuar me Ligjin për tokën bujqësore dhe me Ligjin për qeverisjen lokale.
4. Vlerësohet se çdo vit në Kosovë humbën më shumë se 1.000 hektarë tokë bujqësore.
5. Segmentimi i tokës bujqësore po vazhdon me ritëm të shtuar.
6. Vonimi në hartimin e planeve zhvillimore komunale nga komunat është njëri nga faktorët kyç në ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore.
7. Disa komuna nuk kanë kërkuar pëlqim nga Ministria e Bujqësisë me rastin e ndërrimit të destinimit të tokës bujqësore, të klasave I deri në IV.
8. Disa komuna nuk kanë marrë pëlqim nga Ministria e Mjedisit për planet zhvillimore komunale.
9. Ministria e Mjedisit në kundërshtim me Ligjin për tokën bujqësore ka lëshuar pëlqime për planet zhvillimore komunale, për zgjerimin e zonës urbane në tokat bujqësore në komasacion dhe ato nën ujë.
10. Mekanizmat dhe kapacitetet ekzistuese institucionale njerëzore dhe financiare në nivel qendror dhe komunal nuk janë treguar efikas në mbrojtjen e tokës bujqësore, ndër të tjera edhe për shkak të mungesës së koordinimit adekuat ndër-institucional.

11. Privatizimi i tokës bujqësore nga ana e Agjencisë Kosovare të Privatizimit në shumicën e rasteve është bërë pa program investiv të tenderuesve dhe pa monitorim të këtij programi pas privatizimit.
12. Mbështetja e fermave në subvencione dhe grante ka dhënë efekte pozitive në shfrytëzimin dhe ruajtjen e tokës bujqësore.
13. Shumica e komunave nuk mbajnë evidencë për tokën e pa punuar bujqësore, tokën e dhënë në shfrytëzim dhe tokën të cilës i është ndërruar destinimi i shfrytëzimit dhe nuk raportohen tek Ministria e Bujqësisë.

Rekomandime:

1. Ministria e Mjedisit të plotësojë udhëzimin administrativ Numër 33 për zbatimin e Ligjit për planifikim hapësinor, për elementet themelore të planit zhvillimor të komunave, që të përcaktojë në mënyrë obliguese planifikimin në zonat rurale dhe kriteret e këtij planifikimi.
2. Të amendamentohet Udhëzimi administrativ Numër 41/2006 për Ligjin për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, që të harmonizohet ky ligj me Ligjin për qeverisjen lokale në pjesën e shqyrtimit të kërkesave për ndërrimin e destinimit dhe organeve përgjegjëse që do ta bëjnë këtë.
3. Komunitat sa më shpejt t'i nxjerrin planet zhvillimore komunale në fshatra.
4. Ministria e Mjedisit, Ministria e Bujqësisë, të ndihmojnë komunitat në përgatitjen e tyre dhe aftësimin e zyrtarëve komunal për hartimin e këtyre planeve. Komunitat para aprovimit të planit zhvillimor të kërkojnë pëlqim nga Ministria e Bujqësisë, sipas ligjit. Në raste të mos kërkit të pëlqimit, Ministria e Bujqësisë të njoftojë Qeverinë e Kosovës, si dhe të iniciojë procedurat për mos zbatimin e Ligjit.
5. Të zgjerohet dhe të funksionalizohet Komiteti ndërministror për administrimin e tokës së Kosovës, i cili duhet të merret me hartimin dhe harmonizimin e politikave sektoriale për administrimin dhe menaxhimin e tokës bujqësore.
6. Të themelohet Fondi i tokës për bujqësi.
7. Gjykatat t'i japin prioritet lëndëve që kanë të bëjnë me tokën bujqësore.
8. Ministria e Bujqësisë, bashkë me komunitat të angazhohet në organizimin e fushatave senzibilizuese për mbrojtjen e tokës bujqësore.
9. Ministria e Bujqësisë të ketë një përfaqësues anëtar në Bordin udhëheqës të Agjencionit Kosovar të Privatizimit.

Zbatueshmëria e Ligjit:

Duhet të ndërmerren masat për mbrojtjen e tokës bujqësore nga ndotja për zbatimin e Ligjit për tokën bujqësore.

Inspektorët e tokës të Ministrisë duhet të angazhohen maksimalisht në inspektimin e zbatimit të Ligjit për tokën bujqësore dhe të mos angazhohen në detyra tjera shtesë që nuk kanë të bëjnë me shfrytëzimin dhe mbrojtjen e tokës bujqësore.

Inspektorët e tokës të Ministrisë së Bujqësisë dhe inspektorët e bujqësisë të komunave, në rastet e ndërtimeve pa leje në tokën bujqësore, përmes inicimit të procedurës gjyqësore duhet të propozojnë edhe masat mbrojtëse, konfiskimin e lëndës së përdorimit për kundërvajtje dhe konfiskimin e pasurisë e cila arrihet si rezultat i kundërvajtjes.

Dëshiroj të theksoj se mbi tokën bujqësore gjatë këtyre viteve është bërë krim dhe kjo nuk është më e keqja. Më e keqja është se ne të gjithë, edhe institucionet, edhe qytetarët kemi qenë shumë indiferentë ndaj kësaj dukurie.

Kjo do të lë pasojë në brezat që do të vijnë pas nesh. Faleminderit!

KRYETARI: Ju e keni bërë një punë të mirë, por ajo “duhet” nuk e di a është obligative a jo? Është mirë që gjuha juridike nuk lë edhe mundësi. Do të thotë, është pak më e prerë. Nëse ju keni marrë këto përfundime, do rekomandime shumë, ndoshta është dashur më pak, por të jenë obliguese, obligative dhe jo “duhet”. Sepse, kjo “duhet” edhe “s’duhet”, mund të bëhet.

Fjalën e ka kërkuar deputetja Afërdita Berisha-Shaqiri.

AFËRDITA BERISHA-SHAQIRI: Faleminderit, kryetar!

Në bazë të Rregullores së Punës të Kuvendit të Kosovës, Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor ka autoritet të mbikëqyrë zbatimin e ligjeve.

Komisioni ynë ka bërë zbatimin dhe monitorimin e Ligjit mbi tokën bujqësore për shkak të brengës së institucioneve dhe opinionit për aktivitete të paligjshme që po zbatohen në tokën bujqësore.

Komisioni në raport është munduar të paraqet gjendjen reale të tokës bujqësore. Shpresojmë se ky raport do të ndikojë në sensibilizimin e opinionit për ndërgjegjësimin e institucioneve dhe të qytetarëve që të ruajnë tokën bujqësore dhe të zbatojnë Ligjin në fuqi.

Disa nga përfundimet dhe rekomandimet i dha kryetari i Grupit punues, ndërkaq më gjerësisht ju mund t’i gjeni në raportin e hartuar nga Komisioni ynë. Lidhja Demokratike e Kosovës e përkrah këtë raport. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Unë harrova që të ftoj, në emër të Partisë Demokratike, kush e kërkon fjalën?

(Ndërhyrje)

Shumë mirë Nait, por edhe një gjë po e them. Nëse ju keni konstatuar se Ligji nuk zbatohet, realisht, atëherë dikush është përgjegjës për moszbatimin e ligjit dhe është dashur t'i identifikoni edhe ata që nuk janë përgjegjës dhe s'kanë marrë obligime ligjore që duhet të obligohen. Dhe, nëse ne shkojmë vetëm me përfundime dhe rekomandime, prapë mbetet e njëjta gjë dhe atëherë ne krejt kot flasim këtu. Urdhëroni! E ka fjalën, deputeti Nait Hasani!

NAIT HASANI: Faleminderit, kryetar!

Gjatë monitorimit të Ligjit, si Komision kemi hasur në të gjeturat që i prezantoi raportuesi dhe ne e kemi mbështetur dhe e mbështesim këtë raport me të gjitha rekomandimet dhe të gjeturat që i kemi, si Parti Demokratike, në pellgun e Drinit të Bardhë, në Rahovec, Prizren, Gjakovë, që është pjesë e komasacionit, janë rreth 6.000 hektarë prej klasës I deri IV. Aty në sistemin e ujitjes janë pompat, derivatet, pompat e benzinës, restorantet, motelet të cilat janë ndërtuar mbi to.

Po ashtu, është në komunën e Vushtrrisë, po ashtu edhe në Ferizaj, po ashtu edhe në gjithë territorin, thuaja, të Kosovës, kështu që Komisioni ynë i bie këto rekomandime që Kuvendi t'i miratojë dhe marrë masa për zbatimin dhe mbrojtjen e Ligjit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të “Vetëvendosjes”, deputeti Liburn Aliu e ka fjalën!

LIURN ALIU: I nderuar kryetar,

Të nderuar deputetë,

Në lidhje me Raportin me rekomandime dhe mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për tokën bujqësore, do të doja që krahas përkrahjes për këtë raport shqetësues, të përgëzoj edhe anëtarët e Komisionit për punën e bërë dhe ofrimin e të dhënave shqetësuese për fatin e tokës bujqësore, e cila po vazhdon të cenohet në vazhdimësi.

Të dhënat shqetësuese e tejkalojnë opinionin e krijuar nga ajo që thjeshtë mund të vërehet në dukje. Pra, shihet që është gjendje e rëndë, ndërtimet gjithandej e tregojnë këtë, por raporti dëshmon edhe për më keq, edhe për më rënd.

Problemet e identifikuar në administrimin dhe menaxhimin e tokës bujqësore dhe trendi i përkeqësuar në vazhdim, sidomos në ndërrimin e destinimit të tokës, tregojnë se ky problem duhet trajtuar seriozisht. Dhe këtu nuk kemi të bëjmë me mungesë ligjesh, pasi këto hyjnë te pjesa e sukseseve në këtë raport.

Ligjet janë, ato duhet zbatuar dhe për këtë duhet vullnet politik dhe kur flasim për vullnetin politik, nuk duhet shikuar vetëm kah Ministria e Bujqësisë, por në përgjithësi në politikën e Qeverisë, nga e cila për pasojë toka bujqësore shihet nga çdo aspekt tjetër i

përfitim, përpos nga ai bujqësor. Herë shihet si fushë për ndërtim, e herë arrijnë t'i shihet edhe zhavori pa u eksploatuar nën të, por shumë rrallë si fushë që prodhon dhe që prodhonte për shekuj të tërë.

Rreth 1.000 hektarë në vit sipërfaqe nga toka bujqësore shndërrohet në tokë ndërtimi ose dëmtohet për shkak të nxjerrjes së zhavorrit. Është sipërfaqe tejet e madhe në raport me sipërfaqen e vogël të tokës bujqësore. Kjo tokë prodhonte dhe sillte të mira për gjenerata të tëra dhe është e pakuptimtë dhe të jetë shkurtpamëse që për një interes të ngushtë të përkohshëm të një gjenerate të shkatërrohet kjo tokë.

Mos të harrojmë se janë humbur në masë të madhe tokat në të cilat është investuar më parë, siç janë tokat nën komasacion dhe ato nën sistemin e ujitjes dhe në këtë aspekt prinë komuna e Vushtrrisë, Prizreni e Drenasi, ku janë humbur rreth 2.000 deri në 3.000 toka nën ujitje dhe sistemi i ujitjes 30% në pjesën e Prizrenit, respektivisht Dukagjinit. Dhe, për më keq, një proces i tillë po vazhdon edhe më tutje, pra po shkojmë drejt përkeqësimit të mëtutjeshëm.

Në vizitat që Grupi punues i ka bërë nëpër komuna, ku paraprakisht iu ka dërguar pyetësorët, të cilëve do të duhej t'u përgjigjen personat kompetentë nga komunat, çdoherë janë marrë përgjigje të cunguara në formë: po, jo ose nuk ka informacion. Dhe më pastaj është dashur që domosdoshmërisht t'i nxjerrim informacionet përmes bashkëbisedimeve direkte dhe është vërejtur që tek procesi i degradimit të tokave në vazhdim, komunat janë në dijeni, inspektorët dalin në terren, bëjnë raporte dhe padi, mirëpo problemi pikërisht ngec në këtë pikë.

Është vërejtur po ashtu një mos komunikim dhe mos koordinim në mes institucioneve qendrore dhe lokale, raportimet jo të rregullta dhe pa ndërmarrje të koordinuara nga të gjitha institucionet që duhet përfshirë. Mosmiratimi i planeve zhvillimore, dhe në disa raste të planeve zhvillimore pa pëlqim nga Ministria, pastaj ndërrimit të destinimeve me vendime nga komuna, sërish pa pëlqim nga Ministria – të gjitha këto janë ngecjet konkrete që dalin përpara e që dëshmojnë se ngecjet reale janë vullneti politik.

Gjatë punës së Grupit punues në monitorim të këtij ligji, kemi zhvilluar takim edhe me përfaqësues nga Agjencioni Kosovar i Privatizimit. Ajo që bëri më së tepërmi përshtypje, ishte fakti se gjatë privatizimit të tokave bujqësore nuk janë marrë fare parasysh se kush janë blerësit dhe cili do të jetë fati i tokave pas privatizimit. Ata thjeshtë na u përgjigjën – se e jona ishte vetëm t'i shesim dhe atë atij që ofron më tepër. Ky pra ka qenë procesi i privatizimit të tokave.

Kemi pritur për raportim më të gjerë për privatizimin e tokave bujqësore, për ndërmarrjet e mbetura dhe për planin e privatizimit dhe nuk kemi marrë asgjë deri më tani nga ky agjencion. Nga kjo mospërgjigje lë të dyshohet, pra, edhe për parregullsi të tjera.

Privatizimi pa kritere ishte njëri ndër faktorët që ndikoi në humbjen e tokave bujqësore, pra në ndërrimin e destinimit të tyre, pikërisht se ato shumë shpesh iu shitën atyre që nuk i punojnë, por vetëm që duan t'i shesin e t'i stërshesin dhe të bëjnë ndërtim në to.

Gjatë privatizimit të tokave bujqësore nuk është marrë fare parasysh e kaluara, procesi i shndërrimit të këtyre tokave në toka shoqërore, në çfarë periudhe dhe për të cilat motive. Nuk është pyetur asnjëherë kush se kujt i takonte ajo tokë më parë, kush jetonte nga ajo tokë dhe si u mor ajo. Nuk ka pyetur asnjëherë askush nga AKP-ja për periudhën e Rankoviqit, si u quajt më vonë në ish Jugosllavi “periudha e deformimeve”. A e dinë ata që në vitet e 50-ta, në mënyrën se si u trajtuan shqiptarët dhe tokat e tyre në atë kohë dhe faktin pse arma kryesore e dëbimit të shqiptarëve ishte pikërisht marrja e këtyre tokave, duke i shpallur qytetarët shqiptarë si “uzurpatorë” në tokat e veta. Mos të harrojmë se ka pas një proces, që është quajt “proces i deformimit” dhe nuk ka shkuar korrigjimi deri në fund.

A kanë shikuar ata të AKP-së se mos ka edhe konteste tjera pronësore në gjyqe. Rasti i privatizimit, ta zëmë, konkretisht të tokës bujqësore të Kooperativës “Mirusha” në Malishevë, është njëri ndër rastet më të rënda. Qytetarët e fshatit Bellanicë dhe fshatrat përreth janë disa nga viktimat. Në vitin 2009 kjo tokë është privatizuar në vlerë 12 euro për ari. Nuk u morën fare parasysh kontestet gjyqësore që ekzistonin. Pra, u privatizua në kundërshtim me ligjin. Sot kjo kushton shumë më shtrenjtë, dhe në shitje dhe stërshtitje të vazhdueshme banorët e Bellanicës – pronarët legjitimë, pra, të tokës që ua rrëmbeu pushteti jugosllav, mbasin vetëm vëzhgues.

Tani mbi këto toka të privatizuara do të ndërtohet autostrada dhe në pjesët që do të zinet nga autostrada, kompensohet me nga 1.000 euro për ari, dhe ky është një çmim mesatar, ku ka raste të çmimit që paguhet edhe më shtrenjtë. Është privatizuar pra 12 dhe kompensohet 1.000. Ky është marifeti i pasurimit, pra, në këtë Kosovën e lirë sot.

Dhe pjesa e vendit që quhet Dubrava, ku pritet të ndërtohet nyja e autostradës, pra daljet, aty edhe do të kemi sërish ndërtime. Humbje të reja, pra, të tokës bujqësore, po çfarë ironie! Disa shqiptarë shfrytëzojnë rastin dhe e blejnë tokën e lirë, e disa shqiptarë, disa shqiptarëve të tjerë të cilëve pushteti një kohë më parë ua rrëmbeu dhe e dhunojnë atë tokë, e shesin dhe e stërshejin dhe në fund ajo tokë humbë nga ndërtimet. Fshatarët tani protestojnë, duan pronat e tyre dhe shteti nuk qanë konkën fare. Njerëzit pasurohen në kurriz të fshatarëve të varfër dhe nuk ndërmerret asgjë.

Ky pushtet është katandisur në fakt drejt theqafjes së pashmangshme pikërisht si pasojë e shtypjes së interesit të këtyre qytetarëve. Po, ku e zë fillin ky proces? Gjatë takimeve dhe debatit publik që e keni pasur si grup punues, u kuptua që insistimi për privatizimin sa më të shpejtë dhe pa kritere të tokës bujqësore, u bë me këmbëngulje nga UNMIK-u aso kohe. Ekspertë të çështjeve pronësore juridike dhe të bujqësisë aso kohe insistonin që tokat e ndërmarrjeve shoqërore të mos privatizoheshin, pasi në të ardhmen ato do të duhej të trajtoheshin drejt përmes Ligjit për decnacionalizim dhe deri atëherë propozohej që nga këto toka të themelohej fondi i tokës bujqësore, siç e kanë edhe shumë vende në Evropën perëndimore.

Këto toka pastaj do të mund t’u jepeshin fshatarëve që ta punojnë me qira simbolike dhe me subvencione të tjera do të shtohet prodhimi bujqësor dhe kjo natyrisht do të

thoshte zhvillim, siç thotë edhe sot. Natyrisht, UNMIK-u nuk qante kokën për diçka që lidhej me fjalën zhvillim, parapëlqente fjalën shitje, fjalë kjo që u trashëgua në pushtete deri me sot. Sot e kemi Qeverinë si përfaqësuese të denjë të privatizimit pa kriter. Mësues i mirë ky UNMIK-u, shumë!

Bazuar në këto të dhëna dhe në rekomandimet, Lëvizja “Vetëvendosje” konsideron se privatizimi aktual i tokave bujqësore duhet të ndërpritet dhe të fillojë rishikimi i shitjeve të deritanishme dhe paralel me këtë të bëhet fondi i tokave bujqësore, siç edhe rekomandohet në këtë raport.

Në lidhje me ndalimin e ndërrimit të destinimit të tokës bujqësore, është i domosdoshëm sinkronizimi i veprimeve në mes inspektorateve dhe gjykatave, si dhe me Policinë, natyrisht. Në koordinim me Ministrinë e Bujqësisë dhe atë të Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor, pasi në shumtën e rasteve degradimi i tokave bie në përgjegjësi të këtyre dy ministrive. Pra, i përkrahim rekomandimet, si dhe e miratojmë këtë raport.

KRYETARI: Realisht, ka dalje nga rendi i ditës dhe nuk është mirë...

(ndërrhyrje)

Jo, ka dalje, nuk jemi në orën e historisë këtu. Fjalën e ka deputetja Time Kadrijaj. Nuk është debat historik, lexoje raportin me rekomandime, është dashur të thuhet në Komision.

TIME KADRIJAJ: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, e përkrah raportin e Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural dhe Mjedis dhe do ta votojë.

KRYETARI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Koalicioni për Kosovë të re, deputetja Sevdije Lama.

SEVDIJE LAMA: Ju faleminderit, i nderuari zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Dua të ritheksoj faktin se gjatë mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit për tokën bujqësore, Komisioni ka hasur në vështirësi të mëdha për grumbullimin e të dhënave të nevojshme, pasi që Ministria e Bujqësisë dhe shumica e komunave nuk i posedonin ato dhe për këtë arsye nuk ju kanë përgjigjur pyetësorëve të dërguar nga Komisioni.

Do probleme të identifikuar që kanë pasoja të rënda në ruajtjen e tokës bujqësore, duhet t'i përmendim, si në vijim: Ministria e Bujqësisë nuk ka të hartuar strategji për mbajtjen e tokës bujqësore. Miratimi i vonuar i planit hapësinor të Kosovës, të cilin e kemi bërë në qershor të vitit 2011, vonimi i hartimit dhe miratimit të planeve zhvillimore komunale, mungesa aktuale e planeve të zhvillimit të disa komunave, mos përfshirja e planeve për menaxhimin e tokave rurale në planet zhvillimore komunale, përfshirja e sipërfaqeve të mëdha të tokave bujqësore të klasave prej 1 deri 4 në planet zhvillimore urbane në shumicën e komunave, përfshirja e mëtutjeshme e tokës bujqësore

në planet zhvillimore urbane, e sidomos të asaj në brezat e rrugëve, ku ka ende sipërfaqe të papërfsira nga ndërtimet, këto plane në të vërtetë e përshkruajnë gjendjen e krijuar pas uzurpimit.

Disa komuna nuk kanë kërkuar pëlqim nga Ministria e Bujqësisë për tokat e klasave 1 deri 4 sipas Ligjit për tokën bujqësore. Disa komuna për planet zhvillimore të tyre nuk kanë kërkuar pëlqim nga Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor.

Në 18 komuna, për ndërrimin e destinimit të tokës nga viti 2000 deri në 2010, pa leje të kuvendeve komunale, janë evidentuar sipërfaqe të vogla të tokës bujqësore, ndërsa shumica e tyre nuk kanë fare të dhëna. Mjetet e kompensimit për ndërrim të destinimit të tokës bujqësore paguhën në xhirollogari të buxhetit të komunave, por këto mjete nuk shfrytëzohen për shtimin e sipërfaqeve të punueshme dhe përmirësimin apo rregullimin e tokave bujqësore. Është konstatuar se ka sipërfaqe të tokës bujqësore nën komasacion, të cilës iu ka ndërruar destinimi. Po ashtu, ka sipërfaqe të tokës bujqësore nën sistem të ujitjes, të cilës iu ka ndërruar destinimi.

Në të shumtën e rasteve, kuvendet komunale nuk i detyrojnë investitorët privat që të bëjnë projektet e rikultivimit dhe t'i bëjnë pagesat prej së paku 30 % për sigurimin dhe rikultivimin e tokës bujqësore. Vlerësohet se tokat janë shumë të ndotura. Janë evidentuar një numër i madh i operatorëve ilegal, të cilët janë shfrytëzues të rërës buzë shumicës së lumenjve. Në pellgun e lumit Drini i Bardhë territorin e komunave Rahovec, Prizren dhe Gjakovë, rreth 6000 hektarë të tokës bujqësore të klasave 1 deri 4, të përfshira në komasacion, që janë nën sistemin e ujitjes, nga viti 1999 janë duke u degraduar në përmasa shkatërruese nga shfrytëzimi i rërës, ndërtimit të objekteve afariste, siç janë pompat e derivateve, restorantet, motelet dhe objektet e tjera.

Shumë sipërfaqe të tokës bujqësore publike janë lënë djerrë. Prinë komuna e Gjakovës me 6001 hektarë. Privatizimi i sipërfaqeve të mëdha të tokave bujqësore, sidomos i sipërfaqeve afër qyteteve nga bizneset dhe ndërrimit të destinimit në tokë ndërtimore, është në kundërshtim me ligjin. Në shumicën e tokave të privatizuara bujqësore nuk ka rritje të prodhimtarisë bujqësore, ka sipërfaqe të lëna djerrë, e madje ka sipërfaqe nën sistem të ujitjes dhe në komasacion të cilave ju është ndërruar destinimi.

Numri i rasteve të denoncuarra për shkelje ligjore, është i vogël, ndërsa numri i lëndëve të shqyrtuara nga gjykatat, janë simbolike. Ka dualizëm në veprim në mes të inspektorëve qendror dhe lokal dhe konflikt të kompetencave. Duke marrë parasysh të gjeturat në infrastrukturën ligjore, nga vizitat e realizuara në terren dhe nga raportet e ndryshme për shfrytëzimin e tokës bujqësore, Komisioni ka konstatuar se ligji për tokën bujqësore paraqet bazën e mjaftueshme ligjore për shfrytëzimin dhe mbrojtjen e tokës bujqësore, ndërsa zbatimi i tij mbetet brenga kryesore. Nga të gjeturat gjatë procesit të mbikëqyrjes, Komisioni ka identifikuar problemet, ka bërë vlerësimin e nivelit të zbatimit të ligjit dhe ka dhënë rekomandime në lidhje me masat që duhet të ndërmerren për ndryshimin e gjendjes aktuale për mbrojtjen e tokës bujqësore, të cilat i prezantoi para jush kryesuesi i Grupit punues, zoti Njazi Idrizi.

Koalicioni për Kosovën e Re e përkrah raportin në fjalë. Ju faleminderit.

KRYETARI: Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Sali Morina.

SALI MORINA: Ju faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Besoj që edhe parafolësit në kuadër të këtij komisioni i dhanë sugjerimet dhe njëkohësisht raportuan për rekomandimet që kanë dal nga ky raport. Është fakt, do të thotë, që është një mos koordinim në mes të Ministrisë së Bujqësisë dhe gjithashtu mes komunave dhe, po ashtu, mos koordinim në mes komunave dhe Minsistrisë së Planifikimit Hapësinor, kur thuhet se në disa komuna, pjesa më e madhe e komunave sipas Ligjit për toka, nuk kërkojnë pëlqimin nga Ministria e Bujqësisë dhe po ashtu për planet zhvillimore janë po ashtu një numër shumë i madh i komunës që nuk kërkojnë pëlqim nga Ministria e Mjedisit. Prandaj, do të ishte mirë një koordinim në mes dy ministrive dhe po ashtu mes asociacioneve të komunave që Ligji për tokat bujqësore duhet të implementohet me përpikëri dhe njëkohësisht Ministria e Bujqësisë duhet që përmes takimeve të shpeshta ose edhe përmes udhëzimeve të cilat ka ndalur nga ky ligj, t'i detyrojë komunat që ta respektojnë ligjin për tokat bujqësore.

Një çështje e tillë është edhe çështja e privatizimit, për të cilën mos privatizimi i suksesshëm ndoshta ka lënë shumë toka djerrinë ose dhe zhagitja e këtij procesi nga ana e AKP-së, do të thotë, procesi i zhagitur po ashtu ka lënë shumë toka djerrinë. Një çështje të cilën e ngriti kolegu, deputeti Liburn Aliu, që ka të bëjë me çështjen e privatizimit dhe pikërisht në tokat e Bellonicës, unë kisha kërkuar, kryetar, që kjo çështje të zgjidhet përmes organeve të drejtësisë dhe njëkohësisht t'i jipet prioritet këtij shqetësimi të cilin e kanë qytetarët e Bellonicës sepse ka të bëjë me procesin e privatizimit. Unë vij nga ajo zonë, nga ajo komunë dhe kërkoj që kësaj çështjeje t'i jepet prioritet nga instancat më të larta për të bërë zgjidhjen dhe për të shikuar se ky proces a ka qenë në nivel të drejtë apo nuk ka qenë në nivel të drejtë, prandaj zgjedhjet e tilla dhe jo në organet të drejtësisë, është Ministria e Drejtësisë, janë gjykatat dhe instancat më të larta të shtetit që këtë çështje ta zgjidhin në mënyrë të drejtë dhe në mënyrën të cilën e kërkojnë edhe qytetarët e Bellonicës. Ju faleminderit, shumë!

KRYETARI: Njazi, ke fol, çka po do tash? Urdhëro! Mirë, urdhëro, merre fjalën, reago, unë tani kam mundësi për të folur apet. Regjia, fjalën deputetit Njazi Idrizi!

NJAZI IDRIZI: Mendoj që ky kompleks i tokës bujqësore, problem i tokës bujqësore është kompleks shumë i madh dhe ky grup nuk ka pasur për qëllim që t'i nxjerrë të gjitha të këqijat që janë, që zbatohen realisht në këtë tokë. Ka qenë më përpara një projekt për krijimin e një komisioni ndërinstytucional për trajtimin e kësaj teme, i cili pastaj ka pushuar dhe ka dal pastaj si nevojë që kjo të dal dhe ta marrë rrugën e vet. Problemet këtu janë këtu shumë të mëdha dhe pak a shumë jemi përpjekur që t'i theksojmë brenda informacioneve që i kemi pasur këtu. Afër 6 muaj grupi ka punuar pa ndërprerë, kemi dal në terren dhe e kemi bërë punën tonë. Nuk kemi gjetur se te Ligji ka pasur vështirësi apo probleme. Problemet kanë qenë, përkundrazi, se komunat nuk kanë arritur që ta zbatojnë Ligjin e planifikimit hapësinor, që brenda afatit që e kanë

paraparë, që është paraparë në atë ligj, që brenda 18 muajve t'i krijojnë planet zhvillimore të tyre dhe të caktojnë vijat se kah dhe nga do të shtrihen vendbanimet e tyre. Ata këtë punë, shumica, jo vetë atëherë, por madje edhe sot nuk e kanë bërë dhe njerëzit vazhdimisht në takimet që i kemi pasur, kanë deklaruar se ne duhet të ndërtojmë diku.

Ndërsa, sa iu përket rekomandimeve të fundit, ato kurdoherë shkojnë me fjalët “duhet” apo “nuk duhet”. Do me thënë, kjo ka qenë puna jonë edhe nuk e kam parë që ky reagimi i juaj ka qenë me vend. Ju faleminderit, shumë!

KRYETARI JAKUP KRASNIQI: Ju faleminderit!

Edhe unë do t'i them dy-tri fjalë, por si deputet.

Të nderuar deputetë,

Unë nuk po e mohoj punën e komisionit dhe e vlerësoj punën e komisionit dhe nuk kam problem me komisionet. Konsideroj që ne si shoqëri duhet të jemi më të edukuar dhe ta dimë që toka bujqësore është pasuri kombëtare dhe qasja ndaj pasurisë kombëtare duhet të jetë e të gjitha instancave shtetërore edhe qeveritare, qoftë të nivelit qendror, qoftë të nivelit lokal. Konsideroj që raportet, rekomandimet janë joobliguese dhe veç çka e zbehin ligjin, se nuk e forcojnë dhe intervenimi im ishte që përfundimet e komisionit, që janë përfundimet e mira, unë mendoj se është dashur të obligohet, jo “duhet”, por është dashur të obligohet Ministria e Bujqësisë për t'i kryer obligimet e veta që i ka me ligj.

Gjithashtu, është dashur të obligohet Ministria e Planifikimit Hapësinor për çështjet që i ka me ligj, ajo është e obligueshme, jo “duhet” dhe t'i lehet mundësi asaj ta zhagitë edhe më shumë çështjen. Është dashur të obligohen komunat, çka është në përgjegjësinë e komunave dhe komunat është dashur të obligohen. Unë mendoj që kjo çështje është serioze dhe, në nëse është serioze, ne si Kuvend duhet t'i qasemi në mënyrën më serioze dhe t'i obligojmë, jo ti rekomandojmë, në këtë rast, jo pse ne kemi ndonjë obligim të veçantë ose ndonjë interes të veçantë. Ne si deputet jemi përfaqësues të qytetarëve të Kosovës dhe ne jemi ata që duhet të kemi një vëmendje më të madhe ndaj pasurisë kombëtare dhe jo, shpeshherë Kuvend, si përfaqësues të zgjedhur të institucioneve të Kosovës, nuk jemi kah i mbrojmë çështjet që janë të interesit vital dhe të interesit kombëtar.

Vërejtjet e mija ishin që vërtetë kjo është një çështje e rëndësishme, është një çështje me interes vital për kombin dhe qasja jonë duhet të jenë në mbrojtjen e interesit vital të kombit. Prandaj, ju kisha lutur si komisione, kur të vini në përfundime të tilla, rekomandimet të jenë më të kufizuara, se ka shumë rekomandime dhe pak obligime dhe të jenë më konkrete dhe të jenë obligative. Kjo ishte ndërhyrja ime, se kemi disa rekomandime edhe më vonë që do t'i shohim. Unë nuk dua ta marrë fjalën për to, mjafton një rekomandim, të gjitha rekomandimet tjera që janë, ato janë të panevojshme dhe thonë diçka si diskriminuese, në fakt edhe institucionet mjaft profesionale ndërkombëtare kanë treguar se në Kosovë nuk ekziston një formë e tillë e diskriminimit, për çka vijnë komisionet tona në rekomandimet që do t'i kemi tash më

parë dhe nuk është mirë të themi diçka që është diskriminuese, kur vërtet në Kosovë nuk jemi të diskriminuar.

Këto ishin, do të thotë ndërhyrja ime ishte për këtë, si ta bëjmë që të gjitha institucionet që e kanë përgjegjësinë, të obligohen, jo të rekomandohen. Ju faleminderit, për vëmendje!

KRYETARI: Jo, nuk ka replikë më! Nga ne, mendoj si Kuvend, rekomandimet, raporti me rekomandime u mbështet, por unë kërkoj që Administrata me Komisionin, disa vërejtje që dolën këtu, le t'i plotësojnë dhe ne po i votojmë këto rekomandime me plotësim që do t'i bëjë Komisioni me Administratën e Kuvendit. Jeni dakord?

Atëherë, shkojmë me votim. Votojmë, tash!

Në sallë kemi 67 deputetë.

“Për” kanë votuar 64 deputetë, “kundër” asnjë, asnjë abstenim, Kuvendi miratoi Raportin me rekomandimet e Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural dhe Planifikim Hapësinor për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për tokën bujqësore, me vërejtjen që e thamë.

Vazhdomë pikën e radhës:

24. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të pagjetur dhe Peticione për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për liritë fetare në Kosovë

Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione ka mbikëqyrrur zbatimin e Ligjit për liritë fetare në Kosovë dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime.

Ftoj kryetarin e Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, deputeten Suzana Novobrdaliu për arsyetimin e raportit me rekomandime.

SUZANA NOVOBRDALIU: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Raportuese për këtë raport është zonja Kimete Bajraktari, andaj kërkoj që t'ia kaloni fjalën asaj.

KRYETARI: E kreve, a? Po shkojmë në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, kush e ka fjalën? Deputetja Kimete Bajraktari e ka fjalën.

KYMETE BAJRAKTARI: Ju faleminderit, kryetar!

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, ka bërë mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit numër 02/L-31 për lirinë fetare. Ky Ligj ka për qëllim të sigurojë të drejtën e secilit pa kurrfarë diskriminimi në çfarëdo faze dhe në barazi të plotë para Ligjit për lirinë e mendimit, ndërgjegjes dhe besimit, pavarësisht nga bindja fetare apo vetëdija.

Fusha e lirive fetare në Kosovë, paraqet në prej fushave me rëndësi jetike për çdo shoqëri. Grupi punues ka përgatitur raportin, i cili shpreh vlerësimin e tij për gjendjen lidhur me zbatimin e Ligjit për liritë fetare në Kosovë, duke i përfshirë edhe disa rekomandime për masat që duhet të ndërmerren.

Mbledhja e informacioneve nga ana e Grupit të punës është bërë nëpërmjet të pranimit të dëshmimeve me shkrim, vizitave në terren, plotësimin e pyetësorëve, regjistrimin elektronik të seancave dëgjimore, mbajtjes së procesverbaleve nga zyrtarët e Komisionit.

Grupi punues ka organizuar takime në terren që i ka zhvilluar në institucione shtetërore, si dhe në bashkësitë fetare. Gjatë këtyre vizitave, Grupi punues është takuar me institucionin e Avokatit të Popullit, Ministrinë e Arsimit, bashkësitë fetare të Kosovës, Bashkësinë Islame të Kosovës, Kishën Katolike të Kosovës, Kishën e Evangjeliste, Tarikatet e sektit myslimanë të Rahovecit, Gjakovës dhe Prizrenit.

Grupi punues me gjithë interesimin dhe insistimin, nuk ka pasur mundësi ta realizojë vizitën në Kishën Ortodokse Serbe në Prizren, për shkak se zyrtarët nuk iu kanë përgjigjur ftesës.

Rezultatet e monitorimit paraqesin konstatimet e Grupit të punës lidhur me zbatimin e Ligjit për liritë fetare. Konstatimet bazohen në fakte dhe në argumentet e qëndrueshme dhe jo në mendimet subjektive. Në këtë drejtim, Grupi i punës ka identifikuar shumë probleme që kanë të bëjnë me zbatimin e këtij ligji, mos nxjerrja e akteve nënligjore nga ana e Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive përkatëse, me qëllim të operacionalizimit të plotë. Nuk ekziston plani me dinamikën kohore për nxjerrjen e akteve nënligjore, gjë që dukshëm e ka vështirësuar punën e Grupit punues, si dhe procesin e mbikëqyrjes së implementimit të ligjit.

Ligji nuk parasheh afate të përcaktuara kohore për përmbushjen e detyrimeve specifike. Ligji në fjalë nuk specifikon diçka të rëndësishme dhe ka terminologji që ka kuptime të pakufizuara, siç fjala vjen, neutraliteti i Qeverisë karshi bashkësive fetare, liria e tubimit, nuk e precizon se për çfarë tubimesh bëhet fjalë. Pastaj, Qeveria prej miratimit të ligjit nuk ka pasur koordinimin e nxjerrjeve të akteve nënligjore. Efektet negative janë se Ligji ekzistues nuk i precizon disa çështje të rëndësishme, siç janë: pozita juridike e bashkësive fetare, nuk e rregullon çështjen pronësore juridike të bashkësive fetare, nuk ka ndarje buxhetore për bashkësitë fetare nga buxheti i Qeverisë, nuk rregullon çështjen e tatimeve të ndryshme, në veçanti në atë mbi pronën.

Në bazë të fakteve relevante të Grupit të punës, gjatë vizitave në institucionet publike, të dëgjimeve publike dhe pas shqyrtimit të dokumentacionit relevant, me qëllim të tejkalimit të situatës së tanishme të pavolitshme, është i domosdoshëm zbatimi i rekomandimeve të bëra në këtë raport.

Rekomandimi 1.

Rekomandohet Zyra e kryeministrit që me rastin e ndryshimit dhe plotësimit të Ligji përkatës, të rregullojë statusin juridik të bashkësive fetare në Kosovë.

Rekomandimi 2.

Rekomandohet Zyra e kryeministrit, që me rastin e ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit përkatës, të rregullojë çështjen e statusit pronëso- juridik të bashkësive fetare në Kosovë.

Rekomandimi 3.

Rekomandohet Zyra e kryeministrit, që me rastin e ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit përkatës, të obligojë Ministrinë e Shërbimeve Publike, që në formularët e regjistrimit të popullsisë civile të jenë të përfshira të gjitha bashkësitë fetare të parapara me ligj.

Rekomandohet 4.

Rekomandohet Zyra e Kryeministrit që me rasatin e ndryshimit dhe plotësimit të ligjit përkatës, çështja e bashkësive fetare në Kosovë, të jetë e barabartë, të mos ketë diskriminim.

Rekomandimi 5.

Rekomandohet Zyra e Kryeministrit, që me rasatin e ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit përkatës, të funksionalizohen këshillat e bashkësive fetare nëpër komuna.

Rekomandimi 6.

Rekomandohet Zyra e Kryeministrit që me rastin e ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit përkatës, të zgjidhet edhe çështja e financimi të bashkësive fetare në Kosovë.

Andaj, kërkojmë nga deputetët t'i përkrahin dhe votojnë rekomandimet e bëra nga Komisioni. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të shefave, në emër të Partisë Demokratike, deputeti Kurtan Kajtazi e ka fjalën.

KURTAN KAJTAZI: Ju faleminderit, kryetar!

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike vlerëson se liria e besimit është një prej të drejtave themelore të njeriut dhe një prej parimeve dhe standardeve të pranuara ndërkombtarisht, mbi lirinë e të shprehurit dhe vetëdijes fetare.

Grupi Parlamentar Demokratike të Kosovës ka shqyrtuar raportin e Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione që ka bërë mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për liritë fetare në Kosovë. Ky ligj ka për qëllim të sigurojë të drejtën e secilit pa kurrfarë diskriminimi në çfarëdo faze dhe në barazi të plotë para ligjit për lirinë e mendimit, ndërgjegjes dhe besimit, pavarësisht nga bindja fetare.

Edhe pse Ligji është miratuar në Kuvendin e Kosovës në korrik të vitit 2006, Kosova po ballafaqohet me vështirësi të theksuara në përpjekjen për të vendosur një ligj i cili do të përmbushte nevojën e të gjitha besimeve fetare në Kosovë. Ligji për liritë fetare në Kosovë është ligj bazik dhe kjo ka qenë një prej arsyeve që ka nxitur Komisionin për të monitoruar pikërisht zbatimin e këtij ligji. Arsye tjetër ka qenë gjendja jo e kënaqshme në fushën e liritë fetare që vazhdon të jetë e njëjtë edhe pas hyrjes në fuqi të këtij ligji. Në radhë të parë, janë për brengosje pakënaqësitë e institucioneve fetare. Pra, si rezultat i punës disamujore, Grupi punues ka përgatitur raportin i cili shpreh vlerësimin e tij për gjendjen lidhur me zbatimin e Ligjit për liritë fetare në Kosovë, duke përfshirë edhe disa rekomandime për masat që duhet të ndërmerren. Prandaj, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e mbështet raportin dhe ia propozon Kuvendit për miratim. Ju faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupi Parlamentar të Lidhjes Demokratike, deputetja Rita Hajzeraj - Beqaj.

RITA HAJZERAJ - BEQAJ: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Grupi parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e vlerëson punën e Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Peticione dhe Persona të Pagjetur, po ashtu i përkrahim të gjitha rekomandimet që i ka bërë ky komisionin, por me qenë se ka ardhur Ligji për plotësim dhe ndryshim tani në Parlamentin e Kosovës, konsideroj që këto rekomandime duhet të plotësohen dhe të bëhen amendamente që të përfshihen tash në plotësim ndryshimin e ligjit të ri.

Andaj, ne si Grup Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e përkrahim plotësisht këtë raport nga Komisioni për të Drejtat e Njeriut. Ju faleminderit!

KRYETARI: Në emër të “Vetëvendosjes”? Albulena Gashi.

ALBULENA GASHI: Lëvizja “vetëvendosje” ka shqyrtuar raportin për monitorimin e Ligjit për liritë fetare dhe në parim do ta votojë këtë raport. Mirëpo, kemi disa vërejtje që kanë të bëjnë me disa gabime në drejtshkrim dhe në formulimin e fjalive, që në disa raste ky raport bëhet i paqartë.

Liria fetare është e garantuar me aktet ndërkombëtare të të drejtave dhe liritë të njeriut, ndërsa në Kosovë, kjo liri si e drejtë themelore është e garantuar me Kushtetutë dhe me Ligjin për liritë fetare. Historikisht, populli shqiptar ka qenë shembull i tolerancës ndërfetare, e një gjë e tillë është vërtetuar edhe gjatë monitorimit të Ligjit, ku vërtetohet fakti që liria e shprehjes së besimit fetar nuk paraqet ndonjë problem. Por, çka mbetet shqetësim, është mungesa e Ligjit për Bashkësinë e fetare, ligj ky i cili do të rregullonte mënyrën e rregullimit të statusit juridik të bashkësive fetare, mënyrën e funksionimit, organizimit dhe financimit të tyre. Mungesa e këtij ligji bën që këto bashkësi të regjistrohen si organizata joqeveritare që bien ndesh me Ligjin për lirinë e asociimit në organizata joqeveritare, i cili përjashton të drejtën e regjistrimit të bashkësive fetare sikur organizata joqeveritare. Është pra neni 1, pika 2 e këtij ligji.

Edhe një herë theksoj se ne do ta votojmë këtë raport dhe meqë ky ligj do të vie në Kuvend për plotësim dhe ndryshim, kontributin tonë do ta japim në komisionin funksional.

KRYETARI: Në emër të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, kush e do fjalën? Ka fol. Mirë.

Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, fjalën e ka kërkuar Suzan Novoberdaliu.

SUZAN NOVOBRDALIU: Ju faleminderit, kryetar!

Në bazë të nenit 73 të Rregullores së Kuvendit dhe me qëllim të sigurimit të zbatimit të Ligjit për liritë fetare në Kosovë, numër 02/L-31, i miratuar në korrik të vitit 2006, Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Peticione, Persona të Pagjetur, në takimin e mbajtur më 20 maj të vitit 2011, ka marrë vendim që ta monitorojë zbatimin e Ligjit për liritë fetare në Kosovë.

Komisioni ka organizuar takime në terren, në institucione shtetërore, si dhe me bashkësitë fetare. Gjatë vizitave në teren, Grupi i punës ka arritur në përfundim se një numër i konsiderueshëm i bashkësive fetare nuk ka njohuri të mjaftueshme lidhur me Ligjin, si dhe për aktet nënligjore në bazë të të cilave duhet të punojnë ato. Po ashtu, duhet theksuar se Ligji në fjalë, gjatë zbatimit të tij në praktikë, ka probleme të ndryshme dhe i njëjti ka nevojë për ndryshim dhe amendamentim.

Prandaj, Grupi Parlamentar i Koalicionit për Kosovë Re, përkrah raportin me rekomandimet e Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Peticione dhe Persona të Pagjetur. Ju faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit “6+”, deputetja Duda Balje e ka fjalën.

DUDA BALJE: Zahvaljujem!

Parlamentarna grupa „6+“ podržava sve aktivnosti, kompletan rad kao i predložene preporuke od strane Komisije za ljudska prava, polnu ravnopravnost, nestala lica i peticije i smatra da oni kao amandmani treba da budu uključeni u zakon koji se tiče toga. Zahvaljujem!

KRYETARI: Në emër të SLS-së, a ka dikush? Nuk ka.

Atëherë, deputeti Arsim Bajrami e ka fjalën.

ARSIM BAJRAMI: Ju faleminderit, kryetar!

Nuk do të diskutoj për raportin, për shkak se e përkrahi, vetëm nevojitet një përmirësim, sepse në rekomandime referohet Ministria e Shërbimeve Publike. Nga viti 2008, emërtimi i kësaj Ministrie është: Ministria e Administratës Publike. Me qenë se kanë për të qenë dokument zyrtar, atëherë le të harmonizohet vetëm emërtimi i Ministrisë.

KRYETARI: Deputetja Ganimete Musliu e ka fjalën.

GANIMETE MUSLIU: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuara kolege dhe kolegë deputetë,

I nderuari ministër,

E dimë se me aktet ndërkombëtare të të drejtave, lirive themelore të njeriut, liria fetare është e garantuar, kështu që në Kosovë kjo liri, si e drejtë themelore është e garantuar me Kushtetutë e me ligj për liritë fetare. Prandaj, ne duhet respektuar dhe zbatuar në përpikëri këto akte, sepse nëse lejojmë të dalim përtej kufijve që na lejohen me këto akte, ne mund të bëjmë shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të të tjerëve.

Nëse ndalemi dhe analizojë, historikisht u përmend edhe nga kolegja më herët që foli, populli shqiptar njihet për tolerancë fetare në Ballkan, prandaj pas përfundimit të luftës në Kosovë, sikur jemi përfshirë nga një model i kufizuar i lirisë dhe në këtë drejtim po ndodhë edhe me shfrytëzimin e të drejtave dhe lirive themelore, siç është feja, ku shpeshherë veprohet në mënyrë euforike nga disa grupe të caktuara njerëzish.

Duke përgëzuar Komisionin për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticionet, të cilët na e kanë paraqitur këtë raport, pres që rekomandimet e dala nga ky raport, të merren në konsideratë dhe pasi që tani veç ligji përkatës tashmë ka ardhur në Kuvend, pres që Komisioni përkatës të shqyrtojë me kujdes dhe të punojë që ky ligj të jetë një ligj i arsyeshëm dhe i zbatueshëm, sepse vetëm me ligjet e mirëfillta dhe të zbatueshme shteti mund të jetë rrezistent ndaj çdo tentative për të destabilizuar vendin. Faleminderit!

KRYETARI JAKUP KRASNIQI: Nuk ka të lajmëruar për debat.

Unë do t'i them dy-tri fjalë dhe po i them nga këtu. Unë mendoj se rekomandimi i parë i mbulon të gjitha ato çka duhet të jepet nga ky rekomandim dhe rekomandimet tjera janë të tepërta. Por, nëse mbesin kështu si janë, nëse është vullnet i edhe i juaji, Rekomandimi 4, pjesa e fundit të presja, duhet të jetë pikë dhe: “të mos ketë diskriminim” të hiqet, se në Kosovë nuk ka diskriminim për këtë çështje. Nuk di pse ka hyrë kjo nga Komisioni.

Edhe një çështje tjetër që thuhet: “të gjeturat” dhe përmenden një varg çështjesh. “Prej tyre gjetën metoda alternative grupet fetare, raportuan për vështirësitë për posedimin dhe regjistrimin e pronës të automjeteve, me hapjen e llogarive bankare, në pengimin e tatimit të pagat e punëtorëve dhe zyrat e Avokatit të Popullit”. Dhe, menjëherë është fjalia tjetër: “Kuvendi i Kosovës nuk ka ndërmarrë asgjë në lidhje me këto rekomandime”. Por, ju lutem, Kuvendi i Kosovës për çështje që u përmendën, nuk është, nuk ka pse të merr obligime, do të thotë obligimet janë të tjerëve. Mos të ngarkojmë si Kuvend, ju po e ngarkoni edhe veten me diçka që nuk është. Do të thotë, janë këto dy çështje, që kur të bëhen rekomandimet, vërtet mos t'i ngarkojmë çështjet që nuk janë përgjegjësi e jona dhe, jo veç e jona, por nuk janë as përgjegjësi e qytetarëve të Kosovës.

Do të thotë, edhe raportet e rëndësishme të mekanizmave ndërkombëtar kanë konstatuar se në Kosovë nuk ka diskriminim fetar dhe nuk është mirë nga Komisioni të dalë se sikur në Kosovë paska diskriminim fetar. Unë po e tërheq vërejtjen që këto çështje të mos të thuhën, kur nuk ekzistojnë.

Tash, nëse jeni dakord për këtë që e thashë, të ndryshohet ...

(reagime)

Do të thotë, ne po shkojmë në votimin e amendamenteve me vërejtjet në rekomandime.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim.

Votojmë, tash, edhe vërejtjet e kryetarit. Në sallë janë 69 deputetë.

Me 58 vota “për” 1 “kundër” asnjë abstenim, Kuvendi miratoi Raportin me rekomandime të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për liritë fetare në Kosovë, natyrisht dhe me vërejtjet e kryetarit dhe vërejtjet tjera. Faleminderit!

(reagime)

Do të thotë, Raporti po miratohet me vërejtjet e thëna edhe nga kryetari i Kuvendit dhe deputetët.

Ju faleminderit! Vazhdojmë!

25. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Legjislacion dhe Mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për administrimin e pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar

Komisioni për Legjislacion ka mbikëqyr zbatimin e Ligjit për administrimin e pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportet me rekomandime.

Ftoj kryetarin e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, deputetin Arben Gashi për arsyetimin e Raportit me rekomandime. Deputet Gashi, e ke fjalën!

ARBEN GASHI: Ju faleminderit, kryetar!

Po mundohem t’i bie shkurt, se po e shoh se edhe shumica e deputetëve janë lodhur. Kemi pasur një seancë shumë të gjatë.

Ky ligj ka hyrë në fuqi më 1 janar të vitit 2010, dhe unë po i lexoj problemet e identifikuara nga Grupi punues. Në problemet e identifikuara Ministria ka qenë e autorizuar të nxjerrë aktet nënligjore për zbatimin e Ligjit dhe një pjesë e tyre janë nxjerrë dhe pjesërisht është realizuar kjo, dhe po ashtu nuk është bërë miratimi nga Ministria, e akteve nënligjore të nxjerra nga ushtruesi i detyrës së kryeshefit ekzekutiv të Agjencisë. Problem paraqitet edhe për shkak të mungesës së kapaciteteve, kushteve dhe rrethanave, objekteve të Agjencisë për administratën e pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar.

Problemi është se kjo është një agjenci e re dhe nuk ka edhe vende pune dhe objekte fizikisht ku do të deponohen këto pasuri të konfiskuara ose të sekuestruara. Ndër të tjera, Komisioni ka arritur në përfundimin se për mbikëqyrjen e këtij ligji duhet të merren këto aktivitete që të kemi ngritje të kapaciteteve dhe efikasitet më të mirë. Mangësitë dhe vonesat në nxjerrjen e legjislacionit sekondar nga Ministria e Drejtësisë për zbatimin e Ligjit për administrimin e pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar zvogëlojnë efektivitetin e ligjit dhe përmasat në zbatimin e tij.

Në zvogëlimin efektivitetit të ligjit kanë ndikuar edhe disa dispozita procedurale të ligjit, të cilat kanë nevojë të ndryshohen dhe të plotësohen Kapacitetet e pamjaftueshme hapësinore në objekte reflektojnë dukshëm në zbatimin e ligjit. Këto janë disa përfundime që i ka arritur Komisioni. Po ashtu, Komisioni ka arritur që të nxjerrë disa rekomandime, ndër të cilat janë: shikimi dhe aprovimi sa më parë i akteve nënligjore për zbatimin e Ligjit për administrimin e pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar me qëllim të rritjes të aktivitetit dhe efektivitetit dhe përmasat e zbatimit të tij.

Ministria e drejtësisë t'i rishikojë dispozitat procedurale të ligjit me qëllim të ndryshimit ose të plotësimit të tij, në mënyrë që ndryshimi të jetë pjesa e agjendës legjislative për pjesën e parë të vitit 2012, dhe që Qeveria të sigurojë hapësirë të mjaftueshme të punës, të menaxhmentit dhe administratës së agjencisë, por edhe të depove të ruajtjes së sendeve sendeve të sekuestruara, përkatësisht të sendeve të konfiskuara. Këto janë probleme administrative dhe ligjore të cilat Komisioni i ka identifikuar dhe i rekomandon Ministrisë që t'i ndërmerr masat konkrete. Besoj që kanë qenë, rekomandimet janë shumë konkrete dhe shumë mirë të specifikuara dhe kërkoj nga seanca që t'i përkrahë këto rekomandime. Ju faleminderit!

KRYETARI: Po shkojmë me grupe. Në emër të Partisë Demokratike, kush e donë fjalën? Nuk e donë!

Në emër të LDK-së, kush e do fjalën? Deputeti Armend Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Ju faleminderit, kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i LDK-së e vlerëson punën e Komisionit për Legjislacion, konkretisht të Grupit punues që në bazë të Rregullores së Punës së Kuvendit e ka bërë monitorimin e zbatimit të Ligjit dhe punon në atë drejtim që të ushtrojë agjendën e vet kushtetuese të kontrollit parlamentar në zbatimin e ligjeve nga ana e Qeverisë.

Ne mendojmë që këto rekomandime janë të drejta në bazë të të gjeturave, se sipas takimeve dhe asaj çka është përcjellë edhe gjatë punës së kësaj, krijimit të kësaj agjencie, por ajo çka mendoj që duhet t'i shtohet është, që ne së pari duhet të kemi Ligj për konfiskimin e pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme dhe atëherë të merremi me Ligjin për administrimin e pasurisë së sekuestruar ose dekonfiskuar.

Prandaj, ne vlerësojmë edhe njëherë këto rekomandime, por një rekomandim që është dashur t'i shtohet është që sa më shpejtë të nxirret Ligji për konfiskimin e pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme. Faleminderit shumë!

KRYETARI: Në emër të lëvizjes “Vetëvendosjes”, deputetja Albulenë Haxhiu e ka fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Edhe ne si Grup Parlamentar e vlerësojmë raportin e Komisionit për Legjislacion dhe i përkrahim rekomandimet e këtij komisioni, në lidhje me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për administrimin e pasurisë së sekuestruar ose konfiskuar. Shpresojmë që Qeveria do t'i marrë parasysh rekomandimet tona si komision, sepse në të kundërtën agjencioni do të ekzistojë vetëm sa për sy e faqe. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të AAK-së, fjalën e do kryetari i grupit, deputeti Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

Gjithsesi edhe Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e mbështet raportin e Komisionit dhe do ta votojë. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Koalicionit Kosova e Re, Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, kryetar!

Koalicioni për Kosovën e Re do të përkrahë rekomandimet për shqyrtimin e raportit për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për administrimin e pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar. Duke marrë parasysh se Komisioni ka bërë me grupin punues një punë shumë të mirë dhe ka nxjerr rekomandimet, atëherë edhe Koalicioni për Kosovë Re përkrah këto rekomandime. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të “6+”-së, a do fjalën dikush? Nuk ka.

Nga SLS-ja, nuk ka.

Gëzim Kelmendi, për çaka e ke fjalën:

GËZIM KELMENDI: Faleminderit, kryetar!

Unë veç desha ta shpreh atë reagimin tim, që nuk ma dhatë fjalën në pikën kaluese. Edhe e preka pullën edhe e ngrita dorën. Se në parim në Kosovë, ka diskriminim fetar. E keni raportin e State Departamentit Amerikan të vitit 2010 dhe 2011, ku thotë fort mirë se ndalimi i mbulesës nëpër shkolla fillore dhe të mesme, nuk ka bazë ligjore. Kështu që, ka diskriminim fetar në Kosovë.

KRYETARI: Je jashtë rendit ditës dhe të lutem mos fol jashtë rendit të ditës.

GËZIM KELMENDI: Po e di, për atë arsye edhe nuk ma dhatë fjalën, kryetar.

KRYETARI: Unë po them, që nuk ka.

GËZIM KELMENDI: E keni raportin e State Departamentit Amerikan. Ka diskriminim fetar.

KRYETARI: Ju, mendoj, që nuk e dini as çka është diskriminim fetar, se le diçka tjetër.

GËZIM KELMENDI: Faleminderit për vlerësimin e juaj! Unë nuk e kisha bërë kështu për juve këtë.

KRYETARI: Faleminderit!

Nuk është çështje e koalicionit, por është çështje parimore. Dhe çështjet parimore, janë parimore. Faleminderit!

Në rrethana të tjera do të dihej shumë mirë atëherë do të kishte diskriminim, jo vetëm fetar. Unë mendoj që s'ka diskriminim dhe e mbroj këtë fuqishëm, kudo që shkoj.

Po fillojmë nga pika e pestë, para rekomandimit. Mendoj që duhet të korrigjohen më mirë tekstet që përgatiten nga komisionet. Thotë “propozimet e implementuesit të ligjit”, duhet të jetë “propozimet për implementuesit e ligjit”. Do të thotë, gjuhësisht është më drejtë kështu të jetë. Dhe, është mirë të konsultohet me administratën, se administrata ka edhe lektorët, që duhet ta bëjnë korrigjimin. Dhe, rekomandimet unë mendoj, që duhet t'i drejtohen ose Qeverisë ose Ministrisë, jo edhe njëres edhe tjetres. Dhe me këto vërejtje unë isha pajtuar.

A jeni dakord? Mirë, faleminderit!

Atëherë, shkojmë me vërejtjet, me votim të rekomandimeve.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash.

Me 55 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, Kuvendi miratoi raportin me rekomandimet e Komisionit për Legjislacion lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për administrimin e pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar dhe me korrigjimet e cekura nga kryetari i Kuvendit.

Vazhdojmë me pikën e radhës:

26. Shqyrtimi i raportit të dytë për zbatimin e Planit të veprimit të Kuvendit për Integritet Evropian për vitin 2011

Komisioni për Integritet Evropian, në koordinim me komisionet tjera parlamentare ka hartuar dhe Kuvendit ia ka paraqitur për shqyrtim dhe miratim, raportin e dytë për zbatimin e Planit të Veprimit të Kuvendit të Kosovës për Integritet Evropian, për vitin 2011.

Ftoj kryetarin e Komisionit për Integritet Evropian, deputetin Lutfi Haziri, që në emër të Komisionit para deputetëve të Kuvendit, të arsyetojë dhe prezantojë raportin.

E ka ndërruar raportuesin, raporton deputetja Vjosa Osmani.

VJOSA OSMANI: Faleminderit, kryetar!

Meqenëse kryetari i Komisionit, zoti Haziri nuk është këtu, më luti që ta prezantoj raportin, në emër të tij dhe në emër të Komisionit.

Siç e dini, në bazë të nenit 77, paragrafi 1 i Rregullores së punës së Kuvendit të Kosovës, për çdo vit miratohet plani i veprimit për integrim evropian dhe për të diskutuar rreth zbatimit të këtij plani për integritime evropiane Komisioni i ka paraqitur seancës plenare raportin e dytë, që përfshinë të arriturat dhe sfidat gjatë periudhës raportuese, nga raporti i parë për zbatimin e Planit të Veprimit të Kosovës për Integritime Evropiane të vitit 2011.

Kuvendi i Kosovës, më 28 prill 2011 ka miratuar planin e veprimit për integritime evropiane për vitin 2011, prandaj gjatë këtij viti Komisioni për Integritime Evropiane ka paraqitur dy raporte. Për dallim nga raporti i parë, ky i dyti përmban të gjitha të arriturat e sfidave të planit të veprimit për këtë vit. Siç është e ditur, për dallim nga vitet e kaluara, Komisioni Evropian për Kosovën, këtë vit ka publikuar më herët Raportin e Progresit, prandaj përfshirja e të arriturave deri në fund të këtij viti nga Kuvendi i Kosovës dhe trupat e tij në institucionet e tjera, nuk kanë mund të përfshihen të gjitha.

Komisioni për Integritime Evropiane ka bërë mbikëqyrjen e planit të veprimit nga institucionet relevante dhe në bazë të këtyre rezultateve ka nxjerrë këto përfundime, duke shënuar rezultate në shumë fusha të caktuara, por edhe ngecje në disa fusha të tjera.

Ju e dini që edhe gjatë seancës së sotme, janë adresuar disa prej çështjeve që kanë qenë të paraqitura në këtë raport, prandaj edhe raporti do të përmirësohet në bazë të këtyre të arriturave, gjatë ditës së sotme. Nga Kuvendi, në përgjithësi është shënuar progres, sa i përket numrit të ligjeve të miratuara, që ka qenë një prej rekomandimeve kryesore të Komisionit Evropian. Prej 40 projektligjeve, të cilat është kërkuar të miratohen, Kuvendi ka miratuar 23, kurse 11 janë në fazën e shqyrtimit dhe të miratimit, disa prej të cilave u miratuan edhe sot.

Ndërsa, sa i përket fazës së mbikëqyrjes ndaj ekzekutivit, një prej çështjeve kryesore dhe vërejtjeve kryesore të Raportit të Progresit, të gjitha komisionet parlamentare në planet e tyre vjetore të punës kanë përfshirë mbajtjen e dëgjimeve publike dhe monitorimin e së paku një ligji në fushën, të cilën e mbulojnë këto komisione.

Sa i përket reformës së sistemit zgjedhor dhe amendamentimit të Kushtetutës, siç e dini, ky Kuvend ka mandatar dy komisione, Komisionin për Amendamentimin e Kushtetutës dhe Komisionin për Reformë Zgjedhore, të cilat ende po vazhdojnë mandatin dhe punën e tyre, ashtu siç është kërkuar në Raportin e Progresit. Komisionet parlamentare kanë kërkuar, që ministritë e linjës të raportojnë para komisioneve. Gjatë raportimit është kërkuar, që të sjellin raporte me shkrim për çështje të caktuara.

Sipas raportimeve të komisioneve parlamentare është shënuar përmirësim, sa i përket punës së tyre, në përmbushjen e detyrave të parapara në planin e veprimit. Mirëpo, sfida e këtij plani të veprimit, mbetet edhe më tutje mbikëqyrja e ekzekutivit nga ana e Kuvendit.

Ministritë është dashur që të raportojnë në mënyrë të rregullt para komisioneve parlamentare. Sa i përket dërgimit të raporteve me shkrim nga ana e ministrive, sipas planit të veprimit, katër ditë para mbajtjes së takimit, kjo nuk është realizuar në shumicën e rasteve. Pra, ministritë nuk e kanë përmbushur këtë detyrë, me përjashtim të disave, shumica e ministrive nuk kanë dërguar raporte me shkrim, edhe pse kanë qenë të obliguara ta bëjnë këtë, sipas këtij plani.

Sa i përket monitorimit të zbatimit të ligjeve, Kuvendi i Kosovës nuk ka arritur progres, për shkak të mungesës së kapaciteteve të mjaftueshme, gjë që përmendet edhe në Raportin e Progresit dhe sipas planit të veprimit, vetëm disa nga komisionet parlamentare, kanë realizuar monitorimin e zbatimit të ligjeve, kurse një nga detyrat e parapara me këtë plan, ka qenë që të bëhet të paktën monitorimi i një ligji për komision parlamentar.

Pra, edhe tutje kjo mbetet një ndër sfidat kryesore të Kuvendit të Kosovës. Kuvendi, po ashtu, nuk ka arritur progres të mjaftueshëm sa i përket shqyrtimit më cilësor të legjislacionit dhe ekspertizës ndërsektoriale. Kjo prapë për arsye të mungesës së kapaciteteve. Edhe pse është arritur progres sa i përket miratimit të një udhëzimi për administrimin e buxhetit të komisioneve parlamentare në prill të këtij viti.

Sfidë, po ashtu, mbetet zhvillimi i mirëfilltë i një dialogu mes të Kuvendit dhe organizatave të shoqërisë civile, prandaj kjo sfidë është bartur edhe në planin e veprimit për vitin e ardhshëm, që do të adresohet në pikën në vijim të agjendës së këtij Kuvendi. Ju e dini që Komisioni për Integritet Evropian ka mbajtur disa takime me shoqërinë civile, megjithatë, një ndër prioritetet e Kuvendit, por edhe të Qeverisë, duhet të mbetet ndërtimi i kornizës institucionale për dialog me shoqërinë civile.

Po ashtu, nuk është raportuar progres, sa i përket përpjekjeve në adresimin adekuat dhe me kohë të rekomandimeve nga institucioni i Avokatit të Popullit. Kuvendi i Kosovës ka miratuar Rregulloren për zgjedhjen dhe shkarkimin e Avokatit të Popullit dhe po ashtu janë emëruar zëvendësit e këtij institucioni, megjithatë, sfidë mbetet, miratimi dhe implementimi i rekomandimeve, që vijnë nga ky institucion.

Sa i përket të drejtave të njeriut, nuk ka pasur progres të mjaftueshëm në koordinim, në mënyrë efektive të nivelit qendror dhe atij lokal, për zbatimin e të drejtave të njeriut. Nuk është raportuar për krijimin e një njësie të mjekësisë ligjore, të specializuar për rastet e dhunimit, trafikimit të qenieve njerëzore dhe dhunës në familje, prandaj, po ashtu kjo sfidë do të bartet në planin e veprimit për vitin në vijim.

Duke mos i përmendur të gjitha sfidat dhe të arriturat e kësaj periudhe, ju inkurajoj që ta shikoni raportin në katër kolona. Siç e shihni, në kolonën e parë janë paraqitur sfidat, në kolonën e dytë është trupi i caktuar i Kuvendit, pra komisioni që merret me këtë çështje, në kolonën e tretë janë veprimet e propozuara dhe në kolonën e katërt janë veprimet e përmbushura, apo të arriturat.

Prezantimi i këtij raporti fokusohet në të arriturat dhe sfidat që kanë të bëjnë kryesisht me tri kritere, që vlerësohen, natyrisht, që janë mjaftë të rëndësishme për shtetet që kanë synim anëtarësimin në Bashkimin Evropian. Këto janë kriteret politike, ato ekonomike dhe standardet evropiane. Duke pasur parasysh këtë raport, në përgjithësi mund të konstatojmë se janë përmbushur një numër i madh i sfidave të paraqitura, por si përfundim konsiderojmë që është shumë me rëndësi për Kuvendin e Kosovës, bashkërendimi i veprimeve për plotësimin e të gjitha kritereve, përkatësisht kritereve politike, ekonomike dhe standardeve evropiane, duke përmbushur të gjitha përgjegjësitë dhe detyrat në realizimin e Planit të Veprimit të Kuvendit për Integritime Evropiane.

Më lejoni t'i përmend edhe disa prej çështjeve, meqenëse u adresuan në seancën e sotme.

Në këtë raport do ta shihni, që po ashtu, një prej sfidave që mbetet të adresohet nga ana e Kuvendit të Kosovës, është çështja e punësimit të stafit dhe avancimit të stafit, i cili sipas Raportit të Progresit të vitit 2010 dhe 2011, në shumë raste bëhet duke u bazuar në nepotizëm dhe anëtarësim në parti politike. Kjo është një çështje, që duhet në mënyre serioze të adresohet nga ana e Kuvendit.

E dyta ka të bëjë me Ligjin për financimin e subjekteve politike, i cili ishte sot në shqyrtim të dytë, domethënë, u miratua në shqyrtim të dytë në Kuvendin e Kosovës.

Në Raportin e Progresit shumë qartë është thënë edhe në vitet e kaluara, por sidomos në vitin 2010 dhe 2011, që kur të amendamentohet ky ligj, duhet të kihet parasysh ndalimi apo rregullimi i çështjes së fondeve nga ndërmarrjet apo nga subjektet juridike, të cilat fitojnë tenderë nga Qeveria. Kjo çështje si amendament është propozuar nga Komisioni për Integritime Evropiane dhe në mënyrë unanime, do të thotë njëzëri është miratuar nga të gjithë anëtarët e këtij komisioni. Përkundër këtij fakti dhe përkundër insistimit të madh nga ana e Komisionit Evropian, të cilët jam e sigurt, që përsëri publikisht do të dalin ta shprehin shqetësimin e tyre, që ai amendament sot as nuk u fut në votim në këtë seancë, për arsye se Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka paraqitur si version “B”, të njërës nga rekomandimet dhe meqenëse shkoi amendamenti “A” nuk u votua fare. Prandaj, me lejoni që edhe në emrin tim ta shpreh shqetësimin tim, por edhe të Komisionit për Integritime Evropiane, që ky rekomandim, i cili njëzëri është miratuar nga ana e Komisionit, në emër të të cilit po flas, nuk është shqyrtuar fare në këtë seancë.

Përveç kësaj, raporti në mënyrë shumë shqetësuese ka paraqitur sfidat që kanë të bëjnë me përfaqësimin e jashtëm të Kosovës. Ju e dini që në Raportin e Progresit është përmendur, që në më se tri raste, Kosova ka pranuar gjatë këtij viti të përfaqësohet si UNMIK. Unë besoj që kjo është një çështje, që të gjithë ne si deputetë të Kuvendit të Kosovës, duhet ta ngrisim zërin tonë. Megjithatë, nuk është adresuar nga komisionet përkatëse të Kuvendit të Kosovës dhe kjo sfidë duhet me shumë seriozitet, të adresohet në vitin që vijon. Përveç kësaj, një çështje shumë me rëndësi, është miratimi i ligjeve pa buxhet. Ne e patëm prapë një sfidë të tillë sot me Ligjin për ndihmë juridike, i cili është diskutuar disa herë në këtë Kuvend dhe ky ka qenë problemi kryesor. Duhet ta kemi të gjithë të qartë se miratimi i letrave të paimplementueshme nuk është i mjaftueshëm për t'i adresuar sfidat në Raportin e Progresit. Prandaj, Qeveria dhe ministrinë përkatëse duhet të kenë kujdes, që të bashkërendojnë punën e tyre dhe miratimin e ligjeve me Ministrinë e

Ekonomisë dhe Financave, sepse në shumë raste kemi pasur në një anë rekomandimin e Ministrisë së linjës, për ta miratuar ligjin, kurse në anën tjetër rekomandimin e Ministrisë të Ekonomisë dhe Financave për të mos e miratuar këtë ligj.

Përfundimisht, me shumë shqetësim, shumica e deputetëve kemi marrë tendencën e Qeverisë për ta miratuar ligjin për RTK-n dhe KPM-n, përkundër faktit që ai prej shumicës prej nesh, por edhe prej Komisionit Evropian, është vlerësuar të jetë në kundërshtim...

(Ndërprerje e incizimit)

KRYETARI: Po dëshiron ende të flasësh?
Hajde, regjia vazhdoja fjalën!

VJOSA OSMANI: Unë besoj, që për të gjitha partitë politike, agjenda evropiane është çështja kryesore dhe është çështja e vetme, në fakt, që ka unanimitet të plotë të spektrit politik kosovar, kështu që ju inkurajoj, që për hir të mbajtjes së këtij unanimiteti të spektrit politik kosovar për agjendën evropiane, dëgjoni edhe dhjetë sekonda.

Çështja e fundit, ishte çështja e miratimi të Ligjit për RTK-n dhe KPM-n, që shumë qartë është vlerësuar edhe nga ana e Komisionit Evropian, por edhe nga një numër i madh i deputetëve të Kuvendit të Kosovës, se është në kundërshtim me standardet evropiane, prandaj më duhet të them që tendenca e tillë ka shkuar po ashtu, në dëm të këtij unanimiteti për agjendën evropiane, të cilën e përmenda.

Në pikën në vijim, nuk do të flas shumë gjatë, do ta kem krejt një fjali.
Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Komisionit. Unë do t'i kem do vërejtje, por më vonë, por kjo e fundit, nuk qëndron. Është në ndeshje me grupet e interesit në Kosovë, po jo me standardet evropiane. Të jeni të bindur, që s'është në ndeshje me standardet evropiane, por është me grupet e interesit në Kosovë. Të dy ligjet dhe shoqëria civile jo, por mediat që janë të fuqishme në këtë aspekt kanë krijuar këtë mundësi, por ligji nuk është ndeshur me standardet e ligjeve të Bashkimit Evropian. Këtë duhet ta keni parasysh si deputetë dhe t'i njihni mirë standardet e pastaj të ngarkohet Kuvendi me atë që nuk e ka.

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, fjalën e ka deputetja Blertë Deliu Kodra!

BLERTA DELIU- KODRA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Kuvendi i Kosovës, më 28 prill e ka miratuar edhe Planin e Veprimit për Integritet Evropian për vitin 2011, kurse Kuvendi ka paraqitur edhe raportin e dytë për zbatimin e Planit të Veprimit të Kuvendit për Integritet Evropian, që i përmban të arriturat dhe sfidat, të cilat janë realizuar gjatë kësaj periudhe raportuese për Kuvendin.

Komisioni Evropian për këtë vit ka nxjerrë më herët se herëve të tjera, Raportin e Progresit për Kosovën, prandaj Kuvendi nëpërmjet komisioneve parlamentare e ka përgatitur edhe Planin e Veprimit për Integrim Evropian për vitin 2012.

Kuvendi i Kosovës, vlen të theksohet, se për dallim nga vitet e kaluara e ka përmirësuar dukshëm mbikëqyrjen ndaj ekzekutivit. Komisionet parlamentare në mënyrë të rregullt, sipas planit të veprimit, kanë ftuar ministrat në raportim. Në planin e tyre të punës, komisionet kanë përfshirë monitorimin e së paku një ligji. Shumica e komisioneve gjatë mbajtjes së dëgjimeve me ministrat, kanë pranuar edhe raportet me shkrim.

Kuvendi i Kosovës, siç u tha edhe më herët, më datën 19 prill 2011, ka nxjerrë një udhëzim për administrimin e buxhetit të komisioneve parlamentare, ka organizuar disa dëgjime publike me përfaqësues të Qeverisë, përkatësisht me ministra dhe ka kërkuar raporte për çështje të caktuara, që janë paraparë në plan të veprimit.

Sa i përket sistemit të drejtësisë, këto institucione po zhvillojnë aktivitete për zbatimin e plotë të Ligjit për gjykatat dhe për funksionalizimin e gjithë sistemit gjyqësor në Kosovë, kurse sipas informacioneve të marra, janë duke u zhvilluar aktivitete lidhur me përmbarimin e vendimeve gjyqësore me rritjen e numrit të 30 përmbaruesve.

Kuvendi ka miratuar në gusht, ligjin për Dhomën e Veçantë të Gjykatës Supreme, kurse Zyra e Prokurorit të Shtetit ka njoftuar se ndjekja dhe hetimet ndaj kriminelëve të luftës, janë ngadalësuar. Kjo sepse, hetimet dhe ndjekja e krimeve të luftës është në kompetencën ekskluzive të Prokurorisë Speciale. Me propozim të Ministrisë së Drejtësisë, Qeveria e Kosovës ka themeluar Institutin për Hulumtimin e Krimeve të Luftës. Është njoftuar, po ashtu, se institucionet përkatëse kanë përgatitur dosjen për të burgosurit, të cilët i kanë plotësuar kushtet për falje, do të thotë, 227 persona, që kanë përfituar nga zbatimi i ligjit për falje.

Në çështjen e të drejtave ekonomike dhe sociale është raportuar për progres sa i përket dialogut në mes të sindikatave dhe Qeverisë. Si rezultat i këtij dialogu është arritur marrëveshje për caktimin e pagës minimale.

Nga fillimi i këtij viti është bërë unifikimi i faqeve zyrtare, të ashtuquajturave ueb-faqeve të internetit, për të gjitha komunat e Republikës së Kosovës, duke respektuar kështu edhe Ligjin për përdorimin e gjuhëve, përjashtim bëjnë këtu 3 komunat në veriun e Kosovës, ajo e Leposaviqit, Zubin Potokut dhe Zveçanit.

Në kapitullin që i referohet tregut të brendshëm, miratimi i Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për akreditim, ka krijuar bazë ligjore për anëtarësimin në organizatat evropiane apo ndërkombëtare për standardizim. Ndërkohë që, Ministria e Financave, në bashkëpunim me Bankën Qendrore të Kosovës janë në proces të hartimit të Projektregullores për tregun primar dhe sekondar, për emetimin e letrave në vlerë.

Banka Qendrore e Kosovës, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, ka themeluar, po ashtu, edhe ka funksionalizuar Njësinë për Tregun e B rendshëm të Letrave me Vlerë,

ka siguruar platformën e tregut elektronik të letrave me vlerë, si dhe sistemin depozitar qendror të letrave me vlerë.

Për fund dua të them se Grupi Parlamentar i PDK-së e përkrah në parim zbatimin e Planit të Veprimit të Kuvendit të Kosovës për Integritet Evropian për vitin 2011 dhe i fton të gjithë të tjerët, që ta përkrahin. Faleminderit!

KRYETARI: Mirë, u bë.

Në emër të LDK-së, kush e do fjalën?

Përsëri Vjosa Osmani.

VJOSA OSMANI: Faleminderit!

Që të mos i përsëris, natyrisht që të gjitha ato që i përmenda në emër të Komisionit, përkrahen edhe nga Grupi Parlamentar i LDK-së dhe për sqarim, ju e dini që ky raport lidhur me zbatimin e Planit të Veprimit për Integritet Evropian, bazohet në konstatimet apo të gjeturat e Raportit të Progresit, që hartohet nga Komisioni Evropian.

Çështja që e përmenda së fundi, lidhur me dy ligje të caktuara, ka qenë vlerësim i Komisionit Evropian, prandaj, si i tillë besoj që është e drejtë të ngrihet edhe nga deputetë të caktuar, në veçanti nga Komisioni për Integritet Evropian. Në qoftë se dikush këtu mendon që Komisioni Evropian si pjesë e BE-së shpreh qëndrime të grupeve të caktuara të interesit, atëherë le të jetë ky vlerësim i çdokujt, mirëpo ne si Komision për Integritet Evropian, në veçanti LDK-ja nuk mendon që Komisioni Evropian përkrah grupe të caktuara të interesit.

KRYETARI: Unë e pata për një çështje shumë konkrete, jo për raportin. Meqenëse edhe raporti nuk është as bibël, as kuran për t'u trajtuar, edhe ai i ka mangësitë e veta, prandaj, ne jemi këtu për t'i thënë edhe mendimet tona dhe atë që është. Kujt nuk i pëlqen ajo që është dhe nëse dikush do vërtet, gjithçka që thonë të tjerët, ta bëjmë dhe pjesë tonën, ajo është çështje personale dhe individuale e secilit.

Fjalën e ka deputetja Alma Lama.

ALMA LAMA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Plani i Veprimit të Kuvendit të Kosovës për Integritet Evropian për vitin 2011 është realizuar kryesisht për sa i përket miratimit të ligjeve, mirëpo jo edhe mbikëqyrjes së Qeverisë. Përkundrazi, kemi mbikëqyrje të Kuvendit nga ana e Qeverisë, ose injorim të vendimeve të Kuvendit nga ana e Qeverisë.

Shumica e vërejtjeve për realizimin e këtij plani, u thanë këtu dhe janë thënë nëpërmjet qëndrimit që mban Komisioni për Integritet Evropian, pasi të gjitha vërejtjet janë evidentuar dhe adresuar aty, mirëpo, unë dua të ndalem dhe kam vërejtje edhe për miratimin e ligjeve dhe nuk dua të shkojë shumë larg, por, pikërisht sot ndodhi që nuk u mor parasysh vërejtja e Komisionit Evropian - Ligji për financimin e subjekteve politike.

Ka 3 vjet që Komisioni Evropian bën vërejtje në lidhje me faktin se Qeveria merr donacione nga kompanitë, të cilave iu jep tenderë. Pra, shprehimisht është kërkuar që të shmanget financimi i partive politike, që marrin tenderë publikë. Komisioni për Financa nuk e kishte marrë parasysh këtë vërejtje të Komisionit Evropian dhe këtë korrigjim e mori përsipër ta bënte Komisioni për Integritet, mirëpo, sot në votim kjo gjë nuk u mor parasysh dhe ju garantoj, që në Raportin e Progresit të vitit të ardhshëm, kjo vërejtje do të jetë sërish.

Unë mund të them që sot, nëpërmjet miratimit të Ligjit për financimin e partive politike, thjeshtë, u bë legalizimi i korrupsionit.

Kjo që ndodhi sot nuk është aspak një mbyllje e mirë e vitit, për sa i përket realizimit të Planit të Veprimit për Integritet Evropian.

Ne mund të shkruajmë plane sa të duam në letër, por, në rast se nuk i respektojmë, atëherë është e kotë dhe e pavlerë.

Janë edhe disa ligje të tjera, për të cilat Komisioni Evropian në mënyrë specifike e ka kërkuar adresimin e tyre, por, kjo nuk ka ndodhur, adresimin e vërejtjeve. Unë këtë e shoh si mungesë vullneti për të respektuar standardet evropiane. Praktikrat që të ndërhyjnë të huajt sa herë ne gabojmë, më duket sjellje disi fëmijërore nga ana jonë. Pra, duhet të mësohemi të sillemi si të rritur dhe pjekur institucionalisht, në rast se duam të ndërtojmë me të vërtetë një shtet ligjor.

Unë shpresoj dhe besoj dhe duhet të bëjmë të gjithë përpjekje, që në planin e vitit të ardhshëm, i cili sërish do të diskutohet këtu, të punojmë për ta plotësuar dhe për ta marrë atë seriozisht dhe jo të miratojmë ligje, sipas interesave të ditës apo interesave partiake. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Ju lutem, ju lutem, deputeti Ardian Gjini e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, kryetar!

Mendoj se po thuhet shumëçka që vetëm është thënë në Komision. Komisioni e ka nxjerrë një raport dhe përpilimi i këtij raporti ndoshta është më i lehti prej të gjitha komisioneve tjera, për shkak se i kanë dy pika referente.

E para janë rekomandimet dhe e dyta është ajo që është bërë në Kuvend. Sidoqoftë, me siguri se kemi nevojë, ndoshta ne deputetët të shprehemi lirshëm edhe një herë në Kuvend. Ne e mbështesim raportin e Komisionit dhe do ta votojmë.

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, fjalën e ka deputetja Suzan Novoberdaliu!

SUZANA NOVOBERDALIU: Kryetar, faleminderit!

Edhe ne e mbështesim këtë raport dhe do ta votojmë.

(Ndërprerje e incizimit)

KRYETARI: Më falni, SLS, fjalën e ka deputeti Saša Milosavljević!

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala, gospodine predsedniče!
I SLS podržava ovaj izvještaj i izglasacemo isti.

KRYETARI: Faleminderit, deputet!
Në emër të “6+” deputeti Albert Kinolli e ka fjalën.

ALBERT KINOLLI: Faleminderit!
I nderuar kryetar,
Të nderuar nënkryetarë,
Të nderuar kolegë deputetë,
Grupi Parlamentar “6+” e ka shqyrtuar raportin e dytë për zbatimin e Planit të Veprimit të Kuvendit të Kosovës për Integritet Evropian, për vitin 2011, njëkohësisht, përshëndet progresin e arritur në këtë fushë, duke shprehur se sfidat të cilat përmenden në këtë raport, do t’i tejkalojmë me një angazhim të përbashkët, si në kriteret ekonomike po ashtu edhe politike dhe Grupi Parlamentar “6+” si të tillë, do ta përkrahë raportin. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!
Në emër të Komisionit, fjalën e ka Arben Gashi.

ARBEN GASHI: Me rend më takon kështu, jo për diçka por, në emër të Komisionit kam dy vërejtje, që kanë ndoshta gabim teknik. Te pika 14 dhe pika 15, Komisioni për Legjislacion ka pasur dy obligime, që është dashur t’i realizojë dhe i ka realizuar, ka mbajtur takim me grupet e interesit dhe me palët, që është dashur të mbahen takime më datën 4.7.2011, ndërsa në raport figuron që nuk ka progres të raportuar. Domethënë, pika 14 dhe 15 e tabelës, duhet të përmirësohen te pjesa e raportit sepse, është realizuar progres, janë mbajtur takime dhe janë realizuar detyrat sipas planit të punës. Prandaj, mendoj se duhet të përmirësohen këto dy gabime, që kanë ikur. Kaq kisha, faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Arsim Bajrami e ka fjalën.

ARSIM BAJRAMI: Faleminderit, i nderuari kryetar!
E para që dua të theksoj, Raporti i fundit i Progresit ka identifikuar si storie të suksesshme fushën e integriteteve evropiane, sepse të gjithë ne e kemi diskutuar, para disa seancave dhe e kemi parë gjuhën e raportit, ku thotë se Kosova ka ndërtuar struktura efektive, që merren me çështjen e integriteteve evropiane. Jo vetëm funksionimi i mirë i Ministrisë së Integriteteve Evropiane, por Qeveria ka bërë përpjekje që përmes strukturave brenda ministrive, të fokusojë angazhimet në fushën e integriteteve evropiane dhe në këtë drejtim raporti i Komisionit, është një raport përmbledhës, që fokuson obligimet në të gjitha fushat, jo vetëm në fushat që janë përgjegjësi e ekzekutivit, por në të gjitha fushat, të cilat raportohen në Raportin e Progresit.

Unë kam vetëm disa çështje për të ngritur, definitivisht nuk është sfidë vetëm numri i ligjeve, vetëm kuantiteti legjislativ apo agjenda legislative, por raporti kërkon që vërtet këto ligje të jenë kualitative, efektive, të zbatueshme, të monitorueshme. Dhe, unë po ngris disa çështje, që duhet të jenë çështjet, me të cilat duhet të merret Kuvendi i Kosovës.

Çështja e parë, studimi i fizibilitetit të ligjeve, i cili duhet të jetë një proces shumë studiues, që duhet të zhvillohet, kryesisht, pranë Qeverisë dhe duhet përfshijë, vërtet një vlerësim të përgjithshëm për pretendimet, qëllimet dhe objektivat e një ligji.

Për shkak se duhet ta pranojmë brenda një legjislature, ne 50% të aktivitetit po e zhvillojmë me plotësime dhe ndryshime të legjislacionit ekzistues dhe është një dukuri, që në Kosovë po ndodh. Ligjet në vitin e parë të zbatimit po vërehet se kanë defekte dhe po rikthehen në riparim, që është një angazhim shtesë i Kuvendit, i cili ka për nevojë, për detyrë primare dhe plotësimin e kuadrit ligjor në Republikën e Kosovës, duke qenë se jemi shtet i ri dhe kemi nevojë për shumë ligje, për të plotësuar kushtet për të hyrë në raporte kontraktuale.

Fatkeqësisht, gati 50% e aktivitetit legjislativ është riparim i ligjeve dhe për këtë arsye angazhohem që të ndërtohet një mekanizëm i studimit të fizibilitetit të ligjit në pikëpamje të vlerësimi praktik të objektivit të ligjit në fazën e inicimit të procedurës.

Çështja e dytë, duhet të rrisim performancën e legjislacionit. Ne e dimë Raporti i Progresit ka pasur vërejtje edhe sa i përket performancës së legjislacionit, kualitetit, evitimit të konfliktit të ligjeve dhe standardizimit të ligjeve.

Edhe sot, në këtë seancë, kryetari i Parlamentit në disa raste intervenoi me të drejtë dhe pat intervenca të disa rekomandimeve. Në kushte normale kjo nuk është detyrë e kryetarit të Parlamentit por, e strukturave brenda Parlamentit, e Njesisë për Standardizim, e cila duhet t'i marrë në shqyrtim të gjitha rekomandimet dhe me kohë t'ju bëjë me dije komisioneve se rekomandime të tilla nuk mund të dërgohen në seancë për votim, jo kjo të bëhet në seancë. Dhe në një gjë të tillë kemi nevojë ta forcojmë brenda Kuvendit, sa i përket legjislacionit, në mënyrë që Njësia e Standardizimit të kujdeset, që brenda legjislacionit të mos ketë asnjë dispozitë, e cila mund të jetë konfliktuese ose e pazbatueshme, sepse pastaj po i kthehemi atij ligjit në procedurën për ndryshime dhe plotësime.

Edhe diçka, që nuk është ndërtuar asnjëherë në Kosovë, është premtuar edhe nga Qeveria, por edhe nga Kuvendi, ende, të nderuar kolegë, nuk kemi një mekanizëm, një komision për evitimin e kolizionit të ligjeve, apo konfliktit të ligjeve, çfarë i kanë të gjitha parlamentet, i kanë edhe brenda qeverisë, në mënyrë që mos të miratojmë ligje, të cilat janë në kundërshtim njëri me tjetrin.

Unë e di se ka pas një ide në legjislaturën e kaluar, që të formohen këto dy mekanizma, komisioni për njësimin e ligjeve dhe për evitimin e konfliktit të ligjeve, por asnjëherë nuk

janë formuar dhe ne duhet të mendojmë seriozisht, ndoshta edhe si Parlament, që brenda Parlamentit ta kemi një njësi, e cila i shqyrton ligjet, se a janë në konflikt njëri me tjetrin dhe të evitojë kolizionin para se të votohen.

Çështja e tretë, standardet evropiane sa i përket legjislacionit. Standardet evropiane, sa i përket legjislacionit, janë të kodifikuara dhe janë të njohura. Shtetet, të cilat së fundi janë pranuar apo kanë marrë ftesën, unë mendoj, që e kanë dhënë edhe si donacion për Republikën e Kosovës. Unë e di se Qeveria e Republikës së Kroacisë i ka ofruar Qeverisë së Kosovës, që t'ia japë komplet pakon e librave, sa i përket direktivave, që duhet t'i plotësojë Kosova në integritime evropiane. Dhe, mendoj se këto standarde duhet të jenë të lexueshëm nga vendorët.

Të nderuar kolegë, nuk duhet dhe nuk kemi nevojë për çdo ligj konsulencë ndërkombëtare evropiane, sa i përket standardeve të legjislacionit. Duhet të aftësojmë struktura vendore, ekspertë vendorë, të cilët i njohin këto standarde dhe ato standarde të futen brenda ligjeve në momentin e hartimit të ligjeve. Jo të problematizohet rasti me çdo ligj, cilat janë standardet evropiane dhe jo, të kemi intervenime gjatë shqyrtimit në leximin e dytë, intervenime sa i përket standardeve evropiane.

Definitivisht, ne duhet të kemi juristë të përgatitur, specialistë të standardeve evropiane në sferën e legjislacionit dhe definitivisht, kjo çështje duhet të jetë vendore. Ne duhet të kemi kapacitete për të ndërtuar ekspertizë vendore sa i përket plotësimit të standardeve evropiane. E di që Ministria e Integritimeve është duke punuar në këtë drejtim, ka ekspertë, por ka nevojë edhe Kuvendi të ketë juristë të specializuar për këtë çështje.

Janë dy segmente që u diskutuan, segmenti i mbikëqyrjes efektive të ekzekutivit, një segment, për të cilin është bërë punë mjaftë me komisionet, me raportet korrekte, që i kanë vendosur komisionet me ekzekutivin, me seancat e dëgjimeve publike. Por, segmenti tjetër i mbikëqyrjes efektive ka të bëjë, kryesisht, me konsolidimin e opozitës dhe me ushtrimin e këtij funksioni kushtetues nga vetë opozita, e cila ka detyrë kushtetuese dhe funksion kushtetues, kontrollimin e ekzekutivit përmes mekanizmave të kontrollit efektiv, jo përmes pyetjeve parlamentare, të cilat po shndërrohen më tepër një instrument informativ, por përmes veprimeve tjera kushtetuese serioze, me të cilat vërtet ndërtohet një sistem efektiv i kontrollit të Qeverisë dhe kjo mbetet një sfidë dhe mbetet një çështje, për të cilën duhet të punohet.

Dhe, dy çështjet e fundit, është monitorimi i ligjeve. Fatkeqësisht, të nderuar kolegë deputetë, ende Kuvendi nuk ka struktura të përgatitura, nuk ka ekspertë të mirë, që përgatisin një raport të mirë për monitorimin e ligjeve. Ne sot patëm disa raporte, disa përpjekje, por sinjerisht them, ishin raporte, kryesisht, përshkruese, pa një raportim, për shkak të mungesës së buxhetit, për shkak të mungesës së kapaciteteve. Mendoj se duhet ndarë buxhet shtesë për Kuvendin, që të ushtrohet funksioni i monitorimit të ligjeve, në mënyrë që ky funksion mos të jetë formal, por të jetë esencial, sepse detyra e Kuvendit është që t'i monitorojë ligjet dhe eventualisht t'i riparojë ligjet me vetiniciativë. Jo gjithëherë Kuvendi duhet pritur iniciativën prej Qeverisë. Nëse Kuvendi vëren se një ligj ka pengesa në zbatim, i zbulon defektet e atij ligji, Kuvendi duhet të ketë mundësinë e

plotë kushtetuese, që edhe pa e kthyer ligjin në Qeveri, të fillojë procedurën vetë, sepse edhe Kuvendi ka të drejtë të nisë nisma legjislative.

Kështu që, duhet të punojmë jashtëzakonisht mirë që këtë monitorim të ligjeve mos ta bëjmë formal, por ta bëjmë substancial për ta ndërtuar një sistem efektiv të monitorimit të zbatimit të ligjeve, duhet të ndërtohen kapacitete, duhet të rriten kapacitetet, duhet të ketë buxhet, duhet të ketë buxhet më së paku për aktivitet të deputetëve, sepse këtu duhet ekspertë të kyçen. Pra, ekspertë të fushave të caktuara, të cilët duhet t'i vërejnë defektet e ligjeve në zbatim, ato defekte t'i raportojnë në seancë dhe seanca, menjëherë të fillojë këto gjetje t'i shndërrojë në iniciativa legjislative, sepse neve nuk na duhet vetëm rekomandime të plota, se çka nuk bën, por ato rekomandime duhet të lexohen dhe duhet të shndërrohen në nisma legjislative dhe duhet të kërkojmë nga Qeveria ose të mbështetë këtë nismë ose të japë kosto apo buxhet shtesë dhe kjo iniciativë të shkojë.

Pas kësaj pike do të bisedojmë për Raportin e vitit 2012 dhe unë mendoj se ky debat është i lidhur dhe ka qenë dashur këto dy pika të bashkohen, por e tha edhe kolegja Vjosa, mendoj që një segment i rëndësishëm në Raportin e Progresit, që është cekur ka qenë padyshim, fillimi i reformës zgjedhore dhe reformës kushtetuese dhe padyshim, që në planin për vitin 2012, sipas agjendës që e kemi, sipas obligimeve që kemi karshi Rezolutës së Kuvendit të Kosovës, prioritet në aspektin legjislativ, duhet të jetë miratimi i ndryshimeve kushtetuese dhe miratimi i legjislacionit, sa i përket sistemit elektoral. Dhe, në këtë drejtim, mendoj se në vitin 2012 do të kemi hapa pozitiv, sepse në këto dy procese që po zhvillohen, ka pasur një transparencë shumë të madhe, ka pasur një përfshirje të shoqërisë publike...

(Ndërhyrje)

Jo, është në rend dite, zoti kryetar. Kjo është bash në rend dite, në qoftë se e keni përcjellë, kjo është bash në rend dite dhe besoj, që është edhe në interes të Kuvendit, që punën e vet...

(Ndërhyrje)

Kryetar, është në rend dite plani i veprimit për vitin 2012 dhe për vitin 2012...

(Ndërhyrje)

Po, unë më duket, isha duke kesh diskutuar për faktin se këto dy pika është dashur të diskutohen veç, sepse është e pamundur një debat i shkoqitur për këto dy pika dhe padyshim, që në Planin e veprimit për 2012, do të hyjë si një gjetje pozitive apo si një veprim pozitiv i Kuvendit, pikërisht, sepse Kuvendi i ka udhëhequr mirë këto dy procese, sepse procesi i reformës zgjedhore dhe reformës kushtetuese janë procese të Kuvendit, nuk janë procese të Qeverisë dhe mendoj se ato duhet ta gjejnë vendin edhe në Raportin e Progresit për vitin 2012.

KRYETARI: Safete Hadërgjonaj e ka fjalën.

Veç, mundësisht, rrumbullaksoni fjalën pak!

SAFETE HADËRGJONAJ: Do të përpiqem të flas shumë shkurt, zoti kryetar.

Është çështja e Ligjit për financimin e subjekteve politike, domethënë, Projektligjit për plotësim- ndryshim të Ligjit për financimin e subjekteve politike, sepse është diskutuar sot këtu shumë. Sot është miratuar projektligji, të gjithë i kanë pas amendamentet dhe këto dy amendamente të propozuara edhe janë votuar. Dua të theksoj se në pikën 22 të Planit të Veprimit të Kuvendit thuhet kështu:” është miratuar Ligji për financimin e partive politike, por ende nuk është në përputhje me standardet evropiane.”

Një prej mangësive kryesore të Ligjit është se, as nuk ndalon as nuk rregullon në mënyrë strikte donacionet nga personat juridikë, të cilat ofrojnë mallra dhe shërbime për administratën publike.

Komisioni për Buxhet dhe Financa është përpjekë ta rregullojë çështjen e donacioneve të partive politike, që u jepen partive politike dhe ka angazhuar edhe ekspertë, të cilët e kanë hulumtuar këtë çështjen e donacioneve të subjekteve politike në vende të cilat janë vende të zhvilluara dhe kanë një traditë më të gjatë në këtë çështje dhe ka ardhur me këtë rekomandim, që është në amendamentin 5, që është votuar këtu. Ndalohet dhënia e donacioneve, nga të cilat dhuruesi në mënyrë të qartë mund të përfitojë ndonjë avantazh ekonomik. Donacionet e personave fizikë dhe juridikë për subjekte politike, duhet të bëhen në mënyrë transparente, në llogari bankare dhe duhet të përfshihen në raportet financiare të subjekteve politike përfituese. Raporti financiar i subjekteve politike duhet të përmbajë emrin dhe numrin e regjistrimit, për personat juridik apo emrin mbiemrin dhe adresën për personat fizik.

Ky ka qenë amendamenti i propozuar nga Komisioni për Buxhet. Komisioni për Integritet Evropian e ka dhënë këtë amendament. Subjektet, është fjala ku ndalohet dhënia e donacioneve, subjektet juridike, të cilat përfitojnë kontrata apo tenderë publikë nga buxheti i Republikës së Kosovës dhe nga ndërmarrjet publike, domethënë, kjo është ndalesa që ka dhënë rekomandimin Komisioni për Integritet Evropian. Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar prapë këtë rekomandim të dhënë nga Komisioni i Integritetit Evropian dhe ka ardhur në përfundim, që amendamentin, të cilin e ka dhënë Komisioni për Buxhet është më i pranueshëm për të rregulluar këtë çështje dhe me shumicë votash e ka përkrahur amendamentin, që ka dhënë Komisioni Funkcional, domethënë, Komisioni për Buxhet. Aty nuk kanë qenë vetëm votat e pozitës, por kanë qenë edhe votat e anëtarëve të Komisionit, që kanë qenë nga radhët e opozitës.

Një çështje, me të cilën jemi përballur, pikërisht te ky amendament ka qenë se Komisioni i Ligjeve, ka thënë që është shkelur Kushtetuta me këtë amendament që ka bërë Komisioni për Buxhet. Dhe, Komisioni për Buxhet edhe rekomandimi, që e ka dhënë Komisioni i ligjeve e ka hedhur poshtë, por më përpara ka kërkuar nga administrata të bëjnë një interpretim ligjor, se a është e ndaluar të amendamentohet pjesa që ka të bëjë me ligjin, kur e kemi Projektligjin për plotësim-ndryshime dhe administrata na ka dhënë këtë këshillë juridike. Ndërhyrjet eventuale të Komisionit, që me amendamente të bëjë

ndryshimet dhe plotësimet e tekstit bazik të ligjit, nuk janë shprehimisht të ndaluara, veçmas, nëse ato kanë të bëjnë me natyrën dhe qëllimin e ndryshimeve të parapara më projektligj. Për të gjitha propozimet për ndryshimin e ligjit bazik, duhet të kërkohej mendimi dhe deklarimi i propozuesit të projektligjit, pra i Qeverisë. Kështu që, Komisioni për Buxhet dhe Financa, meqenëse ka qenë pikë e adresuar nga Raporti i Progresit, ka menduar që me këtë amendament ta rregullojë këtë problematikë. Sot është votuar varianti i Komisionit Funkcional dhe meqenëse, ka qenë me shumicë votash, atëherë ka rënë varianti i Komisionit për Integritet Evropian.

Ndjeva për obligim të shpjegoj, sepse disa herë u diskutua sot këtu dhe jo vetëm në këtë pikë të rendit të ditës. Faleminderit!

KRYETARI: Jo, unë ju kisha lutur, herëve tjera do t'ua ndalë fjalën atyre që dalin jashtë rendit të ditës. Për ata është rendi i ditës dhe koncentrohuni në rend të ditës! Fjalën e ka deputeti i fundit i lajmëruar për diskutim, Xhevdet Neziraj.

XHEVDET NEZIRAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Jo, vetëm desha të sqaroj këtë që kërkoj Komisioni për Integritet. Dua t'ua kujtoj Komisionit për Integritet, se një nen tek financimi i subjekteve politike, shkruan shumë qartë se ndalohet ndërmarrjet publike të japin donacione dhe t'i financojnë subjektet politike. Prandaj, këtu kemi të bëjmë me implementimin e ligjit. Faleminderit!

KRYETARI JAKUP KRASNIQI: Faleminderit!

Edhe unë dua t'i them dy tri- fjalë.

Në rend të parë, asnjëherë nuk jam që të mos respektohen gjithçka që është me standardet evropiane dhe që buron nga direktivat evropiane, por ju e dini që shpeshherë në këtë Kuvend kemi miratuar diçka që nuk është në asnjë vend të Bashkimit Evropian dhe s'ka qenë standarde, prandaj, unë jam që gjithçka që votojmë të jetë në standarde, por jo të na shitet për standard, ajo që vërtet nuk është në asnjë direktivë evropiane. Një.

Dy, kur thuhet se disa ministri nuk kanë raportuar, se a është mirë që në raporte të tilla të ceken konkretisht emrat e ministrave që nuk kanë raportuar, do të thotë mos të shkojmë në mënyrë të përgjithësuar. Tjetër, janë disa vërejtje që jep Avokati i Popullit që nuk janë obligim i Kuvendit t'i realizojë, Kuvendi çdo rekomandim të Avokatit të Popullit ia dërgon institucioneve përkatëse dhe këtë ne e kryejmë dhe asnjëherë nuk biem ndesh. Edhe çështja e punësimit mendoj që nuk mund të ngatërrohet me Kuvendin.

Këto ishin vërejtjet e mia. Vërejtje tjetër që mendoj duhet të kihet parasysh nga administrata vërejtjet që i dha deputeti Arben Gashi për pikën e 14 dhe 15, do të duhet t'i ketë parasysh në përfundim, do të thotë të këtyre çështjeve dhe ndonjë vërejtje që është dhënë nga deputetët dhe që ka qenë përmbajtësore, kështu që ne shkojmë votojmë raportin me rekomandime, me vërejtjet që u thanë gjatë diskutimeve.

Lus deputetët, regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash.

Në sallë kemi 74 deputetë. Konstatohet se me 72 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 1 “abstenim”, Kuvendi miratoi raportin e dytë për Zbatimin e Planit të veprimit të Kuvendit të Kosovës për Integritet Evropian, për vitin 2011 me vërejtjet e cekura.

Vazhdojmë pikën e 27-të:

27. Shqyrtimi i Planit të Veprimit të Kuvendit të Kosovës për Integritet Evropian, për vitin 2012

Dhe, tash është fjala për 2012-shin. Komisioni për Integritet Evropian në bazë të Raportit të Progresit të Komisionit Evropian për Republikën e Kosovës, për vitin 2011 ka përgatitur Planin e veprimit të Kuvendit për Integritet Evropian, për vitin 2012 dhe Kuvendi i ka rekomanduar për miratim.

Do të thotë, fjalën e ka deputetja Vjosa Osmani që ta arsyetojë planin e veprimit të vitit 2012.

VJOSA OSMANI: Faleminderit, kryetar!

Shkurt kësaj radhe, Plani i veprimit për vitin 2012 përfshin të gjitha sfidat apo veprimet e paralizuar të vitit të kaluar, do të thotë, gjatë këtij viti që nuk janë përmbytur, ato barten në vitin 2012 dhe në të njëjtën kohë ky plan është amendamentuar duke përfshirë edhe çështjet që janë përmendur në Raportin e Progresit të vitit 2011.

Për përmbyturjen e aktiviteteve të parapara në këtë plan të veprimit është rekomanduar që të gjitha komisionet parlamentare të përfshijnë në agjendën e takimeve tyre të rregullta, pikën e veçantë të ditës “agjenda evropiane” ku do t’i shqyrtojnë sfidat e identifikuar në Raportin e Progresit 2011 dhe veprimet në planin e veprimit. Informacionet e mbledhura nga komisionet parlamentare i dërgohen pastaj Komisionit për Integritet Evropian.

Komisioni për Integritet Evropian do ta informojë Kuvendin pastaj përmes raporteve të rregullta të punës dhe përmes rekomandimeve. Në emër të Komisionit i rekomandojmë gjithë deputetëve që ta miratojnë këtë plan të veprimit dhe po ashtu në emër të Lidhjes Demokratike të Kosovës i rekomandojmë të gjithë deputetëve që të votojnë “pro” këtij plani.

Drejtimin e seancës e merr nënkryetari i Kuvendit, zoti Xhavit Haliti

KRYESUESI: Faleminderit!

Sipas radhës përfaqësuesi i Qeverisë, nëse do të flas? Ka të drejtë të flasë, sepse kemi Ministri të Integritetit. Ky është komision që kontrollon Ministrinë për Integritet.

Nëse nuk keni harruar ju, ministrat... keni të drejtë t’i jepni vërejtjet e juaja, pse jo.

A ma keni shkruar ju ashtu?

VLORA ÇITAKU: Faleminderit, kryesues!

Unë dua të përgëzoj Kuvendin e Kosovës që pa u përmyllur rend e viti kalendarik ka hartuar Planin e veprimit për Integrimet Evropiane për vitin e ardhshëm. Ne sot në Qeverinë e Republikës së Kosovës miratuar edhe PVPE-n për vitin që do pasojë, për 2012 dhe besoj që ai dokument që është miratuar sot dhe dokumenti që Kuvendi i Kosovës do të miratojë, do të jenë komplementarë në mënyrë që bashkarish të jemi në gjendje ta shtyjmë përpara agjendën evropiane, e cila është agjenda më konsensuale në Kosovë dhe është shumë e rëndësishme që ky konsensus nominal që ekziston mes gjithë spektrit politik, tani po de konstruktohet në hapa konkret të cilët po i ndërmarrim bashkarish. Faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Faleminderit! Radhën e kanë kryetarët e komisioneve parlamentare, në qoftë se e dëshirojnë fjalën. Nuk ka të interesuar. Kryetarët ose përfaqësuesit e grupeve parlamentare, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, deputetja Deliu.

Zonjës Deliu mikrofonin, ju lutem, regjia!

BLERTA DELIU – KODRA: Faleminderit, kryesues!

Plani i Veprimit të Kuvendit të Kosovës për Integrimet Evropiane, për vitin 2012 bazohet në përfundimet e dala prej Raportit të Progresit të Komisionit Evropian për Kosovën, për vitin 2011.

Për dallim nga vitet e kaluara, Komisioni Evropian e ka publikuar disa muaj më herët Raportin e Progresit për Kosovën dhe për vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor. Kuvendi i Kosovës për herë të tretë, për çdo vit radhazi ka miratuar një plan veprimi që ka për qëllim të koordinojë punën në mes të komisioneve parlamentare rreth mbikëqyrjes së punës së ekzekutivit në fushat e caktuara, të cilat edhe i mbulojnë. Gjatë hartimit të këtij plani Komisioni për Integrimet Evropiane ka ndjekur metodologjinë e koordinimit me komisionet e tjera parlamentare, duke organizuar kështu takime të përbashkëta dhe duke evidentuar sfidat e dala nga Raporti i Progresit për Kosovën.

Plani i veprimit është paraqitur në formë tabelare me katër kolona, ku janë të përfshira të gjitha sfidat e dala nga Raporti i Progresit të Komisionit Evropian. Në kolonën e parë, institucionet, përkatësisht trupat e Kuvendit të Kosovës, konkretisht komisionet parlamentare që përbëjnë kolonën e dytë, kurse në kolonën e tretë janë të paraqitura veprimet e propozuara që parashihen të ndërmerren nga komisionet parlamentare dhe nga Kuvendi për realizimin e progresit dhe në përmbushjen e sfidave të Raportit të Progresit.

Ndërkaq, në kolonën e katërt është paraqitur perioda kohore e realizimit të këtyre sfidave në këtë plan.

Për fund, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e mbështet Planin e Veprimit të Kuvendit të Kosovës për Integrimet Evropiane, për vitin 2012. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të levizjes " Vetvendosje", deputetja Alma Lama.

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryesues!

Edhe grupi jonë e mbështet Planin e veprimit për vitin 2012, mirëpo kemi edhe një propozim. Duke qenë se realizimi i Planit të veprimit të Kuvendit, për vitin 2011 dhe po kështu edhe për vitet paraprake kanë ndeshur vazhdimisht në mungesën e resurseve për t'u realizuar, siç është mungesa e ekspertizës jo vetëm për hartimin dhe shikimin e ligjeve, po kështu edhe për mbikëqyrjen e Qeverisë.

Propozimi ynë është që në këtë plan të përfshihet edhe iniciativa për ndryshimin e mënyrës se si bëhet buxhetimi edhe për Kuvendin e Kosovës. Unë mendoj që më e rëndësishme dhe më efikase që Kuvendi i Kosovës të nxjerrë një ligj i cili do t'ia mundësonte që buxhetin ta përgatisë vetë dhe jo ai të kalojë nëpërmjet Qeverisë. E thashë, mungesa e një buxheti adekuat është bërë problem ose pengesë për realizimin e Planit të veprimit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, zoti Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Edhe pse mendojmë se Komisioni i ka qitur në pjatë të Kuvendit për vitin 2012të gjitha sfidat që kanë dal prej raportit të ri edhe ato që nuk kanë mbërri, Kuvendi ose kjo legjislaturë që t'i implementojë prej sfidave që kanë dal nga raporti i kaluar i Komisionit Evropian, do të thotë, nuk kanë vendosur prioritete po i kanë qitur të gjitha, prapëseprapë mendojmë se duhet votuar dhe të shohim se çka ndodh më tutje.

Ideja kryesore është se pa vendosur prioritete Kuvendi vazhdimisht ka për të hasur në situatën në të cilën nuk mundet t'i adresojë të gjitha sfidat dhe t'i implementojë të gjitha ato temat të cilat ia qet vetes përpara. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupit Parlamentar Koalicionit Kosova e Re, deputetja Suzan Novobërdaliu.

SUZAN NOVOBËRDALIU: Faleminderit, kryesues!

Edhe Grupi Parlamentar Koalicioni për Kosovë të Re do ta përkrahë Planin e Veprimit të Kuvendit të Kosovës për Integritet Evropian, për vitin 2012. Faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Faleminderit!

Grupi parlamentar SLS, deputeti Sasha Millosavljeviq.

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala, gospodine predsedavajući!

I parlamentarna grupa SLS-a će podržati plan delovanja Skupštine Kosova za evropske integracije za 2012.godinu. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Kinolli, "6+".

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Edhe Grupi Parlamentar “6+” e përkrah dhe do ta votojë këtë Plan të Veprimit për Integritet Evropian, për vitin 2012. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Fjalën e ka kërkuar nënkryetari i Kuvendit, zoti Hamiti.

SABRI HAMITI: Faleminderit, zoti kryesues dhe nënkryetar i Kuvendit!

Unë dua të theksoj që së paku në nivelin deklarativ ky është një program të cilin të gjitha partitë politike të Kosovës edhe ato në Kuvend dhe jashtë Kuvendit e përkrahin.

Sa i përket edhe Komisionit edhe Ministrisë edhe Raporti i Progresit na thotë që kjo ka ndodhur, sepse ekziston një bashkëpunim i madh në mes të Ministrisë dhe Komisionit, e kam fjalën për ministreshën që e kemi këtu Çitakun edhe zotin Hazirin, i cili s’është këtu. Ajo që unë dua të them këtu është diçka tjetër. Janë universalitetet që këtu po quhen “norma” ose “standarde” ose “përgjithësimet” të cilat janë si masë. Megjithatë, vendet i kanë veçoritë e tyre dhe mënyrën e komunikimit e kanë të tyre, por ajo që mua më bën probleme të mëdha është gjuha edhe të folurit për këto çështje edhe ajo që e dëgjova sot këtu edhe ajo që e dëgjoj përditë, edhe në dokumentin që kemi përpara.

Dhe, unë po ju llogaris disa fjalë me qëllim, definitivisht, flisibiliteti, storia, agjenda, sfida, adresimi, implementimi, standardi, komplementare etj. Pse po i them? Të gjitha këto fjalë nuk e kanë të njëjtin kuptim në rrethanat ku vendosen, nuk e kanë të njëjtin kuptim. Secila prej këtyre fjalëve, kjo është si skemë- fjalë, që është bërë skemë dhe nuk e ka të njëjtin kuptim.

Prandaj, është mirë në tekstet shqip të përdoren fjalë që janë shumë, shumë më të kapshme edhe për njerëzit këtu edhe për ata me të cilët komunikojmë, sepse “storia” është mund të thuhet edhe tregim etj., por kjo është fjalë- skemë. Për veprime duhet fjalë të sakta, “agjenda” shikoni këta e thënë dikush e thotë si përmbajtje, dikush si rend dite, dikush si orar në kontekste edhe këtu të kolegëve që folën unë e gjeta në 3-4 mënyra. “Sfida”, kjo është një fjalë greke që ka hyrë te ne në gjuhën shqipe, në Kosovë krejt 10 viteve të fundit, kjo herë merr kuptimin e ballafaqimit, herë të sprovës, herë të problemit, herë të detyrimit, herë të detyrës, nuk është njësoj gjithherë dhe ka kuptime krejt ndryshme.

“Adresimi” dikur është për ta zbuluar, për të kuptuar diçka, për të përmendur, për të identifikuar edhe dikur për ta bërë qëllim. Tutje, “standardi” që është normë në gjuhën, na duhet për t’u bërë vend normal i bie shqip ose vend i zakonshëm për nevojat tona për me qenë standard nuk është për të shkruar në Mars ose në Hënë.

Kjo mënyrë e të menduarit ka të bëjë me qartësinë e planifikimit të çështjeve, zoti kryesues Haliti dhe zonja ministre edhe zoti Haziri që s’është këtu. Pse po them? Nuk do të thotë që pse është evropian, pse është... detyrim evropian, synim evropian që duhet klishetë të merren pa kuptime. Kur ne ta bëjmë jetën të pranueshme për nevojat tona dhe për interesa tona ne jemi evropian, po s’e bëjmë këtë s’jemi evropian. Dhe për fund unë kështu dua ta them, sepse e konsideroj veten në detyrën që e kam si deputet dhe në

komunikim me të tjerët. Zonjës ministresh unë i shpall mirënjohje për atë që më kanë thënë në Francë, në paraqitjen e saj rreth nevojave tash s'po them standardeve të Kosovës për bashkëpunim evropian dhe të përgëzoj.

Ta kam thënë kështu, dua ta them këtu. Pra, se vetëm ashtu, vetëm ...autenticiteti i nevojave e mbërrin edhe atë që synohet. Jo pse ju shtrohesh klisheve. Faleminderit, zoti kryesues!

KRYESUESI: Faleminderit!
Fjalën e ka zoti Hyseni.

Zoti Hydajet Hyseni e ka kërkuar fjalën.

HYDAJET HYSENI: Faleminderit, zoti kryesues!
Zonja dhe zotërinj deputetë,
I erdhi ashtu shtegu që ndoshta do t'i bie se do ta vazhdoja aty ku e la parafolësi.

Po, para se gjithash unë e përshëndes punën që është bërë në komision në hartimin e këtij plani të veprimit. Natyrisht e përshëndes edhe më parë punën që është bërë në përpjekjet tona konsensuale do të thosha për integrim evropian, që është me të drejtë të vlerësuar si prioritet mbi të gjitha prioritetet.

Por, do të dëshiroja që duke mbështetur gjithë atë që është bërë për të dëshmuar gatishmërinë tonë për kooperativitet e cila duhet të vazhdojë. Duke i shprehur po ashtu mirënjohjen gjithë atyre që janë angazhuar të na ndihmojnë në përpjekjet tona për integrim evropian. Të theksoj po ashtu nevojën që tani kemi ardhur në një fazë të tillë në të cilën do të duhej të dëshmonim edhe më shumë gatishmërinë tonë për të qenë jo vetëm objekt i dëgjueshëm, por për të qenë edhe subjekt i procesit për të qenë partner në procesin e integritetit të Kosovës dhe të rajonit në strukturat evropiane.

Dhe, kjo zonja dhe zotërinj, nuk mund të bëhet vetëm me shpirtin e kooperativitetit e të fleksibilitetit, por do të duhej edhe përgjegjshmëria, edhe ekzigjenca, edhe gatishmëria për t'u përballur me konstatimet që jo gjithmonë janë të bazuara dhe të drejta. Dhe, unë dua të ndalem pikërisht te kjo pjesa e fundit, pa mohuar ato konstatimet që na ndihmojnë e që i kemi udhërrëfyes dhe jemi pajtuar dhe e kemi planin e veprimit. Por, në planin e veprimit, zonja dhe zotërinj, nuk i shoh të jenë futur asnjë nga çështjet që janë perceptuar gabimisht ose janë pasqyruar gabimisht në Raportin e Progresit dhe të tilla janë shumë.

Aq shumë sa koha që kam në dispozicion nuk mjafton as për t'i përmendur. Prej faqes së parë deri në fund, ka një mori çështjesh që janë thënë më së buti të diskutueshme. I ka kontribuar kësaj përveç tjerash edhe shpirti ynë tej mase i bindur, i dëgjueshëm, i kujdesshëm për të mos e prishur me miqtë që është sindromë e të qenit rob. Por për fat të keq i kanë kontribuar edhe përveç avoketëve të imazhit të zi për Kosovën, i kanë ndihmuar edhe siç do të thoshte dikush "çobanët" tanë që për të realizuar ndonjë projekt të tyre kanë qenë në gjendje edhe të fabrikojnë fenomene të paqena në Kosovë, t'i

ekzagjerojnë ato, t'i nxijnë realitet jo gjithmonë të shkëlqyeshme në Kosovën e re e plotë plagë.

Është për ta analizuar dhe ky Kuvend është mirë ta bëjë këtë punë, për të parë si po hartohet Raporti i Progresit, kush po ndikon, kush po ndikon për të mirë, por edhe për të parë pse jo kush po ndikon për të nxirë imazhin e Kosovës dhe realitetin e ri në Kosovë? Ka segmente që quhen të shoqërisë civile, të cilat bëjnë gara se cili ka arritur më shumë të fusë një konstatim negativ për Kosovën, pa bazë ato që janë me bazë i falënderojmë.

Unë nuk mund të ndalem në të gjitha këto, por po ndalem vetëm do të thotë ku ka shembuj të tillë. Dua të insistoj vetëm që në Planin e veprimit të fokusohemi edhe në këto çështje dhe tua themi miqve tanë edhe konstatimet e tyre të gabuara dhe ata le të shikojnë si e bën punën administrata e cila paguhet mirë, e cila nuk është jashtë ndikimeve politike. Dhe në këtë kuadër pse të mos kërkojmë që të kemi edhe standarde të njëjta me fqinjët tanë.

Nëse flasim për standardet evropiane, nuk mund të jenë ato të ndryshme në një pjesë të Kosovës dhe të tjera në një pjesë tjetër të Kosovës. Ose të ndryshme brenda Kosovës dhe kreu të ndryshme jashtë Kosovës.

Unë ju lutem vetëm për të mos e zgjatur, se edhe jemi lodhur s'dua t'ju marr kohë, hidheni vëmendjen vetëm te kapitulli që flet për çështjet regjionale, ku është futur çështja e të zhdukurve, çështja e krimeve të luftës, e bashkëpunimit me Hagën etj. Është një njëanshmëri e pabesueshme, një njëanshmëri e cila mund të gjendet vetëm në dokumentet që prodhohen në qarqet antishqiptare që për ne janë aq të njohura. Unë nuk e kuptoj si ka mundur të lejohet që Raportin e Progresit të përvидhet një njëanshmëri e tillë? Flitet për 18 000 të zhdukur nga konfliktet në Bosnje e Serbi si thuhet, është fjala për Kosovën. Në raportet e tyre nuk janë këto konstatime dhe nuk flitet për të zhdukurit tanë dhe ne heshtim.

Flitet për krimet e luftës, por krimet e luftës nuk janë autorët e atyre krimeve të luftës që kanë ndodhur në Kosovë, flitet vetëm për një palë, për shqiptarët. Çka do të thotë kjo, kujt i kontribuon kjo dhe a duhet ta kemi lirinë që të themi me plot zërin "është gabim, nuk pajtohemi" ta themi natyrisht me argumente, ta themi edhe me miqësisht me besimin se do të korrigjohen, por heshtja jonë mund të jetë miratim dhe lehtësim i kësaj prirje për ne më tanimë të dëshmuar si të dëmshme?

Unë, prandaj duke mbështetur punën që është bërë edhe në hartimin e Planit të veprimit edhe në gjithë procesin e integritit, apeloj që të punohet prej fillimit në mbarim edhe në këtë segment dhe të mos lejojë Komisioni për Integritet Evropian që të gjitha çështjet të mendojë t'i zgjidhë vetë. Komisione të tëra që janë përgjegjëse janë lënë anash edhe në propozimin që keni përpara, vetëm bashkë mund të përballemi me një sfidë të tillë që është vërtetë serioze dhe ka të bëjë me fatin e Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Hyseni! Nuk ka të tjerë të paraqitur për diskutime.

Në sallë janë 76 deputetë. Votojmë tani. Faleminderit!

Me 68 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë “abstenim”, Kuvendi miratoi planin e veprimit të Kuvendit për Integritim Evropian, për vitin 2012, kuptohet me vërejtjet që u thanë dhe veçanërisht me vërejtjet e zotit Hamiti dhe zotit Hyseni. Faleminderit!

Pika 28 e rendit të ditës është:

28. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Legjislacion për emërimin e anëtarit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Komisioni për Legjislacion ka shqyrtuar propozimet e kandidatëve për emërimin e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Kuvendit i ka rekomanduar emërimin e tyre në seancë plenare.

Kryetari i Komisionit FunkSIONAL për Legjislacion, deputeti Arben Gashi e ka fjalën.

ARBEN GASHI: Faleminderit!

I nderuar nënkryetar,

Komisioni për Legjislacion, në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në bazë të Ligjit për Këshillin Gjyqësor dhe në bazë të Rregullores së Punës së Kuvendit, ka ndjekur procedurën për emërimin e anëtarëve të Komisionit dhe të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe ia propozon Kuvendit këta kandidatë:

1. Raime Rama Elezi, gjyqtare e Gjykatës së Qarkut në Prizren. Vjen nga radhët e komuniteteve pakicë jo serb.
2. Nebojsa Boriq, gjyqtar i Gjykatës Supreme të Kosovës, që vjen nga radhët e komunitet serb dhe
3. Salih Mekaj, kryetar i Gjykatës së Qarkut në Pejë, që vjen nga radhët e komunitetit shqiptar.

Këta janë 3 kandidatët që komisioni ia rekomandon seancës dhe duke marrë parasysh që nuk ka kundër kandidatë propozojmë që të votohet në bllok dhe të kryhet kjo çështje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Përfaqësuesit e grupeve parlamentare.

Emilija Rexhepi është paraqitur.

EMILIJA REXHEPI: Zahvaljujem, predsedavajući!

Dragi kolege poslanici,

I bošnjačkoj zajednici je jako važna podrška svih poslanika u Parlamentu Kosova oko imenovanja gospođe Rahime Elezi za člana Sudskog saveta Kosova iz razloga zato što ispunjava sve adekvatne uslove i kriterijume koji se od kandidata traže, kao i njeno dugogodišnje radno iskustvo kao sudija može koristiti u savetodavne svrhe u interesu vladavine prava naše države. Zahvaljujem se!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka tjerë të paraqitur. Shkojmë në votim që kërkohet me votim elektronik për miratimin e rekomandimit të Komisionit për Legjislacion për emërimin e anëtarëve të cekur më herët të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Në sallë janë 69 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tani. Me 61 vota “për”, 2 “abstenime”, asnjë “kundër”, Kuvendi emëroi tre anëtarë të Këshillit Gjyqësor të Kosovës me mandat 5 vjeçar.

Pika e 29 e rendit të ditës është:

29. Shqyrtimi i Strategjisë minerare të Republikës së Kosovës për periudhën 2012-2025

Ju kisha lutur më të vogël flisni se nuk po di, a po më bërtitni mu a po e lypni fjalën, a çka është puna? Këtë hall e kam, se nuk kam ndonjë problem tjetër. Faleminderit!

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri ka shqyrtuar Propozim-strategjinë minerare të Republikës së Kosovës, për periudhën 2012-2025 dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim dhe miratim. Fjalën e ka kryetari i Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, deputeti Zenun Pajaziti.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, kryesues!

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri e ka marrë këtë dokument të munguar të institucioneve të ekzekutivit deri më tash dhe e ka trajtuar dhe rekomandon me disa plotësime shtesë që të aprovojë Kuvendi, që të procedojë më tutje këtë strategji.

Më lejoni t’ju them që Komisioni ka trajtuar disa herë, ka pasur takime me Komisionin për Miniera dhe Minerale, me palët e interesit, një dëgjim publik, po ashtu edhe me ministrin që është prezent në sallë dhe i falënderojmë të gjithë ata që kanë kontribuar që të plotësohet dhe ky dokument të vijë deri në fazën finale këtu. Dhe, po ashtu pas dëgjimit publik, Ministria ka marrë disa sugjerime dhe ka bërë disa plotësime shtesë, të cilat i kemi inkorporuar me një rekomandim në disa pika të veçanta që kanë të bëjnë me tekst në faqet: 26, 33, 34 dhe 35 dhe konsiderojmë se me këto plotësime ky dokument tanimë ka do të jetë i përplotësuar, do të jetë i gatshëm për t’u implementuar nga institucionet përkatëse të ekzekutivit.

Unë i ftoj deputetët që ta mbështesin, ta aprovojnë këtë strategji. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Përfaqësuesi i Qeverisë, a dëshiron ta marrë fjalën?

E ka fjalën ministri i Zhvillimit Ekonomik, Besim Beqaj.

BESIM BEQAJ: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

E nderuara ministre,

Ne kemi paraqitur para jush strategjinë minerare, dokument i cili është diskutuar edhe në debat publik, edhe në komisionin. Gjatë kësaj kohe të debateve ne kemi arritur që t'i inkorporojmë të gjitha rekomandimet që kanë ardhur qoftë në debat, qoftë rekomandime të cilat kanë rrjedhë edhe në harmoni me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik.

Ai dokument të cilin neve sot do ta kemi për aprovim, është një dokument i punuar nga ekspertët e kësaj lëmie, njerëz të cilët janë njohës, institucionet që kanë marrë pjesë në këtë dokument janë Komisioni i Pavarur për Miniera, njëkohësisht edhe komisionet tjera, ndërmarrja “Trepça” dhe shumë e shumë profesionistë të kësaj lëmie, të cilët kanë dhënë maksimumin e tyre për një dokument orintimor, strategjik, afatgjatë.

Ajo çka mendoj që është me rëndësi të thuhet është se ky dokument ka qenë edhe njëherë në Kuvendin e Kosovës, në legjislaturën e kaluar, është kthyer dhe Ministria ka marrë për obligim që ta sjellë edhe njëherë këtë dokument në mënyrë që edhe ligjet të cilat janë aprovuar, siç është: Ligji për miniera dhe minerale të mundë të implementohet në tërësi konform strategjisë e cila është para jush sot për aprovim. Faleminderit! Unë i falënderoj të gjithë deputetët dhe të gjithë ata që kanë dhënë kontributin në përmirësimin e këtij dokumenti! Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Kryetarët e grupeve parlamentare e kanë fjalën ose përfaqësuesit.

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, zonja Berisha – Shala.

SALA BERISHA – SHALA: Faleminderit, kryesues!

Përsëritje ministra prezentë,

Të nderuar kolegë deputetë dhe ju të pranishëm,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar këtë dokument. Si grup parlamentar e mbështesim për shumë arsye. Kosovës i duhet një dokument i tillë strategjik. Strategjia e minierave është një prej dokumenteve më të rëndësishme, pra miratimi i kësaj strategjie del edhe si obligim nga Ligji për miniera dhe minerale. Neni përkatës përveç tjerash thotë: “asnjë autoritet publik nuk mund të miratojë ose zbatojë ndonjë plan urbanistik ose hapësinor, pa konsultim paraprak me këtë strategji”.

Ne e dimë se kemi miratuar një plan hapësinor të Kosovës pak muaj më parë, pra në mungesë të kësaj strategjie. Një nga dokumentet më të rëndësishme për zhvillimin ekonomik të Kosovës janë edhe potencialet tona minerale. Kosova është e pasur me vendburime minerale të llojeve të ndryshme me theks të veçantë, mineralet energjetike, siç është limiti, mandej mineralet metalore: plumbi, zinku, argjendi, hekuri, nikeli, kobalti etj. mirëpo këto vendburime nuk janë të hulumtuara sa duhet çka nënkuptohet se mundësia e zgjerimit me rezervat e tyre është e mundur.

Ky fakt është një lloj garantuesi për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, të cilin e synojmë të gjithë së bashku. Meqenëse, në strategji punohet që nga viti 2006 dhe mund ta merrni me mend prej asaj kohe nuk është arritur të aprovohet një dokument i tillë në Kuvend, nuk do të kisha hyrë të komentoj pse jemi në këtë pikë sa i përket sferës së

pasurive minerale. Por, megjithatë më lejoni ta ripërsëris edhe njëherë se segmenti i pasurive minerale e ka përjetuar një lloj koprracie nga ana e UNMIK-ut sa i përket përcjelljes së kompetencave tek vendorët.

Ndoshta, edhe kjo ka arsyeshmërinë e tillë pse është kthyer mandatin e kaluar dhe pse Kosovës i mungon një strategji për miniera? Mendoj se pikëmbështetjet e strategjisë ose një ndër shtyllat kryesore të saj janë: qymyri, nikeli dhe metalet e tjera dhe “Trepça” apo vendburimet e plumbit-zinkut. Që të tri këto shtylla përcillen dhe duhet të përcjelljen nga aspekti i qasjes strategjike afatgjate në pjesën komplementare siç është: arsimit dhe siç shkruhet në strategji- modernizimi i arsimit në këtë lëmi në Kosovë.

Të nderuar deputetë,

Në këtë dokument janë paraqitur edhe sfidat kryesore ekonomike në sektorin minerar, siç janë:

1. Zhvillimi i minierave të linjtit, përkatësisht neve momentalisht na mungon energjia elektrike dhe kjo ndërlidhet me këtë vendburim mineral.
2. Identifikimin e potencialit mineral dhe zgjerimin e aktiviteteve hulumtuese, siç thamë Kosova nuk e ka një hulumtim të duhur të vendburimeve minerale,
3. Reviltarizimi i aseteve fitimprurëse të kompleksit “Trepça” si dhe fillimi, përkatësisht konstituimi, shfrytëzimi dhe përpunimi i mineraleve në vend, sepse e dimë se për momentin nuk kemi përpunim final të këtyre mineraleve.

Të nderuar deputetë,

Strategjia minerare është një dokument bazë orientues, siç e tha edhe ministri për zhvillimin e këtyre resurseve në përputhje me rregullat dhe standardet ndërkombëtare për zhvillim të qëndrueshëm. Gjithmonë ky zhvillim i qëndrueshëm do të jetë në raport miqësor me ambientin, si dhe do të ketë reflektime të drejtpërdrejta në çështjen e zbutjes së çështjeve sociale.

Qeveria parashikon që zhvillimi i ardhshëm i shpejtë dhe i qëndrueshëm i Kosovës të mbështetet në shfrytëzimin dhe përpunimin e resurseve minerale, natyrore, si dhe me ngritjen e vlerës së tyre në tregjet ndërkombëtare, duke siguruar kështu shtimin e punësimit edhe gjatë përpunimit të industrisë nxjerrëse dhe përpunuese të mineraleve. Më lejoni t’i shkojmë pak a shumë do të mundohem shkurtazi, në faqen 27 të këtij dokumenti ku bën fjalë për potencialin ekonomik të sektorit minerar dhe vlen të përmendet, përveç tjerash, se për minierat e plumbit, zinkut dhe argjendit, përllogaritjet janë bërë me supozimin që në Kosovë nuk ka kapacitete metalurgjike për shkrirjen e koncentreve dhe prodhimin e metaleve me cilësi të lartë, ashtu edhe çfarë është situata aktuale.

Kjo domethënë se neve na duhet t’i joshim edhe investimet e huaja në mënyrë që ta përsosim edhe teknologjinë që të bëjmë finalizimin e këtyre pasurive për zhvillimin ekonomik të Kosovës. Resurset e konsideruara në vlerësimin e potencialit ekonomik janë grupuar sipas gjendjes së tyre aktuale të zhvillimit dhe kemi: minierat aktive,

vendburimet minerale në zhvillim, minierat më parë aktive apo të hulumtuara dhe vendburimet që presin për hulumtime të më tutjeshme.

Mandej, në faqen 38 e kemi analizën e aftësisë konkurruese ose sfot analizën, për të cilën nuk do të ju lodhi, sepse e kemi të gjithë dokumentin përpara dhe janë të paraqitura: përparësitë, dobësitë, mundësitë dhe rreziqet në këtë çështje. Vlen të përmendet, edhe në dokument thuhet, por edhe kjo le të përforcohet dhe të mbështetet nga Kuvendi, se Qeveria duhet të luajë rol vendimtar në proceset e ristrukturimit dhe organizimit të ndërmarrjeve minerare në vend me qëllim të rivitalizimit të tyre në mënyrë sa më transparente, ekonomikisht efikase duke rritur njëherësh edhe interesimin e investitorëve potencial.

Roli i shtetit në këtë drejtim është i garantuar edhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Veç tjerash, roli i shtetit duhet të jetë evident në zhvillimin e legjislacionit mineral, ne e kemi një Ligj për miniera dhe minerale për të cilin si komision kemi rekomanduar që të plotësohet dhe të ndryshohet. Mandej, sigurimin e transparencës, shfrytëzimin dhe ndarjen e të ardhurave nga shfrytëzimi i resurseve minerale, zhvillimin e mineraleve në sektorin e energjisë, revitalizimin e minierave të “Trepçës” etj.

E gjithë kjo do të ndikojë dukshëm në zbutjen e çështjeve sociale, po gjithmonë gjatë shfrytëzimit të këtyre mineraleve duhet t’i kemi parasysh raportet miqësore edhe me ambientin. Më lejoni krejt në fund, në faqen 59- te masat për zbatimin e strategjisë minerare ku paraqiten në këtë dokument, ku thuhet se për zbatimin e strategjisë minerare do të përgatitet programi për zbatimin e saj për periudhën 2012-2014. Ky program fokusohet në veprimet si në vijim. Nën një, plotësimi i bazës ligjore dhe rregullatore ku përfshihet edhe trajtimi i standardeve... qasjet për zonat e interesit të veçantë. Vëni re, kjo është shumë me rëndësi se një dokument për zonat e interesit të veçantë është punuar edhe nga Qeveria e mëparshme, përkatësisht ministrja e mëparshme që ka qenë drejtuese e atij sektori dhe është një dokument shumë i rëndësishëm që është një tregues i mirë në qoftë se bazohemi në të se do të kemi një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, mandej thuhet nën dy- ristrukturimi i “Trepçës” dhe përgatitja për investime private.

Ne para pak kohësh, ne si Kuvend i kemi miratuar 3 ligje në pako të cilat i përforcojnë veç këto masa që janë si masa zbatuese për këtë strategji dhe e kemi miratuar Ligjin për ristrukturimin e ndërmarrjeve me interes të veçantë.

Mandej, zhvillimin e minierës së re në Sibovc, përgatitja e një plani për fillimin e tenderimit për zonat e interesit të veçantë. Ne e dimë se me Ligj për miniera se si shkon procedura e tenderimit për këto zona të interesit të veçantë. Zhvillimi i kapaciteteve arsimore ka dalë edhe nga dëgjimi publik pra si rekomandim që Qeveria të ketë një qasje tjetër në zhvillimin e këtyre kapaciteteve, jo në sistemin arsimor si është tani. Mandej, themelimi i Institutit Gjeologjik, që e dimë se këtë hap veç e ka kryer Qeveria, e kemi konkursin që është hapur për kryeshef të këtij Instituti. Themelimi i Muzeut Shtetëror, dihet se është bërë edhe themelimi i këtij muzeu, përshpejtimi i hulumtimeve të rezervave minerale, sigurisht se do të bëhet gjatë funksionimit të këtij Instituti Gjeologjik, promovimi për tërheqjen e investimeve. Dhe krejt në fund ju kërkoj, të nderuar kolegë

deputetë, ta mbështetni këtë dokument, sepse Qeveria në këtë drejtim është në hap përpara para së të bëhet miratimi i këtij dokumenti duke i pasur parasysh këto masa për zbatimin e kësaj strategjie, veçse gjysma prej tyre kanë përfunduar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, zoti Lutfi Zharku e ka fjalën.

LUTFI ZHARKU: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i LDK-së e ka analizuar strategjinë dhe shpreh disa rezerva në disa çështje e në veçanti mbi qasjen gjatë hartimit të strategjisë së sektorit minerar, rolin e rentës minerare, si dhe qasjen ndaj investimeve në këtë sektor.

Strategjia minerare duket se është një kombinim apo një përzierje e dy qasjeve, njëra është aspekti i zhvillimit të sektorit minerar, nëse i abstrahojmë subjektet aktuale, si dhe tjetra është nga aspekti i analizimit të subjekteve ekonomike, që aktualisht veprojnë në këtë sektor. Në këtë mënyrë nga dokumenti nuk është plotësisht e qartë se cili është qëllimi primar i strategjisë, ndërmarrja e masave që sektori minerar, gjegjësisht rezervat tona minerale të pashfrytëzuara dhe të cilat nuk janë në pronësi të subjekteve aktuale që veprojnë në këtë sektorë, të bëhen bartës i zhvillimit ekonomik të vendit, apo qëllimi i strategjisë është analizimi i situatës aktuale të subjekteve, të cilat aktualisht veprojnë në këtë sektor, me theks të posaçëm në “Trepçë” dhe KEK dhe ringjallja e tyre?

Kështu me këtë përzierje qasjesh kam përshtypjen se humbet qëllimi primar i strategjisë që ky sektor të zhvillohet më tutje, por fokusohemi në atë se si strategjia t’i përshtatet zhvillimit të subjekteve aktuale, ekonomike, qofshin ato publike apo private. Gjetja e mënyrave për revitalizimin e “Trepçës” apo zhvillimi i minierave aktuale apo të ardhshme për shfrytëzimin e qymyrit nga KEK-u, duhet të jenë subjekt i një dokumenti apo strategjie të posaçme. Siç dihet LDK-ja edhe më parë ka kërkuar që “Trepça” të rregullohet me ligj të veçantë, kurse KEK-u dhe minierat e saj duhet të trajtojnë si pjesë përbërëse e zgjidhjes së problemit të energjisë elektrike.

Prandaj, strategjia nuk duhet të merret me proceset e ristrukturimit dhe organizimit të ndërmarrjeve minerare. Strategjia minerare duhet të fokusohet në rregullimin ligjor dhe institucional të këtij sektori, analizën e potencialit minerar që është paraqitur mjaftë mirë në këtë dokument, si dhe paraqitjen e rrugës apo mënyrave se si ky sektor të bëhet bartës i zhvillimit ekonomik të vendit dhe të lirohet nga qasja ndaj zhvillimit të sektorit minerar vetëm përmes subjekteve ekonomike që aktualisht veprojnë në këtë sektor.

Strategjia duhet të reflektojë zhvillimin e sektorit minerar në përputhje me strategjinë e zhvillimit të sektorit privat e cila bazohet në zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Në këtë aspekt rëndësi e posaçme duhet t’i jepet shfrytëzimit të mineraleve jo metalore dhe materialeve të ndërtimit, të cilat i kanë parakushtet më të favorshme për t’u zhvilluar.

Së dyti, strategjia nuk analizon rentën minerare si faktor kyç nxitës të shfrytëzimit të pasurive natyrore. Renta minerare është çmimi për shfrytëzimin e mineraleve, prandaj lartësia dhe përcaktimi i saj janë i një rëndësie të posaçme për zhvillimin e këtij sektori.

Strategjia duhet të definojë qartë se cili është roli primar i rentës minerare, mbushje e buxhetit, gjegjësisht aspekti fiskal, apo tërheqja e investimeve, qofshin vendore apo të huaja.

Pa dyshim se inkurajimi i investimeve duhet të ketë përparësi absolute ndaj trajtimit të rentës minerare si faktor fiskal. Por, strategjia na jap një qasje plotësisht të kundërt në pjesën ku analizohet potenciali ekonomik i sektorit minerar.

Sipas strategjisë, në efektet makro-ekonomike të sektorit minerar për një periudhë 13 vjeçare, që vlerësojnë në 7.6 miliardë euro, renta minerare merr pjesë në 1.4 miliardë, gjegjësisht 18.2% .

Kurse të gjitha investimet, qofshin rekonstruime, zhvendosje dhe investime lokale, marrin pjesë me 1.07 miliardë euro, gjegjësisht 14%. Kur kësaj i shtojmë edhe taksat hyrëse të vlerësuara për afër 2.5 miliardë euro apo 32% , situata bëhet edhe më e rëndë.

Këto shifra na japin të kuptojmë se strategjia jep qëllim primar rentës si faktor fiskal dhe të taksave dhe lë pas dore tërheqjen e investimeve.

Natyrisht që me këtë qasje as nuk do të zhvillohet sektori në mungesë të investimeve si dhe për pasojë nuk do të ketë kurrfarë rente dhe taksa tjera për arkëtim.

Përpos kësaj strategjia do të duhej të përmbante një pasqyrë orientuese të rentës minerare sipas llojeve të minerale, përfshirë kritere se si janë përcaktuar ato.

Siç çështje e tretë është promovimi i sektorit minerar, gjegjësisht tërheqja e investimeve, qofshin ato vendore apo të huaja. Strategjia në mënyrë të përgjithësuar e thekson promovimin e investimeve si faktor i zhvillimit, por nuk sqaron se cilat masa do të ndërmerren për të rritur nivelin e investimeve në këtë sektor, përpos që përsëri koncentrohet në “Trepçë” dhe në KEK.

Prandaj, strategjia në mënyrë të saktë duhet të elaborojë se çka do t’i ofrohet një investitori potencial në këtë sektor, duke filluar nga lartësia dhe mënyra e përcaktimit të rentës minerare e deri te ofrimi i kushteve specifike për këtë sektor.

Në fund, strategjia duhet që në mënyrë decitive të përcaktojë se zhvillimi i sektorit minerar do të bazohet ekskluzivisht në investime që vijnë nga sektori privat, në principet e tregut të lirë, pasi që disa formulime, si ai në faqen 42, që besoj se është një lëshim teknik, thotë se industria minerare do të jetë bazë e zinxhirit të vlerave të ekonomisë shtetërore, e vë në dyshim principin themelore të ekonomisë sonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, zoti Visar Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” ka shqyrtuar strategjinë minerare të dorëzuar nga Qeveria dhe po e them në fillim që ne jemi kundër kësaj strategjie, pra do ta votojmë “kundër” për arsyet që do t’i përmend.

Nuk jemi “kundër” për shkak se mendojmë se Kosova nuk duhet të ketë strategji minerare, mirëpo jemi kundër për shkak se mendojmë që vërtet Kosova nuk duhet të ketë çfarëdo strategjie minerare. Jemi kah flasim për një sektor i cili është jashtëzakonisht i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të Kosovës dhe rrjedhimisht trajtimi i tij me kaq jo seriozitet nga Qeveria na bën që të jemi kundër kësaj strategjie.

Në pjesën hyrëse të strategjisë, pra konstatohet me të drejtë që resurset minerale kanë rëndësi të madhe në zhvillimin e një vendi. Strategjia afatgjate e çdo shteti mbështetet me këto pasuri kur ajo i posedon dhe pastaj në vazhdim thuhet që në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës legjislacionin minerar duhet të përcaktojë në mënyrë të qartë pronësinë e shtetit të Kosovës mbi pasuritë minerare.

Në tekstin e strategjisë këto konstatime harrohen dhe në resurse minerale Kosova me këtë strategji, në fakt bëhet rrogëtar në pronën e vet.

Linjiti, plumbi, zinku, argjendi, ari e të tjera, respektivisht KEK-u dhe “Trepça” janë pasuria dhe potenciali kyç zhvillimor në këtë sektor. Zhvillimi i KEK-ut dhe “Trepçës” do të përcaktojë edhe zhvillimin e resurseve minerare dhe realizimin e kësaj strategjie.

Strategjia nuk ka mbështetje në zhvillimet aktuale në këto organizata dhe kjo e bën strategjinë të pareaalizueshme. Kjo është evidente, sidomos kur bëhet fjalë për metalet me ngjyra.

Agjencia Kosovare e Privatizimit në bazë të ligjit numër 04/L-035 për riorganizim e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre e ka filluar procedurën e riorganizimit të “Trepçës”.

Qëllimi primar i këtij administratori, ose si administratorit që përcaktohet me ligj, nuk është sanimi, konsolidimi dhe aftësimi i ndërmarrjes për afarizëm, por sigurimi i mjeteve për pagesën e kreditorëve pretendent.

Këshilli i kreditorëve ka rol vendimtar në aprovimin e planit për riorganizim dhe implikim drejtpërsëdrejti në realizimin e planit dhe afarizmit të ndërmarrjes.

Në rastin e “Trepçës” Këshilli i kreditorëve do të përbëhet prej kompanive nga Serbia, Greqia, Bullgaria dhe Franca. Gjithë kjo procedurë e riorganizimit të “Trepçës”

planifikohet të zgjasë për 3 vjet dhe prej këtyre pasurive pak do të ketë dobi shteti i Kosovës.

Natyrisht që tash ministri do të na thotë, siç e ka thënë në Komision që Qeveria e Kosovës po synon që ta bëjë Qeverinë e Kosovës, pra Kosovën si kreditorin kryesor në këtë, mirëpo me këtë synim ministri nuk ka garantuar se do të jetë i suksesshëm në këtë drejtim.

Kjo strategji nuk i merr parasysh fare programin e menaxhmentit të “Trepçës për realizimin e fazës së dytë të zhvillimit i cili është aprovuar në vitin 2007.

Në përgatitjen e këtij programi është angazhuar një grup i madh i ekspertëve të “Trepçës.” Realizimi i këtij programi do të siguronte modernizimin e minierave ekzistuese, hapjen e minierave të reja, rekonstruktimin, respektivisht ngritjen e kapaciteteve metalurgjike dhe të kapaciteteve për prodhimin e plehrave artificial nga gazat metalurgjik.

Nga kjo strategji është kalkuluar që kur të realizohet kjo pra do të eksportohej diku afër 400 milionë euro në vit në bazë, natyrisht të çmimeve për këto produkte që kanë qenë atëherë në treg.

“Trepça” do të bëhej prodhues domethënës i metaleve të pastërtisë së lartë, plumbit, zinkut, argjendit, arit, indiumit, kadmiumit dhe bismutit e më vonë edhe të metaleve të rralla siç janë germaniumi, seleni, teluri dhe të tjera.

Për realizimin e këtij programi është kalkuluar edhe atëherë që nevojiten 176 milionë euro në periudhë prej 5 vjetëve. Në program është propozuar edhe konstruksioni financiar.

Në fund të vitit 2005 ka përfunduar faza e parë e rekonstruktimit të “Trepçës” dhe ka filluar punua provuese, në ndërkohë janë blerë makinat bashkëkohore produktive dhe është lëshuar në funksion sistemi i hidro-mbushjes me hi nga KEK-u. Në këtë nuk ka qenë problemi ose nuk ekziston më problemi teknik dhe teknologjik dhe minierat nuk kanë qenë kurrë më të përgatitura në këtë aspekt për prodhimin me kapacitet të plotë. Janë pranuar një numër i konsiderueshëm i punëtorëve të rinj dhe me aftësinë e tyre ishte dashur të mërihej kapaciteti i plotë.

Me çmimet aktuale me bursën e metaleve, minierat do të siguronin mjete për financim në masë të madhe të programit zhvillimor të paraqitur. Problem real që mbetet është zgjedhja e statusit të “Trepçës”, të punëtorëve të saj të moshuar, depolitizimi i “Trepçës” dhe zgjedhja e menaxhmentit profesional të cilën “Trepça” aktualisht nuk e ka.

Për sa i përket sektorit të energjisë dhe sektorit, domethënë, të linjitit, ne konsiderojmë që duhet doemos të themelohet Korporata e Linjitit e menaxhuar nga një institucion shtetëror konform trendëve evropiane.

Qeveria e Kosovës do të duhej të jetë aksionare kryesore e kësaj korporate ku do ta mbante tërë linjitin e Kosovës dhe tërë pasurinë e linjtit të Kosovës në pronësi publike.

Nevojat e tregut për linjit janë të mëdha dhe Kosova duhet të planifikojë pasurimin e linjtit në një nga vendburimet për t'i ofruar tregut vendor dhe të jashtëm lëndë të parë djegëse, në mënyrë që t'i mbrojnë pyjet nga prerja masive.

Duhet po ashtu të stimulohen investimet në kimizimin e linjtit, tharjen e tij, briketimin dhe prodhimin e produkteve tjera për konsum të gjerë.

Strategjia në asnjë mënyrë nuk i adreson çështjet që kanë të bëjnë me privatizimin e fushave qymyrmajtëse për aktivitete të vogla minerare.

Shfrytëzimit të qymyrit në Kosovë, përmes metodave të djegies nëntokësore insitum, e cila është një qasje e re, u është në duar të kompanive të ndryshme botërore që të bëjnë analiza vetjake të cilat pastaj po e vënë Kosovën në përgjithësi ose përmes Qeverisë së Kosovës, në pozitë të palakueshme në proceset e vendimmarrjes për zhvillimin e këtyre projekteve.

Në strategji nuk ofrohet asnjë orientim zhvillimor për fushat qymyrore të Dukagjinit, të Drenicës, por vetëm ofrohen përshkrime jo të mjaftueshme për këto fusha qymyrmajtëse.

Nga teksti i strategjisë rrjedh se Kosova pak a shumë heqë dorë nga programi i prodhimit të energjisë elektrike nga linjiti dhe bëhet vetëm spektator në këtë program.

Programi i detajuar për “Trepçën” është thjeshtësuar deri në banalizim, duke konstatuar: “ të zhvillohen aktivitete kërkimore me shpejtësi në mënyrë që të rritet baza e rezervave metalurgjike në vend”. Kjo paraqet një qasje plotësisht joprofesionale nga ana e propozuesit, ngase hulumtimet gjeologjike nuk mund të realizohen shpejt, por e kanë dinamikën e vetë teknike.

Për minierat e plumbit, zinkut dhe argjendit përlllogaritjet janë bërë me supozimin që në Kosovë nuk ka kapacitete metalurgjike.

Me këtë strategji është hequr dorë nga nevoja dhe plani që Kosova të prodhojë metale bazë me pastërti të lartë, siç janë: plumbi, zinku, argjendi e të tjera dhe metale të tjera. Në strategji nuk janë përfshirë metale të ralla që gjenden në xehe të “Trepçës”, indiumi, germaniumi, soleni, teluri që i përmenda më lart.

Për indijum janë bërë përgatitje të nevojshme dhe në kuadër të rekonstruktimit të metalurgjisë së zinkut do të prodhoheshin diku deri në 10 mijë kilogram indium.

Në strategji thuhet që zhvillimi i sektorit minerar duhet të realizohet në harmoni me standardet evropiane dhe me planin nacional zhvillimor, ndërkohë që ne e dimë që plani nacional zhvillimorë kjo Qeveri nuk ka.

Në strategji kudo që ofrohen numra të kalkuluar apo të supozuara janë marrë nga versioni i dokumenteve të vitit 2005, 2009 ose 2010, por ato shifra ishte dashur të rinovohen, ngase aktualisht të gjitha këto shifra janë krejtësisht tjera.

Po ashtu të dhënat në tabelën 9.1, ku flitet për rentat minerare janë vetëm për të dëshiruar. E dimë që renta minerare apo tantiema tash ... linjiti është 0.26 centë, ndërkohë që me programin e Kosovës së Re propozohet që kjo të ngritet deri në 75 centë apo 0.75 euro.

Në përmbledhje të kontributeve makro-ekonomike kanë hyrë edhe mbi 600 milionë euro për investime të cilat kryesisht do të shpenzohen për import të pajisjeve.

Në strategji nuk jepen politika të qarta lidhur me vazhdimin apo edhe bllokimin e operimeve minerare në afërsi të shtretërve të lumenjve. Në këto rrethana vendimet e rëndësishme lidhur me shfrytëzimin e rërës dhe të zhavorrit në Kosovë, merren pa analizë dhe alternativa për zëvendësimin e këtyre resurseve.

Me strategjinë nuk është hartuar politikë e cila do ta rregullonte planifikimin dhe menaxhimin e hapjes së aktiviteteve të reja përmes gurorëve në Kosovë. Pasojë e kësaj do të bëhet shfrytëzimi jo i qëndrueshëm i materialeve gjeologjike ndërtimore, gëlqeroreve, bazalteve, diabazalteve dhe të tjera dhe do të vazhdojë operimi ilegal në lëmin e shfrytëzimit të gurëthyesve.

KPMM-ja ka hartuar planin e gurorëve të Kosovës, si një dokument politik mjaftë të avancuar por hartuesit e strategjisë nuk e kanë parë të arsyeshme që ta inkuadrojnë këtë plan në strategjinë minerare.

Në strategji po ashtu nuk janë përfshirë paraqitjet e mineralizimeve të uranit në Kosovë e për këtë duhet të ketë përcaktim shtetëror strategjik duke iu deklaruar se a do të lejohen kërkime të mëtutjeshme apo do të vendoset embargo në këto kërkime?

Në strategji po ashtu mungojnë edhe qëndrimet lidhur me orientimet strategjike që do të duhej të adresoheshin në këtë sektor.

Përfitimet e Kosovës nga aktivitetet minerare sipas viteve ato në kuadër të ndonjë dinamike globale, gjë që është natyrisht shumë e rëndësishme para se të miratohet një strategji, kërkesat e sektorit të minerar për investime sipas një dinamike globale, adresimi i ndotjeve historike dhe çështja e trajtimit të mbetjeve xehtare si potencial i cili nënshtrohet lejeve minerare. Mirëpo, një çështje shumë e rëndësishme e cila nuk adresohet në këtë strategji, ose adresohet në mënyrë të dëmshme, është edhe pronësia që do ta ketë shteti i Kosovës mbi resurset minerare të Kosovës.

Pra, kryekëput strategjia një farë mënyre bazohet në privatizim apo në futjen e kapitalit privat... mirëpo Qeveria e Kosovës sipas deklaratës së ministrit nuk ka kurrfarë plani deri në ç'masë do të mbahen ose çfarë përqindje të aksioneve Qeveria planifikon t'i mbajë

nën pronësi publike nën pronësi të vet po që se ndodhë ky partneritet publiko privat siç po quhet.

Pra Qeveria në një farë mënyre është përgjigjur në Komision që tregu do ta vendosë këtë. Mirëpo, ata që e njohin tregun e dinë që tregu mund ta vendosë çmimin e aksionit, por jo edhe sasinë apo përqindjen e aksionit që Qeveria mund të planifikojë të shesë. Pra, kjo është dashur të bëhet me një vendim të Qeverisë

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Ymeri!

Në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, zoti Gjini e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Mendoj se, çështja e parë që do duhet thënë që një strategji e cila vjen prej Qeverisë, duhet t'i reflektojë politikat e Qeverisë për atë sferë ose për atë temë. Dhe ky dokument të cilin e kemi marrë ne, nuk reflekton një gjë të tillë për shkak se nuk është e qartë se cilat janë politikat e Qeverisë, cila është ambicia e Qeverisë në këtë drejtim.

Aq më tepër na prezantohet se këtë strategji e kanë hartuar ekspertët. Ekspertët mund ta hartojnë strategji, mirëpo Qeveria e Kosovës e cila është votuar në Kuvend dhe që e mbanë shumicën në Kuvendin e Kosovës, duhet të reflektojë me vendimet e veta, me qëllimet e veta çka synon të bëjë? Për çka strategjia ?

U tha edhe pak më herët në mënyrë pak më ndryshe, unë po them edhe një herë çka të bëjë? Çka bën strategjia? Strategjitë janë mënyra për të shkuar prej pikës a, në pikën b, kur pika a, është tepër e qartë edhe pika b, është tepër e qartë si synim. Në këtë strategji ne nuk e shohim një gjë të tillë edhe mendojmë se lirisht mund të thuhet se as që është strategji.

Një çështje tjetër të cilën dua ta përmend kur diskutojmë për strategjinë minerare të Kosovës, është se për shumë vite populli i Kosovës është mbajtur me shpresë, për shumë vite popullit të Kosovës i është thanë se krejt ish Jugosllavia është ndërtuar me minerare tona, me "Trepçën" e me minerare tona. Edhe që shumë vite pas luftës nuk po mund aspak Kosovë të ndërtohet me këto minerare tona, duke e ditur që i kemi.

Do të thotë ne nuk e kemi të qartë, Qeveria e Kosovës a do t'i ruajë, a do t'i shfrytëzojë qysh do t'i shfrytëzojë? A dëshiron t'i japë me qira a çka do të bëjë? Është një pësjtjellim tepër i madh në këtë strategji dhe ne nuk e shohim qëllimin, cili është qëllimi, për sa kohë çka duhet të ndodhë?

Në këtë strategji prapë u përmendur pak më përpara një temë të cilën unë e kam përmendur në emër të Grupit Parlamentar, në foltore të Kuvendit të Kosovës e ajo është tema e gurthyesve. E kam përmendur se kompanitë në Kosovë shtrojnë autostrada edhe ende kanë licenca për hulumtim, autostradat po përfundojnë dhe Komisioni i Pavarur i Minierave u lëshon licenca për hulumtim, asnjëherë për eksplorim.

Munden ta merrni me mend se cili është dallimi mes hulumtimit dhe eksplorimit, për ta bërë shumë më të qartë kur licenca jepet për hulumtim nuk paguhet taksat të gjitha llojeve, ndërsa kur licenca jepet eksplorim, paguhet taksat e të gjitha llojeve. Do të thotë te ne e kam përmendur në foltore të Kuvendit, ka krim të organizuar në këtë drejtim, e tani jam edhe më i bindur se ka krim të organizuar, sepse edhe pse është përmendur në foltore të Kuvendit të Kosovës, prej një grupi parlamentar, Qeveria e ka futur kryet nën rërë edhe as që është marrë më me këtë temë, as që e ka përmendur, as që i ka shkuar ndërmend dikujt të thotë hajde ta vërtetojmë të paktën se a ka diçka të vërtetë nga kjo punë.

Dhe në këtë strategji minerare asnjë fjalë nuk përmendet për një pasuri që është jashtëzakonisht e madhe, në një vend ku shtrohen me qindra kilometra rrugë, guri shndërrohet në pasuri, mund ta matni, mund ta llogaritni me metra kub se për çfarë pasurie po flitet tani.

Çështje tjetër të cilën duhet ta përmend definitivisht është edhe çështja e paraqitjes. Kur ju thashë se populli i Kosovës, me dekada është mbajtur me shpresë se pasuria jonë minerare është e tillë, aq e madhe sa mundet ta bëjë Kosovën një shtet shumë të prosperuar, për të ngrenë me lugë të arit ose të argjendit.

Qasja joserioze tani e Qeverisë së Kosovës për këtë strategji të bën të bindësh se ndoshta Qeveria ka zbuluar diçka tjetër që krejt çka i kemi thënë vetes ne nuk është e vërtetë, që pasuria të cilën e kemi nuk është në të vërtetë ose që Qeveria nuk e ka në plan të merret me këtë temë. Nuk mund për shpresën më të madhe për zhvillim ekonomik të qytetarëve të Kosovës, nuk mund për pasurinë më të madhe që e kemi jo njerëzore, po flas, në aspektin jo, nuk po flas për pasurinë njerëzore, të kemi paraqitje 20-sekondëshe në fund të seancës pa asnjë seriozitet të cilin do t'ia jepte një vend tjetër. E kam pak mërzi të bëj krahasime, mirëpo nuk kam qare pa e bërë një krahasim. Paramendoni një vend i cili është i pasur me naftë edhe e bën një strategji të naftës për 13 vjet të ketë këso shtete, ta këtë situatën të cilën paraqitja e Qeverisë është 20-sekondëshe edhe një farë forme votoni se mirë e kanë bërë disa ekspertë.

Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës nuk e voton këtë strategji se nuk është strategji, përpos që nuk është strategji nëse do të implementohet si e tillë do t'i bëjë dëm Kosovës në të ardhmen, nuk garanton ardhmëri të mirë për Kosovën dhe në anën tjetër vetëm çka hap mundësi që vendimet të cilat janë në dëm të Kosovës, të justifikohen me përshtatshmëri, me strategjinë të cilën e ka votuar Kuvendi.

Ne i ftojmë edhe deputetë tjerë të Kuvendit që mos e votojnë, për shkak se një strategji që po votohet për 13 vjet me siguri se do të rishikohet në më pak se një ose dy vjet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar Koalicioni Kosova e Re, deputetja Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, nënkryetar!

Përshëndetje për dy ministrat,

Duke marrë parasysh se Kuvendi i Kosovës edhe në mandatin e kaluar e ka pas këtë strategji minerare, mirëpo për arsye të mungesës së një numri të ligjeve të cilat kanë qenë të pa miratuara në mandatin e kaluar, do të thotë për arsye të Rregullores 2005/48, atëherë ky Kuvend ia ka kthyer Qeverisë së kaluar strategjinë për minerare.

Mirëpo në këtë strategji ne kemi diskutuar edhe tri herë në mbledhjen e Komisionit Parlamentar dhe mund të themi se është një strategji përafërsisht identike me strategjinë e kaluar. Mirëpo edhe ministri është këtu prezent, i kemi thanë mjaft qartë prioritetet çfarë është dashur t'i ketë një strategji kanë dalë prej faqes 33 përmbropa, ndërsa data baza sa ka potencial minerar Kosova është qitur përpara, mirëpo kjo mund të rregullohet prapëseprapë se ka mundësi të rregullohet këtu prej këtij Kuvendi.

Në esencë, Ministria e Zhvillimit Ekonomik e ka sjellë këtë strategji, mirëpo duke marrë parasysh se ne kemi amendamentuar njëherë pako të ligjeve të AKP-së dhe Ligjit për ndërmarrje të cilat japin mundësi më të mirën çështjes së kompleksit "Trepça" mund të themi se prapëseprapë strategjia si strategji ka mundësi që të jepen disa rekomandime prej Kuvendit të Kosovës se Kuvendi është ai i cili jep votën e fundit strategjisë për miratim nga ana e Qeverisë, t'i jepet mundësia që në këtë strategji të qitet një vizion pak më i qartë se është thënë po është thënë shumë në mënyrë të shkurtuar.

Ndoshta, unë po them prapë se prapë është problemi që duhet të kemi kujdes gjatë hartimit të strategjive, sidomos në këtë rast që është strategjia deri në vitin 2025. Mirëpo mund t'i epet një rekomandim që misioni dhe vizioni i kësaj strategjie është që sektori minerar në periudhën 2012 – 2025 të zgjerohet nëpërmes investimeve të huaja se asnjë shtet nuk mund të investoj në sektorin e minierave dhe minerareve se kthimi bëhet shumë vonë.

Çështja e rentave minerare u potencua mjaftë mirë këtu në diskutim, mirëpo ajo në bazë të Ligjit për miniera dhe minerare caktohet dhe vjen prapë se prapë në seancë plenare.

Objektiva strategjike për sektorin minerarë unë them edhe një herë se mund të epet një rekomandim çka është qëllimi i Qeverisë, mirëpo Qeveria prapëseprapë është ajo e cila ka marrë mandatin nga qytetarët dhe në fund për dështimet e saj ajo prapë do të marrë votë negative nga qytetarët. Kjo është esenca, Qeveria e ka votë besimin e qytetarëve dhe në fund donë të ndëshkohet nga vetë qytetarët e Kosovës për një projekt o të mirë o të keq.

Edhe një herë them se ka mundësi që në fund të kësaj strategjie të jepen 2 – 3 rekomandime për arsye se është strategji e cila ministri prapë se prapë do të ketë një biznes plan të vetin apo një planifikim më të qartë për një afat 3 vjeçar çka do të ndodhë në sektorin minerar se për ndryshe është shumë vështirë të zbatohet kjo strategji. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të SLS, deputetja Kostiq.

BISERKA KOSTIĆ: Zahvaljujem, gospodine predsjedavajući!

I parlamentarna grupa Samostalne liberalne stranke razmotrila je strategiju za rudnike i minerale u periodu od 2012 – 2025. godine i podržaće usvajanje istu. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit!

Grupi Parlamentar “6+”, nuk janë paraqitur.

Fjalën e ka deputeti Haxhiu.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar ministra,

Kjo strategji parasheh që Qeveria të angazhohet në mënyrë aktive në procesin e rishtruktimit të kompleksit “Trepça”, i cili proces do të orientohet në drejtim të tërheqjes interesit sa më parë të investimeve me qëllim të shfrytëzimit mineral dhe përpunimit të tyre dhe realizimin e përfitimeve për vendin me çka do të krijohej edhe mundësia për punësim dhe shtimin e numrave të punësuarve.

Një plan masash dhe aktiviteteve përfshinë një orar për zbatimin e kësaj politike në periudhë ...

Kjo strategji parasheh në mënyrë decisive zhvillimin e “Trepçës”. Dhe kur flasim për strategjinë nuk do të ishte mirë zoti Ymeri, të jepni konstatime të pasakta sa i përket menaxhimit të “Trepçës” dhe duke u thirrur në emër të një grupi të ekspertëve të vitit 2007, të udhëhequr në atë kohë nga ish drejtori Nazmi Mikullovc, tani anëtar i “Vetëvendosjes”, i cili e ka futur “Trepçën” në një borxh prej 4 milionë e gjysmë euro dhe duke u thirrur tani në një keqmenaxhim ku për herë të parë “Trepça” pas 30 vjetëve arrin të operojë me një plan biznesor pozitiv.

Prandaj, këto konstatime që i tha zoti Ymeri për “Trepçën” nuk konstatojnë, për shkak se anëtar i atëhershëm i cili arriti të favorizohet si ekspert, anëtar i atëhershëm i menaxhmentit “Trepça”, ky menaxhment ka arritur që për herë të parë “Trepçës” t’ia shlyejë borxhet e menaxhmentit të atyre ekspertëve” dhe të operojë tani me një bilanc pozitivë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Replikë, zoti Ymeri.

VISAR YMERI: Së pari Bekim, konstatimet që konstatojnë, t’i mund të mos pajtohesh, por konstatimet konstatojnë s’ mund të thuhet që konstatimet nuk konstatojnë. Pra, kujdes pak çka po flet.

E dyta, unë kur fola për programin e ekspertëve të “Trepçës” iu referova një programi të caktuar i cili është bërë prej ekspertëve të “Trepçës” për ta shpëtuar “Trepçën” nga keqpërdorimeve për ta sjell “Trepçën” në një kompani, për t’ia kthyer kapacitetin që e ka pasur, edhe një kompani profitabile.

Pra, mosrealizimi i këtij plani natyrisht që e le “Trepçën” të mangët. Ti po thua që i kanë shlye borxhet, krejt qëllimi paska qenë t’i shlyej borxhet a apo ta bëjë “Trepçën” një kompani që siç e përmendi edhe Ardian Gjini më herët ka qenë vërtetë ndërmarrje e cila e ka zhvillua jo vetëm ekonominë e Kosovës, por krejt ekonominë e Jugosllavisë.

Tash “Trepça”, jo që s’po i shërben Kosovës, po në fakt është një kompani e cila vazhdimisht po na paraqitet neve si problem. Edhe nuk po e di për çfarë suksesi po flet ti të këtij menaxhmenti.

KRYESUESI: faleminderit!

Kundër -replikë një minutë, Bekim Haxhiu.

BEKIM HAXHIU: Zoti Ymeri, thashë konstatimet e pasakta të juaja nëse nuk e ke kuptuar, dhe nuk mund të flasim për një grup të ekspertëve i cili e ka futur “Trepçën” në borxhe dhe ata të japin një strategji të saktë ose zhvillimore për “Trepçën” kur vetëm ai grup i ekspertëve e ka futur “Trepçën” në borxhe. Prandaj, çfarë ekspertësh janë ata të cilët mund të na japin një strategji zhvillimore kur në kohën e menaxhimit të tyre “Trepça është fut në borxhe 4 milionë e gjysmë euro? Dhe për të arriturat e këtij menaxhmenti flasin bilancet pozitive të “Trepçës” pas 30 vjetësh operimi. Dhe zhvillimi i “Trepçës”, rritja e punësimit të “Trepçës” bën që edhe të jetë më tutje joshëse në të ardhmen për investime të ardhme, konform kësaj strategjie që ka planifikuar Qeveria e Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Fjalën e ka zoti Muhamet Mustafa.

MUHAMET MUSTAFA: Ju faleminderit!

Unë e kërkoja fjalën në fillim që t’ju propozoj këtë debat për një dokument kaq të rëndësishëm ta bëjmë kur jemi më të disponuar për një debat krijues se është tepër vonë dhe jemi tepër të lodhur, unë po shoh që durimi po mungon për me qenë se kemi filluar debatin kisha lutur deputetët që të jenë të durueshëm dhe të kemi një debat sa më cilësor për këtë dokument kaq të rëndësishëm.

Unë e përshëndes aktivitetin e Ministrisë për përgatitjen e këtij dokumenti të rëndësishëm që duhet të përbëjnë një nga instrumentet kryesore për sigurimin e zhvillimit të qëndrueshëm të Kosovës. Zhvillimi i qëndrueshëm i Kosovës nënkupton tri komponentë: rritje afatgjate ekonomike, përfitim nga kjo rritje afatgjate ekonomike nga të gjithë qytetarët e Kosovës, jo vetëm nga grupe të caktuara, dhe tre përgjegjësi ndaj gjeneratave të ardhshme.

Nëse shtrojmë pyetjen sa u përgjigjet këtyre kriterëve ky dokument, sigurisht ka vend për diskutim edhe ka vend për përmirësime në disa pjesë të strategjisë edhe përmirësime bukur radikale.

Megjithatë në fillim dua të theksoj se dokumenti ka bërë një avancim në trajtimin e këtij sektori. Në pjesën hyrëse jep disa të dhëna, por është një ekzagjerim se kur e lexon

pjesën hyrëse thotë se na nuk duhet të punojmë asgjë veç duhet dhënë minierat në koncesion edhe do të jetojmë mirë.

Natyrisht që ky është një iluzion i madh dhe këtu ne duhet ta dimë që, megjithëse janë të gjithë këto pasuri ne kemi një territor të vogël me një dendësi të madhe të popullsisë dhe dendësia e madhe e popullsisë dhe kujdesi për njeriun dhe filozofia e zhvillimit qëndrueshëm pikërisht...

KRYESUESI: Ju lutem qetësi, mendoj që është me interes për të dëgjuar.

MUHAMET MUSTAFA: Pra, kujdesi për njeriun duhet të jetë pikënisje. Ajo ku ka një avancim në botëkuptime edhe që unë e përshëndes është se këtu përmendet shumë zhvillimi i qëndrueshëm dhe në këtë drejtim ka një trajtim më të avancuar se siç jemi mësuar në Kosovë lidhur me nevojën e përfitimeve për komunitetin dhe pjesëmarrjen e komunitetit që është esenciale.

Gjithashtu edhe mjedisi përmendet. Mirëpo, ky dokument ka probleme, u përmendën edhe disa probleme me strukturimin. Për shembull analiza SWOT duhet të jetë shumë më e thelluar dhe po të ishin përdorur këto faqe që janë pas SWOT-it, prej faqes 39 deri në faqen 45 e të futen në SWOT, politikat do të dilnin shumë më të mira.

Nën 2, është filozofia e zhvillimit të misioni. Sipas këtij dokumenti sektori mineral do të jetë forcë motorike e zhvillimit në Kosovë, natyrisht që ky është një iluzion. Mund të jetë pjesërisht faktor shumë i rëndësishëm, por forcë motorike sektori i minerareve nuk mund të jetë. Forcë motorike e zhvillimit të Kosovës janë vetëm njerëzit e Kosovës dhe ata sektorë që i inkuadrojnë popullatën e re të Kosovës .. në shërbime me vlerë të lartë shtuese, shërbimet minerare edhe prodhimet minerare zakonisht eksperiencat në botë flasin që nuk janë shërbime të tilla dhe nuk është mirë që ne në shekullin XXI kur ka avancuar aq shumë teoria e zhvillimit, të dalim me dokumente të tilla.

Në këtë drejtim natyrisht që ne kemi interes dhe duhet t'i shfrytëzojmë pasuritë por t'i shfrytëzojmë në atë që përmendet në dokument zhvillimi i qëndrueshëm, por zhvillimi i qëndrueshëm në ato tri komponentë që unë i theksova në fillim.

Prandaj, zotërinj deputetë,

Nëse duhet të debatojmë, debatojmë mirë, në qoftë se bisedojmë unë propozoj kryesuesin që të bëjë pauzë.

Edhe natyrisht pozita duhet të dëgjojë se duhet ta mbrojë këtë dokument në fund me vota, duhet të dijë çka po flitet këtu.

Prandaj, kjo është një çështje shumë serioze që neve na imponohet në diskutimet për strategjinë e zhvillimit të Kosovës dhe ne duhet të jemi në nivel të lartë, ne duhet patjetër, forca motorike e zhvillimit janë vetëm ata sektorë që e punësojnë rininë e Kosovës, e punësojnë në ata sektorë ku është vlera e lartë shtuese jo në miniera, edhe sepse minierat i kemi parë 20 mijë veta, dihet sa duhet të punësojë Kosova, Kosova çdo

vjet duhet për t'i punësuar 25 mijë vende të reje të punës, prandaj, s'mund të jetë forcë motorike.

Dy, analiza ekonomike është tepër e thjeshtësuar. Këtu përdoret një model i keq ... shumë i thjeshtësuar, improvizuar, kurse dihet se në këta sektorë duhet të përdoret metoda e kostove dhe përfitimeve apo metoda kos-benefit dhe atë edhe një varzion shumë më i avancuar i kësaj metode që e përfshin kostot dhe përfitimet ekonomike dhe sociale, dhe kjo mungon, ky është problemi serioz këtu.

Faktorët kufizues përmenden por nuk janë thanë, e faktorë kufizues janë dendësia e popullsisë.

Zotëri ministër dhe zotërinj deputetë,

Ju dine që njerëzit janë të lidhur me miniera, instrumentet e politikave janë jo të qarta dhe përgjithësimet. Unë e mbështes partneritetin publiko- privat PPI-në ajo domethënë koncesionet. Po ne kemi një problem me koncesione, ne kemi problem me koncesione, sepse ligjet duhet të rishqyrtohen në vijën e praktikave të avancuara ndërkombëtare. Ne kemi atje afate të stërzgjatura të dhënies me qira me mundësi të përsëritjes ku trekëndëshi, investitori, shoqëria dhe komuniteti nuk ka një balancim të interesave.

Prandaj, unë propozoj që strategjia në një të ardhme të afërt të shqyrtojnë në mënyrë kritike ligjet për minierat edhe Ligjin për partneritetin të shohim se cilat janë përvojat, sepse ne i kemi futur afatet koncesionit që janë të tejkaluara dy dekada e këndej janë tejkaluara, nuk ka afate 40 vjet, 99 vjet e tjera e tjera.

Prandaj, këto çështje duhet t'i marrim me seriozitet të madhe. Politikat e taniemave i ceknim por ne duhet të jemi precizë, çka është ajo, sa duhet të jetë tantiema dhe duhet të ceket, është cek mirë që duhet përfituar edhe komuniteti edhe ato. Domethënë unë po i ceki ku ka avancime, por avancimet janë ndalë me gjysmë fryme, në gjysmë hapi duhet shkuar më tutje. Transparenca për tantiemën. Ne edhe sot e kësaj dite në buxhet të Kosovës e dimë sa është tantiema, dhe në qoftë se ne nuk e dimë sa është tantiema se kemi qitë, qysh mundemi me pa transparencën ku po shkon tantiema? Ajo hala është e vogël fatkeqësisht sepse merrni vetëm shembullin e Feroniklit ku askush se dinë sa është tantiema. Ndoshta kishte qenë mirë për të na jepet ndonjë përgjigje definitivisht, është të privatizohet Feronikli, është dashtë mu privatizua vetëm ndërtesat edhe infrastruktura, por si duket investitori ka mendua që e ka privatizua edhe atë që s'mund ta privatizoj pasurinë minerare, për atë pasuri sa paguan Feronikli taksë Kosovës, duhet me thënë haptas. Edhe çka po bënë me ambientin mandej. Prandaj, të gjithë këto janë çështje shumë të rëndësishme, është bërë një hapë i rëndësishëm ministrisë. Unë e lus ministrin edhe e lus Komisionin edhe i lus të gjithë të tjerë që nga ky dokument ta ripunojnë strategjinë një kohë të shkurtë brenda një muaji të sjellim dhe të aprovojnë një dokument që po them që është një hapë i mirë por mund të përmirësohet shumë edhe sepse nga serioziteti ynë në trajtimin e këtij dokumenti do të varet ku është Kosova a është në ato vende kur resurset janë mallkim apo është në ato vende kur resurset janë bekim.

Sot në botë shumica e vendeve që janë të pasura me resurse këtu qysh i kemi rëndësi në nja 10 – 15 faqe janë në vendet ku resurset paraqesin mallkim sepse jetojnë në iluzionin se me miniera mund të zhvillohet, me miniera mund të zhvillohen vetëm nëse është shteti ligjor. Nëse është ballansuar interesi publik dhe interesi i investitorit nëse e ka transparencën në shfrytëzim.

Dhe, bekimi i resurseve janë vendet që numërohen në gishta. Prandaj, ne duhet të kemi kujdes që këto pasuri domethënë vërtetë ne të radhitemi në vende të cilat resurset paraqesin një bekim. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Mustafa!

Fjalën e ka kryetari i Grupit Parlamentar të LDK-së, zoti Beqiri!

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Njëkohësisht nënkryetar,

Duke pa realisht gjithë diskutimet dhe divergjencën por edhe shumë të meta që i ka kjo strategji. Unë kërkoj në emër të Grupit Parlamentar, që ky është një mocion që unë po kërkoj të shtyhet, ta debatojmë nëse është e nevojshme vetëm një pikë kjo të jetë sepse është e rëndësishë së veçantë dhe unë kërkoj në emër të Grupit Parlamentar që kjo pikë t'i kthehet në rishqyrtim Qeverisë dhe ky është mocion. Të cilën kërkojmë mirëkuptim që ta përkrahin edhe të tjerët në të kundërtën ne nuk do të marrim pjesë në votim. Faleminderit! Do të lëshojmë seancën.

KRYESUESI: Faleminderit!

Unë konsideroj mocionin. Fjalën e ka kryetari i Grupit Parlamentar të PDK-së, në emër të Grupit Parlamentar të deklarohet “për” ose “kundër” mocionit.

ADEM GRABOVCI: Ismet, me gjithë respektin e madh që e kam për ty këtë pikë të rendit ne mendojmë që duhet të përfundojmë dhe duhet të votojmë sepse kjo strategji është shumë e rëndësishme dhe ne duhet të ecim përpara. Faleminderit!

KRYESUESI: Nga Grupi Parlamentar i “Vetëvendosjes” zoti Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Faleminderit, zoti kryesues!

Ne e përkrahim mocionin e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës. Vërtetë është një dokument shumë i rëndësishëm për të ngutur kështu, ne edhe në Komision edhe nuk e përmenda fjalën time, edhe në Komision ka kaluar kështu kjo strategji domethënë shkel e shko pa kurrfarë debati të mirëfilltë. Dhe mendojmë që me qenë se është strategjia për sektorin më të rëndësishëm të zhvillimit ekonomik të Kosovës nuk ish kon deshtë mu ngutë dhe me e trajtua në këtë mënyrë kaq jo serioze.

Prandaj, nëse presim edhe një muaj edhe e miratojmë pastaj nuk është se do të humbë shumë Kosova. Mirëpo me këtë strategji do të humb shumë Kosova.

KRYESUESI: Faleminderit!

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, zoti Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Me gjithë respektin mendoj se nuk është praktikë e mirë sa herë që të shohim që një ligj ose një strategji mund të mos kalojë ta tërheq. Mendoj se mundemi me votua “kundër” edhe kur votohet “kundër” vjen herën tjetër. Nëse nuk i ka votat koalicioni në pushtet duhet me i mbledhë deputetët e vetë edhe me i prua këtu. Nuk kemi nevojë ne sa herë ta shohim që s’po donë me kalua strategjia me e shty. Faleminderit!

KRYESUESI: Mendoj që nuk ishte ashtu, se e kundërta.
Deputetja Selmani e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Kërkoj ndjesë, në rast se Grupi Parlamentar i LDK-së ka deshtë që kjo të shtyhet është dashtë në fillim të merret fjala dhe thuhet ky debat të vazhdon nesër dhe jo në përfundim të debati në mënyrë më të mirë kolegjiale po ju them, jo tash kur përfundoj gjithë debati tash shtyhet. Në rast se jeni t’i qesim rekomandimet unë edhe gjatë fjalimit tim thash po i qesim rekomandimet për këtë strategji të miratohet me këto rekomandime edhe profesori Muhamet Mustafa, iu dha rekomandimet çfarë ju duhet. Në rast mendoni që duhet me votuar mirë, në rast se mendoni që nuk duhet të votoni prapëseprapë është e drejta e juaj si deputetë.

KRYESUESI: faleminderit!
SLS-ja, zoti Millosavleviq.

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala, gospodine predsedavajući!
I mi smo protiv odlaganja ove tačke, želimo da se završi sve večeras.

KRYESUESI: Grupi “6+”, nuk ka të lajmëruar.
Zoti Kinolli.

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, nënkryetar!
Edhe ne si Grup Parlamentar “6+” jemi “kundër” shtyrjes së kësaj pike, dëshirojmë që sot kjo të kryhet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!
Atëherë e qes në votim mocionin e propozuar nga Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike që t’i kthehet Qeverisë për një afat kohor të caktuar me qëllim që të ripunohet në bazë të vërejtjeve. E vë në votim, mirë është po votojmë me elektronikë më mirë, më lehtë edhe me u bë numërimi. Në qoftë se ka pa elektronikë atëherë le të lajmërohet kush s’ka kartelë. Faleminderit!

E hedh në votim propozimin, po e përsëris edhe një herë të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, me mbështetjen e Grupit Parlamentar të “Vetëvendosjes”, Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës.

Bëhuni gati për votim, në sallë janë 82 deputetë, votojmë tash.

Miratohet mocioni.

Të nderuar deputetë,

Veç edhe një minutë ju lus edhe një minutë për qetësi.

Uluni një sekondë, se desha në emër të kryetarit dhe Kryesisë së Kuvendit t'ua uroj të gjithëve Krishtlindjet, Vitin e Ri, të gjitha bashkë dhe desha t'iu falënderoj të gjithëve për bashkëpunimin në sesionin vjeshtor.

Seanca e sotshme është edhe përfundimi i sesionit vjeshtor, sesioni pranveror fillon të hënën e tretë të muajit janar, që do të thotë më 16 janar.

Faleminderit! Mirupafshim!

Përgatiti:

Njësia për Transkripteve e Kuvendit të Kosovës